



Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë

Buletini Shkencor

Nr 8, Vol 1, Numër Special - 2025
ISSN 3005-8473

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

BULETINI SHKENCOR

Numër 8, Vëllimi 1, Numer Special- 2025
ISSN 3005-8473

Email: botimeuv@univlora.edu.al
Shtator 2025

Bordi Editorial :

1. Prof.Dr. Aurela Saliaj (Editor-in-chief)
2. Prof.asoc. Denada Sota (Technical and Natural Science Section Editor-in-chief)
3. Prof.asoc. Florian Miti (Economic Section Editor-in-chief)
4. Prof.asoc. Kozeta Hyso (Education Section Editor-in-chief)
5. Prof.asoc. Enkelejd Mëhilli (Health Section Editor-in-chief)

Redaktor menaxher i Buletinit Shkencor:

1. Mrs.Alberta Breshanaj

Bordi Shkencor:

Seksioni I Shkencave Teknike dhe Natyrore

1. Prof.asoc. Hajdar Kiçaj
2. Dr. Ermal Xhelilaj
3. Dr. Ogerta Gjermëni
4. Prof.asoc. Ermal Feleqi
5. Prof.asoc. Luljeta Gushta
6. Dr. Marinela Muço
7. Dr. Dezdemonë Gjylapi

Seksioni i Ekonomise

1. Prof. Dr. Evelina Bazini
2. Prof. Dr. Elenica Pjero
3. Prof. asoc. Fjoralba Velaj
4. Prof. asoc. Xhiliola Agaraj
5. Prof .asoc. Ilirian Lipi
6. Dr. Amalia Çipi
7. Dr. Dorjana Feimi
8. Dr. Arben Hysi
9. Dr. Enida Pulaj
10. Dr. Shkëlqim Sinanaj
11. Dr. Rezarta Brokaj
12. Dr. Rezarta Hasanaj
13. Dr. Sonila Berdo
14. Prof. Dr. Albert Qarri
15. Dr. Klaudja Guga
16. Prof. asoc. Filloreta Madani
17. Dr. Migena Petanaj

18. Dr. Lorena Cakërr
19. Dr. Blerina Dervishaj

Seksioni i Edukimit

1. Prof.Dr. Roland Zisi
2. Prof.Dr . Bardhosh Gaçe
3. Prof.asoc.Monika Hasani
4. Prof.asoc. Artan Xhaferaj
5. Prof.asoc. Gladiola Elezi
6. PhD. Esmeralda Laci
7. Phd. Ilva Lamaj
8. Prof.asoc. Aleks Trushaj
9. Prof.asoc. Petrit Taraj
10. Prof.asoc. Kozeta Hyso
11. Prof.Dr. Armela Panajoti
12. Prof.asoc. Frosina Londo (Qyrdeti)
13. Prof.asoc. Meri Gjoleka
14. Prof.asoc. Bledar Toska
15. Prof.asoc. Veneranda Hajrulla
16. Prof.asoc. Evis Celo
17. Prof.asoc. Zamira Alimemaj
18. Prof.asoc.Ilda Kanani

Seksioni i Drejtesise

1. Prof.asoc. Jonida Mehmeti
2. Prof.asoc. Stela Meçaj
3. Phd. Ilir Kanaj
4. Phd. Erjon Hitaj

Seksioni i Shendetit

1. Prof.asoc. Rezarta Lalo
2. PhD. Juljana Xhindoli
3. Prof.asoc. Majlinda Zahaj
4. Prof.asoc. Mimoza Çanga
5. Dr. Denada Selfo
6. Dr. Evis Allushi
7. Prof.asoc. Fatjona Kamberi
8. Prof.asoc. Petraq Mustaqe
9. Dr. Glodiana Sinanaj

Përmbajtja e këtij buletini përfshin punime akademike të realizuara nga studentë të drejtësisë, të cilat trajtojnë çështje themelore dhe bashkëkohore të së drejtës, duke përfshirë të drejtën kushtetuese, civile, penale dhe ndërkombëtare. Punimet pasqyrojnë aftësitë analitike, interpretimin juridik dhe nivelin e formimit profesional të studentëve, si dhe angazhimin e tyre në kërkimin shkencor.

Përmbajtja

SEKSIONI I STUDENTEVE

BULLIZIMI KIBERNETIK

Ana Isufaj..... 7

NAVIGIMI I TË DREJTAVE TË KONSUMATORIT : RRUGA E SHQIPËRISË DREJT INTEGRIMIT EVROPIAN

Bianka Kananaj..... 18

PARIMI I EFEKTIT TË DREJTPËRDREJTË NË JURISPRUDENCËN E BE-së:THEMELIMI , EVOLUCIONI DHE IMPAKTI LIGJOR NË PRAKTIKEN GJYQËSORE TË SHTETEVE ANËTARE.

Blerina Canaj..... 30

TRAJTIMI I TË MITURVE NË NJË QASJE KRAHASIMORE NDËRMJET RENDIT JURIDIK SHQIPTAR DHE ATIJ EVROPIAN

Elisa Beke..... . 42

NDËRMJETËSIMI NË FUSHËN E TË DREJTËS FAMILJARE

Joana Sherifi..... 58

E DREJTA PËR T’U HARRUAR

Kesjana Stamati..... 74

KONTRATAT VIRTUALE: FUQIA DHE ZBATUESHMËRIA E TYRE

Migena Memaj..... 89

LIGJI DHE E DREJTA PËR ARSIM

Taulant Brisku..... .104

ZBATIMI I GARANCIVE LIGJORE NË RASTET E BIRËSIMIT SURROGATIV

Shefqet Hoxha..... 116

EKSTRADIMI DHE LLOJET E TIJ

Lidia Agalliu..... 130

EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE: PROBLEMATIKAT

Erisa Jaupi..... 141

INSTITUTI I MARTESËS NË RASTIN E VDEKJES SË PREZUMUAR TË BASHKËSHKORTIT

Enerjeta Jançaj..... 156

SEKSIONI I STUDENTËVE

Bullizmi Kibernetik

Ana Isufaj

Program i Integruar i Ciklit te dyte "Master i Shkencave ne Drejtesi"

Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Besiana Petanaj

Fakulteti i Shkencave Humane

Univeristeti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstrakti

Bullizmi është një nga problematikat e shoqërisë moderne i cili nuk prek vetëm të rinjtë por të gjitha moshat. Me avancimin e teknologjisë dixhitale është rritur edhe fenomeni i bullizimit, i cili është i pranishëm në çdo vend dhe kohë. Nëpërmjet këtij punimi synohet të jepet një nocion rreth bullizmit kibernetik, mënyrës se si realizohet ai. Analizimi i pasojave psikologjike, dhe patologjike që shkakton kiberbullizmi, me qëllim parandalimin e saj. Studimin e kuadrit ligjor për bullizmin kibernetik, sipas akteve të Bashkimit Evropian si dhe evidentimi i problematikave në lidhje me identifikimin, trajtimin dhe parandalimin e rasteve të kiberbullizmit. Çfarë masash parandaluese dhe ndëshkuese mund të merren? Cilat mjete legjislative dhe mjete juridike duhet të merren parasysh për të siguruar që viktimat nuk mund të ngacmohet më dhe se dhunuesi nuk do të vazhdojë me sjelljen e tij/saj. Viktimat e bullizmit kibernetik duhet të

mbrohen dhe t'u jepen mjetet e nevojshme për të mbrojtur veten nga ngacmimi. Ngacmuesi duhet trajtuar në mënyrë të tillë që ai/ajo të shihet si një person i tërë, dhe jo vetëm veprimet apo veprat e tij/saj. Motivimi për këtë punim shkencor është që të gjendet themeli ku ligji dhe psikologjia të gjejnë pikat e përbashkëta për të gjetur një zgjidhje sesi të menaxhojmë një fëmijë të përfshirë dhe në procesin e politikave të zhvillimit, legjislacionit, dhe masave restorative të cilat kultivojnë një shoqëri ku ka respekt reciprok për dinjitetin dhe të drejtat e tjera të njeriut.

Fjalët kyçe: bullizëm, bullizmi kibernetik, krim, akte ndërkombëtare, e drejtë.

Abstract

Bullying is one of the problems of modern society which affects not only young people but all ages. With the advancement of digital technology, the phenomenon of bullying has increased, which is present in every place and time. This paper aims to give a notion about cyberbullying, how it is realized. Analysis of the psychological, and pathological consequences caused by cyberbullying, in order to prevent it. Study of the legal framework for cyberbullying, according to the acts of the European Union as well as the identification of problems related to the identification, treatment and prevention of cases of cyberbullying. That preventive and punitive measures can be taken? What legislative tools and remedies should be considered to ensure that the victim can no longer be bullied and that the bully will not continue with his / her behavior. Victims of cyberbullying must be protected and given the tools they need to protect themselves from being bullied. The bully should be treated in such a way that he/she is seen as a whole person, and not just his/her actions or deeds. The motivation for this scientific research is to find the foundation where law and psychology find common ground to find a solution to how to manage a child involved in the process of development policies, legislation, and restorative measures that cultivate a society where has mutual respect for dignity and other human rights.

Keywords: *bullying, cyber bullying, crime, international acts, law*

Nocioni i bullizmit kibernetik

Bullizmi kibernetik nuk ka një nocion unik për të cilën të jetë rënë dakort ndërkombëtarisht. Mungesa e një nocioni unik të kimit kibernetik, përbën shkak që kiberbullizmi ose siç quhet ndryshe bullizmi kibernetik të shihet në këndërvështime të ndryshme. Përcaktimi i nocionit të kiberbullizmit bëhet në varësi të vendit, rajonit, kuadrit ligjor dhe praktikës që ndjek një shtet në lidhje me krimin kibernetik. Megjithatë, përpjekjet për të përcaktuar këtë fenomen janë bërë nga organizatat ndërkombëtare, nga institucionet e BE-së dhe nga rradhët e akademikëve. Komisioni

Evropian e përkufizon bullizmin kibernetik si: *"ngacmim të përsëritur verbal ose psikologjik të kryer nga një individ ose një grup ndaj të tjerëve nëpërmjet shërbimeve online dhe telefonave celularë"*¹ Përgjithësisht bullizmi kibernetik kuptohet si ngacmim që ndodh në internet. Sipas Komisionit, bullizmi kibernetik ndryshon nga bullizmi ballë për ballë në aspekte të ndryshme si anonimiteti që ofron interneti, kapaciteti për të arritur një audiencë më të gjerë, mungesa e ndjenjës së përgjegjësisë së autorëve dhe gatishmëria e viktimave për të raportuar incidentet.⁶

Nga ana tjetër, ngacmimi kibernetik përshkruhet si "një manifestim modern i ngacmimit që kërkon përgjigje urgjente dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës, si faqet e rrjeteve sociale, ofruesit e internetit dhe policinë".²

Pavarësisht dallimeve që ekzistojnë ndërmjet përkufizimeve të kiberbullizmit, artikujt shkencorë si dhe praktika ka evidentuar tiparet

¹ European Commission, 'Safer Internet Day 2009: Commission starts campaign against cyber-bullying' Press Release, (10 February 2009) ⁶ Po aty.

² http://ec.europa.eu/justice/fundamental-rights/rights-child/eu-agenda/index_en.htm

⁸ poldepcitizens@europarl.europa.eu

e përbashkëta të kiberbullizmit që përdoren për të përcaktuar këtë term. Elementët që janë identifikuar si tipare të përbashkëta të kiberbullizmit janë si; përdorimi i mjeteve elektronike ose dixhitale, synimi për të shkaktuar dëm, ndjenja e anonimitetit dhe mungesës së llogaridhënies së abuzuesve si dhe publiciteti në veprime.⁸ Janë pikërisht këto elemente në të cilën shtetet janë referuar për të përcaktuar nocionin e bullizmit kibernetik. Edhe pse këto elemente janë të përbashkëta përsëri ky nocion është i ndryshëm në shtetet të ndryshme.

P.sh. Në Holandë, ngacmimi kibernetik përkufizohet si *"një formë e ngacmimit tradicional që kërkon përdorimin e mjeteve elektronike"*.³ Në mënyrë të ngjashme, në Itali kiberbullizmi shihet si *"manifestimi në internet i bullizmit, duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit"*.⁴ Në Austri, bullizmi kibernetik përkufizohet si 'fyerje, kërcënim, denoncim ose ngacmim i qëllimshëm me anë të mjeteve të komunikimit si celulari apo interneti'.⁵ Në Finlandë, ngacmimi në internet përfshin *'fyerjen e viktimës në një forum diskutimi ose dërgimin e emaileve të pabaza ose të pabaza për viktimën'*.⁶ Megjithëse në literaturë ekzistojnë shumë përkufizime të

ndryshme të bullizmit kibernetik, shumica e akademikëve e përkufizojnë atë si *"një akt ose sjellje agresive që kryhet duke përdorur mjete elektronike nga një grup ose një individ në mënyrë të përsëritur dhe me kalimin e kohës kundër një viktime që nuk mund ta mbrojë veten lehtësisht"*.⁷ Vitet e fundit, disa akademikë kanë argumentuar se bullizmi kibernetik mund të mos jetë termi më i përshtatshëm për të përshkruar sjelljet abuzive të kryera nëpërmjet përdorimit TIK.⁸ Nga rradhët e akademikëve është hedhur ideja që në vend të nocionit bullizëm kibernetik të përdoret termi *"agresion kibernetik"*, pasi është një nocion më i gjerë dhe përfshin një grup më të gjerë abuzimesh që mund të ndodhin në rrjet.⁹ Agresioni kibernetik përkufizohet si *"dëm i qëllimshëm i shkaktuar nga përdorimi i mjeteve elektronike ndaj një personi ose një grupi njerëzish, pavarësisht nga moshë e tyre, të cilët i perceptojnë akte të tilla si fyese, nënçmuese, e dëmshme ose e padëshiruar"*.¹⁰ Me fjalë të tjera, agresioni kibernetik përfaqëson një nocion ombrellë të ngacmimit elektronik pa kërkuar elementet e çekuilibrit të fuqisë ose akte të përsëritura. Në të kundërt, ngacmimi kibernetik perceptohet si një koncept i kufizuar në ngacmimin përmes TIK-ve dhe që nuk mbulon sjellje të tjera agresive si p.sh hakimi i profilit të mediave sociale të dikujt. Ky koncept tregon një

3

<https://www.ncj.nl/richtlijnen/jgzrichtlijnenwebsite/detail-s-richtlijn/?richtlijn=1&rlpag=365>.

⁴ Italian Ministry of Education and Research (MIUR), Guidelines for the prevention of bullying and cyberbullying at schools' level (Linee di orientamento per azioni di prevenzione e di contrasto al bullismo e al cyberbullismo), 2015, MIUR-Prot. no. AOODGSIP 2519).

5

<https://www.help.gv.at/Portal.Node/hlpd/public/content/172/Seite.1720710.html,%20last%20access:%2003/03/2016>

⁶ <https://www.suomidigi.fi/ohjeet-ja-tuki/vahti-ohjeet>.

⁷ ["Cyberbullying involves the use of information and communication technologies to support deliberate, repeated, and hostile behaviour by an individual or group that is intended to harm others." -Bill Belsey.](#)

⁸ Grigg, D. (2010). Cyber-Aggression: Definition and Concept of Cyberbullying. *Australian Journal of Guidance and Counselling*, 20(2), 143-156. doi:10.1375/ajgc.20.2.143.

⁹ ["Cyberbullying involves the use of information and communication technologies to support deliberate, repeated, and hostile behaviour by an individual or group that is intended to harm others." -Bill Belsey](#)

¹⁰ Grigg, D. (2010). Cyber-Aggression: Definition and Concept of Cyberbullying. *Australian Journal of Guidance and Counselling*, 20(2), 143-156. doi:10.1375/ajgc.20.2.143 ¹⁷ Po aty.

formë agresioni social mes dy personave që zakonisht njihen me njëri-tjetrin, prandaj rrezikon të mos mbulojë situatat ku të huajt kryejnë akte të bullizmit kibernetik.¹⁷

Hipotezat e punimit tim janë:


1. Viktimat e bullizmit kibernetik priren të kenë vetëbesim më të ulët se ata që nuk përfshihen në bullizëm kibernetik.
2. Bullizmi kibernetik ka një gamë të gjerë pasojash psikologjike, shëndetësore dhe fizike duke i ndjekur viktimat e bullizimit, gjatë gjithë jetës së tyre.

Zëri i së vërtetës: Anketa, Dëshmi dhe Përvoja personale

Anketa: Si e perceptojnë të rinjtë bullizmin?

Për të kuptuar më mirë përciptimin e të rinjve për bullizmin dhe shkallën e përhapjes së tij, u zhvillua një anketim 100 pjesëmarrës, të grupmoshave të ndryshme ku vetëm 50 prej tyre pranuan të jepnin opinionin e tyre gjë që la shumë për të dëshiruar.


Gjinia
50 responses




Pjesëmarrësit:

74% femra
26% meshkuj

Moshë
50 responses




A keni përjetuar ndonjëherë bullizim?
50 responses



Nga pyetja e ngritur shifrat janë alarmante:

86% të pjesëmarrësve e kanë përjetuar bullizmin
14% të pjesëmarrësve nuk e kanë përjetuar

Çfarë lloji të bullizmit keni përjetuar?
47 responses




Nga rezultatet e mësipërme, ngacmimet më të përhapura janë:

Rezultatet më të larta i kryeson “ngacmimi kibernetik” me 31.9%

- “Ngacmimi verbal” me 29.8%
- “Ngacmimi social” me 27.7%


- “Ngacmimi fizik” me 10.6%

Nga cilët jeni ndjerë të bullizuar?
46 responses




Nga këto rezultate shohim se bullizmi është më shumë i përhapur në rang shoqëror ku nga përgjigjet e grumbulluara: të ndjerit i/e bullizuar nga shokët/shoqet janë 73.9% Nga përgjigjet e grumbulluara rezultojnë që edhe mësuesit hyjnë në rangun e bullizuesve me 15.2% .Gjithashtu janë të renditur edhe familjarë me 6.5% dhe kolegët me 4.3% Ndërsa prindërit dhe psikologët me 0%

Sa shpesh keni përjetuar të bullizoheni?
46 responses



Duke parë rezultatet e këtij grafiku dalim në përfundimin që të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë anketim e kanë përjetuar bullizmin. Shifrat më të mëdha i mban alternativa “disa herë” me 63% Më pas vazhdon alternativa “një herë” me 23.9% dhe duke u ndjekur nga alternativa “shpesh herë” me 10.9%, e në fund alternativa “vazhdimisht” me 2.2%

Ku ka ndodhur bullizmi?
47 responses




Me rezultatet e këtij grafiku dalim në një përgjigje ku “burimi” kryesor i bullizmit është ambienti nëpër shkollë me 74.5%

Burim tjetër është dhe interneti ku të rinjtë e sotëm kanë goxha akses, i cili përbën 10.6% të përgjigjeve të grafikut. Përjetim të bullizmit kemi edhe në ambientet e punës e cila zë një vend prej 4.3% të përgjigjeve si dhe në lagje prej 2.1%.

Ajo që të lë vend për të diskutuar është alternativa “në një ambient tjetër” e cila zë vendin prej 8.5% të përgjigjeve, ndryshe nga alternativat e tjera që i kemi hasur shpesh herë në realitetin tonë. Na lë të kuptojmë që bullizimi po përhapet dhe nëpër vende të tjera që ne mund të frekuentojmë siç mund të jetë një ambient lokal, apo një park lojërash për fëmijët etj.

A e keni raportuar ndonjëherë bullizmin?
48 responses



Ajo që unë do të doja të diskutoja në rezultatet e këtij grafiku janë rezultatet e alternativës “Jo”, edhe pse shifrat e përjetimit të bullizmit ishin të larta në të njëjtën kohë janë të larta

shifrat për mos raportimin e bullizmit, ku lind dhe pyetja që çfarë mund ta step dikë.?

Dhe padiskutim që një pyetje e tillë iu bë personave të cilët iu drejtua dhe anketa ku përgjigjet e tyre ishin:

Frika

Asgje

Kam patur frike se mos me gjykonin ose nuk me kuptonin

Nuk do me besonin ose nuk do benin asgje

Po me eshte dukur e kote

Sepse kam menduar se ata qe bullizojne jane po ata qe jane te pasigurt ne vetvete

Frika ,pasiguria

Posti ku ndodheshin

Sme ka stepur thjesht ja kam kthyer pergjigjen.

Me ka stepur frika se bullizuesit do te me bullizonin me shume pas raportimit tim.

Thjesht e kam kaluar me veten time

Ishte periudhe kalimtare pa pasoja ndaj dhe skam raportuar gje

Mentaliteti kam menduar se do kaloj

Te pasurit frike ose mbyllesha ne vetvete. S'kam pasur informacion ne ate kohe.

Kam qen femij nuk dija si te reagoja e kam zgjidhur vete.

Isha e frikësuar, dhe ndjehesha sikur raportimi im do te ishte i kote, dhe gjithçka do te vazhdonte njesoj.


Thjesht e kam anashkaluar

Pra dalim në përfundimin që “Frika” është ajo që i ndalon më shumë për ta raportuar, mendojnë se janë më të dobët dhe nuk kanë forcën për të ngritur zërin e për tu dëgjuar. Një nga përgjigjet që më ra më shumë në sy ishte “S’kam pasur informacion në atë

kohë”, që do të thotë që bullizmi nuk është trajtuar si një temë e rëndësishme dhe me ndikim të madh në jetën/psikologjinë e dikujt, por si një “lojë mes fëmijëve”

Për tu vlerësuar janë edhe ata që e kanë raportuar bullizmin, por lind pyetja ku e gjejnë më së shumti mbështetjen për tu ndjerë të përkrahur dhe për tu dëgjuar.?

Nëse po, kujt ja keni raportuar?
23 responses




Nga 28 përgjigje të mbledhura, rezultojnë se mbështetja më e madhe kërkohet dhe jepet nga miqtë (39.3%), të ndjekur nga prindërit (32.1%), dhe më pas vëllezërit/motrat më të mëdhenj (21.4%).

Vetëm 7.1% e viktimave janë drejtuar tek mësuesit, që do të thotë se shkolla nuk perceptohet si një mjedis i sigurt për të kërkuar ndihmë. Ky rezultat është shqetësues, pasi mësuesit janë ndër figurat që kalojnë më shumë kohë me nxënësit dhe që, në mënyrë ideale, duhet të jenë të parët që identifikojnë dhe ndalojnë bullizmin.

Fakti që nxënësit preferojnë të flasin me bashkëmoshatarët apo familjarët, por jo me figura autoriteti, mund të tregojë:

- mungesë besimi tek sistemi shkollor,
- mungesë ndërhyrjeje të mëparshme,
- frikë nga stigmatizimi apo ndëshkimi.

Si shtë ndikuar mirëqenia juaj nga bullizmi?
47 responses


Një nga rezultatet më tronditëse të anketës lidhet me ndikimin emocional që ka pasur bullizmi tek individët. Nga 47 të anketuar: 31.9% deklarojnë se janë ndjerë të trishtuar, 25.5% kanë përjetuar ankth, dhe 14.9% kanë humbur vetëbesimin.

Shqetësuese është gjithashtu përqindja e atyre që kanë pranuar se kanë menduar t'i bëjnë keq vetes (14.9%), çka flet për pasojë shumë të thella dhe të rënda psikologjike.

Veçanërisht alarmante është grupi prej 2.1% që kanë raportuar një kombinim të tre simptomave: ndjesi trishtimi, ankth dhe dëshirë për të dëmtuar veten.

Kjo përqindje, ndonëse numerikisht e vogël, është simbol i atyre rasteve të rënda që mund të përfundojnë në bullicid (vetëvrasje për shkak të bullizmit).

Fakti që vetëm 10.6% raportojnë se bullizmi nuk ka ndikuar aspak, tregon se në shumicën dërrmuese të rasteve, ai lë gjurmë të thella në mirëqenien mendore të të rinjve.

A ke qenë ndonjëherë dëshmitar i një bullizmi?
49 responses


Një tjetër tregues i fortë në anketim ishte pyetja nëse të rinjtë kanë qenë ndonjëherë dëshmitarë të një rasti bullizmi. Përgjigjet tregojnë se 93.9% e të anketuarve kanë qenë të pranishëm ose kanë parë një formë bullizmi, ndërsa vetëm një përqindje shumë e vogël, 6.1%, nuk e ka përjetuar këtë situatë si vëzhgues.

Ky rezultat është tregues i përhapjes ekstreme të bullizmit në mjediset ku jetojnë dhe mësojnë të rinjtë.

Por më shqetësues është fakti se ndonëse shumica janë dëshmitarë, shumë pak reagojnë ose raportojnë rastet. Kjo tregon një kulturë të heshtjes, frikës apo indiferencës, që në vetvete e mban gjallë bullizmin.

Ky grup i tretë – dëshmitarët – ka një rol thelbësor në ndërprerjen e bullizmit, dhe ndërgjegjësimi i tyre është po aq i rëndësishëm sa mbështetja për viktimat apo ndëshkimi i agresorëve.

Nëse po, si keni reaguar?
48 responses



Siç shihet, pjesa më e madhe e të anketuarve, përkatësisht 72.9%, kanë pohuar se kanë ndihmuar viktimën. Kjo është një tregues inkurajues që reflekton ndjeshmërinë dhe përgjegjësinë qytetare që disa individë tregojnë ndaj padrejtësive që ndodhin në mjedise sociale apo virtuale. Ndiham ndaj viktimës në rastin e bullizmit kibernetik mund të shprehet në forma të ndryshme, si mbështetje emocionale, mbrojtje publike në komente, apo përmes raportimit të përmbajtjes ofenduese.

Megjithatë, 18.8% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se nuk kanë bërë asgjë, një përqindje që nuk duhet neglizhuar, pasi ajo nxjerr në pah një pasivitet që mund të përkeqësojë situatat e bullizmit, veçanërisht në hapësirat virtuale ku ndihma shpesh kërkon vetëm disa klikime, por ndjenja e përgjegjësisë është më e zbehur. Një pjesë e vogël e të anketuarve, vetëm 4.2%, kanë raportuar rastin e bullizmit, çka tregon se megjithëse ekzistojnë mekanizma për ta ndaluar atë, ndërgjegjësimi dhe përdorimi i tyre është ende i kufizuar. Po aq përqindje, pra 4.2%, kanë pranuar se e kanë inkurajuar bullizuesin, një sjellje që në kontekstin e bullizmit kibernetik mund të përfshijë ndarjen e përmbajtjes ofenduese, komente mbështetëse për bullizuesin ose thjesht "pëlqime" në postime që dëmtojnë viktimën.

Ky grafik pasqyron qartë kompleksitetin e reagimeve ndaj bullizmit dhe sidomos thekson rëndësinë që ka roli i spektatorit në ndalimin ose përforcimin e këtij fenomeni. Në kuadrin e bullizmit kibernetik, ku ndërveprimi ndodh në hapësira virtuale, reagimet e tilla marrin një dimension edhe më të rëndësishëm, pasi ato mund të ndikojnë në përshkallëzimin e dhunës psikologjike ose në mbrojtjen e viktimës përmes solidaritetit online. Për rrjedhojë, analizimi i këtij grafiku kontribuon në kuptimin më të thellë të faktorëve shoqërorë që ndikojnë në zhvillimin dhe përballimin e bullizmit në epokën digjitale.

Në fund të anketimit pjesëmarrësit iu përgjigjën dhe pyetjeve të mëposhtme:

Çfarë mendoni se duhet të bëhet për ta parandaluar bullizimin?

- *Duhet të krijohen ligje në mënyrë që ky fenomen mos të perhapet me shume.*
- *Që ngacmimi, bullizmi të parandalohet duhet që çdo femije sa është ende i vogël, i cili është ende në fazën e rritjes, në fazën e zhvillimit, duhet të edukohet mire dhe prindërit duhet të mesojnë shume gjera në lidhje me shoqërinë, se çfarë duhet të bëjë dhe të mos të bëjë, dhe fëmija e kupton sa është i vogël se çfarë është gjeja e drejte dhe e gabuar.*
- *Për të parandaluar bullizmin duhet: të rritet ndërgjegjësimi, të mbështeten viktimat, të ketë rregulla të qarta, të ndërhyhet menjëherë dhe të promovohet respekti.*
- *Duhet të krijohen ligje se ndryshe forma të tjera parandaluese nuk ka .Për të parandaluar ngacmimin, duhet të ndërmerren hapa në disa nivele: individual, shoqëror dhe institucional.*

- *Edukimi me i mire i familjes*
- *Duhet te behen ore te vecanta neper shkolla qe femijet te sensibilizohen qe te vegjel*

Shoqëri që qesh përballë një tragjedie

Në kuadër të këtij punimi kam analizuar një video-reportazh të realizuar në një gjimnaz shqiptar, ku disa nxënës intervistohen pas vetëvrasjes së një shoqeje të klasës së tyre. Vajza kishte qenë viktimë e bullizmit për një kohë të gjatë, ndërsa ngjarja u bë publike vetëm pasi ajo vendosi t'i japë fund jetës.

Ajo që më tronditi më shumë në këtë video nuk ishte vetëm tragjedia në vetvete, por mënyra si nxënësit reagues ndaj saj. Shumë prej tyre nuk shfaqnin asnjë lloj ndjeshmërie, madje qeshnin, e konsideronin si "teprim", ose thoshin me nënqeshje "ishte pak e ndjeshme". Disa e justifikonin sjelljen e tyre si "shaka që bëjmë gjithë ditën".

Ky reagim tregon një mungesë të thellë edukimi emocional dhe human. Në vend të reflektimit, dominonte ironia. Në vend të pëndësës, shfaqësimi. Kjo është alarmuese – jo vetëm për vetë rastin, por për faktin se shumë të rinj nuk arrijnë të kuptojnë peshën e fjalëve dhe veprimeve të tyre.

Ky është një nga rastet që në literaturën ndërkombëtare quhet bullicid – vetëvrasje si pasojë direkte e bullizmit. Dhe për mua, kjo video është prova më e dhimbshme se bullizmi nuk është fjalë boshe në një faqe libri – por një realitet që vret në heshtje, ndërkohë që të tjerët rrinë e qeshin.

Duhet te behen ore te vecanta neper shkolla qe femijet te sensibilizohen qe te vegjel

Historia ime personale: Nga përçmimi te zëri im.

Ky punim nuk është thjesht një analizë akademike. Për mua, kjo temë është personale. Kam qenë vetë viktimë e bullizmit në shkollë për katër vite me radhë, që nga klasa e gjashtë, në vitin 2013. Në atë kohë, në klasën tonë u bashkuan disa nxënës të rinj, dhe pikërisht nga ta filloi ajo që më pas u kthye në një periudhë të gjatë përbuzjeje e përjashtimi.

Në fillim mendova se ishte një periudhë kalimtare. I injoroja komentet dhe i thosha vetes se do kalonin, se unë isha e fortë. Por realiteti ishte ndryshe. Komentet nuk ndalonin. Talljet u bënë të përditshme, dhe përfshinë gjithnjë e më shumë persona.. Arsyeja? Sepse isha e shkurtër.

Përpiquesha të mos tregoja asgjë. Në sy të të tjerëve ruaja qetësinë, por në shtëpi qaja. Vetëm mamaja ime dinte gjithçka dhe më mbështeti çdo ditë. Kishte raste kur bullizimi pushonte për pak ditë dhe i jepja vetes shpresë, por më pas gjithçka rifillonte edhe më ashpër. Herë pas here përpiquesha të kundërpërgjigjesha, por përgjigja e tyre ishin qeshje edhe më të thella.

Ajo që më dhembte më shumë ishte se edhe ato vajza që i konsideroja mike, qeshnin pas shpine. Kjo më bëri të ndihesha e vetmuar, e pavlerësuar dhe e tradhtuar.

Pas katër viteve, vendosa të flas me psikologun e shkollës. Ishte një hap i vogël, por me ndikim të madh. Ajo më ndihmoi të përballem me ndjenjat e mia dhe të kuptoj që nuk duhet ta mbaj gjithçka brenda. Aty filloi ndryshimi im.

Sot, e ndjej veten të fortë. Nuk jam më ajo vajza që heshti. Jam një zë për të gjithë ata që ndihen siç më ndihesha unë. Kjo është arsyeja pse zgjodha këtë temë. Dua të flas për bullizmin, sepse vetëm duke folur mund të shërojmë atë që dikur heshtja vetëm e përkeqësonte.

Konkluzione dhe rekomandime

Bullizmi kibernetik është një problem i rëndësishëm për shkak të pasojave të tij të vazhdueshme të dëmshme për individët e viktimizuar. Në fillim ndikon në gjendjen psikologjike të viktimave dhe i bën ata të ndihen të izoluar dhe të shtypur. Këto emocione negative më pas çojnë në zhvillimin e çrregullimeve të ndryshme mendore dhe dobësojnë shëndetin e përgjithshëm. Për shkak të aftësive dhe sëmundjeve të dobëta sociale, viktimat e bullizmit përjetojnë vështirësi gjatë studimeve të tyre.

Duke qenë se shumë prej tyre kanë performancë të dobët akademike dhe ndonjëherë nuk e mbarojnë arsimin e tyre, kjo i bën ata të kenë vështirësi në aplikimin dhe mbajtjen e një pune. Problemet e punësimit i bëjnë viktimat e bullizmit të kenë të ardhura më të ulëta, ndërsa problemet shëndetësore i bëjnë ato të shpenzojnë shumë para për trajtimin e çrregullimeve të tyre mendore. Duke pasur parasysh efektet e përmendura të bullizmit, është e nevojshme të trajtohet ky fenomen duke mbështetur nxënësit e shkollave të viktimizuara dhe duke i mësuar ata të adresojnë shkelësit e tyre dhe të rregullojnë ndjenjat e tyre.

Nga sa u tha më sipër, tregon se bullizmi ka një gamë të gjerë pasojash psikologjike, fizike, ekonomike dhe shëndetësore për viktimat e tij, duke i ndjekur ato gjatë gjithë jetës së tyre. Nëse kalimtarët besojnë se bullizmi është i parëndësishëm dhe përfundon vetë me kalimin e kohës, viktimat do të vazhdojnë të përjetojnë efektet e tij negative në të ardhmen. Ne mund të parandalojmë bullizmin kibernetik duke kufizuar informacionin që ndajmë në internet. Përveç kësaj, ne duhet t'i ndërgjegjësojmë fëmijët për format e bullizmit kibernetik dhe pasojat e tij.

Si përfundim, ndërgjegjësimi është çelësi

për të parandaluar ngacmimet në internet. Fëmijët duhet t'i ndërgjegjësojmë që në moshë të hershme, në mënyrë që ata të jenë gjithmonë të kujdesshëm. Për më tepër, prindërit duhet të monitorojnë aktivitetet e fëmijëve të tyre në internet dhe të kufizojnë përdorimin e tyre. Më e rëndësishmja, ngacmimi kibernetik duhet të raportohet menjëherë pa vonesë sepse kjo mund të parandalojë që të ndodhin incidente të mëtejshme. Roli i Shtetit tonë është gjithashtu primar, qeveria duhet të ndërmarr iniciativa dhe të hartoj programe për edukimin dhe ndërgjegjësimin e përdoruesve të mediave sociale.

Më poshtë po listoj disa rekomandime për parandalimin e bullizmit kibernetik.

- Nevojitet më shumë informacion në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet viktimave dhe autorëve të bullizmit kibernetik dhe për pasojat afatgjata të bullizmit kibernetik si për ngacmuesit ashtu edhe për viktimat.
- Duhet të kryhen më shumë studime në lidhje me mënyrën se sesi bullizmi kibernetik evoluon gjithnjë në ndryshim të platformave të mediave sociale dhe pajisjeve të teknologjisë së re si telefonat inteligjentë, tabletët dhe madje edhe sistemet e lojërave në internet. Hulumtimi cilësor është i nevojshëm për të siguruar një pasqyrë më të madhe në kontekstin, përmbajtjen dhe efektet e bullizmit kibernetik. Ndoshta më e rëndësishmja është kërkimi i mëtejshëm i fokusuar në krijimin e ndërhyrjeve efektive. Ndërhyrjet që drejtohen nga teknologjia janë veçanërisht premtuese sepse ato mund të përfitojnë nga përdorimi me shpejtësi në rritje të teknologjisë tek të rinjtë dhe të shpërndahen përmes platformave në të cilat ndodh bullizmi kibernetik.
- Për më tepër, Facebook ishte kryesisht vendi më i zakonshëm për bullizmin kibernetik. Prandaj, prindërit dhe profesionistët e shkollave

duhet të jenë të vetëdijshëm se çfarë postojnë fëmijët e tyre dhe çfarë postohen në llogaritë e tyre. Megjithatë, për shkak se platformat e mediave sociale po ndryshojnë vazhdimisht, prindërit dhe profesionistët e shkollave duhet të përforcojnë mesazhet universale të parandalimit të bullizmit kibernetik që mund të aplikohen në të gjitha mediumet dixhitale. Është e rëndësishme që ndërhyrjet duhet të marrin parasysh platformat e mediave sociale, gjininë dhe veçanërisht identitetin seksual.

- Shkollat duhet të përfshijnë në kurrikulën e tyre mësimet të fokusuar në bullizmin kibernetik dhe të edukojnë të rinjtë për hapat e duhur që duhet të ndërmarrin nëse janë viktimë ose dëshmitar i bullizmit kibernetik.

- Në nivel shkolle, duhet të zhvillohen dhe zbatohen politika për të siguruar një mjedis shkolle të sigurt dhe mbështetës. Shkollat mund të krijojnë rregulla për përdorimin e mediave sociale në faqen e shkollës që dekurajojnë bullizmin kibernetik dhe të punojnë me prindërit për të inkurajuar rregullat në shtëpi. Shkollat gjithashtu mund të përfshijnë mësimet të fokusuar në bullizmin kibernetik në kurrikulën e tyre dhe të edukojnë të rinjtë për hapat e duhur që duhet të ndërmarrin nëse janë viktimë ose dëshmitar i bullizmit kibernetik. Shkollat gjithashtu mund të zbatojnë ndërhyrje të bazuara në prova për reduktimin e bullizmit kibernetik dhe ndërtimin e aftësive për zgjidhjen dhe përballimin e problemeve.

- Për shkak se bullizmi kibernetik shoqërohet me pasoja psikologjike, shërbimet e shëndetit mendor ose duhet të jenë të disponueshme në vend ose nëpërmjet sistemeve të përshtatshme të referimit për studentët që janë viktimë dhe ngacmues.

- Duhet të ketë një bashkëpunim dhe

partneritet të fortë midis shumë palëve të interesuara, duke përfshirë studentët, prindërit, mësuesit, administratorët, këshilltarët dhe zbatues të ligjit.

Navigimi i të drejtave të konsumatorit : rruga e Shqipërisë drejt integritetit evropian

Bianka Kananaj

Program i Integruar i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"

Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Prof.As. Jonida Mehmetaj

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Ky punim analizon zhvillimin dhe forcimin e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri në kontekstin e procesit të integritetit në Bashkimin Europian, duke u fokusuar në harmonizimin e legjislacionit vendas me direktivat europiane, sfidat praktike të zbatimit dhe perceptimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre. Fillimisht, është trajtuar evolucioni i të drejtave të konsumatorit në nivel ndërkombëtar dhe evropian, si dhe parimet bazë që udhëheqin mbrojtjen e konsumatorit në BE. Më tej, punimi shqyrton kornizën ligjore shqiptare, krahasimin me standardet europiane dhe sfidat institucionale, duke përfshirë rolin e institucioneve të mbikëqyrjes, shoqërisë civile dhe medias. Përmes një analize empirike krahasuese ndërmjet Tiranës dhe Vlorës mbi njohuritë e qytetarëve dhe rasteve praktike të raportuara në linjat e konsumatorit, punimi nxjerr në pah

dobësitë aktuale në monitorim, transparencë dhe zbatim të ligjit. Në përfundim, jepen rekomandime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe praktikës gjyqësore, edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, forcimin e mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, si hapa thelbësorë drejt përbushjes së standardeve të Bashkimit Europian dhe ndërtimit të një tregu të sigurt dhe të drejtë për konsumatorin shqiptar.

Fjalë kyçe: Mbrojtja e konsumatorit; e drejta e konsumatorit; Shqipëria; Bashkimi Europian; legjislacioni; tregtia elektronike; integriteti evropian; standardet e BE-së; edukimi i konsumatorëve; praktika gjyqësore.

Abstract

This paper explores the development and strengthening of consumer rights in Albania within the broader context of the country's integration into the European Union. It focuses on aligning national legislation with EU directives, the practical challenges of enforcement, and how citizens perceive and understand their rights as consumers.

The first part outlines the evolution of consumer protection at both the international and European levels, highlighting the core principles that guide EU policies in this field. The discussion then shifts to the Albanian legal framework, comparing it with European standards and identifying key institutional challenges—particularly regarding oversight bodies, the role of civil society, and the influence of the media.

Through a comparative empirical analysis between the cities of Tirana and Vlora—examining citizens' awareness and real-life cases reported through consumer hotlines—the paper sheds light on current gaps in monitoring, transparency, and law enforcement.

In conclusion, it offers concrete recommendations aimed at improving the legal framework and judicial practice, raising consumer awareness and education, expanding access to alternative dispute resolution mechanisms, and enhancing inter-institutional cooperation. These steps are essential for meeting EU standards and building a safe, fair, and transparent market for Albanian consumers.

Keywords: *Consumer protection; consumer rights; Albania; European Union; legislation; e-commerce; EU integration; EU standards; consumer education; judicial practice.*

Sfidat dhe perspektivat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri

Sfidat në forcimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionale

Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionale për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit është një element thelbësor për ndërtimin e një tregu të sigurt dhe të ndershëm, duke garantuar respektimin e të drejtave të qytetarëve dhe për afrimin me standardet e Bashkimit Europian (neni 169 i Traktatit për Funksonimin e BE-së). Në Shqipëri, megjithëse janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe krijimin e strukturave institucionale të dedikuara, sfidat në forcimin dhe funksionimin efektiv të këtyre mekanizmave mbeten të shumta. Një nga sfidat kryesore lidhet me boshllëqet dhe fragmentimin në kuadrin ligjor aktual për mbrojtjen e konsumatorit. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit” (neni 1) përcakton të drejtat bazë të konsumatorëve dhe përgjegjësitë e subjekteve tregtare, por nuk adreson në mënyrë të detajuar disa problematika që lidhen me tregtinë online, mbrojtjen e të dhënave personale gjatë proceseve të blerjeve elektronike, rastet e mashtrimeve financiare apo produktet digjitale. Këto boshllëqe krijojnë pasiguri ligjore, duke lejuar që tregtarët të shmangin detyrimet e tyre ligjore dhe konsumatorët të mbeten të pambrojtur në shumë situata praktike. Për shembull, megjithëse Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për tregtinë elektronike” (neni 10) parashikon detyrimin për informim të plotë të konsumatorit dhe të drejtën e tërheqjes nga kontrata, zbatimi i këtyre dispozitave mbetet i pamjaftueshëm për shkak të mungesës së një mekanizmi të centralizuar

monitorimi dhe kontrolli¹¹.

Një tjetër sfidë është mungesa e harmonizimit të legjislacionit sektorial që ndikon në të drejtat e konsumatorit, si në fushën e sigurisë ushqimore, tregtisë elektronike, mbrojtjes së të dhënave personale dhe mbrojtjes së konkurrencës, ku dispozitat shpesh janë të shpërndara dhe nuk ndërlidhen në mënyrë efektive¹². Kjo krijon konfuzion për konsumatorët dhe për vetë institucionet mbikëqyrëse, duke sjellë mbivendosje ose mungesë kompetencash të qarta ndërmjet tyre. Për shembull, Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" (neni 9, neni 12) përcakton përgjegjësitë e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit për sigurinë ushqimore, ndërsa Ligji nr. 9902/2008 (neni 27) përcakton përgjegjësitë e institucioneve të tjera mbi sigurinë e produkteve, duke krijuar shpesh mungesë koordinimi në rastet e inspektimeve dhe trajtimit të rasteve emergjente. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme institucionale është një tjetër sfidë e madhe në forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e konsumatorëve. Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit përballen me mungesë të burimeve njerëzore dhe financiare, gjë që e bën të pamundur realizimin e kontroleve të plota në të gjithë tregun¹³. Kjo situatë bën që inspektimet të fokusohen më tepër tek rastet e raportuara nga qytetarët dhe jo në monitorim proaktiv dhe sistematik të tregut, duke rritur rrezikun për konsumatorët që të ekspozohen ndaj produkteve të pasigurta ose shërbimeve abuzive. Në shumë raste, numri i

ulët i inspektorëve dhe mungesa e laboratorëve të akredituar për testimin e produkteve e kufizon aftësinë e institucioneve për të reaguar shpejt dhe për të marrë masa efektive. Një problem tjetër lidhet me mungesën e koordinimit ndërinstitucional ndërmjet institucioneve që kanë kompetenca të ndërlidhura me mbrojtjen e konsumatorit. Për shembull, rastet e mashtrimeve në tregtinë online kërkojnë bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por mungesa e një protokolli të qartë bashkëpunimi e vështirëson këtë proces. Kjo çon në vonesa në trajtimin e rasteve, mungesë transparence për konsumatorët dhe pamundësi për të ndjekur rastet deri në zgjidhjen e plotë të tyre¹⁴.

Në lidhje me mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e konsumatorit, një sfidë e rëndësishme mbetet mungesa e mekanizmave efektivë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR) dhe platformave online të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ODR), të cilat janë të aplikuara gjerësisht në vendet e Bashkimit Europian. Ligji nr. 9902/2008 (neni 8) u garanton konsumatorëve të drejtën për të paraqitur ankesa, por proceset e ndjekjes së ankesave janë të ngadalta dhe shpesh kërkojnë ndjekjen e rrugës gjyqësore, e cila është e kushtueshme dhe e ndërlikuar për qytetarët. Mungesa e një sistemi të strukturuar për trajtimin e ankesave i bën konsumatorët të hezitojnë të raportojnë shkeljet dhe ul presionin mbi subjektet për të respektuar detyrimet ligjore. Një sfidë tjetër është niveli i ulët

¹¹ Goyens, M., & Terryn, E., "Consumer protection in the European Union: Past, present and future", *Journal of Consumer Policy*, 43(3), 367–388, 2020.

¹² Cartwright, P., *Consumer Protection and the Law*, Oxford: Hart Publishing, 2020.

¹³ Riefa, C., "Consumer protection and online platforms: A European perspective", *European Review of Contract Law*, 17(1), 89–113, 2021.

¹⁴ Leka, R., "Mbrojtja e konsumatorit si pjesë e të drejtave të njeriut në Shqipëri", *Revista Shqiptare e Jurisprudencës*, 7(1), 75–88, 2022.

i ndërgjegjësimit të konsumatorëve mbi të drejtat e tyre dhe mbi mekanizmat ligjorë të mbrojtjes së këtyre të drejtave. Mungesa e edukimit të qytetarëve në lidhje me të drejtat e konsumatorit, procedurat e raportimit dhe institucionet kompetente bën që shumë qytetarë të mos i njohin dhe të mos i përdorin mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Kjo situatë është veçanërisht e theksuar në zonat rurale dhe në grupet vulnerabël të shoqërisë, ku mungesa e informacionit dhe frika nga përballja me institucionet janë faktorë që e pengojnë mbrojtjen efektive të konsumatorëve¹⁵. Proceset gjyqësore të zgjatura dhe kostot e larta të gjyqeve janë gjithashtu një pengesë në forcimin e mekanizmave ligjorë për mbrojtjen e konsumatorëve. Shumë qytetarë heqin dorë nga ndjekja ligjore e rasteve të shkeljes së të drejtave të tyre për shkak të vonesave të gjata dhe shpenzimeve të konsiderueshme që lidhen me procesin gjyqësor (Kodi i Procedurës Civile (neni 98)). Kjo situatë kërkon rishikimin e mekanizmave ligjorë për të ofruar procedura të shpejta dhe me kosto të ulët për rastet që lidhen me mbrojtjen e konsumatorit¹⁶. Për të kapërcyer këto sfida, kërkohet hartimi i një strategjie kombëtare për mbrojtjen e konsumatorit që të përfshijë harmonizimin e plotë të legjislacionit me direktivat e BE-së, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të inspektimeve, krijimin e platformave dixhitale për raportimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe zhvillimin e fushatave sensibilizuese për edukimin e konsumatorëve. Vetëm në këtë mënyrë, Shqipëria do të mund të ndërtojë një sistem të

qëndrueshëm për mbrojtjen efektive të të drejtave të konsumatorit dhe do të përmbushë objektivat e saj në procesin e integritetit evropian¹⁷.

Rekomandime për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe praktikës gjyqësore

Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe praktikës gjyqësore në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit është thelbësor për krijimin e një tregu të drejtë, të sigurt dhe të përafshur me standardet e Bashkimit Europian (neni 169 i Traktatit për Funksonimin e BE-së). Për të kapërcyer sfidat aktuale në Shqipëri, rekomandimet konkrete duhet të mbështeten në tre shtylla kryesore: harmonizimin ligjor, forcimin e praktikës gjyqësore dhe edukimin e konsumatorit. Së pari, rekomandohet rishikimi dhe përditësimi i Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" (neni 1, neni 6, neni 8, neni 37) për të përfshirë dispozita të qarta mbi mbrojtjen e konsumatorëve në tregtinë elektronike, produktet digjitale dhe shërbimet online. Ligji aktual nuk adreson në mënyrë të detajuar të drejtat e konsumatorit në platformat online, të cilat janë rritur ndjeshëm si përdorim, veçanërisht pas pandemisë. Duhet të parashikohet detyrimi i shitësve online për të dhënë informacion të plotë mbi produktet, të dhënat e kontaktit dhe kushtet e kthimit, si dhe të garantohen procedura të qarta për tërheqjen nga kontrata dhe kthimin e produktit, në përputhje me praktikatat e BEGjithashtu, është e nevojshme të kryhet harmonizimi i ligjeve sektoriale, si Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" (neni 9, neni 12), Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 "Për

¹⁵ Shima, A., "E drejta e konsumatorit dhe mbrojtja e saj në Shqipëri", Revista e Shkencave Juridike, 5(2), 23–34, 2019.

¹⁶ Hysi, V., "Zbatimi i të drejtave të konsumatorit në Shqipëri dhe sfidat drejt BE-së", Studime Juridike, 6(1), 91–103, 2018.

¹⁷ Riefa, C., "Consumer protection and online platforms: A European perspective", European Review of Contract Law, 17(1), 89–113, 2021.

tregtinë elektronike” (neni 10) dhe Ligji nr. 32/2014 “Për kreditë për konsumatorët” (neni 5, neni 12), duke i lidhur qartë me dispozitat e ligjit të mbrojtjes së konsumatorit. Kjo do të shmangë mbivendosjen ose boshllëqet gjatë zbatimit, do të qartësojë kompetencat e institucioneve dhe do të lehtësojë konsumatorët në ndjekjen e rasteve. Një rekomandim tjetër lidhet me krijimin e mekanizmave efektivë për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve (ADR) dhe platformave online për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (ODR), të cilat do të lehtësonin zgjidhjen e shpejtë të rasteve të thjeshta pa kosto të larta për konsumatorët. Për këtë qëllim, mund të krijohet një portal kombëtar i mbrojtjes së konsumatorit ku qytetarët mund të raportojnë rastet dhe të ndjekin statusin e tyre në kohë reale. Kjo do të ulte ngarkesën në gjykata dhe do të përshpejtonte proceset e zgjidhjes së rasteve të konsumatorëve. Në aspektin gjyqësor, rekomandohet specializimi i trupave gjyqësore për çështjet e mbrojtjes së konsumatorit, duke organizuar trajnime për gjyqtarët mbi të drejtat e konsumatorit, kuadrin ligjor dhe praktikën europiane, për të garantuar interpretim të saktë dhe të unifikuar të ligjit gjatë gjykimit të rasteve. Shpesh, praktika gjyqësore në Shqipëri karakterizohet nga vendime të ndryshme për raste të ngjashme, gjë që krijon pasiguri ligjore dhe dekurajon konsumatorët nga ndjekja e rrugës gjyqësore¹⁸.

Për të përmirësuar praktikën gjyqësore, rekomandohet gjithashtu të përcaktohen afate të qarta ligjore për gjykimin e rasteve të konsumatorëve me procedurë të përshpejtuar, për të shmangur vonesat e zgjatura që

karakterizojnë proceset aktuale. Në këtë mënyrë, rastet që lidhen me të drejtat e konsumatorit do të trajtohen me prioritet, duke garantuar mbrojtjen efektive të konsumatorëve dhe duke reduktuar kostot procedurale për qytetarët. Një rekomandim i rëndësishëm është fuqizimi i rolit të organizatave të shoqërisë civile dhe medias, të cilat mund të kontribuojnë në monitorimin e zbatimit të ligjit dhe në informimin e konsumatorëve mbi të drejtat e tyre. Organizatat e shoqërisë civile mund të ndihmojnë qytetarët në hartimin dhe ndjekjen e ankesave, ndërsa media mund të luajë rol në rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rastet e shkeljeve dhe mundësitë ligjore që kanë konsumatorët për të mbrojtur të drejtat e tyre. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i teknologjisë në mbrojtjen e konsumatorëve, përmes krijimit të një aplikacioni kombëtar ku qytetarët mund të raportojnë rastet e shkeljeve, të marrin këshillim ligjor falas dhe të kenë akses në udhëzime praktike për mbrojtjen e të drejtave të tyre¹⁹. Ky aplikacion mund të lidhet me Linjën e Konsumatorit dhe institucionet përgjegjëse, duke krijuar një sistem të integruar komunikimi dhe ndjekjeje të rasteve. Në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor, rekomandohet gjithashtu përcaktimi i sanksioneve më të ashpra ndaj subjekteve që shkelin vazhdimisht të drejtat e konsumatorëve, për të krijuar efekte parandaluese dhe për të rritur përgjegjshmërinë e operatorëve ekonomikë. Për shembull, në rastet e produkteve të pasigurta ose të mashtrimeve në tregtinë online, përveç gjobave administrative (Ligji nr. 9902/2008 (neni 61)), mund të parashikohet edhe ndalimi i përkohshëm i aktivitetit për operatorët që përsërisin shkeljet²⁰.

¹⁸ Riefa, C., “Consumer protection and online platforms: A European perspective”, *European Review of Contract Law*, 17(1), 89–113, 2021.

¹⁹ Xhaxho, E., “E drejta e konsumatorit në tregtinë online në Shqipëri: Sfidat dhe zgjidhjet”, *Buletini i*

Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 15(2), 42–53, 2020.

²⁰ Goyens, M., & Terryn, E., “Consumer protection in the European Union: Past, present and future”, *Journal of Consumer Policy*, 43(3), 367–388, 2020.

Në aspektin institucional, rekomandohet forcimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse, si Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, duke rritur numrin e inspektorëve, duke siguruar pajisje moderne për kontrollet dhe duke krijuar laboratorë të akredituar për testimin e produkteve, në mënyrë që të mund të garantohet monitorimi efektiv i tregut dhe zbatimi i ligjit. Së fundmi, rekomandohet organizimi i fushatave të vazhdueshme sensibilizuese kombëtare për edukimin e qytetarëve mbi të drejtat e konsumatorit, procedurat ligjore dhe institucionet ku mund të drejtohen për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre. Edukimi publik është një komponent i domosdoshëm për forcimin e mekanizmave ligjorë dhe praktikës gjyqësore, pasi një qytetar i informuar është më i aftë të mbrojë të drejtat e tij dhe të kontribuojë në ndërtimin e një tregu të ndershëm dhe të sigurt. Këto masa janë të domosdoshme për të siguruar mbrojtjen efektive të konsumatorëve, forcimin e besimit të qytetarëve tek shteti dhe garantimin e një tregu konkurrues dhe të sigurt, duke e afuar më tej Shqipërinë me standardet e Bashkimit Europian në procesin e integritetit²¹.

Roli i edukimit dhe ndërgjegjësisimit të konsumatorëve

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve janë elementë kyç për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të tyre dhe për forcimin e funksionimit të tregut të lirë dhe konkurrues në Shqipëri, në përputhje me objektivat e përafrimit

me Bashkimin Europian (neni 169 i Traktatit për Funksionimin e BE-së). Një konsumator i informuar dhe i ndërgjegjshëm jo vetëm që ka mundësi të mbrojë të drejtat e tij, por kontribuon në krijimin e një mjedisi tregtar të sigurt dhe të drejtë, duke ndikuar pozitivisht në respektimin e ligjit nga subjektet tregtare dhe në forcimin e monitorimit shoqëror të tregut²². Në Shqipëri, edukimi i konsumatorëve ka filluar të zërë vend në diskursin publik dhe institucional, por niveli i ndërgjegjësisimit mbetet ende i ulët, veçanërisht në zonat rurale dhe tek grupet vulnerabël të shoqërisë. Shumë qytetarë nuk janë të informuar mbi të drejtat e tyre si konsumatorë, mbi institucionet ku mund të drejtohen për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe mbi procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur u shkelen të drejtat, në kundërshtim me detyrimin e shtetit për të garantuar informimin dhe edukimin e konsumatorëve (Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" (neni 6)). Një konsumator i paedukuar dhe i painformuar është më i ekspozuar ndaj mashtrimeve tregtare, produkteve të pasigurta dhe praktikave të padrejta tregtare, duke mos qenë në gjendje të kërkojë të drejtat e tij, të raportojë shkeljet apo të përdorë mekanizmat ligjorë që i garanton ligji. Kjo situatë krijon një terren të favorshëm për abuzime nga ana e subjekteve tregtare, të cilët përfitojnë nga mungesa e reagimit të konsumatorëve për të shmangur detyrimet ligjore që kanë ndaj tyre.

Rritja e ndërgjegjësisimit të konsumatorëve mund të realizohet përmes edukimit formal dhe informal. Edukimi formal mund të përfshijë integrimin e moduleve të posaçme mbi të drejtat e konsumatorit në kurrikulat e arsimit

²¹ Goyens, M., & Terryn, E., "Consumer protection in the European Union: Past, present and future", *Journal of Consumer Policy*, 43(3), 367–388, 2020.

²² Cartwright, P., *Consumer Protection and the Law*, Oxford: Hart Publishing, 2020.

parauniversitar dhe universitar, për të rritur ndërgjegjësimin tek të rinjtë që në moshë të hershme mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në treg. Edukimi informal, nga ana tjetër, mund të realizohet përmes fushatave publike, trajnimeve në komunitet, aktiviteteve ndërgjegjëse dhe informimit nëpërmjet mediave tradicionale dhe rrjeteve sociale. Roli i institucioneve publike në edukimin e konsumatorëve është i pazëvendësueshëm. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit duhet të zhvillojnë programe të vazhdueshme informimi dhe edukimi të qytetarëve, duke shpërndarë materiale informuese, duke organizuar takime me komunitetet dhe duke ofruar këshillim falas për qytetarët në lidhje me të drejtat e tyre dhe procedurat që duhet të ndjekin për t'i mbrojtur ato. Këto aktivitete duhet të zhvillohen në të gjitha qytetet dhe veçanërisht në zonat rurale, ku niveli i informimit është më i ulët dhe konsumatorët janë më të pambrojtur. Shoqëria civile ka një rol shumë të rëndësishëm në edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Organizatat e mbrojtjes së konsumatorëve mund të ofrojnë këshillim ligjor falas, të ndihmojnë qytetarët në përgatitjen dhe ndjekjen e ankesave pranë institucioneve përkatëse, si dhe të organizojnë fushata informuese mbi të drejtat e konsumatorëve. Përmes monitorimit të tregut dhe raportimit të rasteve të abuzimeve, organizatat e shoqërisë civile mund të ndikojnë në rritjen e transparencës dhe në krijimin e një klime presioni ndaj subjekteve tregtare për të respektuar të drejtat e konsumatorëve. Media gjithashtu luan një rol të madh në ndërgjegjësimin e konsumatorëve, duke publikuar raste të abuzimeve, duke informuar qytetarët mbi të drejtat e tyre dhe mbi institucionet ku mund të drejtohen për ndihmë dhe duke rritur presionin publik ndaj

institucioneve dhe subjekteve që shkelin të drejtat e konsumatorëve. Emisionet investiguese, raportimet e rasteve konkrete dhe debatet publike janë mjete efektive për të informuar qytetarët dhe për të rritur përgjegjësinë e operatorëve ekonomikë. Teknologjia mund të përdoret si një mjet efektiv për edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve. Krijimi i platformave online dhe aplikacioneve mobile ku qytetarët mund të marrin informacion mbi të drejtat e tyre, të raportojnë shkeljet, të ndjekin statusin e ankesave të tyre dhe të marrin këshilla ligjore falas, do të lehtësonte aksesin e qytetarëve në informacion dhe do të rrisë reagimin e tyre në rastet e shkeljeve. Për shembull, Linja e Konsumatorit (0800 1515) mund të shndërrohet në një platformë dixhitale ku qytetarët mund të raportojnë rastet dhe të marrin informacione të detajuara në kohë reale. Një element tjetër i rëndësishëm në edukimin e konsumatorëve është forcimi i transparencës dhe informimit nga ana e subjekteve tregtare. Subjektet duhet të jenë të detyruara të ofrojnë informacion të plotë dhe të saktë mbi produktet dhe shërbimet që ofrojnë, mbi çmimet, afatet e garancisë dhe kushtet e kthimit, në përputhje me Ligjin nr. 9902/2008 (neni 6, neni 7, neni 37). Edukimi i konsumatorëve do t'i ndihmojë ata të kuptojnë rëndësinë e informacionit të dhënë nga tregtarët dhe të kërkojnë të drejtat e tyre kur ky informacion nuk jepet ose kur është i pasaktë. Për të forcuar edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, rekomandohet që institucionet përgjegjëse të hartojnë dhe zbatojnë një Strategji Kombëtare për Edukimin e Konsumatorëve, e cila të përfshijë masa konkrete si krijimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë, organizimi i seminareve, përdorimi i mediave sociale për informim, krijimi i partneriteteve me shkollat dhe universitetet, si dhe organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse në bashkëpunim me shoqërinë

civile dhe median²³. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve ka një ndikim të dyfishtë: jo vetëm që ndihmon konsumatorët të mbrojnë të drejtat e tyre, por ndihmon edhe institucionet në monitorimin dhe kontrollin e tregut, pasi qytetarët e informuar janë më të prirur të raportojnë shkeljet dhe të kërkojnë respektimin e ligjit nga subjektet tregtare²⁴. Kjo rrit nivelin e transparencës dhe të përgjegjësisë në treg, duke krijuar një mjedis konkurrues dhe të ndershëm që përfiton nga të gjithë. Për të arritur këtë qëllim, nevojitet një angazhim i përbashkët i institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, medias dhe vetë konsumatorëve, duke krijuar një kulturë të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit dhe një shoqëri që e konsideron respektimin e këtyre të drejtave si pjesë të pandashme të jetës së përditshme dhe të procesit të integritetit europian.

Perspektiva e integritetit të plotë në standardet e BE-së për mbrojtjen e konsumatorit

Perspektiva e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian e lidh ngushtë mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit me procesin e përafrimit ligjor dhe institucional, duke u bërë një nga indikatorët kyç për vlerësimin e gatishmërisë së vendit për anëtarësim. Mbrojtja e konsumatorit është pjesë e Kapitullit 28 "Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit" të *acquis communautaire*, si dhe lidhet me standardet e garantuara nga neni 169 i Traktatit për Funksionimin e BE-së, që thekson të drejtën e qytetarëve për një nivel të lartë mbrojtjeje dhe

informimi në treg. Shqipëria ka ndërmarrë hapa për përafrimin e legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së për mbrojtjen e konsumatorit përmes miratimit të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" (neni 1, neni 6, neni 8, neni 37, neni 61), të harmonizuar pjesërisht me direktivat e BE-së mbi të drejtën e tërheqjes nga kontrata, të drejtën e informimit, ndalimin e klauzolave abuzive dhe mbrojtjen nga praktikatat mashtruese tregtare²⁵. Po ashtu, Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 "Për tregtinë elektronike" (neni 10), dhe Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" (neni 9, neni 12) janë pjesë e kësaj përpjekjeje, duke krijuar bazën ligjore për forcimin e kontrollit të tregut dhe sigurisë së produkteve. Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, integrimi i plotë në standardet e BE-së kërkon tejkalimin e disa sfidave strukturore dhe organizative²⁶. Një nga sfidat kryesore është përafrimi i plotë i legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së, duke përfshirë Direktivën 2011/83/BE për të drejtat e konsumatorëve, Direktivën 2005/29/KE për praktikatat e padrejta tregtare dhe Direktivën 2006/114/KE për reklamat mashtruese. Këto direktiva kërkojnë dispozita të detajuara që garantojnë të drejtën e tërheqjes nga kontrata, transparencën e informacionit, mbrojtjen nga reklamat mashtruese dhe garantimin e sigurisë së produkteve në të gjitha fazat e tregtimit. Një element tjetër kyç në këtë perspektivë është funksionimi efektiv i institucioneve mbikëqyrëse dhe inspektuese, të cilat duhet të kenë kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të kontrolluar tregun në mënyrë sistematike dhe për

²³ Cartwright, P., *Consumer Protection and the Law*, Oxford: Hart Publishing, 2020.

²⁴ Goyens, M., & Terry, E., "Consumer protection in the European Union: Past, present and future", *Journal of Consumer Policy*, 43(3), 367–388, 2020.

²⁵ Hysi, V., "Zbatimi i të drejtave të konsumatorit në Shqipëri dhe sfidat drejt BE-së", *Studime Juridike*, 6(1), 91–103, 2018.

²⁶ Xhaxho, E., "E drejta e konsumatorit në tregtinë online në Shqipëri: Sfidat dhe zgjidhjet", *Buletini i Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës*, 15(2), 42–53, 2020.

të parandaluar hyrjen e produkteve të pasigurta ose mashtruese në treg. Aktualisht, mungesa e burimeve dhe e laboratorëve të certifikuar për analizimin e produkteve mbetet një pengesë, e cila duhet adresuar për të përmbushur standardet e BE-së. Po ashtu, integrimi në standardet e BE-së kërkon krijimin dhe zbatimin e mekanizmeve të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ADR) dhe platformave online të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ODR), të cilat janë pjesë e sistemit europian për mbrojtjen e konsumatorit. Këto mekanizma sigurojnë një zgjidhje të shpejtë dhe me kosto të ulët për konsumatorët në rastet e shkeljes së të drejtave të tyre, duke ulur ngarkesën në gjykata dhe duke rritur besimin e qytetarëve tek mekanizmat institucionalë²⁷.

Pjesë e perspektivës së integrimit është gjithashtu forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional, ku institucionet si Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare duhet të krijojnë protokolle bashkëpunimi për trajtimin e rasteve të shkeljeve dhe për koordinimin në inspektime dhe kontrole. Kjo do të mundësojë shmangien e mbivendosjeve kompetencash dhe do të garantojë një reagim më të shpejtë dhe efektiv në mbrojtjen e konsumatorëve²⁸. Edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve është një tjetër komponent thelbësor në procesin e integrimit në standardet e BE-së. Konsumatorët shqiptarë duhet të jenë të informuar mbi të drejtat e tyre ligjore, procedurat e raportimit dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të tyre, në përputhje me Ligjin nr. 9902/2008 (neni 6). Organizimi i fushatave sensibilizuese dhe përdorimi i teknologjisë dhe mediave sociale për

informimin e qytetarëve është një hap i domosdoshëm për të rritur ndërgjegjësimin publik dhe për të krijuar një kulturë mbrojtjeje të të drejtave të konsumatorit. Për të realizuar integrimin e plotë në standardet e BE-së, Shqipëria duhet të përdorë mekanizmat e asistencës teknike dhe financiare të BE-së, për të zhvilluar kapacitetet institucionale, për të përmirësuar infrastrukturën laboratorike dhe për të siguruar trajnime për stafet inspektuese dhe gjyqësore në lidhje me praktikën më të mira të BE-së në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Bashkëpunimi me organizatat europiane të mbrojtjes së konsumatorit dhe pjesëmarrja në rrjetet europiane të monitorimit të tregut do të mundësojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe përmirësimin e praktikave kombëtare. Kjo kërkon harmonizimin e plotë të legjislacionit me direktivat europiane, forcimin e inspektimeve, krijimin e mekanizmeve të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, edukimin e konsumatorëve dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional.

Vetëm përmes këtyre masave, Shqipëria do të mund të sigurojë një mbrojtje efektive për konsumatorët, duke kontribuar jo vetëm në procesin e integrimit europian, por edhe në ndërtimin e një shoqërie të drejtë, të sigurt dhe me ekonomi funksionale të tregut.

Përfundime

Mbrojtja e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri përbën një shtyllë thelbësore të forcimit të shtetit të së drejtës, garantimit të një tregu të ndershëm dhe të sigurt, si dhe të procesit të integrimit europian, në përputhje me standardet e Bashkimit Europian (neni 169 i Traktatit për Funksionimin e BE-së). Analiza e realizuar në këtë punim ka treguar se Shqipëria ka ndërmarrë hapa të

²⁷ Shima, A., "E drejta e konsumatorit dhe mbrojtja e saj në Shqipëri", Revista e Shkencave Juridike, 5(2), 23–34, 2019.

²⁸ Hysi, V., "Zbatimi i të drejtave të konsumatorit në Shqipëri dhe sfidat drejt BE-së", Studime Juridike, 6(1), 91–103, 2018.

rëndësishëm në ndërtimin e kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e konsumatorit, përmes miratimit të ligjeve si Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" (neni 1, neni 6, neni 8, neni 37, neni 61), Ligji nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin" (neni 9, neni 12) dhe Ligji nr. 10128, datë 11.05.2009 "Për tregtinë elektronike" (neni 10), të cilat kanë krijuar bazën ligjore për mbrojtjen e konsumatorëve shqiptarë. Megjithatë, analiza ka evidentuar se ekzistojnë ende sfida të konsiderueshme që pengojnë zbatimin efektiv të të drejtave të konsumatorit në praktikë. Boshllëqet në harmonizimin e legjislacionit me direktivat e BE-së, fragmentimi ligjor ndërmjet ligjeve sektoriale, mungesa e koordinimit ndërinstitutional, mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të institucioneve inspektuese, proceset e zgjatura gjyqësore dhe kostot e larta për konsumatorët janë ndër faktorët që kufizojnë mbrojtjen efektive të konsumatorit në Shqipëri. Skandalet e fundit që kanë përfshirë produktet ushqimore të pasigurta dhe rastet e mashtrimeve në tregtinë online apo në fushën e mikrokreditimit kanë treguar dobësitë e mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të ligjit, duke dëshmuar nevojën për forcimin e kontrolleve të tregut, rritjen e transparencës dhe forcimin e masave parandaluese dhe ndëshkimore ndaj shkelësve. Në këtë kontekst, është e domosdoshme krijimi i mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ADR) dhe platformave online (ODR), për të ofruar zgjidhje të shpejta dhe me kosto të ulët për konsumatorët. Gjithashtu, edukimi dhe ndërgjegjësimi i konsumatorëve mbetet një sfidë që duhet adresuar në mënyrë prioritare. Shumë qytetarë nuk janë të informuar për të drejtat e tyre, institucionet ku mund të drejtohen dhe procedurat që duhet të ndjekin për mbrojtjen e të drejtave të tyre. Rritja e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, përmes fushatave informuese, edukimit në shkollë dhe përdorimit të teknologjisë, do të ndihmonte në forcimin e rolit të qytetarëve si pjesë aktive në monitorimin e tregut dhe raportimin e shkeljeve.

Rekomandimet e dala nga ky studim nënvizojnë nevojën për:

Harmonizimin e plotë të kuadrit ligjor me direktivat e BE-së.

Forcimin e kapaciteteve të institucioneve inspektuese dhe laboratorike.

Krijimin e procedurave të përsheptuara gjyqësore për çështjet e konsumatorëve.

Krijimin e një platforme dixhitale kombëtare për raportimin dhe ndjekjen e rasteve.

Edukimin dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm të konsumatorëve.

Vendosjen e sanksioneve më të ashpra për shkelësit e përsëritur.

Përparimi i Shqipërisë drejt integritetit evropian lidhet drejtpërdrejt me garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, si pjesë e garantimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimit të një tregu të lirë dhe konkurrues. Zbatimi i masave të rekomanduara do të ndihmojë në forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve, do të rrisë besimin e qytetarëve tek institucionet dhe do të kontribuojë në krijimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe të drejtë në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve nuk është vetëm një domosdoshmëri ligjore, por një investim në mirëqenien e qytetarëve dhe në forcimin e demokracisë në vend, duke e afruar Shqipërinë me standardet e Bashkimit Evropian dhe me aspiratat për një të ardhme evropiane.

Rekomandime

Bazuar në analizën e realizuar mbi zhvillimin e të drejtave të konsumatorit në Shqipëri dhe sfidat që shoqërojnë procesin e përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian, rekomandohen këto masa konkrete për përmirësimin e mbrojtjes së konsumatorit në nivel ligjor, institucional dhe praktik:

Harmonizimi i plotë i legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së, përfshirë Direktivën 2011/83/BE për të drejtat e konsumatorëve, Direktivën 2005/29/KE për praktikën e padrejta tregtare dhe Direktivën 2006/114/KE për reklamën mashtruese, duke rishikuar Ligjin nr. 9902/2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit" (neni 1, neni 6, neni 8, neni 37), Ligjin nr. 9863/2008 dhe Ligjin nr. 10128/2009 për tregtinë elektronike, në mënyrë që të përfshihen dispozitat e qarta mbi mbrojtjen e konsumatorëve në tregtinë online, produktet digjitale dhe shërbimet elektronike.

Krijimi i mekanizmave të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ADR) dhe platformave online (ODR), për të mundësuar zgjidhjen e shpejtë dhe me kosto të ulët të mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe subjekteve tregtare, duke shmangur proceset gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme, si dhe për të përmbushur kërkesat e standardeve të BE-së në këtë fushë.

Forcimi i kapaciteteve institucionale të Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, përmes rritjes së numrit të inspektorëve, trajnimeve të vazhdueshme mbi legjislacionin dhe praktikën europiane, sigurimit të pajisjeve moderne të monitorimit dhe krijimit të laboratorëve të certifikuar për analizimin e produkteve në kohë reale.

Vendosja e një sistemi të integruar dixhital kombëtar për raportimin e shkeljeve dhe monitorimin e rasteve të konsumatorëve, i lidhur me Linjën e Konsumatorit dhe institucionet inspektuese, në mënyrë që qytetarët të mund të raportojnë rastet në kohë reale, të ndjekin statusin e tyre dhe të marrin këshilla ligjore falas.

Organizimi i fushatave të vazhdueshme sensibilizuese dhe edukative, në bashkëpunim me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe median, për të informuar konsumatorët mbi të drejtat e tyre, mbi procedurat e raportimit dhe mbi institucionet ku mund të drejtohen në rastet e shkeljeve, në përputhje me Ligjin nr. 9902/2008 (neni 6).

Specializimi i trupave gjyqësore për trajtimin e rasteve të konsumatorëve, përmes trajnimeve të dedikuara dhe krijimit të procedurave të përsheptuara për gjykimin e rasteve që lidhen me të drejtat e konsumatorit, duke shmangur vonesat dhe kostot e larta për qytetarët.

Vendosja e sanksioneve të ashpra dhe masave ndëshkimore ndaj subjekteve që shkelin vazhdimisht të drejtat e konsumatorëve, përfshirë gjoka të rritura dhe ndalimin e aktivitetit tregtar për subjektet që përsërisin shkeljet, në përputhje me Ligjin nr. 9902/2008 (neni 61), për të rritur efektin parandalues dhe respektimin e ligjit.

Inkurajimi i përdorimit të teknologjisë në edukimin dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve, përmes krijimit të aplikacioneve mobile dhe platformave online që ofrojnë informacion të detajuar mbi të drejtat e konsumatorit, udhëzime praktike dhe akses në raportim të shkeljeve.

Forcimi i bashkëpunimit nderinstitucional ndërmjet institucioneve të mbrojtjes së konsumatorit, si Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të siguruar koordinim në trajtimin e rasteve dhe për të shmangur mbivendosjen e kompetencave.

Shfrytëzimi i mbështetjes financiare dhe asistencës teknike të Bashkimit Europian, për të përmirësuar kapacitetet institucionale, për të

krijuar infrastrukturë laboratorike dhe për të mundësuar trajnimin e vazhdueshëm të stafit dhe forcimin e standardeve të mbrojtjes së konsumatorit në Shqipëri.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve do të ndihmojë Shqipërinë në forcimin e sistemit të mbrojtjes së konsumatorit, do të sigurojë respektimin e të drejtave të qytetarëve, do të rrisë besimin e konsumatorëve tek institucionet shtetërore dhe do të kontribuojë drejtpërdrejt në procesin e integritetit europian, duke ndërtuar një ekonomi funksionale tregu në përputhje me standardet e BE-së dhe një shoqëri ku mbrojtja e konsumatorit të jetë një prioritet real dhe i zbatueshëm.

Parimi i efektit të drejtpërdrejtë në jurisprudencën e BE-së: themelimi , evolucioni dhe impakti ligjor në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare.

Blerina Canaj

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Prof.As. Jonida Mehmetaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Parimi i drejtpërdrejtë përfaqëson një nga gurët themelorë të rendit juridik të Bashkimit Europian (BE), duke i mundësuar individëve që të mbrojnë të drejtat e tyre që burojnë nga traktatet, rregulloret dhe, në disa raste, direktivat e BE-së, përpara gjykatave kombëtare. Ky punim shqyrton themelimin, evolucionin dhe ndikimin e këtij parimi në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare, duke analizuar kontributin e Gjykatës së Drejtësisë në përcaktimin e standardeve të efektit të drejtpërdrejtë dhe rolin e gjykatave kombëtare si garante të zbatimit të ligjit europian. Përmes analizës së jurisprudencës kryesore si Van Gend en Loos, Costa v ENEL, Simmenthal, Marshall dhe rasteve të tjera, evidentohet se ky parim ka transformuar qytetarët europianë në subjekte aktive të së drejtës së BE-së, duke forcuar shtetin e së drejtës dhe funksionimin e tregut të brendshëm. Megjithatë, puna eidenton edhe

kufizimet e parimit, si mungesa e efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, tensionet me gjykatat kushtetuese kombëtare dhe sfidat e adaptimit ndaj zhvillimeve dixhitale dhe sfidave të reja të BE-së. Përmes rekomandimeve konkrete, punimi thekson nevojën për forcimin e kapaciteteve të gjykatave kombëtare, përdorimin e Kartës së të Drejtave Themelore dhe adaptimin e parimit të drejtpërdrejtë në fushat e reja ligjore, me qëllim ruajtjen e rolit të tij si një instrument thelbësor për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve europianë dhe forcimin e rendit juridik të BE-së.

Fjalë kyçe :*Parimi i drejtpërdrejtë, Bashkimi Europian, e drejta e BE-së, Gjykata e Drejtësisë, shtetet anëtare, tregu i brendshëm, të drejtat e qytetarëve, jurisprudenca, integrimi europian.*

Abstract

The principle of direct effect represents one of the cornerstones of the legal order of the European Union (EU), enabling individuals to invoke their rights derived from treaties, regulations, and, in certain cases, directives of the EU before national courts. This thesis examines the foundation, evolution, and impact of this principle on the judicial practice of the Member States, analyzing the contribution of the Court of Justice in setting the standards for direct effect and the role of national courts as guarantors of EU law enforcement. Through the analysis of key case law such as *Van Gend en Loos*, *Costa v ENEL*, *Simmenthal*, *Marshall*, and others, it becomes evident that this principle has transformed EU citizens into active subjects of EU law, strengthening the rule of law and the functioning of the internal market. However, the study also highlights the limitations of the principle, including the absence of horizontal direct effect for directives, tensions with national constitutional courts, and challenges in adapting to digital developments and new EU realities. Through concrete recommendations, the thesis emphasizes the need to strengthen the capacities of national courts, promote the use of the Charter of Fundamental Rights, and adapt the principle of direct effect to new legal areas, in order to preserve its role as a fundamental tool for the protection of EU citizens' rights and the reinforcement of the EU legal order.

Keywords: *Direct effect, European Union, EU law, Court of Justice, Member States, internal market, citizens' rights, case law, European integration.*

Pyetjet kërkimore dhe hipotezat

Ky studim udhëhiqet nga pyetjet kërkimore:

Çfarë është parimi i drejtpërdrejtë dhe cilat janë kushtet për zbatimin e tij në të drejtën e BE-së?

Si ka evoluar ky parim në jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së?

Cili ka qenë ndikimi i parimit të drejtpërdrejtë në sistemet gjyqësore të shteteve anëtare të BE-së?

Si ndikon parimi i drejtpërdrejtë në forcimin e të drejtave të individëve dhe në zbatimin efektiv të të drejtës së BE-së në praktikë

Hipotezat e këtij studimi janë:

Parimi i drejtpërdrejtë është një mekanizëm kyç për të siguruar zbatimin efektiv të të drejtës së BE-së dhe për të garantuar të drejtat e individëve.

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë ka luajtur një rol vendimtar në formësimin dhe zhvillimin e këtij parimi.

Zbatimi i parimit të drejtpërdrejtë në praktikën gjyqësore të shteteve anëtare ndikon në harmonizimin e të drejtës dhe të praktikës gjyqësore në BE.

Vendet që janë në proces integrimi, përfshirë Shqipërinë, përballen me sfida në zbatimin praktik të këtij parimi për shkak të pengesave ligjore dhe kulturore.

Analiza krahasuese e jurisprudencës së BE-së dhe praktikës kombëtare

Parimi i drejtpërdrejtë ka marrë formën e tij përfundimtare nëpërmjet jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European (GJDBE), e cila ka vendosur standardet e zbatimit të tij, ndërsa praktika gjyqësore kombëtare e shteteve anëtare ka pasur një rol kyç në operacionalizimin e këtij parimi në nivel kombëtar. Kjo analizë krahasuese është e domosdoshme për të kuptuar se si është realizuar balanca ndërmjet ruajtjes së karakterit unik të së drejtës së BE-së dhe respektimit të sovranitetit ligjor të shteteve anëtare²⁹.

Standardet e GJDBE mbi parimin e drejtpërdrejtë

Gjykata e Drejtësisë, në vendime si Van Gend en Loos (1963) dhe Costa v ENEL (1964), ka vendosur kriteret që një dispozitë e së drejtës së BE-së duhet të përmbushë që të ketë efekt të drejtpërdrejtë: qartësi, precizitet dhe mungesë të kushteve të tjera³⁰. Në vendimin Simmenthal (1978), GJDBE konfirmoi se gjykatat kombëtare janë të detyruara të mos zbatojnë ligjet kombëtare që bien ndesh me të drejtën e BE-së me efekt të drejtpërdrejtë, duke garantuar unitetin e së drejtës europiane³¹. Gjykata ka zhvilluar më tej aplikimin e këtij parimi në lidhje me direktivat, duke lejuar efektin e drejtpërdrejtë vertikal në rastet kur ato janë të qarta, precize dhe të pakushtëzuara, siç u konfirmua në Van Duyn (1974) dhe Marshall (1986), por duke refuzuar efektin horizontal të tyre³².

Praktika gjyqësore kombëtare: përafrime dhe tensione

Gjykatat kombëtare, megjithëse në parim të detyruara të zbatojnë të drejtën e BE-së sipas kriterëve të përcaktuara nga GJDBE, kanë manifestuar qasje të ndryshme në varësi të sistemeve të tyre ligjore dhe qasjes ndaj sovranitetit kombëtar. Në Gjermani, rasti Solange I (1974) reflektoi një qëndrim rezervues ndaj zbatimit të drejtpërdrejtë kur preken të drejtat themelore, megjithatë në Solange II (1986) Gjykata Kushtetuese Gjermane pranoi se nuk do të ndërhynte në zbatimin e së drejtës së BE-së përderisa mbrojtja e të drejtave themelore është e garantuar në nivel evropian³³. Në Francë, fillimisht në rastin Cohn-Bendit (1978) u refuzua aplikimi i drejtpërdrejtë i direktivave kundër akteve administrative, por me vendimin Perreux (2009) u pranua që individët mund të mbështeten te dispozitat e direktivave të qarta dhe të pakushtëzuara kundër akteve administrative kombëtare pas kalimit të afatit të transpozimit³⁴. Në Itali, pas vendimit të GJDBE në Simmenthal, Gjykata Kushtetuese Italiane pranoi parimin e përparësisë dhe detyrimin e gjykatave të zakonshme për të zbatuar të drejtën e BE-së, duke krijuar një praktikë të qëndrueshme në respektimin e efektit të drejtpërdrejtë³⁵. Në Holandë, ku kushtetuta parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të traktateve mbi ligjet kombëtare, zbatimi i këtij parimi ka qenë konsistent dhe pa rezistenca institucionale³⁶.

Harmonizimi dhe ndikimi në procesin e integritetit

Analiza krahasuese tregon se pavarësisht

²⁹ Craig & de Búrca, 2020, p. 212

³⁰ Van Gend en Loos, 1963, p. 17; Costa v ENEL, 1964, p. 600

³¹ Case 106/77 Simmenthal, 1978, p. 635

³² Case 41/74 Van Duyn, 1974, p. 1354; Case 152/84 Marshall, 1986, p. 730

³³ BVerfGE 37, 271, 1974, p. 284; BVerfGE 73, 339, 1986, p. 392

³⁴ CE, Ass., 22 dhjetor 1978, Cohn-Bendit, Rec. Lebon, p. 527; CE, Ass., 30 tetor 2009, Perreux, Rec. Lebon, p. 333

³⁵ Case 106/77 Simmenthal, 1978, p. 635

³⁶ Craig & de Búrca, 2020, p. 214

tensioneve fillestare, praktikat kombëtare janë përafruar gradualisht me standardet e GJDBE falë interpretimit të vazhdueshëm të jurisprudencës europiane dhe përmirësimit të kapaciteteve të gjykatave kombëtare. Ky proces ka forcuar unitetin e rendit juridik të BE-së dhe ka ndihmuar në ruajtjen e funksionalitetit të tregut të brendshëm dhe të katër lirive themelore³⁷. Parimi i drejtpërdrejtë ka ndihmuar në zvogëlimin e hendekut ndërmjet rendit juridik kombëtar dhe të drejtës së BE-së, duke

ligjit europian në të gjitha nivelet³⁸. Analiza krahasuese tregon se parimi i drejtpërdrejtë mbetet një mjet kyç për të garantuar zbatimin efektiv të së drejtës së BE-së, pavarësisht sfidave në nivel kombëtar. Rruga e përafrimit të jurisprudencës kombëtare me standardet e GJDBE dëshmon se integrimi europian është një proces që ndërtohet përmes respektimit të të drejtave të individëve dhe forcimit të sundimit të ligjit në të gjitha shtetet anëtare.

Krahasimi ndërmjet jurisprudencës së GJDBE dhe praktikës kombëtare

Element	Jurisprudenca e GJDBE	Praktika Kombëtare në BE
Standardet e aplikimit	Qartësi, precizitet, mungesë kushtesh (Van Gend)	Zbatim në varësi të traditës kushtetuese
Efekti i drejtpërdrejtë	Traktatet, rregulloret (horizontal dhe vertikal); direktivat (vetëm vertikal)	Aplikim i ndryshëm, p.sh. Francë (Perreux)
Parimi i përparësisë	Ligjet kombëtare nuk zbatohen në rast konflikti	Pranohet (Gjermani, Itali), me disa rezerva
Sfidat kryesore	Mungesa e efektit horizontal për direktivat	Hezitim për aplikim për shkak të sovranitetit
Qasja ndaj të drejtave të individëve	Qytetari si subjekt aktiv i të drejtës së BE-së	Zbatim i ndryshëm në varësi të kapaciteteve

transformuar raportet midis qytetarëve dhe institucioneve, si dhe ka shërbyer si një mekanizëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve europianë dhe zbatimin efektiv të

Sfida të reja për parimin e drejtpërdrejtë në kontekstin e zhvillimeve të BE-së

Parimi i drejtpërdrejtë ka qenë një mekanizëm

³⁷ Schütze, 2021, p. 125

³⁸ Weatherill, 2020, p. 245

thelbësor për garantimin e zbatimit efektiv të së drejtës së Bashkimit Europian (BE), por zhvillimet e fundit brenda BE-së, ndryshimet politike dhe juridike në shtetet anëtare, si dhe evolucioni i rendit juridik europian kanë nxjerrë në pah sfida të reja për funksionimin e këtij parimi. Këto sfida lidhen me forcimin e të drejtave të individëve, raportet ndërmjet të drejtës së BE-së dhe të drejtës kushtetuese kombëtare, ndryshimet në kuadrin institucional të BE-së, si dhe konteksti i krizave të brendshme dhe të jashtme me të cilat përballlet BE-ja³⁹. Zhvillimi i vazhdueshëm i legjislacionit të BE-së dhe krijimi i mekanizmave të reja ligjore kanë sjellë një rritje të kompleksitetit të së drejtës europiane, duke krijuar vështirësi për gjykatat kombëtare në identifikimin e dispozitave që kanë efekt të drejtpërdrejtë dhe kriteret e aplikimit të tyre. Për shembull, rregulloret e BE-së mund të kenë dispozita që kërkojnë interpretim për të kuptuar nëse krijojnë të drejta për individët, ndërsa direktivat shpesh kërkojnë transpozim kombëtar dhe interpretim konform, gjë që rrit pasigurinë juridike⁴⁰.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet mungesa e efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, që kufizon mundësinë e individëve për të mbrojtur të drejtat e tyre ndaj subjekteve private. Ky kufizim është kritikuar si një pengesë për zbatimin e plotë të të drejtave të garantuara nga e drejta e BE-së, sidomos në fushat që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të punonjësve dhe të konsumatorëve⁴¹. Gjykata e Drejtësisë ka tentuar të adresojë këtë sfidë përmes përdorimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së

dhe Kartës së të Drejtave Themelore, duke ofruar mbrojtje të të drejtave të individëve në mungesë të efektit horizontal të direktivave, siç u pa në rastin Mangold (2005) dhe Küçükdeveci (2010)⁴².

Tensionet me gjykatat kushtetuese kombëtare

Zhvillimet e fundit kanë nxjerrë në pah tensione ndërmjet parimit të drejtpërdrejtë dhe jurisprudence së gjykatave kushtetuese kombëtare, të cilat kanë rritur shqetësimet për respektimin e sovranitetit kushtetues kombëtar. Në Gjermani, vendimi i Gjykatës Kushtetuese Federale për PSPP (2020) sfidoi kompetencën e Gjykatës së Drejtësisë, duke deklaruar se disa vendime të BE-së mund të tejkalojnë kompetencat e deleguara dhe mund të mos zbatohen në Gjermani, çka përbën një sfidë të drejtpërdrejtë për funksionimin e parimit të drejtpërdrejtë⁴³. Këto tensione mund të dobësojnë unitetin e rendit juridik të BE-së dhe të krijojnë pasiguri për zbatimin e të drejtës europiane në nivel kombëtar, sidomos në shtetet që kanë jurisprudence të fortë kushtetuese për sovranitetin kombëtar⁴⁴.

Për vendet që janë në proces të përafrimit me BE-në, si Shqipëria, zbatimi i parimit të drejtpërdrejtë përballlet me sfida të kapaciteteve institucionale, mungesës së eksperiencës së gjyqtarëve dhe harmonizimit të ligjeve kombëtare me *acquis communautaire*. Mungesa e kapaciteteve mund të vonojë aplikimin e plotë të të drejtës europiane dhe përdorimin e parimit të drejtpërdrejtë si instrument mbrojtës për individët⁴⁴. Krizat politike, si Brexit, rritja e euroskepticizmit në disa shtete anëtare dhe sfidat që lidhen me sundimin e

³⁹ Craig & de Búrca, 2020, p. 220

⁴⁰ Weatherill, 2020, p. 247

⁴¹ Case 152/84 Marshall, 1986, p. 732; Case C-91/92 Faccini Dori, 1994, p. I-3348

⁴² Case C-144/04 Mangold, 2005, p. I-10014; Case C-555/07 Küçükdeveci,

2010, p. I-368 ¹⁵¹ BVerfG, 2 BvR 859/15, 2020, p. 12

⁴³ Schütze, 2021, p. 132

⁴⁴ Krasniqi, 2021, p. 98

ligjit në shtete si Polonia dhe Hungaria, kanë krijuar një ambient të ri sfidues për funksionimin e parimit të drejtpërdrejtë, pasi zbatimi i së drejtës së BE-së mund të vihet në pikëpyetje nëse shtetet anëtare nuk respektojnë parimet themelore të BE-së dhe vendimet e Gjykatës së Drejtësisë⁴⁵. Gjithashtu, sfida të reja lidhen me përdorimin e parimeve të së drejtës së BE-së në fushat e reja, si inteligjenca artificiale, mbrojtja e të dhënave personale dhe transformimi dixhital, ku nevojitet përcaktimi i qartë i të drejtave që mund të zbatohen drejtpërdrejt dhe roli i Gjykatës së Drejtësisë në interpretimin e tyre.

Në këtë kontekst të sfidave të reja, ka një nevojë për rikonceptim të parimit të drejtpërdrejtë, për të siguruar që individët të kenë qasje efektive në drejtësi dhe të drejtat e tyre të mbrohen në mënyrë praktike.

Opsione të mundshme për zhvillimin e mëtejshëm të këtij parimi përfshijnë:

Zgjerimin e efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat në fusha të caktuara.

Përdorimin më të gjerë të Kartës së të Drejtave Themelore në lidhje me dispozitat e së drejtës së BE-së.

Rritjen e trajnimeve për gjyqtarët kombëtarë në aplikimin e së drejtës europiane.

Forcimin e dialogut ndërmjet gjykatave kombëtare dhe GJDBE për të shmangur tensionet institucionale dhe për të siguruar unitetin e rendit juridik të BE-së⁴⁶.

Sfida të reja për parimin e drejtpërdrejtë në kontekstin e zhvillimeve të BE-së tregojnë se, pavarësisht suksesit të tij në të kaluarën, ky parim përballet me pengesa që kërkojnë një qasje të kujdesshme dhe të koordinuar ndërmjet

Gjykatës së Drejtësisë, gjykatave kombëtare dhe institucioneve të BE-së. Vetëm përmes adaptimit të vazhdueshëm dhe forcimit të kapaciteteve të shteteve anëtare mund të sigurohet që parimi i drejtpërdrejtë të mbetet një mekanizëm funksional për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve europianë dhe për forcimin e rendit juridik të BE-së.

E ardhmja e parimit të drejtpërdrejtë në BE

Parimi i drejtpërdrejtë ka qenë një ndër themelet juridike që ka forcuar ndërtimin e rendit juridik të Bashkimit European (BE) dhe ka kontribuar në përafrimin e së drejtës europiane me qytetarët e saj. Megjithatë, sfidat bashkëkohore që përfshijnë rritjen e kompleksitetit të së drejtës së BE-së, tensionet me sovranitetin kombëtar dhe zhvillimet teknologjike kërkojnë një reflektim mbi të ardhmen e këtij parimi dhe adaptimin e tij ndaj konteksteve të reja ligjore dhe politike⁴⁷. Një nga debatet më të rëndësishme për të ardhmen e parimit të drejtpërdrejtë është mundësia e zgjerimit të efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të individëve edhe në marrëdhëniet midis subjekteve private. Aktualisht, kufizimi i efektit horizontal për direktivat, i konfirmuar në raste si Marshall (1986) dhe Faccini Dori (1994), ka krijuar boshllëqe në zbatimin e të drejtës së BE-së, duke kufizuar aftësinë e individëve për të kërkuar zbatim të drejtpërdrejtë të të drejtave që rrjedhin nga direktivat⁴⁸.

Rritja e kompleksitetit të marrëdhënieve ligjore në tregun e përbashkët, si dhe nevoja për mbrojtje efektive të të drejtave të punonjësve dhe konsumatorëve, nxit diskutimin për të shqyrtuar

⁴⁵ Craig & de Búrca, 2020, p. 221

⁴⁶ Schütze, 2021, p. 134

⁴⁷ Craig & de Búrca, 2020, p. 224

⁴⁸ Case 152/84 Marshall, 1986, p. 732; Case C-91/92 Faccini Dori, 1994, p. I-3349 ¹⁵⁸ Schütze, 2021, p. 135

mundësinë që Gjykata e Drejtësisë të zhvillojë më tej jurisprudencën e saj, duke zgjeruar efektin horizontal në fusha të caktuara për të garantuar efektivitetin e së drejtës së BE-së¹⁵⁸. Në të ardhmen, Karta e të Drejtave Themelore të BE-së (2000) mund të luajë një rol qendror në forcimin e parimit të drejtpërdrejtë, duke shërbyer si bazë për aplikimin horizontal të disa të drejtave, siç u pa në rastet Mangold (2005) dhe Küçükdeveci (2010)⁴⁹. Kjo mund të ndihmojë në tejkalimin e kufizimeve aktuale dhe të krijojë një urë ndërmjet të drejtës së BE-së dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të individëve në marrëdhëniet horizontale. Gjithashtu, përdorimi i parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së mund të shërbejë për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të individëve, duke lejuar gjykatat kombëtare të zbatojnë këto parime në rastet kur dispozitat e direktivave nuk mund të aplikohen drejtpërdrejt.

Harmonizimi me sovranitetin kushtetues kombëtar

Në dekadat e ardhshme, një sfidë do të jetë balancimi ndërmjet parimit të drejtpërdrejtë dhe ruajtjes së sovranitetit kushtetues të shteteve anëtare, veçanërisht pas vendimeve të fundit të Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë në çështjen PSPP (2020), ku u ngritën pikëpyetje mbi kufijtë e kompetencave të BE-së¹⁶⁰. Për të garantuar efektivitetin e së drejtës së BE-së pa krijuar tensione institucionale, është e nevojshme të forcohet dialogu ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë dhe gjykatave kushtetuese kombëtare. Ky dialog do të ndihmojë në ruajtjen e unitetit të rendit juridik të BE-së, pa cenuar bazat kushtetuese të shteteve anëtare dhe duke rritur legjitimitetin e

rendit juridik europian në sytë e qytetarëve europianë. Zhvillimi i teknologjive të reja, përfshirë inteligjencën artificiale, mbrojtjen e të dhënave personale dhe transformimin dixhital të shërbimeve, kërkon një përshtatje të konceptit të parimit të drejtpërdrejtë për të garantuar që qytetarët të mund të mbrojnë të drejtat e tyre në këto fusha të reja. Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) është një shembull pozitiv se si rregulloret mund të aplikohen drejtpërdrejt dhe të mbrojnë të drejtat e qytetarëve në mënyrë efektive⁵⁰. Në të ardhmen, është e nevojshme që legjislacioni i BE-së të hartohet në mënyrë të tillë që të mundësojë zbatimin e drejtpërdrejtë të të drejtave në fushat dixhitale, duke ofruar siguri juridike për qytetarët dhe bizneset që veprojnë në tregun e brendshëm. Për të siguruar një zbatim efektiv të parimit të drejtpërdrejtë, është e domosdoshme që gjykatat kombëtare të kenë kapacitete të mjaftueshme ligjore dhe njohuri mbi të drejtën e BE-së. Ky aspekt është veçanërisht i rëndësishëm për vendet në proces integrimi si Shqipëria, ku përgatitja e gjyqtarëve dhe avokatëve në zbatimin e së drejtës europiane është një hap i domosdoshëm për integrimin efektiv në BE⁵¹. Në tërësi, e ardhmja e parimit të drejtpërdrejtë duhet të shihet si një proces evolutiv që forcon mbrojtjen e të drejtave të individëve, ruan unitetin e rendit juridik të BE-së dhe kontribuon në funksionimin e tregut të brendshëm. Kjo kërkon një qasje pragmatike dhe të koordinuar ndërmjet institucioneve të BE-së, Gjykatës së Drejtësisë dhe gjykatave kombëtare. Zgjerimi i kapaciteteve interpretative të Gjykatës së Drejtësisë, përdorimi i Kartës së të Drejtave Themelore, forcimi i trajnimeve dhe rritja e bashkëpunimit institucional do të jenë shtyllat kryesore për sigurimin e suksesit të këtij

⁴⁹ Case C-144/04 Mangold, 2005, p. I-10015; Case C-555/07 Küçükdeveci, 2010, p. I-369 ¹⁶⁰ BVerfG, 2 BvR 859/15, 2020, p. 15

⁵⁰ Weatherill, 2020, p. 249

⁵¹ Krasniqi, 2021, p. 100

parimi në dekadat e ardhshme. Parimi i drejtpërdrejtë do të mbetet një mjet i fuqishëm ligjor për mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe për sigurimin e zbatimit efektiv të së drejtës së BE-së. Megjithatë, përballja me sfidat e reja kërkon fleksibilitet dhe zhvillim të mëtejshëm të këtij parimi, duke e përshtatur atë ndaj konteksteve të reja dixhitale, sociale dhe kushtetuese, për të garantuar që BE të mbetet një hapësirë ku sundimi i ligjit dhe mbrojtja e të drejtave të individëve janë prioritet absolut.

Vlerësimi i rëndësisë së parimit për të drejtën dhe qytetarët e BE-së

Parimi i drejtpërdrejtë është një nga arritjet më të rëndësishme juridike të Bashkimit European (BE), pasi ka transformuar mënyrën e zbatimit të së drejtës europiane dhe ka ndryshuar natyrën e marrëdhënies ndërmjet individëve dhe rendit juridik të BE-së. Ky parim i ka kthyer qytetarët europianë në subjekte aktive të së drejtës së BE-së, duke forcuar të drejtat e tyre, garantuar funksionimin e tregut të brendshëm dhe konsoliduar shtetin e së drejtës në të gjithë hapësirën europiane⁵². Parimi i drejtpërdrejtë, i vendosur nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së në rastin Van Gend en Loos (1963), ndryshoi tërësisht karakterin e traktateve themeluese të BE-së, duke i kthyer ato nga marrëveshje ndërqeveritare në burime të drejtpërdrejta të të drejtave për individët⁵³. Kjo solli krijimin e një rend juridik supranacional, ku ligji europian ka përparësi ndaj ligjeve kombëtare dhe zbatohet drejtpërdrejt nga gjykatat kombëtare⁵⁴.

Ky transformim ka garantuar që ligji europian të

mos mbetet vetëm një instrument politik ose institucional, por të ketë një ndikim praktik në jetën e përditshme të qytetarëve europianë, duke siguruar që të drejtat e tyre të jenë të mbrojtura dhe të zbatueshme në praktikë⁵⁵. Parimi i drejtpërdrejtë ka krijuar një mekanizëm efektiv për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, duke i lejuar ata të kërkojnë zbatimin e dispozitave të së drejtës së BE-së në gjykatat kombëtare, pa qenë të varur nga autoritetet kombëtare për transpozimin ose miratimin e legjislacionit kombëtar. Rastet Defrenne v Sabena (1976) dhe Reyners v Belgium (1974) janë shembuj klasikë ku individët kanë fituar të drejta konkrete përmes parimit të drejtpërdrejtë, duke forcuar barazinë gjinore dhe lirinë e vendosjes⁵⁶. Ky parim forcon qytetarinë europiane dhe besimin e qytetarëve tek BE si garantues i të drejtave dhe lirive të tyre themelore, duke krijuar një lidhje të drejtpërdrejtë midis individëve dhe rendit juridik të BE-së¹⁶⁸. Parimi i drejtpërdrejtë ka një rëndësi të veçantë për funksionimin e tregut të brendshëm të BE-së, pasi lejon individët dhe subjektet ekonomike të mbrojnë liritë e tyre themelore, si lirinë e lëvizjes së mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe personave, kundër masave kombëtare që mund të jenë në kundërshtim me të drejtën e BE-së⁵⁷.

Në rastin Simmenthal (1978), Gjykata konfirmoi se gjykatat kombëtare janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e së drejtës së BE-së me efekt të drejtpërdrejtë dhe të injorojnë çdo dispozitë kombëtare që bie në kundërshtim me to, duke garantuar kështu funksionimin e një tregu të unifikuar europian⁵⁸. Parimi i drejtpërdrejtë ka ndihmuar në forcimin e sundimit të ligjit në BE,

⁵² Craig & de Búrca, 2020, p. 226

⁵³ Van Gend en Loos, 1963, p. 18

⁵⁴ Case 6/64 Costa v ENEL, 1964, p. 602

⁵⁵ Hartley, 2014, p. 265

⁵⁶ Case 43/75

Defrenne, 1976, p.

464; Case 2/74

Reyners, 1974, p.

642 ¹⁶⁸ Schütze,

2021, p. 137

⁵⁷ Weatherill, 2020, p. 251

⁵⁸ Case 106/77 Simmenthal, 1978, p. 638

pasi ka garantuar zbatimin efektiv të ligjit europian në të gjitha shtetet anëtare, pavarësisht ndryshimeve në traditat ligjore ose presioneve politike në nivel kombëtar. Ky parim detyron shtetet anëtare të respektojnë dispozitat e së drejtës së BE-së dhe i jep qytetarëve një mjet të fuqishëm për të kërkuar mbrojtjen e të drejtave të tyre⁵⁹. Gjithashtu, parimi i drejtpërdrejtë ndihmon në forcimin e llogaridhënies së institucioneve kombëtare dhe promovon një sistem gjyqësor ku qytetarët kanë mundësi të kërkojnë drejtësi në rast të shkeljes së të drejtave që rrjedhin nga ligji europian⁶⁰. Pavarësisht rëndësisë së tij, parimi i drejtpërdrejtë nuk është pa kufizime. Një nga kufizimet kryesore është mungesa e efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, që kufizon mundësinë e individëve për të kërkuar zbatimin e të drejtave ndaj subjekteve private, siç u konfirmua në rastet Marshall (1986) dhe Faccini Dori (1994)⁶¹.

Ky kufizim ka krijuar sfida për mbrojtjen e plotë të të drejtave të qytetarëve europianë, veçanërisht në fushat ku direktivat luajnë një rol qendror, si mbrojtja e konsumatorëve, punësimi dhe mjedisi¹⁷⁴. Në të ardhmen, parimi i drejtpërdrejtë do të vazhdojë të ketë një rol kyç në rendin juridik të BE-së, por do të kërkojë përshtatje me sfidat bashkëkohore, si transformimi dixhital, mbrojtja e të dhënave personale dhe nevoja për të ruajtur balancën ndërmjet rendit juridik të BE-së dhe sovranitetit kombëtar të shteteve anëtare⁶². Forcimi i rolit të Kartës së të Drejtave Themelore dhe përdorimi më i gjerë i parimeve të përgjithshme të së drejtës së BE-së mund të shërbejnë si mekanizma plotësues për të forcuar zbatimin e

parimit të drejtpërdrejtë dhe për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të qytetarëve europianë në dekadat e ardhshme⁶³.

Parimi i drejtpërdrejtë ka një rëndësi thelbësore për të drejtën dhe qytetarët e BE-së, pasi siguron mbrojtjen e të drejtave individuale, funksionimin e tregut të brendshëm, forcimin e sundimit të ligjit dhe ruajtjen e unitetit të rendit juridik europian. Pavarësisht sfidave që has, ky parim mbetet një nga shtyllat më të forta të BE-së dhe një garanci për të ardhmen e saj si një hapësirë ku të drejtat e qytetarëve respektohen dhe mbrohen në mënyrë efektive.

Përfundime

Parimi i drejtpërdrejtë përfaqëson një ndër zhvillimet më të rëndësishme të rendit juridik të Bashkimit Europian (BE), duke transformuar mënyrën e funksionimit të së drejtës europiane dhe raportin e saj me qytetarët dhe shtetet anëtare. Nëpërmjet këtij parimi, BE ka arritur të sigurojë zbatimin efektiv të dispozitave të saj ligjore, duke garantuar që individët të kenë mundësinë të mbrojnë të drejtat e tyre para gjykatave kombëtare dhe të ndikojnë drejtpërdrejt në respektimin e të drejtës së BE-së në nivel kombëtar⁶⁴. Vendimi historik Van Gend en Loos (1963) vendosi themelet e këtij parimi, duke deklaruar që Traktatet e BE-së krijojnë një rend juridik të ri ndërkombëtar, ku jo vetëm shtetet anëtare, por edhe individët kanë të drejta dhe detyrime të cilat gjykatat kombëtare duhet t'i mbrojnë⁶⁵. Ky parim, i kombinuar me parimin e përparësisë, siç u konfirmua në rastin Costa v ENEL (1964), siguron që në rast konflikti midis ligjit kombëtar

⁵⁹ Craig & de Búrca, 2020, p. 227

⁶⁰ Schütze, 2021, p. 139

⁶¹ Case 152/84 Marshall, 1986, p. 733; Case C-91/92 Faccini Dori, 1994, p. I-3350 ¹⁷⁴ Craig & de Búrca, 2020, p. 228

⁶² Weatherill, 2020, p. 253

⁶³ Schütze, 2021, p. 140

⁶⁴ Craig & de Búrca, 2020, p. 230

⁶⁵ Van Gend en Loos, 1963, p. 19

dhe të drejtës së BE-së, kjo e fundit të ketë përparësi, duke u zbatuar drejtpërdrejt në të gjitha shtetet anëtare⁶⁶.

Parimi i drejtpërdrejtë ka forcuar rolin e individit në rendin juridik europian, duke i kthyer qytetarët europianë në subjekte aktive që mund të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Rastet *Defrenne v Sabena* (1976) dhe *Reyners v Belgium* (1974) janë dëshmi të aplikimit të këtij parimi në praktikë, ku individët kanë mundur të mbrojnë të drejtat e tyre në lidhje me barazinë gjinore dhe lirinë e vendosjes⁶⁷. Gjithashtu, ky parim ka luajtur një rol të rëndësishëm në garantimin e funksionimit të tregut të brendshëm të BE-së, duke u siguruar që katër liritë themelore të BE-së të respektohen dhe të mbrohen në mënyrë efektive nga individët dhe subjektet ekonomike, përballë masave kombëtare që mund të pengojnë funksionimin e tyre⁶⁸. Në këtë kontekst, rasti *Simmenthal* (1978) konfirmoi detyrimin e gjykatave kombëtare për të zbatuar dispozitat e së drejtës së BE-së me efekt të drejtpërdrejtë dhe për të mos zbatuar dispozitat kombëtare që bien ndesh me to⁶⁹. Megjithatë, parimi i drejtpërdrejtë nuk është pa sfida dhe kufizime. Një nga kufizimet më të mëdha është mungesa e efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, siç u konfirmua në rastet *Marshall* (1986) dhe *Faccini Dori* (1994), duke kufizuar mundësinë e individëve për të kërkuar zbatimin e të drejtave që rrjedhin nga direktivat ndaj subjekteve private⁷⁰. Kjo ka krijuar hendek në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, veçanërisht në fushat ku direktivat kanë një rol të rëndësishëm, si

mbrojtja e punonjësve dhe konsumatorëve. Për të adresuar këto kufizime, Gjykata e Drejtësisë ka zhvilluar mekanizma plotësues si interpretimi konform dhe parimi i përgjegjësisë së shtetit, duke mundësuar mbrojtjen e të drejtave të individëve edhe në rastet kur parimi i drejtpërdrejtë nuk mund të aplikohet në mënyrë të plotë. Në rastin *Von Colson* (1984), Gjykata theksoi se gjykatat kombëtare duhet të interpretojnë ligjin kombëtar në përputhje me direktivat e BE-së, ndërsa në rastin *Francovich* (1991), u vendos përgjegjësia e shtetit për dëmshpërblimin e individëve për moszbatimin e direktivave⁷¹. Në të ardhmen, parimi i drejtpërdrejtë mbetet një garanci për funksionimin efektiv të rendit juridik të BE-së dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve europianë, por kërkon adaptim ndaj sfidave bashkëkohore. Rritja e kompleksitetit të së drejtës së BE-së, zhvillimet dixhitale dhe tensionet me sovranitetin kushtetues të shteteve anëtare kërkojnë një qasje të balancuar ndërmjet ruajtjes së efektivitetit të së drejtës së BE-së dhe respektimit të parimeve kushtetuese kombëtare¹⁸⁵.

Zgjerimi i përdorimit të Kartës së të Drejtave Themelore dhe forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë dhe gjykatave kombëtare janë hapësira që mund të shfrytëzohen për të forcuar zbatimin e parimit të drejtpërdrejtë dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të individëve në mënyrë efektive në BE⁷². Për Shqipërinë dhe vendet e tjera që janë në proces integrimi, parimi i drejtpërdrejtë do të ketë një rol të rëndësishëm në harmonizimin e së drejtës kombëtare me atë të BE-së dhe në

⁶⁶ Case 6/64 *Costa v ENEL*, 1964, p. 603

⁶⁷ Case 43/75 *Defrenne*, 1976, p. 465; Case 2/74 *Reyners*, 1974, p. 643

⁶⁸ Weatherill, 2020, p. 255

⁶⁹ Case 106/77 *Simmenthal*, 1978, p. 640

⁷⁰ Case 152/84 *Marshall*, 1986, p. 734; Case C-91/92 *Faccini Dori*, 1994, p. I-3351

⁷¹ Case 14/83 *Von Colson*, 1984, p. 1915; Case C-6/90 *Francovich*, 1991, p. I-5369 ¹⁸⁵ Schütze, 2021, p. 142

⁷² Craig & de Búrca, 2020, p. 232

përgatitjen e sistemit gjyqësor për zbatimin e të drejtës europiane. Kjo kërkon trajnimin e gjyqtarëve dhe forcimin e kapaciteteve të institucioneve për të siguruar që qytetarët shqiptarë të mund të përfitojnë nga ky mekanizëm menjëherë pas anëtarësimit⁷³.

Rekomandime

Pas analizës së thelluar të parimit të drejtpërdrejtë në jurisprudencën e Bashkimit European (BE), rolin të tij në të drejtën e BE-së dhe ndikimit të tij te qytetarët europianë, rezultojnë e nevojshme hartimi i rekomandimeve konkrete për forcimin e zbatimit dhe efektivitetit të këtij parimi, si dhe përshtatja e tij me sfidat bashkëkohore që lidhen me zhvillimet dixhitale, ndryshimet socio-ekonomike dhe nevojën për ruajtjen e unitetit të rendit juridik të BE-së.

1. Zgjerimi i efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat

Një nga rekomandimet kryesore është rishqyrtimi i kufizimeve aktuale të efektit horizontal të drejtpërdrejtë për direktivat, i cili kufizon mundësinë e qytetarëve për të mbrojtur të drejtat e tyre ndaj subjekteve private, siç u konfirmua në rastet Marshall (1986) dhe Faccini Dori (1994)⁷⁴. BE duhet të marrë në konsideratë zgjerimin e këtij efekti në fusha të caktuara, si mbrojtja e të drejtave të punonjësve, e konsumatorëve dhe e mjedisit, për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të qytetarëve europianë në të gjitha nivelet.

2. Rritja e transparencës dhe edukimit juridik për qytetarët

Qytetarët europianë shpesh nuk janë të ndërgjegjshëm për të drejtat që rrjedhin nga ligji

i BE-së dhe mekanizmat që mund të përdorin për të mbrojtur këto të drejta. Prandaj, BE dhe shtetet anëtare duhet të ndërmarrin fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi juridik, duke ofruar trajnime dhe udhëzues praktikë për qytetarët në lidhje me mënyrën e përdorimit të parimit të drejtpërdrejtë për të mbrojtur të drejtat e tyre përpara gjykatave kombëtare¹⁸⁹.

3. Forcimi i rolit të gjykatave kombëtare si garante të së drejtës së BE-së

Për të siguruar zbatimin efektiv të parimit të drejtpërdrejtë, është e nevojshme që gjykatat kombëtare të kenë kapacitete të mjaftueshme për zbatimin e së drejtës së BE-së dhe për interpretimin e dispozitave me efekt të drejtpërdrejtë. Kjo kërkon rritjen e trajnimeve për gjyqtarët dhe avokatët në fushën e të drejtës së BE-së, forcimin e bashkëpunimit ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Drejtësisë përmes procedurës paraprake dhe krijimin e një kulture juridike që respekton dhe zbaton ligjin europian në praktikë⁷⁵.

4. Përdorimi i Kartës së të Drejtave Themelore si mjet plotësues

Karta e të Drejtave Themelore të BE-së mund të shërbejë si një instrument plotësues për forcimin e zbatimit të parimit të drejtpërdrejtë, veçanërisht në rastet kur direktivat nuk mund të aplikohen drejtpërdrejt në marrëdhëniet horizontale. Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë, si në rastet Mangold (2005) dhe Küçükdeveci (2010), ka treguar se parimet e përgjithshme të së drejtës së BE-së dhe Karta mund të shërbejnë si bazë për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve kundër subjekteve private, duke përmirësuar kështu nivelin e mbrojtjes juridike në BE⁷⁶.

5. Adaptimi i parimit ndaj sfidave dixhitale dhe

⁷³ Krasniqi, 2021, p. 102

⁷⁴ Case 152/84 Marshall, 1986, p. 734; Case C-91/92 Faccini Dori, 1994, p. I-3352 ¹⁸⁹ Craig & de Búrca, 2020, p. 235

⁷⁵ Hartley, 2014, p. 268

⁷⁶ Case C-144/04 Mangold, 2005, p. I-10016; Case C-555/07 Küçükdeveci, 2010, p. I-370

zhvillimeve të reja

Në epokën e transformimit dixhital, BE duhet të sigurojë që parimi i drejtpërdrejtë të mund të zbatohet edhe në fushat e reja që lidhen me teknologjinë, inteligjencën artificiale dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Krijimi i kuadrit ligjor të përshtatshëm që mundëson aplikimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të reja në këto fusha do të garantojë që qytetarët të kenë mundësi të mbrojnë të drejtat e tyre edhe në sektorët e rinj të aktivitetit ekonomik dhe social.⁷⁷

6. Zbatimi i parimit të drejtpërdrejtë në vendet në proces integrimi

Për vendet që janë në proces integrimi, si Shqipëria, rekomandohet përafrimi i legjislacionit kombëtar me *acquis communautaire* të BE-së, krijimi i mekanizmave të brendshëm që lejojnë zbatimin e drejtpërdrejtë të dispozitave të marrëveshjeve të stabilizim-asociimit dhe forcimi i kapaciteteve të gjykatave kombëtare për të zbatuar parimin e drejtpërdrejtë në praktikë. Kjo do të mundësojë një proces të suksesshëm integrimi dhe përgatitjen e qytetarëve shqiptarë për të përfituar të drejtat që rrjedhin nga e drejta e BE-së pas anëtarësimit⁷⁸.

7. Forcimi i dialogut ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë dhe gjykatave kombëtare

Për të garantuar zbatim të njëtrajtshëm të së drejtës së BE-së dhe parimit të drejtpërdrejtë, rekomandohet forcimi i përdorimit të procedurës paraprake⁷⁹, si dhe zhvillimi i një dialogu të hapur ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Gjykatës së Drejtësisë. Kjo do të ndihmojë në zgjidhjen e paqartësive interpretative, shmangien e tensioneve ndërmjet ligjit evropian dhe ligjeve kombëtare dhe forcimin e unitetit të rendit juridik

Të BE-së⁸⁰.

Zbatimi efektiv i këtyre rekomandimeve do të ndihmojë ruajtjen e rolit thelbësor të parimit të drejtpërdrejtë në të drejtën e BE-së dhe forcimin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve evropianë, duke e përshtatur këtë parim me zhvillimet e reja sociale, teknologjike dhe ligjore. Parimi i drejtpërdrejtë mbetet një mjet thelbësor për funksionimin e rendit juridik të BE-së dhe garantimin e të drejtave të qytetarëve, ndaj zhvillimi dhe përshtatja e tij me sfidat bashkëkohore është thelbësore për të ardhmen e BE-së si një hapësirë e së drejtës, demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave themelore.

⁷⁷ Weatherill, 2020, p. 257

⁷⁸ Krasniqi, 2021, p. 104

⁷⁹ neni 267 TFBE

intervistave me profesionistë të fushës (avokatë,

Trajtimi i të miturve në një qasje krahasimore ndërmjet rendit juridik shqiptar dhe atij evropian.

Elisa Beke

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Prof.As. Jonida Mehmetaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakti

Trajtimi i të miturve në një qasje krahasimore ndërmjet rendit juridik shqiptar dhe atij european është një çështje e rëndësishme në kontekstin e reformave të sistemit të drejtësisë penale. Objektivi i këtij studimi është të analizojë dhe vlerësojë përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit European në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin, si dhe të identifikojë sfidat praktike në zbatimin e këtij legjislacioni. Përmes një qasjeje krahasuese, studimi shqyrton përvojat e shteteve të BE-së dhe veçanërisht modelet e suksesshme në garantimin e të drejtave të të miturve.

Duke u mbështetur në literaturën shkencore dhe analizën e të dhënave të mbledhura përmes

gjyqtarë, punonjës socialë, përfaqësues të OJF-ve), synohet të nxirren përfundime të vlefshme mbi nivelin e përputhjes së sistemit shqiptar me praktikatat europiane. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se, ndonëse janë ndërmarrë hapa pozitivë në përafrimin e legjislacionit, zbatimi praktik i të drejtave të të miturve mbetet sfidues. Ky studim gjithashtu sugjeron masa konkrete për përmirësimin e trajtimit të të miturve në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Fjalë kyçe: të miturit, drejtësia penale, Shqipëria, Bashkimi European, qasje krahasimore, të drejtat e njeriut, rehabilitim.

Abstract

The treatment of minors in a comparative approach between the Albanian and European legal systems is an important issue in the context of criminal justice system reforms. The aim of this study is to analyze and evaluate the compatibility of Albanian legislation with European Union standards in the treatment of minors in conflict with the law, as well as to identify the practical challenges in the implementation of this legislation. Through a comparative approach, the study examines the experiences of EU member states and particularly successful models in ensuring the rights of minors.

Relying on scientific literature and the analysis of data collected through interviews with professionals in the field (lawyers, judges, social workers, and NGO representatives), the study aims to draw valuable conclusions regarding the level of alignment of the Albanian system with European practices. The findings of the research show that although positive steps have been taken to harmonize legislation, the practical implementation of minors' rights remains challenging. This study also suggests concrete measures for improving the treatment of minors in line with international standards.

Keywords: *minors, criminal justice, Albania, European Union, comparative approach, human rights, rehabilitation.*

Interpretim i rendit juridik evropian

Ligji në Evropë është i mbështetur në një sistem institucional të zhvilluar që synon të sigurojë drejtësi dhe të mbrojë të drejtat e njeriut në mënyrë efikase. Në thelb të këtij sistemi qëndron Këshilli i Evropës, një organizatë ndërqeveritare e themeluar për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet vendeve anëtare. Një nga instrumentet më të rëndësishme që ai ka krijuar është Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila garanton një sërë të drejtash themelore për të gjithë qytetarët e vendeve anëtare. Për të siguruar zbatimin e këtyre të drejtave, është krijuar Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), me seli në Strasburg.⁸⁰ Personat që ndihen të dëmtuar nga veprimet e shtetit mund të paraqesin kërkesë në gjykatë, e cila shqyrton çdo rast.⁸¹ Vendimet e saj kanë karakter të detyrueshëm ligjorë në vendet anëtare.⁸² Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të miturve është një nga funksionet kryesore të kësaj gjykate.⁸³ Përveç Këshillit të Evropës, Bashkimi Evropian ka një rol gjithashtu të rëndësishëm në përcaktimin e standardeve ligjore për të drejtat e njeriut, përfshirë Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore. Fëmijët që përballen me sistemin penal përfshihen në mbrojtjen që ofrohet nga këto instrumente, të cilat ruajnë dinjitetin njerëzor. Ligjet evropiane punojnë për të krijuar një kornizë të përbashkët që trajton të miturit me respekt dhe në përputhje me moshëb e tyre. Ai nxit përdorimin e masave alternative ndaj ndëshkimit penal dhe mbrojtjen e interesit më të mirë të

⁸⁰ Shih: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 19.

⁸¹ Shih: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 34 dhe neni 35.

⁸² Shih: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 46, pika 1.

⁸³ Shih: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 8

fëmijës në çdo fazë të procesit gjyqësor.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një traktat ndërkombëtar i miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950.⁸⁴ Më 1953, KEDNJ mori fuqi ligjore, duke vendosur standarde të detyrueshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Evropë.⁸⁵ Konventa shërben si bazë për zhvillimin e jurisprudencës evropiane të të drejtave të njeriut.⁸⁶ Ajo siguron një kornizë të përbashkët ligjore për garantimin e të drejtave civile dhe politike të çdo individi.⁸⁷ Me dispozita për të drejta themelore KEDNJ mbështetet në GJEDNJ për zbatim të drejtë dhe të barabartë në të gjithë Evropën.⁸⁸ Individët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Evropiane vetëm pasi të kenë shfrytëzuar rrugët juridike kombëtare.⁸⁹ Vendimet e GJEDNJ-së janë detyruese për shtetet palë dhe kanë ndikuar drejtpërdrejt në reformat e brendshme ligjore të shumë vendeve, përfshirë Shqipërinë.⁹⁰

Trajtimi i të miturit në sistemin penal ndikohet drejtpërdrejt nga ndalimi i torturës në nenin 3 të Konventës.⁹¹ Neni 5 garanton të drejtën për liri dhe siguri, duke theksuar se ndalimi i të miturve

duhet të jetë i justifikuar dhe proporcional.⁹² Të miturit kanë të drejtën për një gjykim të drejtë sipas nenit 6, që është thelb për proceset penale.⁹³ Në të njëjtën kohë, neni 8 garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.⁹⁴ Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ruajtjen e privatësisë së të miturve në konflikt me ligjin. GJEDNJ ka theksuar në vendimet e saj nevojën për mbrojtje të veçantë për fëmijët, duke u bazuar në kontestin shoqëror.⁹⁵ Vendimet e saj kanë çuar në e legjislacionit në lidhje me ndalimin e të miturve, kushtet e paraburgimit dhe respektimin e të drejtave procesuale. Standardet minimale për të drejtat e njeriut në Evropë janë forcuar nëpërmjet Konventës.⁹⁶ Ajo mbështetet nga një sistem monitorimi efikas që nxit shtetet ta zbatojnë në praktikë. Shqipëria e ratifikoi KEDNJ-në në vitin 1996 dhe ka detyrimin të përputhë legjislacionin e saj me standardet e saj. Reforma në drejtësi ka nxitur Shqipërinë të adaptojë masa për mbrojtjen më të mirë të të miturve, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Konventa i sheh të miturit jo thjesht si objekt ndëshkimi, por si persona me të drejta të plota dhe me nevojë për mbrojtje të veçantë. Në këtë kuptim, ajo nxit një qasje rehabilituese dhe jo vetëm represive në drejtësinë penale për të miturit. Ky dokument ka qenë bazë edhe për krijimin e Kartës së të

⁸⁴ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, miratuar nga Këshilli i Evropës më 4 nëntor 1950, hyri në fuqi më 3 shtator 1953.*

⁸⁵

https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/50questions_sqi

⁸⁶ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Preambulë; si dhe neni 32 lidhur me juridiksionin e Gjykatës.*

⁸⁷ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Preambulë dhe neni 1.*

⁸⁸

https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/50questions_sqi

⁸⁹ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 35, pika 1.*

⁹⁰

https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/50questions_sqi

⁹¹ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 3 – “Nuk lejohet asnjëherë tortura, trajtime çnjerëzore ose degraduese.”*

⁹² Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 5(1)(d) – ndalimi i një të mituri për qëllime edukimi ose paraqitjeje para autoritetit kompetent.*

⁹³ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 6 – E drejta për gjykim të drejtë.*

⁹⁴ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 8 – E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.*

⁹⁵ Shih: *Vendime të GJEDNJ-së lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për shembull Neulinger dhe Shuruk kundër Zvicrës (2010).*

⁹⁶ Shih: *Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Preambulë dhe dispozita të tjera themelore.*

Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian. Ndikimi i KEDNJ-së në përmirësimin e sistemeve të drejtësisë në Evropë është i pakontestueshëm.⁹⁷ Përmes saj, drejtësia nuk trajton vetëm shkeljen e ligjit, por edhe dinjitetin dhe të ardhmen e njeriut – veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijët.

Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e njohur si GjEDNJ, është një institucion kyç në sistemin juridik evropian. Ajo ka për detyrë të mbrojtë dhe zbatojë të drejtat e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. GjEDNJ shqyrton ankesat që individët apo grupet i bëjnë shteteve anëtare për shkelje të të drejtave të tyre. Vendimet e GjEDNJ-së kanë ndikuar ndjeshëm në përcaktimin e standardeve që drejtojnë ligjin dhe drejtësinë në të gjithë Evropën. Gjykata thekson rëndësinë e respektimit të dinjitetit dhe të drejtave të njeriut në çdo rast. Në rastet që përfshijnë të miturit, GjEDNJ kërkon që shtetet të marrin parasysh moshën dhe nevojat e tyre specifike. Jurisprudenca e saj ka përcaktuar se masa ndëshkuese duhet të jetë proporcionale dhe të fokusohet në rehabilitim. GjEDNJ ka nxjerrë vendime që e ndalojnë trajtimin arbitrar apo keqtrajtim të të miturve në sistemin penal. Gjykata ka theksuar gjithashtu rëndësinë e një procesi të drejtë dhe transparent. Ajo kërkon që të miturit të kenë qasje në mbrojtje ligjore dhe të informohen në mënyrë të përshtatshme. Vendimarrja juridike është ndërtuar mbi parimin

e interesit më të mirë të fëmijës, i zhvilluar nga jurisprudenca. GjEDNJ ka theksuar nevojën për masa alternative ndaj ndëshkimit penal, për të shmangur efektet negative të burgosjes. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ), përmes vendimeve të saj, ka dënuar praktikat që cenojnë privatësinë dhe integritetin e fëmijëve, duke theksuar se të miturit duhet të trajtohen me dinjitet, respekt dhe kujdes të veçantë gjatë procedurave penale. Jurisprudenca e Gjykatës ka orientuar shtetet anëtare drejt krijimit të strukturave të specializuara për fëmijët në konflikt me ligjin dhe ka nxitur bashkëpunimin ndër-institucional për garantimin e mbrojtjes dhe mbështetjes së tyre.⁹⁸ GjEDNJ ka shqyrtuar raste të ndalimeve arbitrare, mbajtjes në kushte jo të përshtatshme dhe mungesës së përfaqësimit ligjor, duke vendosur standarde që garantojnë trajtim human dhe të drejtë në sistemin e drejtësisë penale.⁹⁹ Jurisprudenca e GjEDNJ është një udhërrëfyes për reformimin e legjislacionit kombëtar. Vendimet e saj janë detyruese dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në praktikat gjyqësore. GjEDNJ ka theksuar rëndësinë e parandalimit të recidivës dhe riintegritimit social të të miturve. Jurisprudenca nxit përdorimin e masave edukative dhe rehabilituese. Gjykata ka kërkuar që proceset gjyqësore të jenë të shpejta dhe të përshtatura për fëmijët.¹⁰⁰ GjEDNJ mbështet trajnimet e vazhdueshme të profesionistëve që punojnë me të miturit. Në këtë mënyrë, ajo kontribuon në zhvillimin e një sistemi më human dhe efikas.

Në përfundim, jurisprudenca e GjEDNJ është themel për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në

⁹⁷ Shih: Raporte dhe vendime të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe analiza të Këshillit të Evropës mbi implementimin e KEDNJ-së.

⁹⁸ Shih: GjEDNJ, *Blokhin kundër Ruisë* (2016), nr. 47152/06 – ku theksohet nevoja për procedura të përshtatura për të miturit dhe për mbështetje institucionale.

⁹⁹ Shih: GjEDNJ, *Blokhin kundër Ruisë* (2016), *Assenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë* (1998) – ku theksohen standardet për mbrojtjen e të miturve në ndalim dhe e drejta për ndihmë juridike.

¹⁰⁰ Shih: GjEDNJ, *T. v. Mbretëria e Bashkuar* (2000), *Blokhin kundër Ruisë* (2016) – ku theksohet nevoja për procedura të drejta dhe të përshtatura për fëmijët.

Evropë.¹⁰¹ Ajo përcakton standardet e domosdoshme për trajtimin e drejtë dhe dinjitoz të të miturve. Kjo jurisprudencë ndihmon vendet anëtare të përmirësojnë legjislacionin dhe praktikën e tyre. GjEDNJ siguron që e drejta për një proces të drejtë dhe trajtimi human të jenë të garantuara për të gjithë.¹⁰² Këto parime kontribuojnë në ndërtimin e një drejtësie më gjithëpërfshirëse dhe sociale në Evropë.

Rekomandimet e Këshillit të Evropës: CM/Rec (2008) 11 për drejtësinë për fëmijët

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në sistemin penal është një ndër prioritetet e Këshillit të Evropës. Një dokument i rëndësishëm i miratuar prej tij është Rekomandimi CM/Rec (2008) 11, për drejtësinë për fëmijët.¹⁰³ Qëllimi i këtij rekomandimi është që të gjithë fëmijët të trajtohen me dinjitet dhe respekt gjatë çdo faze të proceseve gjyqësore. Ai thekson rëndësinë e mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës në çdo vendim që merret në sistemin e drejtësisë penale. Rekomandimi synon përdorimin e masave alternative ndaj ndëshkimit penal, të cilat duhet të jenë të përshtatshme në përputhje me moshën dhe nevojat e fëmijës.¹⁰⁴ Sipas tij, kërkohet që të miturit të kenë ndihmë ligjore të kualifikuar dhe mbështetje psikologjike gjatë gjithë procesit. Dokumenti siguron udhëzime për trajtimin e veçantë dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë ose dëshmitarë në proceset penale. Autoritetet duhen të respektojnë kërkesën për të

kufizuar sa më shumë kohën që fëmijët kalojnë në paraburgim, sipas CM/Rec (2008) 11. Rekomandimi promovon ngritjen e institucioneve të dedikuara për trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe kërkon trajnim të vazhdueshëm për stafin e sistemit të drejtësisë, duke përfshirë gjyqtarët dhe punonjësit socialë. Qëllimi kryesor është bashkëpunimi midis institucioneve për të ofruar mbrojtje dhe riintegrim.¹⁰⁵ Dokumenti nxit gjithashtu përfshirjen e familjes në procesin e trajtimit të fëmijës.¹⁰⁶ Ai thekson rëndësinë e informimit të fëmijëve në mënyrë të kuptueshme për të drejtat e tyre dhe procedurat që do të ndjekin. Rekomandimi kërkon që proceset të jenë të shpejta dhe efektive, duke shmangur vonesat që mund të dëmtojnë fëmijën. CM/Rec (2008) 11 promovon përdorimin e metodave jo-dhunore dhe të qasjes riparuese në trajtimin e të miturve.¹⁰⁷ Rekomandimi kërkon që të miturit të trajtohen si persona me të gjithë të drejtat dhe jo vetëm nga ana procedurale. Dokumenti kërkon që të respektohet privatësia dhe konfidencialiteti i fëmijëve gjatë të gjithë procedurës. Ai thekson nevojën për një qasje multidisiplinare që përfshin profesionistë të ndryshëm për të garantuar mbështetje të plotë. Rekomandimi ka ndikim të drejtpërdrejtë në legjislacionin dhe praktikën kombëtare të vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Ai është një udhërrëfyes për zhvillimin e reformave në drejtësinë për fëmijët, duke kontribuar në krijimin e një sistemi më human dhe

¹⁰¹ Shih: Jurisprudenca e GJEDNJ-së mbi të drejtat e fëmijëve, si në çështjet Blokhin kundër Rusisë, Neulinger dhe Shuruk kundër Zvicrës

¹⁰² Shih: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 3 dhe 6 – ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe e drejta për një gjykim të drejtë.

¹⁰³ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi drejtësinë për fëmijët

¹⁰⁴ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11 i Komitetit të Ministrave, pika 2 dhe

4.

¹⁰⁵ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika 8 – mbi bashkëpunimin ndër-institucional dhe qasjen gjithëpërfshirëse ndaj fëmijëve në kontakt me drejtësinë

¹⁰⁶ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika 11 – për nevojën e përfshirjes aktive të prindërve dhe kujdestarëve.

¹⁰⁷ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika 13 – mbi drejtësinë riparuese dhe shmangien e metodave ndëshkuese.

efektiv.¹⁰⁸ Dokumenti synon të sigurojë që fëmijët në konflikt me ligjin të mos dëmtohen më tej, por të kenë mundësi për riintegrim social. Përmes këtij rekomandimi, Këshilli i Evropës përforcon rëndësinë e respektimit të normave ndërkombëtare dhe të drejtave themelore.¹⁰⁹ Në thelb, ky rekomandim synon sigurimin e një trajtimi të drejtë dhe human për fëmijët në procedurat penale. Ai kontribuon në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe në ndërtimin e një drejtësie riparuese që përqendrohet në interesin më të mirë të fëmijës.¹¹⁰ Me anë të tyre, vendeve anëtare përkrahen në krijimin e kushteve dhe mekanizmave për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve në mbarë Evropën.¹¹¹

Aktet normative të Bashkimit Evropian të cilat trajtojnë të drejtat e të miturve

Bashkimi Evropian është formuar nëpërmjet marrëveshje kombëtare shumëpalshe një ndërmjet shteteve anëtare. Sistemi politike karakterisohet nga nga një sistem vendimarrës specifik. Legjislacioni dhe aktet e BE-së janë të detyrueshme vetëm për shtetet anëtare, ndërsa vendet që synojnë anëtarësimin janë të detyruara të harmonizojnë kuadrin ligjor me atë të BE-së. Aspirata e anëtarësimit në BE nuk sjell vetëm të drejta por sjell dhe një sërë detyrimesh për çdo

shtet që aspirojnë të bëhet pjesë e Bashkimit.¹¹² Për vendin tonë procesi i integritetit sjell detyrime për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe e të miturve në veçanti.¹¹³ Procesi i harmonizimit të legjislacionit të brendshëm me atë të Bashkimit Evropian përbën një objektiv afatgjatë dhe mbetet një ndër prioritetet kryesore të grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim. Burimet kryesore të së drejtës komunitare janë traktatet dhe direktivat.¹¹⁴ Mekanizmi zbatues i së drejtës komunitare është Komisioni Evropian. Bashkimi Evropian është një organizatë unike, e cila funksionon mbi bazën e akteve juridike të miratuara nga shtetet anëtare dhe institucionet e tij. Aktet kryesore të BE-së ndahen në dy kategori: aktet themeluese dhe aktet dytësore. Aktet themeluese përfshijnë traktatet që kanë krijuar dhe zhvilluar Bashkimin Evropian.¹¹⁵ Traktati i Parisit i vitit 1951 shënoi hapin e parë drejt integritetit evropian.¹¹⁶ Ai krijoi Komunitetin Evropian të Qymyrit dhe Çelikut, me synim shmangien e luftërave të ardhshme.¹¹⁷ Më pas, Traktati i Romës i vitit 1957 themeloi Komunitetin Ekonomik Evropian dhe Euratom-in.¹¹⁸ Traktatet e mëvonshme i shtuan kompetenca dhe fusha të reja veprimi BE-së. Traktati i Maastricht-it i vitit 1992 krijoi vetë Bashkimin Evropian si një strukturë me tre shtylla.¹¹⁹ Ai futi konceptin e qytetarisë evropiane dhe bashkëpunimin në drejtësi, siguri dhe politikë të

¹⁰⁸ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika hyrëse dhe qëllimi i përgjithshëm.

¹⁰⁹ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, paragrafi 3 dhe 5.

¹¹⁰ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika 7 dhe 14.

¹¹¹ Shih: Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2008)11, pika 15 dhe 16.

¹¹² Shih: Komisioni Evropian, Raportet e Progresit për Zgjerimin e BE-së, për vendet candidate, seksioni mbi të drejtat themelore.

¹¹³ <https://www.crca.al/wp-content/uploads/2022/11/Drejtësia-per-te-mitur.pdf>

¹¹⁴ Traktati për Bashkimin Evropian (TBE) dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) përbëjnë bazën juridike të BE-së.

¹¹⁵ shih: European Union, Treaties and agreements, European Union Official Website.

¹¹⁶ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹¹⁷ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹¹⁸ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹¹⁹ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

jashtme. Traktati i Amsterdimit solli ndryshime në drejtim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.¹²⁰ Traktati i Nicës riorganizoi institucionet për të përballuar zgjerimin e madh.¹²¹ Më në fund, Traktati i Lisbonës i vitit 2007 është baza aktuale ligjore e BE-së. Ai i dha një personalitet të qartë juridik BE-së dhe forcoi rolin e Parlamentit Evropian.¹²² Përveç traktateve, BE funksionon edhe nëpërmjet akteve dytësore. Këto janë rregulloret, direktivat, vendimet, rekomandimet dhe opinionet¹²³. Rregulloret janë ligje që zbatohen njësoj në të gjitha shtetet anëtare. Ato kanë fuqi detyruese dhe nuk kërkojnë miratim nga parlamentet kombëtare. Direktivat janë udhëzime që vendosin objektiva për shtetet anëtare, por lënë hapësirë për mënyrën e zbatimit. Ato përkthehen në legjislacion kombëtar brenda një afati të caktuar. Vendimet janë detyruese për subjektet të cilave u drejtohen, qofshin këto shtete apo individë. Rekomandimet dhe opinionet nuk kanë fuqi detyruese, por udhëzojnë politikën dhe vendimet e vendeve anëtare.¹²⁴ Të gjitha këto akte janë të rëndësishme për funksionimin harmonik të BE-së.¹²⁵ Ato garantojnë unitetin juridik dhe sigurojnë që rregullat evropiane të zbatohen në mënyrë të njëjtë. Përmes tyre, BE arrin të ruajë balancën ndërmjet sovranitetit të shteteve dhe interesit të përbashkët. Harmonizimi ligjor dhe

uniteti i veprimit varen nga këto akte. Ato ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve evropianë dhe në politikën kombëtare.¹²⁶ Prandaj, njohja e akteve kryesore të BE-së është thelbësore për çdo qytetar dhe profesionist i së drejtës. Këto akte janë baza e të gjithë rendit juridik evropian. Disa prej akteve themelore të cilat trajtojnë të drejtat e të miturve në legjislacionin e Bashkimit evropian janë: Traktatet e BE-së, Karta e të drejtave themelore të BE-së, Direktivat për drejtësinë për të miturit, Vjenë 1997, Direktiva e Këshillit Ekonomik dhe Social (2005).¹²⁷

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian është një dokument juridik që përmbledh të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve të BE-së.¹²⁸ Ajo u shpall për herë të parë më 7 dhjetor 2000 në Nisë dhe mori fuqi detyruese me Traktatin e Lisbonës në vitin 2009.¹²⁹ Karta ka të njëjtën vlerë juridike si traktatet e tjera themelore të BE-së. Karta përbëhet nga një preambulë dhe 54 nene, të ndara në gjashtë kapituj tematikë.¹³⁰ Kapitulli i parë flet për dinjitetin njerëzor dhe ndalon torturën, skllavërinë dhe dënimet çnjerëzore. Kapitulli i dytë përfshin liritë themelore si liria e mendimit, fesë dhe jetës private.¹³¹ Kapitulli i tretë garanton barazinë përpara ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi.¹³² Aty përfshihen edhe të drejtat e fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.¹³³ Kapitulli i katërt trajton

¹²⁰ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹²¹ https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹²² https://europa.eu/european-union/about-eu/history_en.

¹²³ https://europa.eu/european-union/law/legal-acts_en.

¹²⁴ https://europa.eu/european-union/law/legal-acts_en.

¹²⁵ https://europa.eu/european-union/about-eu/how-it-works_en.

¹²⁶ https://europa.eu/european-union/about-eu/how-it-works_en.

¹²⁷ https://ec.europa.eu/info/policies/justice-and-fundamental-rights/rights-child_en.

¹²⁸ <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/fc583291-b51a-445f-987a-ee24ad1d8f3e>

¹²⁹ <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/fc583291-b51a-445f-987a-ee24ad1d8f3e>

¹³⁰ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³² <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³³

<https://www.un.org/disabilities/documents/convention>

solidaritetin dhe të drejtat në punë, mbrojtjen sociale dhe grevat.¹³⁴ Kapitulli i pestë përqendrohet te të drejtat e qytetarëve të BE-së për pjesëmarrje demokratike dhe qasje në administratë.¹³⁵ Kapitulli i fundit rregullon të drejtën për gjykim të drejtë dhe mbrojtjen gjyqësore efektive.¹³⁶ Karta zbatohet vetëm kur një shtet anëtar vepron brenda fushës së së drejtës së BE-së. Ajo nuk mund të përdoret për çështje që nuk kanë lidhje me legjislacionin e BE-së.¹³⁷ Gjykata e Drejtësisë së BE-së përdor Kartën për të vlerësuar përputhshmërinë e ligjeve kombëtare me standardet evropiane. Gjithashtu, institucionet e BE-së janë të detyruara të respektojnë Kartën në të gjitha veprimet e tyre. Karta rrit transparencën dhe forcimin e të drejtave të individit përballë shtetit dhe institucioneve.¹³⁸ Ajo është një mjet i fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave themelore në nivel evropian. Për qytetarët, ajo përfaqëson një siguri shtesë juridike dhe një mbështetje në rast padrejtësisht. Karta pasqyron vlerat bazë të BE-së si respekti për dinjitetin njerëzor, lirinë dhe demokracinë.¹³⁹ Ajo është një shtyllë e rëndësishme e rendit ligjor evropian. Përmes saj, BE forcon identitetin dhe integritetin e saj si një bashkësi që mbështetet mbi të drejtat e njeriut.

Direktiva (BE) 2016/800, e miratuar më 11 maj 2016, është një instrument ligjor i Bashkimit Evropian që ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të përfshirë në procedura penale si të dyshuar apo të akuzuar.¹⁴⁰ Qëllimi i saj është të

sigurojë që këta fëmijë të trajtohen me respekt, dinjitet dhe me masa të përshtatshme që marrin parasysh moshën dhe nevojat e tyre të veçanta gjatë gjithë procesit gjyqësor.¹⁴¹ Një nga parimet themelore të saj është interesi më i mirë i fëmijës. Fëmijët kanë të drejtë të informohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për akuzat dhe të drejtat e tyre. Prindërit ose kujdestarët duhet të përfshihen në proces që nga fillimi. Ndiham juridike falas dhe përfaqësimi nga një avokat është e detyrueshme për çdo fëmijë. Fëmijët duhet të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre dhe të përfshihen në mënyrë aktive në procesin gjyqësor. Masa e ndalimit apo paraburgimit duhet të përdoret vetëm si zgjidhje e fundit dhe për një periudhë sa më të kufizuar.¹⁴² Në rastet kur ndalohen, ata nuk duhet të strehohen apo të qëndrojnë në ambiente të përbashkëta me të rrituri. Autoritetet kanë detyrimin të sigurojnë mbështetje gjithëpërfshirëse psikologjike, arsimore dhe sociale për fëmijët në konflikt me ligjin, në mënyrë që të nxitet rehabilitimi dhe riintegrimi i tyre në shoqëri. Vlerësimi individual i çdo fëmije është i domosdoshëm para vendimeve të rëndësishme. Procedurat duhet të zhvillohen në një mënyrë që i përshtatet moshës dhe pjekurisë së fëmijës. Ruajtja e privatësisë së fëmijës përbën një element kyç të kësaj direktive, duke synuar mbrojtjen e tij nga ekspozimi publik dhe ndikimet negative gjatë dhe pas procedurave penale. Qëllimi kryesor i saj është rehabilitimi dhe riintegrimi i fëmijës në shoqëri. Drejtësia

/crpd_albanian.pdf

¹³⁴ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³⁵ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³⁶ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹³⁷ <https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2024/01/ALBHarmonizacija-na-nacionalnoto-zakonodavstvo-so-zakonodavstvoto-na-EU-4.pdf>

¹³⁸ <https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/01/Vleresimi-i-te-Drejtave-te-Njeriut-dhe-Shtetit-te-se-Drejtës-teksta-Shqiperia-kryeson-OSBE-ne.pdf>

¹³⁹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:12012P/TXT>.

¹⁴⁰ <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/800/oj/eng>

¹⁴¹ <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2016/800/oj/eng>

¹⁴² European Union Agency for Fundamental Rights (FRA), *Child-friendly justice – Perspectives and experiences of children involved in judicial proceedings*,

penale duhet të ruajë perspektivën e rehabilitimit dhe integritetit të fëmijës, pa cënuar të ardhmen e tij. Kjo direktivë synon unifikimin e standardeve në të gjithë Bashkimin Evropian, ndërsa gjykatat dhe institucionet përgjegjëse kanë detyrimin të sigurojnë zbatimin e saj efektiv në praktikë. Ajo përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt një sistemi më të drejtë dhe më human për fëmijët në konflikt me ligjin.

Direktiva 2005/29/EC u miratua nga Parlamenti dhe Këshilli i BE-së më 11 maj 2005.¹⁴³ Ajo synon të mbrojë konsumatorët nga praktikat tregtare të padrejta në tregun e brendshëm evropian. Kjo direktivë synon të unifikojë kuadrin ligjor të shteteve anëtare sa i përket mbrojtjes së konsumatorit në Bashkimin Evropian. Në thelb, ajo fokusohet në dy kategori kryesore të sjelljeve të dëmshme tregtare: ato mashtruese, që çojnë konsumatorin në vendime të gabuara për shkak të informacionit të rremë ose të paplotë, dhe ato agresive, që përfshijnë forma presioni apo manipulimi që cenojnë lirinë e zgjedhjes së konsumatorit. Praktikrat mashtruese përfshijnë informacion të rremë, mashtrues ose të pjesshëm për produktet. Praktikrat agresive përfshijnë presione psikologjike, frikësim ose ndikim të tepërt mbi konsumatorin. Qëllimi i saj është të garantojë që konsumatorët të marrin vendime të informuara. Kjo ndihmon në rritjen e besimit në tregun e përbashkët. Direktiva vendos një listë të zezë me 31 praktika që janë gjithmonë të ndaluara.¹⁴⁴ Kjo listë ka fuqi detyruese në të gjitha shtetet anëtare. Ajo ka ndikuar fuqishëm edhe në mbrojtjen e konsumatorit në tregtinë elektronike. Informacioni për produktet duhet të

jetë i saktë, i plotë dhe i kuptueshëm. Konsumatorët kanë të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim në rast mashtrimi. Po ashtu, individët kanë të drejtë të kërkojnë shpalljen të pavlefshme të kontratave që janë ndërtuar mbi praktika të padrejta ose mashtruese. Direktiva detyron bizneset të veprojnë me ndershmëri dhe përgjegjësi. Autoritetet shtetërore janë të detyruara të sigurojnë zbatimin efektiv të saj.¹⁴⁵ Masat për shkelësit përfshijnë ndalime, gjoba dhe pasoja të tjera ligjore. Kjo direktivë është një gur themeli në politikën evropiane për mbrojtjen e konsumatorëve. Ajo është pjesë e Paketës së Drejtave të Konsumatorit të BE-së.¹⁴⁶ Përveç mbrojtjes, ajo edukon konsumatorët për të njohur më mirë të drejtat e tyre. Bizneset që veprojnë në disa vende përfitojnë nga rregullat e unifikuara. Zbatimi i saj ka përmirësuar transparencën në marrëdhëniet tregtare. Konsumatorët sot ndihen më të mbrojtur falë kësaj direktive. Ajo mbetet një ndër instrumentet më të rëndësishme për krijimin e një tregu të ndershëm dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e BE-së.

Analiza krahasimore midis sistemit juridik shqiptar dhe atij evropian

Pikat e përbashkëta midis rendit juridik shqiptar dhe atij evropian për të mitur

Çështjet që kanë në thelb trajtimin e të miturve cilët janë në konflikt me ligjin janë shumë të rëndësishme si në rendin juridik shqiptar dhe atë evropian. Që të dyja këto sistemi kanë në fokus të tyre parimin e mbrojtjes së interesit më të mirë të fëmijës. Parimi është i domosdoshëm në të gjitha

¹⁴³ Direktiva 2005/29/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 maj 2005, "për praktikrat tregtare të padrejta të ndërmarrjeve ndaj konsumatorëve në tregun e brendshëm", Gazeta Zyrtare e BE-së, L 149, 11.6.2005, fq. 22–39

¹⁴⁴ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32005L0029>.

¹⁴⁵ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A12012M%2FTXT>.

¹⁴⁶ Directive 2005/29/EC ("Unfair Commercial Practices Directive"), pjesë e paketës ligjore "New Deal for Consumers" të BE-së që përditëson dhe forcon mbrojtjen e konsumatorit në tregun unikal evropian

tematikat penale që lidhen me të miturit. Të dyja këto sisteme i kanë përshtatur ligjet e tyre për të qenë sa më afër me Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. E përbashkëta tjetër është se të dyja këto sisteme i trajtojnë të miturit në sstruktura drejtësie të ndarë nga ai i të rrituri. Të miturit trajtohen me një qasje të veçantë, ku synimi nuk është ndëshkimi, por rehabilitimi dhe riintegrimi i tyre në shoqëri. Ligji shqiptar nr. 37/2017 për drejtësinë penale për të mitur është i përafët me shumë standarde të Këshillit të Evropës. Gjithashtu edhe Rekomandimi CM/Rec(2008)11 ndiqet gjërësisht në të dyja sistemet. Masat alternative janë në zbatim si Shqipëri dhe në Evropë. Të dyja këto sisteme dëni me burg për të miturit e përcaktojnë simasa e fundit dhe në një kohështritje të shkurtër. Këto sisteme gjithashtu kanë në zbatim masa si ndërmjetësimi, këshillimi, vendosja në shërbime komunitare dhe ndjekja e programeve të edukimit. Respektimi i dinjitetit të fëmijës gjatë procedurave penale është një tjetër pikë e përbashkët mes të dy sistemeve. Gjithashtu, në të dy sistemet fëmijët kanë të drejtën për përfaqësim ligjor dhe ndihmë juridike falas. Procedurat penale për të miturit duhet të zhvillohen në kushte të përshtatshme për moshën e tyre dhe me prezencën e prindit ose kujdestarit. Në Shqipëri si dhe në vendet e BE-së, theksohet nevoja për krijimin e strukturave të posaçme gjyqësore dhe ndjekjes penale për të miturit. Personat që kanë lidhje të drejtpërdrejt me çështjet e të miturve duhet të jenë të specializuar për atë fushë. Mbrojtja e privatësisë së të miturit është e garantuar si në Shqipëri ashtu edhe në Evropë. Nuk lejohen publikimi i emrit dhe të dhënave personale të fëmijëve që janë nën hetim apo gjykim. Të dy sistemet janë të mendimit se duhen të merren masa më të buta dhe të shmanget paraburgimi. Ata të miturit që janë caktuar për të vuajtur

dënimin me burg, duhet të jenë të ndarë nga të rriturit dhe në kushte që nuk dëmtojnë dinjitetin e tyre.

Një tjetër ngjashmëri është përdorimi i vlerësimeve individuale për çdo fëmijë përpara vendimit gjyqësor, për të përcaktuar nevojat dhe rrethanat e tij. Shqipëria dhe shumica e shteteve evropiane kanë çështje kryesore përfshirjen e psikologëve, punonjësve socialë dhe pedagogëve. Politikat penale në të dy sistemet kanë si pikënisje kryesore parandalimin e përsëritjes së veprave penale nga fëmijët. Në të dy sistemet ligjore synohet zhvillimi i procedurave të shkurtra dhe të kuptueshme për të miturit. Ata duhet të kuptojnë akuzën dhe pasojat e saj në një mënyrë të përshtatshme për moshën. Të dy sistemet kërkojnë që fëmija të dëgjohet në mënyrë aktive gjatë procesit. E drejta themelore në vendimet në procesin gjyqësor është dëgjimi i fëmijës. Përfundimisht, arrihet në konkluzion se Shqipëria ka hedhur hapa të rëndësishëm në përafrimin e ligjit të saj me standardet evropiane. Sistemi shqiptar i drejtësisë për të miturit është i ndërtuar mbi të njëjtat parime themelore që gjejmë edhe në rendin juridik evropian. Megjithëse ka nevojë për përmirësime praktike dhe zbatim më të plotë, baza ligjore është në përputhje me modelin evropian. Kjo ngjashmëri është e lidhur me përkushtimin e Shqipërisë ndaj të drejtave të fëmijëve dhe ndaj politikave së sistemit të drejtësisë penale. Në të dy sistemet, roli parësor nuk është ndëshkimi, por mbrojtja, edukimi dhe integrimi i të miturit si individë të shoqërisë.

Dallimet ndërmjet rendit juridik shqiptar dhe atij evropian

Rendi juridik shqiptar ka bërë përpjekje të mëdha për t'u përafruar me standardet evropiane, por ende ka dallime të dukshme në zbatim dhe strukturim. Së pari, në Shqipëri mungon ende një praktikë e qëndrueshme për zbatimin e masave

alternative ndaj ndëshkimit penal. Në vendet evropiane si Suedia, Holanda dhe Gjermania, masat alternative janë të institucionalizuara dhe aplikohen rregullisht. Ndërsa në Evropë përdorimi i ndërmjetësimit penal është standard i zakonshëm, në Shqipëri ai mbetet i kufizuar dhe shpesh aplikohet vetëm në teori. Po ashtu, institucionet mbështetëse si psikologët, punonjësit socialë dhe mentorët janë më të strukturuar në Evropë dhe funksionojnë në mënyrë të koordinuar. Në Shqipëri këto role janë ende të fragmentuara dhe jo gjithmonë të integruara në procesin penal. Gjykatat për të mitur në disa vende evropiane janë institucione të pavarura dhe të specializuara, ndërsa në Shqipëri janë të integruara në gjykatat e zakonshme. Në aspektin procedural, vendet evropiane kanë standarde më të avancuara për dëgjimin aktiv të të miturve dhe respektimin e të drejtave të tyre gjatë procesit gjyqësor. Në Shqipëri, fëmijët shpesh nuk informohen mjaftueshëm për të drejtat që u takojnë gjatë procedurave.

Një tjetër dallim ka të bëjë me përgatitjen profesionale të aktorëve të drejtësisë. Në shtetet evropiane, gjyqtarët dhe prokurorët që merren me çështjet e të miturve janë të trajnuar posaçërisht për këtë fushë. Në Shqipëri, ndonëse ekzistojnë trajnime, ato nuk janë të vazhdueshme dhe nuk kanë të njëjtin nivel specializimi. Edhe mungesa e strukturave rezidenciale të përshtatshme për të miturit në Shqipëri është një dallim thelbësor krahasuar me Evropën. Në vendet evropiane, ndalimi i të miturit është me të vërtetë masa e fundit, ndërsa në Shqipëri përdoret ende më shpesh se ç'këshillohet nga standardet ndërkombëtare. Shpesh, fëmijët mbahen në paraburgim në kushte që nuk janë të përshtatshme për moshën apo gjendjen e tyre psikologjike. Ndërkohë, në Evropë janë të zakonshme qendrat edukative me kushte dinjitoze dhe staf të trajnuar.

Në aspektin legjislativ, Shqipëria ka një ligj të vetëm të konsoliduar për drejtësinë penale të të miturve (Ligji 37/2017), ndërsa në shumicën e vendeve evropiane ka një kuadër më të gjerë dhe më të ndërlidhur mes kodit penal, kodit të procedurës penale dhe ligjeve për mbrojtjen e fëmijës. Gjithashtu, sistemet evropiane i japin rëndësi më të madhe zërit të fëmijës në çdo fazë të procesit ligjor. Moshë minimale e përgjegjësisë penale është një tjetër pikë dalluese: në disa vende evropiane është mbi 14 vjeç, ndërsa në Shqipëri është 14. Megjithatë ky nivel është teknikisht i pranueshëm, ka shtete që e kanë rritur më tej për të reflektuar zhvillimin emocional dhe njohës të fëmijëve. Në Evropë është e zakonshme edhe përdorimi i vlerësimit psikologjik përpara marrjes së çdo vendimi penal, gjë që në Shqipëri ndodh më rrallë. Sistemet evropiane janë më të përparuara në ndjekjen e statistikave, monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të praktikave për të miturit. Në Shqipëri, mungesa e të dhënave të detajuara dhe të besueshme e bën më të vështirë vlerësimin e efektivitetit të sistemit. Po ashtu, mbështetja pas përfundimit të dënimit është më e organizuar në Evropë përmes shërbimeve të pas-rehabilitimit.

Në përfundim, rendi juridik shqiptar ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit me atë evropian, por mbetet mbrapa në zbatimin praktik, trajnimin e specialistëve, organizimin e strukturave dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse. Dallimet lidhen kryesisht me burimet njerëzore dhe financiare, infrastrukturën ligjore, dhe përvojën institucionale në trajtimin gjithëpërfshirës të të miturve në konflikt me ligjin.

Gjetjet e studimit

Krahas qasjes krahasimore të rendit juridik shqiptar dhe atij evropian, studiuesja pa të arsyeshëm të grubullonte të dhëna nga

profesionistë të ndryshëm që janë të përfshirë në çështjet me të miturit. Më poshtë janë përshkruar të dhënat e mbledhura nga kjo fushë studimi. Në këtë pyetësor kanë marrë pjesë 25 profesionistë të fushave të ndryshme që kanë lidhje me të miturit në sistemin e drejtësisë. Kjo përbërje përfshin 10 avokatë, 5 gjyqtarë, 8 punonjës socialë dhe 2 përfaqësues të organizatave joqeveritare. Pjesëmarrësit kanë qënë më shumë femra 60%, ndërsa meshkujt përbëjnë 40%. Ka një larmi profesionale nisur nga eksperiencia me çështjet me të miturit, e cila jep një perspektivë të gjerë mbi problemet dhe sfidat aktuale. Pjesëmarrësit kanë përfituar njohuri të ndryshme mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e zbatimit të tij. Kjo ndihmon në identifikimin e mangësive në ligj dhe në praktikë. Ky profil i shumëllojshëm ndihmon për të marrë një panoramë të plotë dhe realiste të situatës në Shqipëri. Kjo gjithashtu ndihmon në hartimin e rekomandimeve të bazuara në nevojat reale dhe praktikat ekzistuese.

Përmirësimi i kuadrit ligjor për të miturit: Sipas përgjigjeve të të intervistuarve, kuadri ligjor për të miturit në Shqipëri ka pësuar përmirësime të dukshme gjatë viteve të fundit. 40% e tyre vlerësojnë përmirësimin si "mjaftueshëm", ndërsa 32% e konsiderojnë atë si "shumë". Kjo tregon se janë bërë hapa të rëndësishëm në përshtatjen e ligjeve me nevojat e veçanta të të miturve. Megjithatë, 28% e të intervistuarve vlerësojnë se përmirësimet janë ende të pamjaftueshme. Kjo për shkak të mungesës së burimeve, trajnimeve dhe koordinimit ndërinstitutional. Ligjet ekzistuese nuk merren gjithmonë me zbatim të plotë dhe efikas. Në disa raste, mungesa e strukturave mbështetëse për të miturit ndikon negativisht në zbatimin praktik. Gjithashtu, mentaliteti ndëshkues në disa institucione pengon një qasje më humane dhe rehabilituese. Përmirësimi i kuadrit ligjor kërkon edhe më shumë angazhim për të

përfshirë standardet europiane. Trajnimi i profesionistëve dhe ndarja e burimeve janë çelësi për të avancuar më tej. Për më tepër, është e nevojshme të rritet bashkëpunimi mes institucioneve dhe organizatave joqeveritare. Kjo do të përmirësojë shërbimet dhe do të sigurojë mbështetje më të mirë për të miturit. Përfundimisht, përmirësimi ligjor është një proces që kërkon vëmendje të vazhdueshme dhe përfshirje të gjithë aktorëve relevantë.

Përputhshmëria e legjislacionit shqiptar me standardet e BE-së: Shumica e të intervistuarve e vlerësojnë legjislacionin shqiptar për të miturit si relativisht të përputhshëm me standardet e Bashkimit Europian. Afër 44% e tyre e konsiderojnë këtë përputhshmëri si "mjaftueshëm", ndërsa 24% e shohin atë si "shumë të përputhshëm". Megjithatë, 24% e pjesëmarrësve janë skeptikë dhe e vlerësojnë përputhshmërinë si "pak". Një pjesë e vogël prej 8% e konsiderojnë legjislacionin shqiptar si të papërputhshëm me standardet europiane. Kjo tregon se edhe pse ka hapa përpara, ende ekzistojnë sfida në harmonizimin e plotë të normave ligjore. Disa nga këto sfida lidhen me implementimin praktik të ligjit dhe mungesën e strukturave mbështetëse. Po ashtu, ka nevojë për përditësime ligjore të bazuara në zhvillimet e fundit në BE. Ndryshimet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur duhen përshtatur më mirë me praktikat dhe rekomandimet ndërkombëtare. Përputhshmëria ligjore është një proces dinamik që kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe përmirësim. Ekspertët theksojnë rëndësinë e trajnimeve të vazhdueshme për profesionistët e sistemit. Bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndërkombëtar mund të ndihmojë në përforcimin e kësaj përputhshmërie. Rritja e ndërgjegjësimit mbi standardet evropiane është po ashtu e rëndësishme për të gjithë aktorët. Përfundimisht, harmonizimi me standardet e BE-së është një nga

prioritetet kryesore për zhvillimin e drejtësisë për të miturit në Shqipëri

Efektiviteti i zbatimit praktik të ligjeve për të mitur: Vetëm 12% e tyre e vlerësojnë zbatimin si shumë efektiv. Një pjesë prej 40% e konsiderojnë zbatimin si mjaftueshëm efektiv, ndërsa 36% e shohin atë si pak efektiv. Po ashtu, mungesa e trajnimeve të specializuara dhe koordinimit institucional ndikojnë negativisht. Mentaliteti ndëshkues dhe mungesa e qasjes rehabilituese janë gjithashtu faktorë pengues. Shpeshherë, institucionet nuk arrijnë të sigurojnë mbështetjen e nevojshme për ri-integrimin e të miturve. Ndërkaq, ekzistenca e pakët e strukturave të rehabilitimit përkeqëson këtë situatë. Përmirësimi i zbatimit kërkon investime të vazhdueshme në kapacitete njerëzore dhe materiale. Bashkëpunimi më i mirë ndërmjet institucioneve mund të rrisë efektivitetin. Rritja e ndërgjegjësimit dhe përmirësimi i politikave janë po ashtu thelbësore. Përfundimisht, zbatimi praktik është sfidues dhe kërkon angazhim të të gjitha palëve të përfshira. Vetëm në këtë mënyrë mund të sigurohet një sistem drejtësie më i drejtë dhe më efikas për të miturit.

Pengesat në zbatimin e ligjeve për të mitur: Sipas 48% të të anketuarve, sfida kryesore në zbatimin e legjislationit për të miturit është mungesa e burimeve njerëzore. Kjo situatë e vështirëson ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe ndjekjen efektive të rasteve. Ndërkohë, 40% e të pyeturve vënë në dukje mungesën e trajnimeve të specializuara për profesionistët si një tjetër pengesë që ndikon negativisht në funksionimin e sistemit. Pa trajnim adekuat, profesionistët nuk janë të përgatitur për të trajtuar nevojat specifike të të miturve. Koordinimi i dobët institucional, që përmendet nga 32% e të intervistuarve, pengon bashkëpunimin efektiv ndërmjet

institucioneve. Mentaliteti ndëshkues, i pranishëm në disa institucione, e vështirëson zbatimin e qasjes rehabilituese. Këto pengesa ndikojnë në cilësinë e trajtimit dhe mund të çojnë në rritjen e recidivës. Për të përmirësuar situatën, është e nevojshme të rriten burimet dhe të ofrohen trajnime të vazhdueshme. Gjithashtu, duhet përmirësuar koordinimi dhe të ndryshohet mentaliteti nga ndëshkimi në rehabilitim. Kjo kërkon përfshirjen e politikëbërësve dhe aktorëve të tjerë relevantë.

Ekzistenca e strukturave të rehabilitimit për mbështetjen e të miturve: Nga të intervistuarit, vetëm 3 persona theksojnë se ekzistojnë struktura të mjaftueshme rehabilitimi për të miturit në Shqipëri. Një shumicë prej 60% (15 persona) shprehin se këto struktura nuk ekzistojnë ose janë shumë të pakta. Rreth 28% mendojnë se ekzistenca e këtyre strukturave është pjesërisht e realizuar. Kjo tregon një hendek të madh në ofrimin e mbështetjes pas dënimit, që është esenciale për ri-integrimin social. Specialistët theksojnë rëndësinë e investimeve në qendra rehabilitimi dhe programe mbështetëse. Mungesa e këtyre strukturave ndikon negativisht në efektivitetin e zbatimit të ligjit. ashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare mund të ndihmojë në krijimin e programeve të rehabilitimit. Po ashtu, duhet të zhvillohen programe individuale të trajtimit për çdo të mitur. Përmirësimi i strukturave do të kontribuojë në uljen e recidivës dhe rritjen e integritetit. Kjo kërkon angazhim të vazhdueshëm nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile. Ndërkaq, mungesa e mbështetjes psikologjike dhe sociale mbetet problem shqetësues.

Ndikimi i politikave në ri-integrimin real të të miturve në shoqëri : Sipas të dhënave, 40% e të intervistuarve vlerësojnë se politikat aktuale kanë një ndikim shumë pozitiv në ri-integrimin e të

miturve. 32% e vlerësojnë ndikimin mjaftueshëm të mirë. Megjithatë, 20% janë skeptikë dhe mendojnë se ndikimi është pak, ndërsa 8% e shohin atë si aspak efektiv. Kjo tregon se megjithëse ka përpjekje, efektiviteti i politikave ende nuk është i plotë. Është e nevojshme të ketë një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin arsimin, shëndetin dhe mbështetjen sociale. Po ashtu, duhet të rritet bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe komunitetin. Ndërhyrjet e hershme dhe programet mbështetëse pas dënimit janë elementë kyç për ri-integrimin. Trajnimet e profesionistëve për menaxhimin e rasteve janë të domosdoshme. Politikat duhet të jenë fleksibile dhe të përshtatura për realitetin shqiptar. Vlerësimet tregojnë nevojën për rritje të burimeve dhe financimeve në këtë sektor. Angazhimi i komunitetit dhe familjes është gjithashtu i rëndësishëm.

Vërejtja e dallimeve thelbësore mes qasjes shqiptare dhe vendeve të BE-së në trajtimin e të miturve: 40% e të intervistuarve theksojnë se ekzistojnë dallime të rëndësishme mes qasjes shqiptare dhe atyre të vendeve të Bashkimit Europian në trajtimin e të miturve. Ata argumentojnë se sistemi shqiptar është më ndëshkues dhe më pak i fokusuar në rehabilitim krahasuar me vendet e BE-së. Ndërkohë, në Shqipëri, mungesa e burimeve dhe strukturave të specializuara është evidente. Dallimet lidhen edhe me nivelin e trajnimit të profesionistëve dhe koordinimin ndër-institucional. Në BE, ka një fokus të qartë në parandalimin dhe trajtimin me qasje gjithëpërfshirëse. Për më tepër, në vendet e BE-së përdoren më shumë masa alternative ndaj dënimit, ndërsa në Shqipëri dominon ndëshkimi penal. Kjo ndikon në cilësinë dhe efektivitetin e trajtimit të të miturve. Dallimet kulturore dhe sociale ndikojnë gjithashtu në qasjet e ndryshme. Për të

përmirësuar sistemin shqiptar, duhet të adoptohen praktikatat më të mira evropiane.

Konkluzione

Në përfundim, analiza e të dhënave nga intervistat tregon qartë sfidat dhe mundësitë për sistemin e drejtësisë penale për të mitur në Shqipëri. Profesionistët e përfshirë, avokatë, gjyqtarë, punonjës socialë dhe përfaqësues të OJF-ve, kanë shprehur mendime të ndryshme, por ka një konsensus të gjerë mbi nevojën për përmirësime. Një pjesë e madhe e tyre vlerësojnë se kuadri ligjor për të miturit ka nevojë për përmirësim, por gjithashtu shprehin shqetësim për zbatimin praktik të këtyre ligjeve. Përputhshmëria e legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Europian është në nivel mesatar, por ende jo e plotë. Kjo reflektohet edhe në faktin se vetëm 40% e të intervistuarve mendojnë se Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është plotësisht në përputhje me standardet bashkëkohore evropiane. Efektiviteti i zbatimit praktik vlerësohet i kufizuar, me vetëm 12% që e shohin atë si shumë efektiv. Një problem kryesor që del nga analiza është mungesa e burimeve njerëzore dhe trajnimeve të specializuara për profesionistët që punojnë me të miturit. Kjo çon në një koordinim të dobët ndërmjet institucioneve dhe në një mentalitet ndëshkues që pengon procesin rehabilitues. Struktura të dedikuara për rehabilitimin dhe mbështetjen sociale të të miturve janë të pakta ose të pamjaftueshme, gjë që kufizon mundësitë për ri-integrimin e tyre në shoqëri. Politikat aktuale, megjithëse kanë ndikim pozitiv në disa aspekte, nuk arrijnë të adresojnë plotësisht nevojat e këtij grupi vulnerabël. Ndërkaq, bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shqiptare dhe organizatave ndërkombëtare është duke u përmirësuar, por kërkon më shumë angazhim dhe koordinim.

Vërehet një dallim i rëndësishëm midis qasjes

shqiptare dhe atyre të vendeve të Bashkimit Europian, ku vendet e BE-së kanë fokus më të madh në rehabilitimin dhe mbështetjen psikologjike të të miturve. Në Shqipëri, sistemi mbetet ende kryesisht ndëshkues, duke u përqendruar më shumë në sanksionet penale sesa në masat alternative dhe ri-integrimin. Adopimi i praktikave pozitive europiane, si programet e mbështetjes sociale, psikologjike dhe arsimit pas dënimit, është i domosdoshëm për të përmirësuar efektivitetin e sistemit shqiptar. Po ashtu, rritja e trajnimeve për profesionistët dhe përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstytucional janë çelësa kryesorë për sukses. Ndërhyrjet gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat edukative, sociale dhe psikologjike të të miturve do të ndihmojnë në uljen e recidivës dhe në krijimin e mundësive reale për një të ardhme të qëndrueshme. Është e rëndësishme që politika të orientohen drejt rehabilitimit dhe jo vetëm ndëshkimit, duke përdorur masa alternative dhe duke siguruar mbështetje pas dënimit. Për më tepër, përfshirja e shoqërisë civile dhe komunitetit në procesin e ri-integrimit është e domosdoshme për suksesin afatgjatë. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se sistemi shqiptar ka bërë hapa përpara, por kërkon një transformim të thellë për të arritur standardet europiane. Kjo përfshin investime në burime njerëzore, trajnime, struktura të specializuara dhe një ndryshim në mentalitetin institucional dhe shoqëror. Vetëm me këto ndryshime mund të sigurohet një drejtësi më humane dhe efektive për të miturit në konflikt me ligjin.

Në përfundim, rekomandohet që institucionet shqiptare të forcojnë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare dhe të adoptojnë praktikën më të mira europiane. Po ashtu, duhet të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve të rehabilitimit dhe mbështetjes sociale. Fokusi duhet të jetë në rehabilitimin gjithëpërfshirës të

të miturve dhe në rritjen e mundësive për integrim. Në këtë mënyrë, do të zvogëlohet recidiva dhe do të krijohet një sistem më i drejtë dhe më efektiv. Në përfundim, është e nevojshme që politika dhe praktikën të zhvillohen në mënyrë të qëndrueshme dhe të koordinuar. Vetëm kështu mund të arrihet një drejtësi penale për të mitur që respekton të drejtat e njeriut dhe promovon zhvillimin e shëndetshëm të të miturve. Me këtë qasje, Shqipëria do të bëhet pjesë e sistemit europian të drejtësisë për të mitur, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të sigurt dhe më të drejtë.

Rekomandime

Bazuar në analizën e intervistave me profesionistë të fushës dhe krahasimin me sistemin evropian, del e qartë nevoja për ndërhyrje të thella dhe të qëndrueshme në drejtësinë penale për të mitur në Shqipëri. Në vijim paraqiten rekomandime konkrete të ndara në fusha kyçe:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor

Shqipëria duhet të përditësojë Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur duke u bazuar në praktikën më të mira të vendeve të BE-së. Përputhshmëria ligjore me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës duhet të garantohet. Krijimi i një mekanizmi vlerësimi të përhershëm për përputhjen e ligjeve me standardet ndërkombëtare është i domosdoshëm. Ligji duhet të fokusohet më shumë në masa parandaluese dhe rehabilituese sesa në ndëshkim. Zbatimi i ligjit duhet të monitorohet nga një strukturë e pavarur me mandat të qartë.

2. Zbatimi efektiv i ligjit në praktikë

Zbatimi i ligjit për të miturit është një nga pikat më të dobëta të sistemit shqiptar. Institucionet duhet të pajisen me burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale për të zbatuar ligjet në praktikë. Kontrolli i brendshëm dhe i jashtëm mbi zbatimin e ligjit duhet të rritet. Raportimi i rregullt

për efektivitetin e masave të marra është thelbësor. Përfshirja e komunitetit lokal dhe shoqërisë civile në monitorim do të rrisë transparencën dhe përgjegjshmërinë.

3. Zhvillimi i masave alternative ndaj ndëshkimit penal

Sistemi shqiptar duhet të vendosë në qendër masat alternative për të miturit. Masat si ndërmjetësimi, këshillimi, detyrimet shoqërore dhe edukimi duhet të zbatohen gjerësisht. Prokurorët dhe gjyqtarët duhet të inkurajohen të aplikojnë më shpesh këto masa. Zhvillimi i udhëzimeve të posaçme për aplikimin e tyre do të ndihmonte në unifikimin e praktikës gjyqësore. Programet alternative duhet të monitorohen për efektivitetin e tyre në ri-integrimin e të miturve.

4. Fuqizimi i strukturave të rehabilitimit

Në Shqipëri mungojnë qendrat e posaçme për rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin. Duhet të ndërtohen dhe financohen struktura të reja të specializuara, me staf të trajnuar. Rehabilitimi duhet të përfshijë mbështetje psikologjike, edukim dhe formim profesional. Duhet të zhvillohen programe pas-dënimi për të ndihmuar të miturit të integrohen në shoqëri. Përfshirja e familjes në procesin rehabilitues është element kyç për suksesin afatgjatë.

5. Rritja e kapaciteteve njerëzore

Mungesa e stafit të trajnuar është një nga sfidat më të mëdha të sistemit aktual. Duhet të hartohen programe trajnime të detyrueshme për gjyqtarë, prokurorë, punonjës socialë dhe policë që punojnë me të miturit. Trajnime duhet të jenë të përsëritura dhe të përditësuara sipas zhvillimeve ndërkombëtare. Universitetet dhe institucionet arsimore duhet të përfshijnë module për drejtësinë për të mitur në kurrikula. Stimulimi i profesionistëve për të ndjekur trajnime ndërkombëtare është i domosdoshëm.

6. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar

Përmirësimi i koordinimit ndërmjet institucioneve vendore është i domosdoshëm. Ndërveprimi midis gjykatave, shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe familjeve duhet të forcohet. Rekomandohet krijimi i ekipeve të përbashkëta ndërinstitucionale për trajtimin e rasteve të të miturve. Mbështetja nga organizatat ndërkombëtare duhet të fokusohet në ndihmën teknike dhe ndarjen e praktikave të mira. Përfshirja e Shqipërisë në programe rajonale dhe evropiane të bashkëpunimit do të sillte përfitime të shumta.

7. Ndryshimi i qasjes kulturore dhe sociale ndaj të miturve në konflikt me ligjin

Duhet të luftohet mentaliteti ndëshkues i shoqërisë shqiptare ndaj të miturve. Fushata sensibilizuese për publikun mbi të drejtat e fëmijëve dhe rehabilitimin janë të domosdoshme. Mediat duhet të trajtojnë rastet me ndjeshmëri dhe pa stigmatizim. Roli i komunitetit në parandalimin e devijimeve të të miturve duhet të zgjerohet. Përfshirja e ish-të dënuarve të rehabilituar si dëshmi suksesi mund të ndikojë pozitivisht në ndryshimin e perceptimit shoqëror.

8. Vlerësimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i sistemit

Duhet të krijohen mekanizma të vazhdueshëm për vlerësimin e politikave dhe praktikave në fushën e drejtësisë për të mitur. Institucionet duhet të hartojnë raporte vjetore mbi progresin dhe vështirësitë në këtë fushë. Analizat statistikore dhe kërkimet shkencore duhet të përdoren për të informuar vendimmarrjen. Vlerësimi i impaktit të masave rehabilituese është jetik për përsosjen e sistemit. Rekomandohet që praktikatat e suksesshme të dokumentohen dhe të shërbejnë si modele për zhvillim të mëtejshëm.

Ndërmjetësimi në fushën e të drejtës familjare

Joana Sherifi

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Jonada Zyberaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Ndërmjetësimi në çështjet familjare përfaqëson një mjet alternativ dhe inovativ për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve, i cili ka fituar gjithnjë e më shumë rëndësi në sistemet bashkëkohore të drejtësisë. Ky proces karakterizohet nga një qasje e strukturuar, vullnetare dhe e paanshme, ku një ndërmjetës neutral ndihmon palët në konflikt të komunikojnë dhe të arrijnë një marrëveshje të ndërsjellë, duke shmangur gjykatat dhe procedurat e gjata e të ngarkuara emocionalisht. Në fushën e të drejtës familjare, ndërmjetësimi zbatohet në çështje të tilla si divorci, ndarja e pasurisë, kujdestaria e fëmijëve dhe detyrimet ushqimore, duke synuar mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës dhe ruajtjen e marrëdhënieve ndërpersonale.

Ky punim synon të analizojë thellësisht funksionimin dhe kuadrin ligjor të ndërmjetësimit në çështjet familjare, me fokus të veçantë në Shqipëri, duke e vendosur atë në raport me praktikën më të mira të shteteve

evropiane si Italia, Gjermania, Franca dhe Spanja. Fillimisht, shqyrtohet evolucioni historik i ndërmjetësimit dhe parimet universale që e karakterizojnë këtë proces. Më tej, analizohet Ligji nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar si dhe ndërthurja e tij me Kodin e Familjes, Kodin Civil apo Kodin e Procedurave Civile etj.

Përmes analizës, krahasohen gjithashtu modelet ligjore dhe institucionale të vendeve evropiane në lidhje me ndërmjetësimin familjar brenda territorit të tyre, duke identifikuar standardet dhe praktikën që mund të përshtaten në realitetin shqiptar. Ky studim konkludon me rekomandime konkrete për fuqizimin e ndërmjetësimit si mekanizëm efektiv, të drejtë dhe të qasshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve familjare në shërbim të qytetarëve dhe drejtësisë sociale.

Fjalët kyce: *Ndërmjetësimi, e drejta familjare, ligj, zgjidhja alternative e mosmarrëveshjeve, Shqipëria, konflikt.*

Abstract

Family mediation represents an alternative and innovative means of peaceful dispute resolution that is gaining increasing importance in contemporary justice systems. This structured, voluntary, and impartial process involves a neutral mediator who facilitates communication between conflicting parties to help them reach a mutual agreement, avoiding lengthy and emotionally charged court proceedings. In family law, mediation is especially relevant in cases of divorce, division of assets, child custody, and maintenance obligations, aiming to protect the best interests of the child and preserve interpersonal relationships.

This thesis aims to provide an in-depth legal analysis of family mediation, with a particular focus on its application within the Albanian legal framework, while also comparing it with the best practices of European countries such as Italy, Germany, France, and Spain. Initially, the study examines the historical evolution of mediation and the universal principles that define it. Subsequently, it explores the application of Law No. 10385/2011 "On mediation in dispute resolution" in Albania, alongside the Family Code and relevant procedural provisions.

Through a comparative legal analysis, the thesis identifies and evaluates the legislative and institutional models of family mediation in selected European jurisdictions, focusing on domestic application and legal integration. The study highlights key differences and common standards that could be adapted to strengthen the effectiveness and accessibility of mediation in Albania. The findings lead to concrete recommendations for improving mediation as a

mechanism for resolving family disputes fairly, efficiently, and with reduced emotional burden, contributing to a more just and citizen-oriented legal system.

Keywords: Mediation, family law, law, alternative dispute resolution, Albania, conflict.

Kuadri ligjor që rregullon veprimtarinë e ndërmjetësimit

Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë

Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë",¹⁴⁷ i ndryshuar, në nenin 25 të tij parashikon se "*është detyrë e gjykatës që të bëjë përpjekje për të pajtuar palët në mosmarrëveshje dhe/ose të njoftojë e të udhëzojë palët për mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim*". Ndryshimet në këtë nen të KPrC janë bërë përpara ndryshimeve në ligjin nr. 10385/2011 me ligjin nr.26/2018 i cili, e ka përkthyer këtë detyrë të gjykatës në një detyrim për të njoftuar dhe udhëzuar palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të disa lloj mosmarrëveshjesh të parashikuara në këtë ligj, por pa u kufizuar vetëm në to. Në nenin 158/ç të KPrC, lidhur me veprimet e pajtimit (shtuar me ligjin nr.38/2017), parashikohet se :

1. *Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve.*
2. *Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët*

lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për ndërmjetësim.

3. Kur arrihet pajtimi pa filluar seanca gjyqësore, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët. Gjyqtari me vendim miraton pajtimin.

4. Në rast të paraqitjes së aktmarrëveshjes për pajtim ose për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, gjykata vendos miratimin e saj, nëse

kjo e fundit nuk është në kundërshtim me ligjin.

5. Kur pajtimi arrihet në seancë gjyqësore, kushtet e marrëveshjes pasqyrohen në procesverbalin gjyqësor. Gjkata jep vendim për miratimin e tij, por në çdo rast ai nuk duhet të jetë në kundërshtim me ligjin.

6. Kundër vendimit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me pajtim ose me ndërmjetësim, ose mospranimin e pajtimit, mund të bëhet ankim i veçantë.

Në nenin 297 të KPrC, lidhur me pezullimin e gjykimit (shtuar me ligjin nr.38/2017), parashikohet se, gjykata vendos pezullimin e gjykimit, kur njëra nga palët paraqet kërkesën për zgjidhje të çështjes me ndërmjetësim dhe gjykata e vlerëson të arsyeshme. Gjatë pezullimit nuk mund të kryhen veprime procedurale. Në këtë rast, gjykimi i çështjes rifillon kur marrëveshja për ndërmjetësim të mosmarrëveshjes nuk arrihet dhe/ose është plotësuar afati prej 30 ditësh. Përpjekjet e gjykatës për të zgjidhur çështjen me pajtim (ndërmjetësim) parashikohen edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në apel.¹⁴⁸

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar¹⁴⁹, përmban parashikime të cilat lidhen me kontratën e ndërmjetësimit (nenet

973-981) duke dhënë kështu një kuadër të plotë të përmbajtjes, shpërblimit dhe detyrimeve të palëve në një proces ndërmjetësimi.

Në të drejtën civile shqiptare, ndërmjetësimi përfaqëson një institucion të rëndësishëm juridik që shërben si një mekanizëm ndihmës për lidhjen e kontratave midis palëve, duke siguruar ndërveprim të strukturuar dhe neutral për realizimin e marrëveshjeve. E veçantë në trajtimin normativ të këtij institucioni është mënyra e rregullimit të tij në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, konkretisht në Kreun XV (nenet 973–981), ku ndërmjetësimi paraqitet si një marrëdhënie autonome, që nuk identifikohet as me përfaqësimin klasik, as me agjencinë apo me ndonjë formë tjetër të ndërhyrjes në emër të palës. Përkundrazi, ndërmjetësi vepron në mënyrë të pavarur, pa ndonjë lidhje varësie apo bashkëpunimi me asnjërën nga palët, duke ruajtur në këtë mënyrë neutralitetin dhe objektivitetin si vlera thelbësore për funksionimin efektiv të këtij instituti.

Neni 973 i Kodit Civil e përkufizon ndërmjetësin si personin që vë në kontakt dy ose më shumë palë me qëllim përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me to në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie apo përfaqësimi. Ky përkufizim është thelbësor për të vendosur statusin juridik të ndërmjetësit, i cili ndonëse ka rol aktiv në nxitjen e një kontrate, nuk është pjesëmarrës në të dhe nuk krijon detyrime kontraktore për palët, duke e vendosur atë në një pozitë të veçantë brenda sistemit të së drejtës kontraktore.

Trajtimi i çështjes së shpërblimit të ndërmjetësit zhvillohet në nenet 974 dhe 975. Në rastet kur mungon një marrëveshje paraprake ose

¹⁴⁸ Neni 461 i KPrC, paragrafi 1, "Fillimisht gjykata verifikon paraqitjen e rregullt të palëve, bën bashkimin e ankimeve të bëra kundër të njëjtit vendim dhe bën përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim".

¹⁴⁹ Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

kur nuk ka tarifa të përcaktuara në mënyrë të zakonshme, gjykata ka të drejtë të caktojë vlerën e shpërblimit dhe përpjesëtimin e tij midis palëve. Ky mekanizëm ruan parimin e ekuilibrit kontraktor, duke mos e lënë ndërmjetësin të pambrojtur përballë një situatë ku puna e tij nuk shpërblehet. Ndërkohë, neni 975 përcakton se e drejta e ndërmjetësit për shpërblim lind kur kontrata sjell efektet e saj, pavarësisht ngjarjeve të mëvonshme. Megjithatë, e drejta e shpërblimit përjashtohet nëse ndërmjetësi ka qenë në dijeni për ndonjë shkak pavlefshmërie të kontratës – një dispozitë që pasqyron parimin e ndershmërisë dhe besimit të mirë në marrëdhëniet civile.

Një aspekt tjetër me interes është e drejta për rimbursimin e shpenzimeve të ndërmjetësit edhe kur marrëveshja nuk përmbillet, siç parashikohet në nenin 976. Ky rregullim mbron interesat ekonomike të ndërmjetësit përballë dështimit të marrëveshjes, duke reflektuar një qasje pragmatike të ligjvënësit shqiptar ndaj marrëdhënieve civile. Në vijim, neni 977 rregullon rastet kur disa ndërmjetës kontribuojnë në lidhjen e një kontrate, duke u njohur secilit të drejtën për pjesën e tij të shpërblimit. Kjo dispozitë pasqyron parimin e bashkëpërgjegjësisë dhe ndarjes proporcionale të punës, dhe gjithashtu shmang mundësinë e konflikteve midis ndërmjetësve vetë.

Një ndër detyrimet më të rëndësishme të ndërmjetësit është detyrimi për informim të palëve, i parashikuar në nenin 978. Kjo dispozitë kërkon që ndërmjetësi të njoftojë palët për çdo rrethanë që ka dijeni dhe që ndikon në vlerësimin apo sigurinë e marrëveshjes. Në këtë kontekst, ndërmjetësi shndërrohet në një garantues të transparencës kontraktore, duke mbrojtur jo vetëm barazinë midis palëve, por edhe sigurinë juridike të vetë kontratës. Po ashtu, ai mban përgjegjësi për vërtetësinë e nënshkrimeve dhe për transmetimin korrekt të

titujve, gjë që e ngarkon me detyra që afrohen me ato të noterit, sidomos në raste që lidhen me pasuri të luajtshme me vlerë të lartë apo të drejta të negociueshme.

Një dispozitë më e detajuar për ndërmjetësin profesionist është neni 979, i cili e detyron atë të ruajë kampionet e mallrave të shitura, të përpilojë lista të nënshkruara të titujve dhe të mbajë shënime në një libër përkatës për çdo kontratë. Kjo rregullon veprimtarinë e ndërmjetësit në mënyrë të dokumentuar dhe të gjurmueshme, duke krijuar garanci jo vetëm për palët, por edhe për sistemin gjyqësor në rast të mosmarrëveshjeve të mëvonshme. Ndërmjetësi, sipas nenit 980, mund të ngarkohet nga njëra palë edhe për përfaqësim në zbatimin e kontratës, duke kaluar nga një rol neutral në një marrëdhënie që mund të krijojë detyrime përfaqësuese. Ky nen bën një zhvillim të fleksibilitetit funksional të figurës së ndërmjetësit, duke i lejuar atij të transformohet, nëse palët pajtohen, në një aktor më të përfshirë në realizimin e objektit kontraktor.

Së fundmi, neni 981 rregullon një situatë të veçantë në të cilën ndërmjetësi nuk zbulon emrin e njërit kontraktues. Në këtë rast, ndërmjetësi mban përgjegjësi për zbatimin e kontratës, por nëse më pas shfaqet ose zbulohet kontraktuesi tjetër, palët mund të ndërmarrin veprime gjyqësore drejtpërdrejt kundër njëra-tjetrës. Kjo dispozitë përfaqëson një garanci juridike për palën që vepron në mirëbesim, duke ruajtur koherencën e marrëdhënies kontraktore edhe në kushtet e mungesës së transparencës fillestare. Dispozitat e Kreut XV të Kodit Civil shqiptar paraqesin një strukturë të plotë dhe të balancuar për ndërmjetësimin në të drejtën civile. Ato jo vetëm që theksojnë rëndësinë e ndërmjetësit si një aktor neutral dhe i besueshëm në marrëdhëniet kontraktore, por edhe e pajisin atë me detyrime dhe përgjegjësi që rrisin nivelin e sigurisë dhe korrektesisë në lidhjen e marrëveshjeve. Ky kuadër ligjor përbën një reflektim të vlerave

themelore të së drejtës civile moderne: liria e kontraktimit, ndershmëria, transparenca dhe mbrojtja e mirëbesimit.

Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë

“Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 338, lidhur me përpjekjen për pajtim, parashikon se “*në rastin e veprave që ndiqen me kërkesën e viktimës akuzuese, gjykata thërret viktimën dhe atë kundër të cilit është bërë kërkesa për gjykim dhe u propozon zgjidhjen e çështjes me pajtim. Në qoftë se viktimë akuzuese e tërheq kërkesën dhe ai që akuzohet e pranon tërheqjen, gjykata vendos pushimin e çështjes. Në të kundërtën, ajo cakton datën e seancës dhe u bën të njohur atyre se mund të ndihmohen nga mbrojtës*”.

Siç është parashikuar në ligjin nr. 10385/2011, të ndryshuar¹⁵⁰, ndërmjetësimi në fushën penale zbatohet për mosmarrëveshjet që shqyrtohen nga gjykata me kërkesën e viktimës akuzuese, ose me ankim të të dëmtuarit, sipas neneve 59¹⁵¹ dhe 284¹⁵², të Kodit të Procedurës Penale.

Në rast se i referohemi Kodit Penal, veprat penale të parashikuara në nenet 59 dhe 284 të KPrP janë nenet 90-92, 112/1, 119-122, 125, 127, 148, 149, 254 (rrahja, plagosja e rëndë dhe e lehtë nga pakujdesia, dhunimi i banesës, fyerja, shpifja) si dhe nenet 85, 89, 102/1, 105, 106,

130, 239- 241, 243, 264, 275 dhe 318, (kur procedimi penal fillon nga prokuroria ose policia gjyqësore vetëm duke u bazuar në kërkesën e viktimës akuzuese, ose në ankimin e të dëmtuarit, si shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, plagosja e lehtë me dashje, etj).

Ligj nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale Për Të Mitur”

Kodi i Drejtësisë Penale Për Të Mitur¹⁵³ e përkufizon “ndërmjetësimin” si procesin e zgjidhjes jashtëgjyqësisht dhe përmes dialogut mes një të mituri që ka kryer veprën penale dhe viktimës, i cili realizohet nga ndërmjetësi dhe synon të zgjidhë mosmarrëveshjen mes tyre dhe pasojat që vijnë nga vepra penale, si dhe të përmirësojë marrëdhëniet midis tyre, pavarësisht nëse zbatohet ose jo si masë shmangieje¹⁵⁴. Gjithashtu, ndërmjetësi konsiderohet si organ kompetent në administrimin e drejtësisë penale për të mitur¹⁵⁵.

Ligji nr. 37/2017 në Kreun VII “*Shmangia nga ndjekja penale dhe nga dënimi përmes masave alternative*” parashikon, ndër të tjera, edhe programet e drejtësisë restauruese dhe/ose ndërmjetësimin¹⁵⁶. Organi procedues vendos për zbatimin e programit të drejtësisë restauruese, në përputhje me legjislacionin për ndërmjetësimin, me qëllim krijimin e mundësive për të miturin që të korrigjojë pasojat e veprës penale të kryer prej

¹⁵⁰ Neni 2 i ligjit nr. 10385/2011, i ndryshuar

¹⁵¹ Neni 59 i KPrP “Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127 dhe 254 të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërbllimin e demit”.

¹⁵² Neni 284 i KPrP “Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 89, 102 paragrafi i parë, 105, 106, 130, 148, 149, 243, 254, 264, e viktimës, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Ankimi bëhet nga viktimë të prokurori ose 275, 290, paragrafi i parë, dhe

318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin në policinë gjyqësore me anën e një deklarate, në të cilën personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të posaçëm, shfaqet vullneti që të procedohet në lidhje me një fakt të parashikuar nga ligji si vepër penale”.

¹⁵³ Ligj nr. 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale Për Të Mitur”, i ndryshuar

¹⁵⁴ Neni 3 pika 13 e ligjit nr. 37/2017;

¹⁵⁵ Po aty neni 3 pika 15 dhe neni 32;

¹⁵⁶ Po aty neni 63;

tij ndaj viktimës, komunitetit dhe/ose shoqërisë¹⁵⁷. Ndërmjetësimi familjar dhe në grup, përkufizohet si një masë alternative për shmangien e ndjekjes penale, ku marrin pjesë bashkërisht me viktimën dhe të miturin në konflikt me ligjin, edhe të afërmit e tyre, persona nga rrethi i tyre shoqëror, përfaqësues nga agjenci publike për mbrojtjen e të miturve, mbikëqyrjen e tyre dhe parandalimin e kriminalitetit për të miturit. Në këtë proces i akuzuari dhe familja e tij pritet të arrijnë një marrëveshje me viktimën, e cila përfshin kompensimin e dëmit, kryerjen e detyrimeve që janë të pranueshme prej viktimës dhe që pritet të mbajnë të akuzuarin larg situatave konfliktuale të ngjashme në të ardhmen¹⁵⁸. Ligji nr. 37/2017, detajon në nenin 64 mënyrën se si zhvillohet ndërmjetësimi në çështjet penale me të mitur duke vendosur disa kërkesa si:

pëlqimin e lirë për ndërmjetësim të shprehur si nga i mituri i akuzuar për veprën penale ashtu dhe nga pala e dëmtuar;

pjesëmarrjen personale të të miturit autor të veprës penale dhe të palës së dëmtuar;

mundësinë e pjesëmarrjes së përfaqësuesit ligjor të të miturit, psikologut, punonjësit të Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, prokurorit dhe/ose personat e tjerë të caktuar prej tij.

Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas rastit, mund të zbatohet edhe si masë shmangieje por edhe si një mundësi që çon në përmirësimin e marrëdhënieve midis të miturit autor dhe viktimës së veprës penale¹⁵⁹. Prokurori gjatë hetimit dhe gjyqtari gjatë gjykimit mund të propozojnë ndërmjetësimin nëse vlerësojnë se

kjo alternativë është më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historinë e të miturit, mundësinë e kthimit të raporteve normale mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësinë e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësinë e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimin e tij në shoqëri¹⁶⁰. Në rast se propozimi i prokurorit/gjyqtarit për ndërmjetësim pranohet nga palët, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pezullimin e procesit penal për një afat jo më shumë se 45 ditë. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit arrihet, atëherë prokurori/gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit nuk arrihet me kalimin e 45 ditëve, pezullimi bie dhe vazhdon hetimi/gjykimi i çështjes¹⁶¹.

Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”

Ndërmjetësimi është një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që synon shmangien e gjykimit tradicional dhe promovimin e dialogut ndërmjet palëve, me ndihmën e një ndërmjetësi të paanshëm. Kodi i Familjes¹⁶² i ndryshuar ka inkorporuar ndërmjetësimin si një mekanizëm ligjor në disa dispozita të rëndësishme që përfshijnë regjimin pasuror martesor, zgjidhjen e martesës, procesin e pajtimit, si dhe çështjet që lidhen me të miturit. Ky integrim i ndërmjetësimit është në përputhje me parimet e së drejtës bashkëkohore familjare dhe me standardet evropiane dhe ndërkombëtare që promovojnë zgjidhjet alternative të mosmarrëveshjeve. Në kontekstin familjar, ndërmjetësimi synon mbrojtjen e interesit më të

¹⁵⁷ Po aty neni 63, pika 1;

¹⁵⁸ Po aty neni 63, pika 6;

¹⁵⁹ Po aty neni 64, pika 5;

¹⁶⁰ Po aty neni 64, pika 6;

¹⁶¹ Po aty neni 64, pika 7.

¹⁶² Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i Familjes”, i ndryshuar

mirë të fëmijëve, ruajtjen e marrëdhënieve ndërpersonale dhe reduktimin e konflikteve të zgjatura.

Marrëveshja për regjimin pasuror martesor – Neni 66

Neni 66 i Kodit të Familjes parashikon mundësinë që bashkëshortët të bien dakord mbi një **regjim pasuror martesor** të ndryshëm nga ai ligjor (i zakonshëm), përmes një marrëveshjeje të posaçme. Marrëveshja për regjimin pasuror duhet të jetë me **shkrim dhe të noterizuar**, por ndërmjetësimi paraprak mund të ndihmojë në hartimin e saj mbi baza të dakorduara dhe të paanshme.

Në rastet kur bashkëshortët nuk bien dakord për ndarjen e pasurisë ose për përcaktimin e regjimit të saj, ata mund të drejtohen te një ndërmjetës i licencuar për të hartuar një marrëveshje të drejtë dhe të ekuilibruar.

Ndërmjetësimi ndihmon për të shmangur konfliktet gjyqësore që shpesh rezultojnë në përshkallëzim të mosmarrëveshjeve financiare.

Zgjidhja e martesës me marrëveshje – Neni 125

Dispozita e Nenit 125 parashikon se:

"Kur bashkëshortët bien dakord për zgjidhjen e martesës dhe kanë rënë dakord për pasojat e saj, paraqesin së bashku një kërkesë në gjykatë për zgjidhjen e martesës."

Ky formulim përmbledh katër elementë thelbësorë: Vullneti i lirë i të dy bashkëshortëve për të zgjidhur martesën; Marrëveshja paraprake për pasojat ligjore që rrjedhin nga ndarja; Paraqitja e përbashkët e kërkesës në gjykatë; Miratimi gjyqësor i marrëveshjes, pas një vlerësimi mbi përputhshmërinë e saj me ligjin dhe interesat e fëmijëve.

Kjo formë e zgjidhjes së martesës është e njohur në të drejtën krahasuese si *"divorci konsensual"* dhe shënon një largim nga praktikat tradicionale, ku procesi i divorcit ishte i gjatë, konfliktual dhe i mbështetur vetëm në faje apo shkelje të rënda bashkëshortore.

Neni 125 mbështetet mbi disa parime të rëndësishme të së drejtës familjare moderne:

Parimi i autonomisë së vullnetit të bashkëshortëve: Ligji nuk e imponon martesën si një lidhje e përjetshme në kushtet kur vullneti për bashkëjetesë është konsumuar. Prandaj, i njeh bashkëshortëve të drejtën për t'u ndarë në mënyrë të qetë dhe të ndërgjegjshme.

Parimi i mbrojtjes së fëmijëve të mitur: Gjykata, edhe në rastin e marrëveshjes, ka detyrimin të verifikojë nëse zgjidhja e propozuar nuk dëmton interesin më të lartë të fëmijës, sidomos në lidhje me kujdestarinë, vendbanimin dhe detyrimin ushqimor.

Parimi i ekonomizimit të drejtësisë: Përmes kësaj procedure, gjykatat lirohen nga ngarkesa e lartë e çështjeve kontestuese të divorcit, ndërkohë që palët fitojnë një zgjidhje të shpejtë dhe më pak konfliktuale.

Por marrëveshja e bashkëshortëve nuk ka efekt automatik. Ajo duhet të miratohet nga gjykata, e cila ka një rol aktiv në kontrollimin e:

Ligjshmërisë së përmbajtjes së marrëveshjes;

Barazisë mes palëve në ndarjen e pasurisë; Mbrojtjes së interesit të fëmijëve të mitur; Mbrojtjes së palës më të dobët, në rast se ekziston një pabarazi e dukshme në pozicionin ekonomik apo social.

Kështu, gjykata mbetet garantuese e drejtësisë materiale, edhe kur palët kanë zgjedhur zgjidhjen

konsensuale.

Neni 134: Detyrimi për të përpjekur pajtimin

“Kur një bashkëshort kërkon zgjidhjen e martesës, gjykata përpiqet të pajtojë bashkëshortët.”

Ky nen vendos një detyrim pozitiv për gjykatën që të mos veprojë menjëherë drejt ndarjes, por të nxisë një përpjekje fillestare për pajtim. Kjo dispozitë shpreh filozofinë e së drejtës familjare moderne, ku synohet shmangia e konflikteve të panevojshme dhe inkurajimi i zgjidhjeve jo-kontestimore. Megjithatë, përpjekja për pajtim nuk është një pengesë ndaj të drejtës për divorc; ajo duhet të jetë një mundësi reale, e ofruar në mirëbesim dhe pa detyrim.

Por, ky nen krijon një bazë të fortë për përdorimin e ndërmjetësimi, pasi ndërmjetësimi përmban mekanizma efektivë për t'i ndihmuar palët të shprehin shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre në një ambient të strukturuar e neutral.

Neni 134-135: Shtyrja e shqyrtimit për pajtim

“Për përpjekje pajtimi, gjykata, me pëlqimin e bashkëshortëve, mund të shtyjë shqyrtimin e çështjes deri në tre muaj.”

Ky nen i jep gjykatës kompetencën për të pezulluar përkohësisht procesin gjyqësor me qëllim që palët të marrin kohë për të reflektuar. Shtyrja deri në tre muaj nuk është vetëm një periudhë pritjeje, por mund të përkthehet në një fazë ndërmjetësimi aktiv, ku palët asistohen nga profesionistë për të shqyrtuar mundësinë e vazhdimi të martesës ose ndarjes në mënyrë të civilizuar. Kjo dispozitë: Nxiti zgjidhjen e konflikteve me dialog; Mbron stabilitetin emocional të fëmijëve, duke i dhënë kohë prindërve për të menduar me qetësi për vendimet që ndikojnë jetën e tyre; I jep hapësirë praktikës së ndërmjetësimi familjar, si një rrugë

joformale dhe më pak konfrontuese.

Në këtë mënyrë, ligji i jep prioritet procesit pajtues, përpara ndërhyrjes autoritare të gjykatës për zgjidhjen e konfliktit.

Neni 135: Vlerësimi i pamundësisë së pajtimit

“Kur gjykata konstaton se bashkëshortët nuk mund të pajtohen, vazhdon shqyrtimin e kërkesës për zgjidhjen e martesës.”

Ky nen është logjikisht përmbyllja e përpjekjes për pajtim. Ai njeh faktin që, në rrethana të caktuara, martesa është prishur në mënyrë të pakthyeshme, dhe çdo përpjekje për pajtim do të ishte e kotë apo madje e dëmshme. Megjithatë, edhe në këtë fazë, ndërmjetësimi mund të mbetet i vlefshëm, jo për të rikthyer martesën, por për të zgjidhur me konsensus pasojat e divorcit:

Rregullimin e kujdestarisë së fëmijëve;
Përcaktimin e të drejtave të vizitës;
Ndarjen e pasurisë;
Marrëveshjet për detyrimin ushqimor.

Pra, ndërmjetësimi e ruan relevancën e tij, edhe kur bashkëshortët vendosin në mënyrë të pakthyeshme për ndarje.

Konfliktet për fëmijën – Neni 221

Në qoftë se prindërit nuk bien dakord për atë që kërkon interesi i fëmijës, ata mund t'i drejtohen gjykatës, e cila vendos pasi është përpjekur ta zgjidhë çështjen me pajtim

Ky nen paraqet një normë procedurale dhe substanciale që vendos rregullat për mënyrën se si gjykata ndërhyr kur ka konflikte ndërmjet prindërve mbi çështje që lidhen me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

Tri elemente qenësore që duhen veçuar në këtë nen janë:

Dëgjimi i të dy prindërve dhe fëmijës mbi 10 vjeç – një garanci procedurale që i jep zë interesit dhe dëshirës së vetë fëmijës, në përputhje me Konventën për të Drejtat e Fëmijës (neni 12).

Parimi i interesit më të mirë të fëmijës (best interest of the child) – parimi udhëheqës që orienton çdo vendim të gjykatës në këtë fushë. Detyrimi i gjykatës për të përpjekur pajtimin dhe për të dërguar palët në ndërmjetësim – një dispozitë novatore që synon shmangien e procedurave të gjata dhe konfliktuale në gjykatë.

Kështu, në të gjitha çështjet familjare ku përfshihen interesat e të miturve: si paditë për pension ushqimor, ndarjen e pasurisë bashkëshortore, apo çdo lloj tjetër mosmarrëveshjeje ndërmjet anëtarëve të familjes që nuk kërkon domosdoshmërisht ndërhyrjen e gjykatës, ndërmjetësimi përbën një mënyrë alternative për zgjidhjen paqësore të konflikteve.

Ky proces ofron një mundësi që palët të gjejnë zgjidhje të përbashkëta përmes ndihmës së një ndërmjetësi të kualifikuar dhe të paanshëm, i cili, ndryshe nga një avokat që përfaqëson vetëm njërin palë, qëndron në pozicion neutral dhe ndihmon të dyja palët të kuptojnë më mirë nevojat dhe shqetësimet e njëri-tjetrit. Gjatë ndërmjetësimit, palët nxiten të eksplorojnë alternativa të ndryshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke u përqendruar në ndërtimin e një marrëveshjeje të pranueshme për të dyja palët.

Ndërmjetësimi familjar nuk kufizohet vetëm te ndarja ose divorci, por përdoret gjithnjë e më shumë edhe për zgjidhjen e konflikteve të tjera

brenda familjes, si mosmarrëveshjet mes prindërve dhe fëmijëve, kujdesi për të moshuarit ose anëtarët e sëmurë të familjes, raportet ndërmjet gjyshërve dhe nipërve, si dhe situatat e mungesës së strehimit të shkaktuar nga konfliktet familjare.

Ndërmjetësi, në disa raste, mund të japë sugjerime për zgjidhjen e konfliktit, gjithmonë me qëllim lehtësimin e një marrëveshjeje të drejtë dhe të qëndrueshme, por nuk merr asnjëherë rolin e një vendimmarrësi dhe nuk i dikton palëve veprimet që duhet të ndërmarrin.

Ligji nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar

Përkufizimi i ndërmjetësimit

Në nenin 1 të ligjit nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar,¹⁶³ ndërmjetësimi përkufizohet si “veprimtari jashtëgjyqësor, në të cilën palët kërkojnë zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje me anë të një personi të tretë asnjans (ndërmjetësit), për të arritur një zgjidhje të pranueshme të mosmarrëveshjes dhe që nuk bie në kundërshtim me ligjin. Ndërmjetësimi për zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve është veprimtari e pavarur, që ushtrohet në përputhje me këtë ligj dhe nën monitorimin dhe mbikqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë. Ndërmjetësit nuk kanë të drejtë të urdhërojnë apo të detyrojnë palët të pranojnë zgjidhjen e mosmarrëveshjes”.

Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 26/2018, në nenin 1 shtohet një nen 1/2 “përkufizime” në të cilin ndërmjetësimi përkufizohet si “procedura e zgjidhjes jashtëgjyqësore të konflikteve, ku dy ose më shumë palë në mosmarrëveshje, mbi bazë të vullnetit të lirë, përpiqen për të zgjidhur

¹⁶³ Ligji nr. 10385/2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, i ndryshuar,

mosmarrëveshjet me mbështetjen e ndërmjetësit”¹⁶⁴ Nga leximi i dispozitave të mësipërme rezulton se, përkufizimi i ndërmjetësit, tashmë i dhënë në mënyrë të përsëritur, përmban elementët kryesorë që e karakterizojnë atë, të cilët i gjejmë edhe në aktet evropiane të sipërpërmendura.

Ndërmjetësimi jashtëgjyqësor dhe ndërmjetësimi i referuar nga gjykata

Në Shqipëri, ndërmjetësimi jo vetëm rregullohet nga një ligj i posaçëm, por ky i fundit i referohet ndërmjetësit në fushën civile, tregtare, të punës dhe familjare, pronësisë intelektuale, të drejtave të konsumatorëve, si dhe të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private. Ligji për ndërmjetësimin parashikon të dy llojet e ndërmjetësit, si atë jashtëgjyqësor, ashtu edhe atë të referuar nga gjykata. Në fakt, ndërmjetësimi jashtëgjyqësor dhe ai i referuar nga gjykata kanë qenë të parashikuar edhe në versionet e mëparshme të ligjeve për ndërmjetësimin në Shqipëri, por ndryshimet e njëpasnjëshme kanë plotësuar fushat e ndërhyrjes dhe kanë qartësuar veprimet e gjyqtarit, prokurorit apo organit përkatës shtetëror. Me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 26/2018 në ligjin për ndërmjetësimin, ekzistenca

e të dy llojeve të ndërmjetësit është pranuar që në nenin 1/1.2/a/b “përkufizime”.

Përveç përkufizimit të ndërmjetësit, në nenin 1/1.2/b jepet edhe përkufizimi i “ndërmjetësit

të referuar nga gjykata ose prokurori” i cili cilësohet si “një procedurë ndërmjetësimi e filluar pas vënies në dijeni të palëve ndërgjyqëse nga gjykata mbi mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim, pranimi të palëve dhe kalimit nga gjykata të çështjes për ndërmjetësim, në përputhje me këtë ligj, Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”.

Gjithashtu, në nenin 2 pika 1 e ligjit nr.10385/2011¹⁶⁵ parashikohet ndërmjetësimi jashtëgjyqësor dhe ai i referuar nga gjykata apo organi përkatës shtetëror¹⁶⁶. Në rastin e ndërmjetësit të referuar nga gjykata, ligji nr.10385/2011 parashikon në nenin 2 pika 4 se “gjykata ose organi përkatës shtetëror, brenda kompetencave të parashikuara në ligj, detyrimisht njofton, udhëzon dhe, sipas rastit, informon në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme palët për zgjidhjen me ndërmjetësim, veçanërisht, por pa u kufizuar vetëm në to, të mosmarrëveshjeve:

- a) në çështjet civile dhe familjare, kur ndërthuren interesat e të miturve;
- b) në çështjet e pajtimit në rastet e zgjidhjes së martesës, të parashikuar nga neni 134 i Kodit të Familjes;
- c) me karakter pasuror, që lidhen me të drejtat e pronësisë ose të bashkëpronësisë, pjesëtimin e pasurisë, paditë për kërkimin e sendit, për paditë mohuese e për paditë për pushimin e cenimit të posedimit, mosmarrëveshjet që rrjedhin nga mospërmblidhjet e detyrimeve kontraktuese, si dhe ato që kanë si objekt shpërblimin e dëmit jashtëkontraktues”.

¹⁶⁴ Neni 1/1.2/a i ligjit ndryshues nr. 26/2018;

¹⁶⁵ Ndryshuar me ligjin nr. 26/2018.

¹⁶⁶ Neni 2 pika 1 e ligjit nr. 10385/2011

“Ndërmjetësimi, sipas këtij ligji, zbatohet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara nga pikat 2 dhe 3, të këtij neni, në çdo kohë që palët në konflikt, me vullnetin e tyre të lirë, kërkojnë dhe pranojnë ndërmjetësimin si

alternativë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pavarësisht nëse mosmarrëveshja është paraqitur përpara organit të përcaktuar nga ligji për zgjidhjen e saj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe në ato raste kur gjykata apo organi përkatës shtetëror, pas vënies në lëvizje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, njofton dhe udhëzon palët drejt ndërmjetësit, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni”;

Nga leximi i dispozitave të mësipërme vëmë re se ligji jo vetëm rregullon të dy llojet e ndërmjetësimit (jashtëgjyqësor dhe ndërmjetësimin e referuar nga gjykata) por i ka dhënë edhe një karakter detyrues njoftimit dhe udhëzimit të palëve për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjeve. Dispozita lidhur me ndërmjetësimin e referuar nga gjykata, gjejmë edhe në KPrC, KPrP apo Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur.

Megjithatë, vihen re disa mangësi në formulimin e dispozitave.

Ndërkohë që në disa nene të ligjit nr. 10385/2011 parashikohet edhe referimi nga *“organi përkatës shtetëror”*¹⁶⁷ ose *“organe të tjera kompetente”*¹⁶⁸ ky parashikim nuk reflektohet në përkufizimin e nenit 1/1.2/b i cili flet për *“ndërmjetësim të referuar nga gjykata ose prokurori”* duke përjashtuar nga përkufizimi referimin e organeve të tjera kompetente, veçanërisht në kuadër të ndërmjetësimit të mosmarrëveshjeve midis organeve të administratës publike dhe subjekteve private. Gjithashtu, neni 1/1.2/b i referohet vetëm Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur duke lenë të papërfshirë Kodin e Procedurës Penale. Për sa i përket subjektit që mund të kryejë ndërmjetësimin e referuar nga gjykata, prokurori ose organi përkatës shtetëror, ligji nr.10385/201 parashikon se janë ndërmjetësit e licencuar sipas kërkesave të këtij ligji që do të ofrojnë këtë shërbim.

Pra, ligji shqiptar ka zgjedhur modelin ku shërbimi i ndërmjetësimit ofrohet nga ndërmjetës që veprojnë jashtë sistemit gjyqësor pavarësisht se qasja që inkurajohet është ajo ku gjyqtarët të mund të veprojnë si ndërmjetës së bashku me ndërmjetësit e tjerë të licencuar. Një qasje e tillë inkurajohet pasi gjyqtarët, të trajnuar

që të veprojnë edhe si ndërmjetës, mund të jenë më të gatshëm t'i rekomandojnë palëve që të zgjidhin mosmarrëveshjen e tyre me ndërmjetësim dhe rrjedhimisht, të ndikojë në rritjen e numrit të mosmarrëveshjeve të zgjidhura me ndërmjetësim. Siç e theksuam më lart, pothuajse të gjithë rekomandimet apo direktivat kërkonin që legjislacioni vendas të siguronte referimin për ndërmjetësim në çdo fazë të procesit gjyqësor.

Në nenin 13 dhe 14 parashikohet se gjykata njofton dhe udhëzon palët për zgjidhjen me ndërmjetësim të mosmarrëveshjes objekt gjykimi dhe kur palët bien dakord pezullon gjykimin duke u caktuar palëve një afat në përputhje me natyrën e mosmarrëveshjes, por jo më shumë se 30 ditë.

KPrC në nenin 158/ç të tij, lidhur me veprimet e pajtimit¹⁵² parashikon se *“1. Gjyqtari, gjatë veprimeve përgatitore, bën të gjitha përpjekjet për të zgjidhur mosmarrëveshjen me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Për këtë qëllim, kur është rasti, urdhëron edhe paraqitjen e vetë palëve. 2. Në çdo fazë të gjykimit, gjykata vë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për ndërmjetësim. 3. Kur arrihet pajtimi pa filluar seanca gjyqësore, mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga palët. Gjyqtari me vendim miraton pajtimin.”*.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se në procesin civil, përpjekjet e gjyqtarit për të referuar mosmarrëveshjen tek ndërmjetësimi duhet të përqëndrohen gjatë veprimeve përgatitore megjithatë, KPrC parashikon mundësinë që në çdo fazë të gjykimit gjykata të vërë në dijeni palët lidhur me mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjes me ndërmjetësim dhe nëse ato pranojnë e kalon çështjen për

¹⁶⁷ Neni 2 i ligjit nr. 10385/2011

¹⁶⁸ Neni 12 i ligjit nr. 10385/2011.

ndërmjetësim. Ky parashikim i KPrC është pikërisht edhe ai që rekomandohet nga aktet evropiane të sipërcituar. E njëjta situatë paraqitet edhe për çështjet penale me të mitur pasi neni 64 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur parashikon propozimin për ndërmjetësimin nga ana e prokurorit gjatë gjithë fazës së hetimit dhe nga ana e gjyqtarit gjatë gjithë gjykimit. Situata nuk paraqitet e njëjtë në procesin penal pasi KPrP e parashikon “përpyekjen për pajtim” të gjyqtarit vetëm gjatë veprimeve procedurale përgatitore.

Ndërmjetësit

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë e përkufizon ndërmjetësin si personin që vë në lidhje dy ose më shumë palë për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi¹⁶⁹. Ndryshimet e bëra në ligjin nr.10385/2011 me ligjin nr.26/2018, shtuan në listën e përkufizimeve edhe atë për ndërmjetësin si personin e licencuar dhe të regjistruar në Regjistrin e Ndërmjetësve, i zgjedhur vullnetarisht nga palët midis ndërmjetësve të përfshirë në listën e ndërmjetësve të licencuar, të cilit i kërkohet të zhvillojë ndërmjetësimin në mënyrë të paanshme, të përshtatshme dhe të efektshme, në përputhje me parashikimet e ligjit për ndërmjetësimin¹⁷⁰.

Lidhur me aftësitë profesionale të ndërmjetësit, ligji nr.10385/2011 në nenin 5¹⁷¹ parashikon “Kushtet për licencim” duke përcaktuar se shtetasi shqiptar duhet të përmbushë njëkohësisht këto kushte për t’u licencuar si ndërmjetës:

a) të ketë kryer programet e studimeve të ciklit të dytë, sipas përcaktimeve të legjislacionit për

arsimin e lartë; b) të ketë mbushur moshën 28 vjeç;

b/1) të ketë eksperiencë profesionale jo më pak se tre vjet;

c) të mos jetë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqsor të formës së prerë;

ç) të ketë kaluar me sukses provimin kualifikues për ndërmjetës, pas përfundimit të programit të trajnimit fillestar.

Nga parashikimet e nenit 5 vërejmë se edhe ligji shqiptar ashtu si edhe legjislacioni i vendeve të tjera parashikon disa kërkesa që duhet të përmbushin kandidatët për ndërmjetës. Ndërkohë që përfundimi i studimeve universitare të ciklit të dytë (master) është një nga kërkesat, vihet re se ligji nr. 10385/2011 nuk e përcakton degën e studimeve duke lënë të hapur që subjekte nga kualifikime të ndryshme të mund të pajisen me licencë. Arsimi juridik nuk është një domosdoshmëri për tu licencuar si ndërmjetës. Ky parashikim është në përputhje edhe me çfarë parashikohet në aktet evropiane lidhur me kualifikimin e ndërmjetësve. Gjithashtu, për çështje specifike (çështjet ku përfshihen interesat e të miturve apo çështjet me natyrë tregtare) ligji vendos kërkesa më të detajuara lidhur me kualifikimin e ndërmjetësve¹⁷². Kriteri i arsimit të lartë kombinohet edhe me kriteret e tjera si kriteri i bazuar mbi moshën (të ketë mbushur moshën 28 vjeç)¹⁷³ apo kriteri i eksperiencës profesionale (jo më pak se tre vjet)¹⁷⁴ duke bërë që ligji shqiptar për ndërmjetësimin të përmbajë një listë të plotë të të gjitha kërkesave të parashikuara në Manualin Evropian për Ligjin e Ndërmjetësimit.

Ndryshimi që vihet re në ligjin shqiptar për ndërmjetësimin, krahasuar me eksperiencën e vendeve të tjera, është që profesioni i ndërmjetësit

¹⁶⁹ Neni 973 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;

¹⁷⁰ Neni 1/2 i ligjit nr.26/2018;

¹⁷¹ Ndryshuar me ligjin nr. 26/2018;

¹⁷² Shtuar me ligjin nr. 26/2018

¹⁷³ Ndryshuar me ligjin nr. 26/2018, nga 25 vjeç në 28 vjeç

¹⁷⁴ Shtuar me ligjin ndryshues nr. 26/2018.

nuk shihet i lidhur me profesionet e tjera ligjore (gjyqtarët apo avokatët) të cilët mund të shërbenin si ndërmjetës pa patur nevojë për licencim të dyfishtë (p.sh në Itali avokatët e licencuar janë edhe ndërmjetës). Një ndërmjetës duhet të ketë standarde të larta morale dhe shumica e vendeve konsiderojnë se një person i cili ka një precedent penal nuk duhet të ketë të drejtë të licencohet si ndërmjetës. Të njëjtin parashikim përmban edhe ligji shqiptar për ndërmjetësimin i cili kërkon që kandidati të mos jetë dënuar për kryerjen me dashje të veprave penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë. Konsiderohet e rëndësishme që legjislacioni i brendshëm të përmbajë parashikime të qarta lidhur me trajnimin e ndërmjetësve.

Një nga synimet e ndryshimeve të sjella me ligjin nr. 26/2018 ishte edhe parashikimi i trajnimit vazhdues të ndërmjetësve. Në këtë kontekst, neni 5/1 i ligjit nr. 10385/2011 ndryshon duke parashikuar kërkesa të qarta për trajnimin e ndërmjetësve. Në këtë nen parashikohet detyrimi që ndërmjetësit ti nënshtrohen trajnimit fillestar (përpara licencimit të tyre) dhe trajnimit vazhdues (pas licencimit të tyre). Trajnimi fillestar ofrohet, të paktën një herë në vit, nga DHKN dhe mund të ofrohet edhe nga institucione të arsimit të lartë, të akredituara sipas ligjit, programi i të cilave miratohet paraprakisht nga MD. Në përfundim të trajnimit fillestar, zhvillohet provimi kualifikues për ndërmjetës. Provimi i kualifikimit organizohet të paktën njëherë në vit nga MD, në bashkëpunim me DHKN. Pas licencimit dhe regjistrimit në RN, ndërmjetësi ka detyrim ndjekjen e programeve të trajnimit vazhdues.

Të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësit

Ligji shqiptar për ndërmjetësimin parashikon në nenin 9 të tij "Të drejtat e ndërmjetësit" dhe në

nenin 10 të tij "Detyrimet e ndërmjetësit". Formulimi i këtyre neneve është prekur nga ndryshimet e bëra me ligjin nr. 10385/2011.

Në nenin 9, të ndryshuar, parashikohet se "1. Ndërmjetësit, që e ushtrojnë këtë veprimtari si profesion, kanë të drejtë të kërkojnë dhe të shpërblehen për punën, si dhe për shpenzimet e kryera në procedurën e ndërmjetësimit, sipas marrëveshjes për ndërmjetësim, të nënshkruar me palët. 2. Ndërmjetësi i përzgjedhur nga palët në mosmarrëveshje nuk është i detyruar të lidhë marrëveshje ndërmjetësimi. Në këtë rast, ndërmjetësi nuk është i detyruar të arsyetojë vendimin e tij". Në nenin 10 të ligjit nr. 10385/2011 përcaktohen detyrat e ndërmjetësit si më poshtë: "1. Ndërmjetësi e ushtron profesionin e vet në mënyrë të paanshme, me ndershmëri dhe profesionalizëm, respekton rregullat e etikës profesionale dhe përdor të gjitha mjetet e ligjshme për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve. 2. Ndërmjetësi nuk ofron këshillim ligjor. 3. Ndërmjetësi ruan konfidencialitetin për të dhënat, për të cilat ka dijeni për shkak të një procedure ndërmjetësimi, në raport me secilën prej palëve apo me persona të tjerë jashtë procedurave të ndërmjetësimit, me përjashtim të rastit kur pala, të dhënat e së cilës bëhen publike ose përpunohen sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, ka dhënë miratimin e saj me shkrim. 4. Ndërmjetësi ruan sekretin profesional dhe nuk mund të detyrohet të dëshmojë për fakte dhe rrethana, për të cilat vihet në dijeni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së ndërmjetësimit, përveç rasteve kur ka detyrimin me ligj që faktet t'i referojë tek autoritetet proceduese shtetërore. 5. Përveçse kur palët kanë rënë dakord ndryshe, ndërmjetësi nuk duhet të veprojë si arbitër për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje që ka qenë ose është subjekt i procedurave të ndërmjetësimit ose për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje tjetër, që rrjedh nga e njëjta marrëdhënie, e cila i është nënshtruar

procedurës së ndërmjetësimit. 6. Me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.”

Nga analiza e dispozitave të mësipërme lidhur me të drejtat dhe detyrat e ndërmjetësit rezulton se për sa i përket detyrave të tij, ato janë të ngjashme me çfarë kërkohet nga aktet evropiane por edhe me modelet e ligjeve të ndërmjetësimit në vende të ndryshme (p.sh paanshmëria, ndërshmëria, profesionalizmi dhe etika, konfidencialiteti i procesit etj). Megjithatë, vihet re se për sa i përket detyrimeve të tjera të natyrës procedurale që shfaqen në legjislacionin e disa vendeve, ligji shqiptar për ndërmjetësimin nuk kërkon që ndërmjetësit, përpara se të fillojnë një procedurë ndërmjetësimi, të nënshkruajnë domosdoshmërisht një marrëveshje ndërmjetësimi me palët. Përkundrazi, ky detyrim lind me përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësi njofton me shkrim, gjykatën ose arbitrazhin, me qëllim fillimin e procedurave të pezulluara për efekt të ndërmjetësimit.

Për sa i përket përgjegjësisë së ndërmjetësit, legjislacioni shqiptar parashikon si përgjegjësinë disiplinore të tij ashtu edhe atë civile. Përgjegjësia disiplinore e ndërmjetësit është përfshirë në ligjin për ndërmjetësimin me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 26/2018. Në ligjin nr. 10385/2011 në nenin 11/1 parashikohet se “Veprimtaria e ndërmjetësve i nënshtrohet kontrollit për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga Ministria së Drejtësisë, në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar në çdo rast të drejtën për t’u

informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur”. Procedimi disiplinor ndaj një ndërmjetësi fillon mbi bazën e një ankimi të bërë ndaj tij që klasifikohet si “sjellje jo profesionale” ku përfshihen veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore apo nënligjore, Statutin dhe Kodin e Etikës të Ndërmjetësve dhe/ose “shërbime të papërshtatshme profesionale”, ku përfshihen veprime apo mosveprime ndaj palëve në ndërmjetësim, të cilat janë në kundërshtim me këtë ligj¹⁷⁵. Bordi Disiplinor, në proporcion me natyrën dhe rëndësinë e shkeljes, vendos një nga masat disiplinore: verejte me shkrim, gjobe apo pezullim aktiviteti¹⁷⁶

Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se legjislacioni shqiptar paraqitet i plotë, vecanërisht pas ndryshimeve me ligjin nr. 26/2018, për sa i përket parashikimeve lidhur me aftësitë dhe kualifikimet e ndërmjetësve, standartet morale që duhet të plotësojnë ata, testimin të tyre, trajnimin fillestar dhe vazhdues si dhe lidhur me detyrimet dhe përgjegjësitë e tyre. Megjithatë, dhe duke marrë në konsideratë që pritet që së shpejti të hartohet urdhëri i Ministrit të Drejtësisë mbi kohëzgjatjen, përmbajtjen dhe organizimin e trajnimit fillestar dhe vazhdues, përzgjedhjen e trajnerëve, trajnimin e trajnerëve, vlerësimin e performancës së tyre, organizimin dhe vlerësimin e provimit kualifikues, atëherë sugjerohet që gjatë procesit të hartimit të këtyre rregullave nga DHKN dhe MD duhen mbajtur në konsideratë udhëzimet e dhëna më sipër me qëllim që të sigurohet cilësia e trajnimit për ndërmjetësit. Gjithashtu, vihet re se, ligji për ndërmjetësit nuk përmban parashikime lidhur me trajnimin e specializuar në tema/fusha të caktuara, rrjedhimisht, sugjerohet që DHKN dhe MD duhet të mbajnë në konsideratë edhe këtë nevojë me

¹⁷⁵ Neni 11/4 i ligjit nr. 10385/2011 me ligjin nr. 26/2018;

¹⁷⁶ Neni ne ligj

qëllim që të rrisë cilësinë e ndërmjetësimit në çështje specifike (p.sh çështjet familjare).

Marrëveshja e ndërmjetësimit

Me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 10385/2011 me ligjin nr. 26/2018, pika 2 e nenit 9 të ligjit ndryshohet, dhe tashmë parashikon se, *“Ndërmjetësi i përzgjedhur nga palët në mosmarrëveshje nuk është i detyruar të lidhë marrëveshje ndërmjetësi. Në këtë rast, ndërmjetësi nuk është i detyruar të arsyetojë vendimin e tij”*. Në nenin 17 të ligjit nr. 10385/2011 parashikohet se palët dhe ndërmjetësi nënshkruajnë bashkërisht, me shkrim, marrëveshjen për realizimin e procesit të ndërmjetësimit, ku duhet të përcaktohen:

- a) gjeneralitetet e palëve të kësaj marrëveshjeje dhe të përfaqësuesve të tyre;
- b) përshkrimi i objektit të mosmarrëveshjes;
- c) pranimi i parimeve të ndërmjetësimit, sipas këtij ligji dhe të ndërmjetësit të caktuar;
- ç) vendi i ndërmjetësimit;
- d) shpenzimet e ndërmjetësimit dhe shpërblimi i ndërmjetësit.

Nga analiza e dispozitave të mësipërme rezulton se nënshkrimi i një marrëveshjeje ndërmjetësi nuk është i detyrueshëm sipas ligjit shqiptar për ndërmjetësimin, dhe palët së bashku me ndërmjetësin, janë të lira të vendosin rregullat dhe mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit¹⁷⁷. Megjithatë, edhe në rast të nënshkrimit të një marrëveshjeje të tillë, ligji parashikon përmbajtjen minimale të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu,

ligji nr. 10385/2011 parashikon se në mungesë të një marrëveshjeje për mënyrën e zhvillimit të ndërmjetësimit, ndërmjetësit mund ta zhvillojnë ndërmjetësimin në mënyrën më të përshtatshme për palët, mbështetur në rrethanat e çështjes, në çdo kërkesë që mund të paraqesin palët dhe në çdo nevojë për një zgjidhje të shpejtë të mosmarrëveshjes. Në çdo rast, në zbatimin e procedurave të ndërmjetësimit, ndërmjetësi duhet të kujdeset për të siguruar trajtimin e drejtë dhe të paanshëm të palëve, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes¹⁷⁸. Siç e theksuam më lart, në Manualin Evropian për Ligjin e Ndërmjetësimit¹⁷⁹ rekomandohet hartimi i një modeli të marrëveshjes së ndërmjetësimit, të cilës palët dhe ndërmjetësit mund ti referohen, çfarë do të siguronte jo vetëm përputhshmërinë me ligjin por edhe me standartet që duhet të përmbushë ky proces.

Aktmarrëveshja për zgjidhjen e mosmarrëveshjes

Ligji shqiptar për ndërmjetësimin parashikon se kur palët bien dakord për zgjidhjen e pranueshme të mosmarrëveshjes ndërmjet tyre, së bashku me ndërmjetësit, nënshkruajnë marrëveshjen përkatëse, në kuptim dhe në zbatim të kushteve, rasteve dhe të procedurave të parashikuara në ligj. Kjo marrëveshje është e detyrueshme dhe e ekzekutueshme në të njëjtën shkallë me vendimet e arbitrazhit¹⁸⁰. Ligji përcakton edhe përmbajtjen e aktmarrëveshjes¹⁸¹ e cila duhet të përmbajë detyrime të qarta dhe saktësisht të përcaktuara. Afati për përmbushjen e detyrimeve të

¹⁷⁷ Neni 15 pika 1e ligjit nr. 10385/2011;

¹⁷⁸ Neni 17 pika 3 dh 4 e ligjit nr. 10385/2011;

¹⁷⁹ Manual Evropian për Ligjin e Ndërmjetësimit, CEPEJ (2019) 9, Strasburg, 13 dhe 14 Qershor 2019, fq 60, <https://rm.coe.int/cepej-2019-9-en-handbook/1680951928>

¹⁸⁰ Neni 22 i ligjit nr. 10385/2011;

¹⁸¹ Neni 22 pika 2 e ligjit nr. 10385/2011, 2. Në aktmarrëveshje përcaktohen:

- a) palët;
 - b) përshkrimi i mosmarrëveshjes;
 - c) detyrimet e kushtet që palët i vënë njëra-tjetrës dhe mënyra e afati i përmbushjes së tyre;
 - ç) nënshkrimi i palëve dhe i ndërmjetësit.
- Afati për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në marrëveshje vendoset nga palët në mirëkuptim me njëratjetrën. Aktmarrëveshja duhet të përmbajë detyrime të qarta dhe saktësisht të përcaktuara.

përcaktuara në marrëveshje vendoset nga palët në mirëkuptim me njëra-tjetrën. Aktmarrëveshja lidhet me shkrim, përveç rasteve kur ndërmjetësi dhe palët vlerësojnë se ajo mund të lidhet me gojë, nisur nga natyra e mosmarrëveshjes, si dhe kur ligji nuk e ndalon një gjë të tillë. Për sa i përket zbatimit të aktmarrëveshjes së ndërmjetësimit¹⁸², kur çështja është referuar për ndërmjetësim nga gjykata ose prokurori, ndërmjetësi, në përfundim të procedurës së ndërmjetësimit, ose në afatin e përcaktuar në ligj, i njofton ato për zgjidhjen ose jo të mosmarrëveshjes, duke dërguar edhe aktet përkatëse.

Në rastin kur çështja penale ku përfshihen të mitur në konflikt me ligjin është zgjidhur me anë të ndërmjetësimit, prokurori ose gjyqtari vendos pushimin e çështjes. Nëse aktmarrëveshja respekton kushtet e përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, përbën titull ekzekutiv dhe në këtë rast, ngarkohet shërbimi përmbarimor për ekzekutimin e tij. Nga analiza e dispozitave lidhur me aktmarrëveshjen e ndërmjetësimit dhe zbatueshmërinë e saj rezulton se ligji shqiptar për ndërmjetësimin përmban të gjithë parashikimet e nevojshme si për sa i përket formës dhe përmbajtjes së saj ashtu edhe për sa i përket sigurimit të zbatueshmërisë së saj.

¹⁸² Neni 23 i ligjit nr. 10385/2011;

E drejta për t'u harruar

Kesjana Stamati

Program i Integruar i Ciklit të dytë " Master i Shkencave në Drejtësi "

Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Oljana Hoxhaj

Fakulteti i Shkencave Humane

Univeristeti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

E drejta për t'u harruar është një nga zhvillimet më të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë, që ka pasur ndikim të thellë në ligjet dhe praktikat ndërkombëtare. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit ka krijuar mundësi të panumërta për shpejtësi dhe lehtësi në shpërndarjen e të dhënave, pra ky koncept ka lindur si përgjigje ndaj sfidave që paraqet epoka e informacionit digjital, ku të dhënat personale mund të qëndrojnë të përhapura dhe të qasshme pa pëlqimin e individëve. Rëndësia e kësaj të drejte qëndron në mbrojtjen e dinjitetit të individëve dhe garantimin e kontrollit të tyre mbi informacionin që lidhet me ta. Ky studim analizon historinë dhe evoluimin e të drejtës për t'u harruar, duke përfshirë rregulloret ndërkombëtare si Rregullorja e Mbrojtjes së të Dhënave të Bashkimit Evropian (GDPR), e cila ka krijuar një kuadër ligjor të rëndësishëm për

implementimin e kësaj të drejte. Në këtë kontekst, shqyrtohen sfidat dhe dilemat që paraqet implementimi i saj, duke përfshirë balancimin mes të drejtës për privatësi dhe interesave publike, si dhe ndikimin që ka ky koncept në lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim. Gjithashtu, vlerësohen praktikat gjyqësore evropiane dhe zbatimi i të drejtës për t'u harruar në legjislacione të ndryshme evropiane. Pjesa e sondazhit mbi njohjen e kësaj të drejte nga qytetarët do të ofrojë një pasqyrë mbi nivelin e ndërgjegjësimit dhe aplikimin e saj në praktikat e përditshme. Ky studim ka si qëllim të ofrojë një analizë të thelluar të ndikimeve ligjore, sociale dhe etike të të drejtës për t'u harruar në shoqërinë moderne.

Fjalët kyçe: *E drejta për t'u harruar, legjislacion, praktike gjyqësore, të drejtat e njeriut, informacion personal.*

Abstract

The right to be forgotten is one of the most significant developments in the field of personal data protection and privacy, having had a profound impact on international laws and practices. Information and communication technology has created countless opportunities for speed and ease in the distribution of data, and this concept arose as a response to the challenges posed by the digital information age, where personal data can remain widespread and accessible without individuals' consent. The importance of this right lies in protecting the dignity of individuals and ensuring their control over the information related to them. This study analyzes the history and evolution of the right to be forgotten, including international regulations such as the European Union General Data Protection Regulation (GDPR), which has created an important legal framework for the implementation of this right. In this context, the challenges and dilemmas posed by its implementation are examined, including the balancing of the right to privacy with public interests, as well as the impact this concept has on freedom of expression and the right to information. Furthermore, European judicial practices and the application of the right to be forgotten in different European and neighboring legislations are evaluated. The survey section on citizens' recognition of this right will provide an overview of the level of awareness and its application in everyday practices. The aim of this study is to offer an in-depth analysis of the legal, social, and ethical implications of the right to be forgotten in modern society.

Key Words: *Right to be forgotten, legislation, judicial practices, human rights, personal information.*

Një vështrim i përgjithshëm mbi të drejtën për t'u harruar

Në epokën digjitale, në botën e re të burimeve të informacionit pothuajse të pakufizuara, harrimi gradual është zëvendësuar nga memorizimi automatizuar, dhe kjo, së bashku me përfitimet e saj, sjell një sërë problemesh që prekin deri tek vetë-përmbajtja dhe tërheqja, si në jetën private ashtu edhe në atë publike, duke çuar në ndërprerjen e pjesëmarrjes në proceset e rëndësishme të shoqërisë. Deri kohët e fundit, njerëzit nuk ishin kaq të shqetësuar për të dhënat personale që lënë pas online, por tani, duket se të dhënat mbeten në internet përgjithmonë dhe mund të vazhdojnë të ndikojnë në jetën e dikujt për vite me radhë. Një gabim i kaluar, një neglizhencë e pavullnetshme, një shfaqje emocionale e papritur mund të dalin papritur pas shumë kohësh që dikush dhe të tjerët tashmë i kanë harruar ato, duke vazhduar të dëmtojnë reputacionin e një personi, që do të thotë se ai ose ajo do të përjetojë dy herë. Të kemi të kaluarën tonë të regjistruar në thellësitë e internetit është si të kemi një dosje të detajuar. Cilat janë kufijtë e kontrollit mbi jetën digjitale të njerëzve, duke pasur parasysh ndikimin e pabarabartë të individëve, shteteve dhe korporatave në rrjedhën e informacionit? Kush zotëron regjistrat online të të dhënave të ndara? Cilat janë pasojat e ruajtjes së artefakteve të aktiviteteve digjitale të

individëve? Si ndikojnë të dhënat e vjetra në identitetin personal duke dalë papritur me kalimin e kohës? Dhe sa larg duhet të shkojë mbrojtja e të dhënave tona? Përmes këtij artikulli synohet të shqyrtohen çështjet e rëndësishme të epokës digjitale në lidhje me ndryshimet e veçanta në qasjen ndaj të drejtave të njeriut dhe, në vend të parë, të drejtën për t'u harruar. Prandaj, ky artikull do të ofrojë një pasqyrë të gjerë të konceptit të të drejtës për t'u harruar, lidhjes së saj me të drejtat e tjera nga perspektiva evropiane, duke i kushtuar gjithashtu vëmendje çështjeve të zgjatjes së kësaj të drejte jashtë Bashkimit European (BE).

Ajo që pason është një përpjekje për të bërë një analizë gjithpërfshirëse të së drejtës për t'u harruar me theks në origjinën e saj dhe lidhjen me të drejtat e tjera. Studimi përpiqet të tregojë se shfaqja e të drejtës për t'u harruar është natyrale, jo aksidentale, dhe është sjellë nga një kombinim unik kushtesh që lidhen me epokën digjitale. Së pari dhe para së gjithash, këto kushte janë gjurma digjitale, perceptimi i ri i kohës dhe kuptimi i ri i të dhënave. Siç do të demonstrohet në artikull, e drejta për t'u harruar duhet të njihet si një e drejtë e veçantë e njeriut, si pjesë e një brezi të ri të të drejtave.

Përshkrimi i lidhjes së të drejtës për t'u harruar me arritjet e përparimeve teknologjike, veçanërisht në fushën e teknologjisë së informacionit, tregon se kuptimi dhe aplikimi i kësaj të drejte ende nuk është plotësisht i vendosur dhe se ka shumë probleme që lidhen me të. Këto përfshijnë, në radhë të parë, juridiksionin e saj dhe balancimin me të drejtat e tjera, mundësitë teknike të "harrimit digjital" ose fshirjes së të dhënave. Duket se kënaqja e kushteve të ndryshme dhe respektimi i proporcionalitetit në aplikimin e kësaj të drejte do të jetë e komplikuar dhe kërkon më shumë kërkime.

Metodat e kërkimit të përdorura kanë përfshirë qasjen dialektike për të formuar një pasqyrë të plotë të të drejtës për t'u harruar, lidhjes së saj me të drejtat themelore dhe interesat legjitime; qasjen aksologjike për të studiuar marrëdhënien midis kësaj të drejteje dhe vlerave kryesore, si autonominë dhe identitetin në radhë të parë; metodën historike për të studiuar origjinat e të drejtës për t'u harruar; krahasimin e ligjeve, doktrinave dhe praktikave të Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në lidhje me të drejtën për t'u harruar; dhe metodën formale ligjore për të studiuar dokumentet ligjore, legjislacionin për të drejtat e njeriut të Bashkimit Evropian dhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë të BE-së. Artikulli gjithashtu shqyrtoi dy raste kyçe të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së në detaje: *Google Spain, Google Spain SL dhe Google Inc. v. Agencia Española de Protección de Datos dhe Costeja González [2014]* dhe *Google LLC, pasuesi ligjor i Google Inc. v. Commission nationale de l'informatique et des libertés (CNIL) [2019]*. Kjo përzgjedhje është bërë për shkak të faktit se këto raste duket se kanë ndryshuar tërësisht qasjen ndaj të drejtës për t'u harruar dy herë—në vitin 2014 dhe 2019.

Sot, interneti ka hapur shumë rrugë për inovacion, përparim, komunikim dhe publikim; na ka ofruar një mjet që na mundëson të bëjmë atë që dikur ishte një ide utopike dhe tani ka bërë të mundur gjëra të zakonshme. Pa internetin, jeta jonë e përditshme nuk do të ishte ashtu siç është sot; progresive, të shpejtë dhe të përshtatshme. Nëse kjo është e mirë apo e keqe, mbetet për t'u vlerësuar.

Me fokusin në botën tonë pothuajse plotësisht digjitale, me zhvillimet e reja teknologjike që janë thellësisht të ngulitura në jetën e përditshme, duket se ne e kemi harruar krejtësisht botën analoge. Ajo që shumica e përdoruesve të internetit nuk e dinë ose përpiqen

ta injorojnë është fakti se çdo artikull digjital që ata posedojnë mbledh një sasi të madhe të dhënash. Të dhënat personale janë bërë monedha që ne i shkëmbejmë për shërbime që na shiten si "falas". Bruce Schneier¹⁸³ e quan këtë "mbikëqyrje". Teknologjia përbën jetën tonë të përditshme pa u vetëdijësuar për të. Max Schrems¹⁸⁴, një avokat austriak i privatësisë, kërkoi në vitin 2011 që Facebook të dorëzonte të gjithë të dhënat që ata kishin mbi të. Dy vjet më vonë, ai mori 1,200 faqe me gjithçka që ai kishte pëlqyer apo klikur, miqtë e tij, fotot dhe të gjithë materialet reklamues që kishte parë. Edhe pse të gjitha këto të dhëna mund të mos përdoren, ato janë aty. Me këtë bëhet shumë e qartë se rregullat që kemi vendosur për të na mbrojtur nga kërcënimet që shfaqen online nuk janë më të vlefshme. Koha ka ndryshuar, duke kërkuar forma të reja të mbrojtjes dhe rregullave që përshtaten me realitetin e ri digjital.

Ne jetojmë në epokën digjitale ku ruajtja e të dhënave, rikthimi i lehtë dhe arritja globale e informacionit elektronik është e thjeshtë dhe ku shprehja "njohuria është fuqi" ka marrë një kuptim krejt të ri. Monitorimi sekret, transferimi i paqartë dhe monetizimi i të dhënave personale përmes marketingut justifikojnë dhe kërkojnë masa të reja mbrojtëse rregullatore për njerëzit, pasi, siç vuri në dukje Floridi, ne jemi informacioni ynë (Mckay, 2017:539). Brenda teorisë normativiste, nocioni i kontrollit lejon individët të vendosin vetë se cilat informacione dhe deri në çfarë mase ata duan të komunikojnë, duke e përcaktuar privatësinë si tërheqjen vullnetarizmi nga shoqëria (Westin, 1967:7). Teoria e Westinit do të ofrojë kuadrin për këtë hulumtim.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) është një përpjekje për të

përshtatur ligjin e privatësisë me realitetin. Ajo përfshin një numër të drejtash personale që kanë për qëllim t'i kthejnë njerëzve fuqinë dhe kontrollin mbi të dhënat e tyre personale dhe të përpiqen, ndryshe nga Direktiva e mëparshme, të bashkojnë mbrojtjen e të dhënave brenda kufijve të Bashkimit Evropian. Edhe pse GDPR duket se është shkruar me qëllime të mira, ajo gjithashtu ngre një numër çështjesh të diskutueshme, për shembull, në lidhje me të drejtën themelore të Lirisë së Shprehjes dhe Informacionit (Neni 11, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian), pasi këto do të jenë ngarkesa të rëndësishme dhe të shtrenjta që bizneset tani do të duhet të përballojnë. Duke qenë se traktatet si Safe Harbor, shpërthimi i Edward Snowden dhe rasti shumë i fundit i Cambridge Analytica, ku të dhënat e më shumë se 71 milionë njerëzve janë zbuluar nga Facebook, kanë treguar se rrjedhat ndërkombëtare të të dhënave po bëhen gjithnjë e më të pranishme, GDPR gjithashtu do të duhet të merret parasysh në një kontekst global.

E drejta për t'u harruar u jep njerëzve mundësinë për të kërkuar që kompani si motorët e kërkimit të fshijnë lidhje që çojnë në informacionin e tyre personal. Ajo hyri në fuqi pas vendimit të vitit 2014 të Gjykatës së Spanjës për Google, ku një qytetar spanjoll kërkoi nga Google fshirjen e të dhënave të vjetra dhe të pavlefshme që mund të dëmtonin situatën e tij të tanishme. Më mirë se "fshirja", termi më i përshtatshëm është "heqja nga lista", pasi informacioni po hiqet nga lista duke fshirë URL-të nga motorët e kërkimit. Megjithatë, kjo e mundëson fuqishëm individin të redaktojë historinë e tij personale digjitale. Brenda GDPR, përkufizimi i të dhënave personale është zgjeruar duke i dhënë të drejtës për t'u harruar një kuadër të ri që e lehtëson dhe zgjeron aplikimin e saj.

¹⁸³ <https://uu.diva-portal.org/smash/get/diva2:1233032/FULLTEXT01.pdf>

¹⁸⁴ <https://edition.cnn.com/2019/07/09/tech/facebook-data-privacy-max-schrems>

Megjithatë, ky proces ka rregulla thelbësore, pasi informacioni i kërkuar për t'u fshirë duhet të përmbushë kërkesa të caktuara për t'u fshirë (shih Nenin 17, ose më lart). Megjithatë, e drejta për Lirinë e Shprehjes dhe Informacionit luan një rol thelbësor, pasi mund të përbëjë një kundërshtim ndaj së parës. Prandaj, është në duar të gjykatave për të gjetur një balancë midis këtyre dy të drejtave. Kontroversia gjithmonë sjell diskutime dhe shprehje mendimesh. Këtu merr si një pikënisje ky hulumtim..

Privatësia si koncept social dhe kulturor i cili në vete ka aspekte të rëndësishme jetësore, në mënyrë kronologjiko-kohore po fiton rëndësinë e vet jetike. Në këtë kuptim, duke marrë parasysh ndryshimet e shpejta të shumë segmenteve të shoqërisë, e sidomos zhvillimin e teknologjisë së informacionit dhe rritjen e përdorimit të internetit, gjithnjë e më tepër diskutohet mbi çështjet e privatësisë individuale dhe mbrojtjen e privatësisë nga ana e shtetit dhe shoqërisë. Prandaj, gjithmonë shtrohet nevoja e rregullimit ligjor të mbrojtjes së privatësisë si një nga të drejtat bazike të njeriut, sidomos kur privatësia tashmë paraqitet përveç se si vlerë individuale, edhe kolektive. Ndaj, mbrojtja e të dhënave personale kohëve të fundit është ngritur në piadestalin më të lartë të mbrojtjes konstitucionale dhe ndërkombëtare juridike.

Fillimisht, ne kuadër të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në nenin 12 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut garantohej liria nga ndërhyrjet në privatësinë, familjen, shtëpinë dhe korrespondencën. Ne kuptim të njëjtë, edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nenin 8 të saj e siguron të drejtën e respektimit "të jetës private dhe familjare, shtëpisë dhe korrespondencës" së një individi, e drejtë që mund të limitohet nga kufizime "në pajtim me ligjin" dhe që janë "të nevojshme në një shoqëri demokratike". Ndërsa, instrumenti themelor

ligjor për mbrojtjen të dhënave personale në Bashkimin Evropian, na paraqitet Direktiva 95/46 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 24 tetorit 1995 për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si edhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, i cili na paraqitet si referim mbi rregullimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe vendos kuadrin rregullator-juridik që synon të vendosë një ekuilibër ndërmjet shkallës së lartë të mbrojtjes së privatësisë së individit dhe lëvizjes së lirë të ato të dhënave.

"E drejta për t'u harruar", si koncept ndërlidhet me të drejtën e individëve për të mos i'u përdorur të dhënat personale për shkak se të njëjtat nuk përputhen me qëllimet fillestare të mbledhjes së tyre. Ky koncept, pra, është i lidhur ngushtë me privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Për herë të parë në mënyrë normative, "E drejta për t'u harruar" u rregullua me 27 prill të vitit 2016 dhe filloj të zbatohet me 25 maj të vitit 2018, ku në vendet anëtare të Bashkimit Evropian hyri në fuqi Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (KE 2016/679). Megjithatë, kjo e drejtë ende ndeshet me sfida të natyrave të ndryshme, veçanërisht në lidhje me balancimin e të drejtës për të harruar me të drejtën e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së informacionit. Ndërsa në anën tjetër, disa besojnë se kjo e drejtë është thelbësore për ruajtjen e privatësisë dhe integritetit të individëve. Pra e drejta për t'u harruar mund të shihet si një përpjekje për të balancuar lirinë e informacionit dhe të drejtat e privatësisë.

Në epokën e informacionit dhe të teknologjisë digjitale, një nga çështjet më të diskutueshme dhe më të rëndësishme ka të bëjë me mënyrën se si menaxhohet dhe ruhet informacioni personal. Pjesë e këtij debat është dhe koncepti i "të drejtës për t'u harruar", një e drejtë e cila është formuluar për herë të parë në jurisprudencën e Bashkimit Evropian dhe ka shkaktuar një ndikim

të jashtëzakonshëm në praktikat ligjore dhe teknologjike në të gjithë botën. Ky koncept ka për qëllim të ofrojë individëve mundësinë që të kërkojnë heqjen e të dhënave të tyre personale nga interneti, nëse ato janë të vjetra, të pasakta ose të padëshiruara, dhe nëse ruajtja e tyre është bërë pa pëlqimin e tyre ose për arsye të tjera të paspecifikuara.

E drejta për t'u harruar është një zhvillim i rëndësishëm në fushën e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtave të njeriut. Ajo përfaqëson një përpjekje për të balancuar interesin e publikut për qasje në informacion dhe nevojën e individëve për të ruajtur dinjitetin dhe intimitetin e tyre në një botë ku informacioni mund të qëndrojë i aksesueshëm dhe i pastruar për një periudhë të pacaktuar. Ky koncept ka tërhequr vëmendje të gjerë, duke ngjallur debate të ndryshme rreth kufijve të tij, aspekteve të zbatimit të tij dhe ndikimit në lirinë e shprehjes dhe kërkimin e informacionit. A është e mundur që të ruhet një ekuilibër midis të drejtave të individëve dhe interesave të shoqërisë? Si mund të implementohet kjo e drejtë pa cenuar liritë themelore, siç është liria e informacionit? Në këtë kontekst, zhvillimi i teknologjisë dhe përhapja e platformave sociale kanë krijuar mundësi të reja për mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave personale. Kjo ka bërë që individët të jenë më të ekspozuar ndaj mundësive të manipulimit dhe të dhënave të gabuara ose të paautorizuara. E drejta për t'u harruar paraqet një përgjigje ndaj këtyre shqetësimeve, duke kërkuar që individët të kenë mundësinë të kontrollojnë të dhënat që lidhen me ta dhe që mund të ndikojnë në jetën e tyre profesionale dhe personale.

Ambiguiteti i së drejtës për t'u harruar

E drejta për t'u harruar: një e drejtë "e paqartë" për qëllimet e BE-së

E drejta e specifikuar mbetet si një "koncept i paqartë"¹⁸⁵ dhe i pamjaftueshëm i zhvilluar në praktikën e zbatimit të ligjit, gjë që kërkon përmirësimin e saj, megjithëse GDPR përcakton disa kritere dhe udhëzime për zbatimin e kësaj të drejte. Kjo shpjegohet kryesisht me faktin se barra kryesore e përcaktimit të udhëzimeve dhe standardeve për zbatimin e së drejtës së lartpërmendur, si rregull, qëndron në aktivizmin gjyqësor të GJED-së, i cili, bazuar në një analizë rast pas rasti, gradualisht shpjegon dhe përshkruan konturet e kësaj të drejte. Në veçanti nëse shohim evolucionin e praktikës gjyqësore të GJED-së për të drejtën për t'u harruar, mund të shohim se nëse në një rast Gjykata njeh ekzistencën e një të drejte të tillë, në një tjetër përshkruan fushën territoriale të zbatimit të saj nga kufijtë e BE-së, në të tretin, ajo përcakton mundësinë e ushtrimit të së drejtës për t'u harruar jashtë BE-së në rast shpifjeje, etj. Siç mund ta shohim, vetë e drejta për t'u harruar si e tillë "krijohet" kryesisht përmes ligjbërjes evolucionare nga ana e GJED-së, pavarësisht nga konsolidimi i saj në GDPR. Rrjedhimisht, S. Kulk dhe F. Zuiderveen Borgesius vërejnë me të drejtë se: "Ne mund të presim shumë më tepër praktikë gjyqësore për kërkesat për heqje nga lista. Më shumë praktikë gjyqësore shpresojmë se do të çojë në më shumë udhëzime për të vendosur kërkesat për heqje nga lista."¹⁸⁶ Shfaqja e një të drejte të tillë "të paqartë", e cila

¹⁸⁵ AUSLOOS, Jef. 'E drejta për t'u harruar' – ia vlen të mbahet mend? *Rishikimi i Ligjit dhe Sigurisë së Kompjuterit*, 2012, vol. 28, nr. 2, f. 143–152.

¹⁸⁶ KULK, Stefan; ZUIDERVEEN BORGESIU, Frederic. Privatësia, liria e shprehjes dhe e drejta për t'u harruar në

Evropë. Në Selinger, E.; Polonetsky, J. & Tene, O. (red.), *Manuali i Privatësisë së Konsumatorit të Kembrixhit*, Cambridge University Press, 2018, f. 301–320.

zhvillohet pothuajse ekskluzivisht si rezultat i ligjbërjes së GJED-së në kushte kur "imperializmi dixhital" bëhet qëllimi i shumë vendeve të zhvilluara, bëhet një lloj mjeti për të pohuar fuqinë e saj dixhitale për BE-në shumë përtej kufijve të saj (Shih rastin e C-18/18 Eva Glawischnig-Piesczek kundër Facebook Ireland Limited). Sigurisht, nga njëra anë, mund të konsiderohet si avantazh, por nga ana tjetër, nëse marrim parasysh se vendimet e GJED-së, të cilat "synojnë" shtrirjen e rregullave të tyre në rendin dixhital global, do të përballen me rrezikun që të mos jenë në gjendje të sigurojnë "forcën shtrënguese" të vendimeve të saj. Kjo mund të konsiderohet një disavantazh. Kjo do të thotë se marrja e gjykimeve që nuk janë të destinuara të bëhen realitet mund të zvogëlojë ndjeshëm besueshmërinë e vetë GJED-së, e cila nga ana tjetër ka nevojë për një zgjidhje efektive në praktikën e zbatimit të ligjit.

A është kjo e drejtë një mjet ligjor për mbrojtjen e privatësisë?

Shpesh duke marrë parasysh pyetjet rreth të drejtës për t'u harruar, ne intuitivisht "mendojmë" në sferën e privatësisë. Dhe ndoshta jo vetëm intuitivisht. Edhe nëse neni 16 (1) e TFUE thotë se "Çdokush ka të drejtë për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me të" dhe CFR në nenin 8(1) tregon shfaqjen e tij të një të drejte të pavarur për mbrojtjen e të dhënave personale, të ndarë nga ajo e

privatësisë¹⁸⁷, Direktiva 2002/58/EC¹⁸⁸ ose Direktiva 2006/24/EC¹⁸⁹ vazhduan të ruajnë këtë lidhje. Vihet re edhe në tekstin e Direktivës 95/46/EC (në tekstin e mëtejshëm – DPD), ku fjala "privatësi" përsëritet shumë herë. Kjo është arsyeja pse shqyrtimi nga GJED-ja i rasteve të reja në lidhje me zbatimin e të drejtës për t'u harruar si mjet i mbrojtjes së privatësisë është i pashmangshëm.

Kjo dëshmohet edhe nga shkalla e përdoruesve të internetit që kontaktojnë Google me kërkesa për të hequr nga interneti të dhënat e tyre personale. Kompania e Big Data gjatë tre viteve të ekzistencës së së drejtës për t'u harruar, pasi ka marrë parasysh rreth 2.3 milionë kërkesa për heqjen e URL-ve nga përdoruesit e internetit, nga të cilat shumica dërrmuese (rreth 90 përqind) ishin individë, plotësuan vetëm 43% të kërkesave të tilla.¹⁹⁰ Një interes i tillë i përdoruesve të internetit për të mbrojtur privatësinë e tyre madje ka çuar në shfaqjen e kompanive të tilla, aktivitetet e biznesit të të cilave bazohen në ofrimin e shërbimeve për zbatimin e të drejtës për t'u harruar.¹⁹¹ Megjithatë, gjatë ekzistencës së saj, e drejta për t'u harruar tashmë ka arritur të tregojë "thembrën e saj të Akilit" në praktikën e zbatimit të ligjit, e cila kërkon qasje të reja dhe efikase për të rritur potencialin e saj të mbrojtjes së privatësisë. Pyetja qendrore kur analizohet më tej marrëdhënia midis të drejtës për t'u harruar dhe privatësisë është motivimi i individëve për të kërkuar mbrojtje. Mund të jetë një rast i një

¹⁸⁷ DE HERT, Paul. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk jeni në gjendje të qëndroni autonom në dokumentet themelore të BE-së? *Revista e Utrecht e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane*, 2015, vol. 31, nr. 80, f. 2.

¹⁸⁸Direktiva 2002/58/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 korrikut 2002 në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbrojtjen e privatësisë në sektorin e komunikimeve elektronike.

¹⁸⁹ Direktiva 2006/24/EC e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 15 marsit 2006 për ruajtjen e të dhënave

të gjeneruara ose të përpunuara në lidhje me ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun ose të rrjeteve publike të komunikimeve dhe ndryshimin e Direktivës 2002/58/EC.

¹⁹⁰ BERTRAM, Theo; BURSZEIN, Elie; CARO, Stephanie et al. *Tre vjet e drejta për t'u harruar*, online 2018.

¹⁹¹ GESENHUES, Amy. *Ndodhi e pashmangshme: Kompania e parë ofron shërbimin e heqjes së "të drejtës për t'u harruar"*, online 2014.

studimi tjetër për të zbuluar kategoritë e pretendimeve të paraqitura nga ata që janë të shqetësuar për informacionin që është i disponueshëm publikisht si nga menaxherët privatë të të dhënave ashtu edhe nga autoritetet publike. Për të kuptuar se si e drejta për të qenë i harruar duhet të zhvillohet për të "zhbllokuar" potencialin e tij mbrojtës të privatësisë, është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje mangësive kryesore të kësaj të drejte, të cilat do të diskutohen më poshtë në më shumë detaje.

E drejta për t'u harruar përballë inteligjencës artificiale

Sipas GDPR-së, njerëzit kanë të drejtë të kërkojnë që informacioni i tyre personal të hiqet nga të dhënat e një organizate. Kur dikush nuk pranon më që të dhënat e tij personale të përpunohen, ose kur ka pasaktësi të konsiderueshme në informacion, ose nëse gjykohet se informacioni është i panevojshëm, ai mund të kërkojë fshirjen e të dhënave të tij. Megjithatë, ky privilegj nuk është absolut dhe organizatat nuk janë gjithmonë të detyruara t'i përmbahen kërkesës. Sipas Nenit 17 të GDPR-së, individët kanë të drejtë që të dhënat e tyre personale të fshihen. Kjo përfshin çdo të dhënë që nuk është më e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur ose përpunuar fillimisht.

Nëse kontrolluesi i ka zbuluar të dhënat personale të një individ publikut, ai duhet të ndërmarrë hapat e duhur për t'u siguruar që çdo kontrollues tjetër përpunues është në dijeni se të gjitha lidhjet me këto të dhëna personale, së bashku me çdo kopje ose replikë ekzistuese të të dhënave personale, duhet të fshihen. Nëse një person nuk jep lejen e tij që të dhënat e tij personale të përpunohen më, ai mund të kërkojë që ato të fshihen. Në një rast të tillë, organizata duhet të bëjë çmos për të fshirë të dhënat, gjë që përfshin njoftimin e çdo marrësi të palës së tretë

që mund t'i ketë marrë të dhënat në të kaluarën. E njëjta gjë vlen edhe nëse një individ mendon se informacioni i tij personal po ruhet pa nevojë; ai ka të drejtë të kërkojë që ato të fshihen.

E drejta për t'u harruar është e kufizuar kur ndërhyr në të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informacionit. Nëse një person dëshiron që të dhënat e tij personale të hiqen për shkak të pasaktësisë së tyre, por të dhënat janë ende të vërteta, organizata mund të mos jetë e detyruar t'i fshijë ato. E drejta për t'u harruar është një pjesë thelbësore e GDPR-së që u jep individëve më shumë pushtet mbi të dhënat e tyre personale, por sa zbatohet kjo e drejtë përballë inteligjencës artificiale

Si funksionon ChatGPT?

Për të kuptuar sfidat që paraqet e drejta për t'u harruar kur zbatohet në një model të madh të bazuar në inteligjencën artificiale, siç është ChatGPT, duhet të kuptojmë se si funksionon sistemi OpenAI dhe çfarë lloj të dhënash përdor.

ChatGPT është një chatbot i mundësuar nga inteligjenca artificiale nga OpenAI bazuar në GPT-3.5. Është i jashtëzakonshëm për përgjigjet e tij si njerëzore gjatë bisedave. OpenAI Inc., një organizatë jofitimprurëse, është kompania mëmë e OpenAI LP fitimprurëse, e cila zhvilloi ChatGPT.

ChatGPT përdori një bashkim të të mësuarit të mbikëqyrur dhe përforcues për ta zhvilluar. Mbledhja e të dhënave për modelin e politikave të mbikëqyrura (modeli SFT) filloi duke zgjedhur një listë kërkesash, e ndjekur nga një caktim i etiketuesve njerëzorë për të shkruar përgjigjen e pritur për secilën kërkesë. Për ChatGPT u përdorën dy burime kërkesash: disa u shkruan ose u sugjeruan nga etiketuesit, ndërsa të tjerat u morën nga transaksionet API të OpenAI. Ky proces zgjati pak dhe ishte mjaft i kushtueshëm, megjithatë rezultati ishte një grup të dhënash relativisht i

vogël, por i kuruar i nivelit të lartë me rreth 12-15 mijë pika të dhënash, të cilat formuan bazën për rafinimin e një modeli gjuhësor të para-trajnuar.

Për të përmirësuar performancën e tij, ChatGPT u mësua gjithashtu nëpërmjet Mësimi Përforsues me Feedback Njerëzor (RLHF). Kjo metodë përdor reagimet njerëzore për të ndihmuar ChatGPT në të mësuarit se si t'i bindet udhëzimeve dhe të japë përgjigje që njerëzit do t'i konsideronin të kënaqshme. Të dhënat e mbledhura nga programi përdoren për të krijuar përgjigje për pyetje, së bashku me materiale të tjera si email-e, ese, fragmente kodi dhe madje edhe poezi. Është gjithashtu i dobishëm për krijimin e asistentëve virtualë dhe për t'iu përgjigjur shpejt pyetjeve të klientëve. OpenAI ka krijuar një aplikacion mbresëlënës të IA-së duke bashkuar teknikat e të mësuarit të mbikëqyrur dhe përforsues, duke i lejuar chatbot-it të gjenerojë përgjigje si një njeri dhe të zhvillojë biseda. Të dhënat e ruajtura nga ChatGPT mund të përdoren për të gjeneruar përgjigje për biseda dhe pyetje, si dhe për të formuar asistentë virtualë që mund t'u përgjigjen shpejt nevojave të klientëve.

ChatGPT nuk është një robot online që kërkon të dhëna në internet. Përkundrazi, është trajnuar paraprakisht me një sasi të konsiderueshme teksti, siç janë romanet, artikujt dhe faqet e internetit. Kjo do të thotë se nuk mbledh asnjë informacion të ri nga vetë interneti. Përkundrazi, përdor të dhënat që tashmë i njeh për të gjeneruar përgjigje. Shumë të dhëna personale nga njerëz për të cilët flitet shpesh në internet përfshihen në të dhënat e tij ekzistuese.

Pra, si funksionon saktësisht ChatGPT? Ai përdor një metodë të të mësuarit automatik të quajtur të mësuarit e transferimit, e cila përfshin një model që së pari trajnohet në një detyrë të pasur me të dhëna dhe më pas akordohet në një detyrë të veçantë. Në këtë rast, modeli është i

para-trajnuar në një koleksion masiv fjalësh të marra nga uebi dhe më pas akordohet për aktivitetin e veçantë.

Modelet e Mëdha Gjuhësore (LLM), të tilla si ChatGPT, përfaqësojnë përparime në fushën e inteligjencës artificiale gjeneruese. Megjithatë, aftësia e tyre për të përpunuar dhe gjeneruar përmbajtje ngre sfida kritike në mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e të drejtës për t'u harruar. Këto modele, duke vepruar me sasi të mëdha të dhënash dhe algoritme komplekse, përballen me probleme që lidhen me fshirjen e informacionit, gjenerimin e përmbajtjes së pasaktë dhe mungesën e transparencës në funksionimin e tyre.

Më poshtë diskutohen tre çështje kryesore që nxjerrin në pah këto vështirësi dhe implikimet e tyre ligjore.

1. Qëndrueshmëria e të Dhënave në LLM: modelet gjeneruese të IA-së, kur trajnohen në vëllime të mëdha të dhënash, përballen me vështirësi në fshirjen retroaktive të informacionit personal. Edhe pse teknika të tilla si ç'mësimi automatik janë në zhvillim e sipër, ato ende nuk garantojnë një zbatim të plotë dhe efektiv të së drejtës për t'u harruar.

2. Problemi i halucinacioneve: përveç ruajtjes së të dhënave personale, këto modele mund të gjenerojnë përmbajtje të gabuar ose fiktive. Kjo aftësi paraqet një rrezik shtesë, pasi një 'halucinacion' mund të përfshijë informacione të ndjeshme të individëve, duke gjeneruar implikime serioze ligjore dhe për reputacionin.

3. Transparenca dhe kontrolli: si GDPR ashtu edhe Rregullorja për Inteligjencën Artificiale theksojnë rëndësinë e transparencës. Megjithatë, kompleksiteti teknik i LLM-ve ua vështirëson përdoruesve të kuptojnë se si përpunohen, ruhen dhe përdoren të dhënat e tyre, duke e komplikuar aftësinë e tyre për të ushtruar të drejta të tilla si e drejta e fshirjes.

Për të adresuar këto probleme, është e

rëndësishme të lëvizim në tre drejtime:

1. Teknologjitë e shtypjes së të dhënave: zbatimi i algoritmeve që lejojnë sistemet e inteligjencës artificiale të harrojnë në mënyrë selektive informacionin është thelbësor. Kjo qasje do të siguronte që e drejta për t'u harruar të shtrihet edhe te modelet e inteligjencës artificiale pa ndikuar në aftësinë e tyre për të gjeneruar përmbajtje të dobishme dhe relevante.

2. Vlerësimet e ndikimit: si GDPR ashtu edhe Rregullorja e Inteligjencës Artificiale kërkojnë vlerësime të ndikimit për të identifikuar dhe zbutur rreziqet që lidhen me privatësinë. Këto vlerësime duhet të jenë një parakusht për zhvillimin dhe zbatimin e LLM-ve, duke lejuar identifikimin e shkeljeve të mundshme të së drejtës për t'u harruar.

3. Bashkëpunimi shumëdisiplinor: bashkimi i ekspertëve ligjorë, zhvilluesve të inteligjencës artificiale dhe rregullatorëve është thelbësor për të hartuar zgjidhje praktike dhe etike që përputhen me parimet rregullatore evropiane.

E drejta për t'u harruar është një shtyllë thelbësore për të mbrojtur privatësinë e qytetarëve në epokën dixhitale. Megjithatë, zbatimi i saj përballat me sfida të rëndësishme në kontekstin e inteligjencës artificiale gjeneruese. Zhvillimet rregullatore, siç është Rregullorja e Inteligjencës Artificiale, dhe zhvillimi i teknologjive të reja që synojnë fshirjen e të dhënave janë hapa thelbësorë për të siguruar që kjo e drejtë të respektohet në një mjedis teknologjik në ndryshim të vazhdueshëm.

Ndërveprimi midis privatësisë dhe inovacionit teknologjik kërkon një ekuilibër delikat. Duke mbrojtur të drejtat themelore, siç është e drejta për t'u harruar, ne jo vetëm që ruajmë dinjitetin dhe autonominë individuale, por gjithashtu hedhim themelet për një të

ardhme në të cilën inteligjenca artificiale është një mjet në shërbim të njerëzimit, jo një rrezik për vlerat e tij themelore.

Përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me standardet e BE-së

Në epokën digjitale, ku teknologjitë e informacionit dhe komunikimit kanë marrë një rol qendror në jetën publike dhe private, mbrojtja e të dhënave personale është bërë një nga sfidat më të mëdha për shtetet, institucionet dhe individët. Rritja e ndjeshme e mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave ka sjellë nevojën për një kuadër ligjor më të sofistikuar, që të garantojë mbrojtjen e privatësisë së individit dhe kontrollin mbi të dhënat që lidhen me të. Në këtë kuadër, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në përputhjen e legjislacionit të saj me standardet evropiane, sidomos pas miratimit të Ligjit Nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i cili është ndërtuar mbi modelin e Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Evropian.

Ky zhvillim është i rëndësishëm për kontekstin shqiptar për dy arsye kryesore: së pari, për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve shqiptarë në raport me informacionin personal, dhe së dyti, për përputhshmërinë me kërkesat e integritetit evropian, që përfshijnë respektimin e standardeve të BE-së në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave. Ndër të gjitha të drejtat që burojnë nga kjo fushë, një prej më të debatueshmeve dhe më të ndërlikuarave në praktikë është e drejta për t'u harruar, e cila për herë të parë u njoh në nivel jurisprudence nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së dhe më pas u formalizua në kuadrin ligjor evropian.

Kuadri Ligjor Shqiptar: Risi dhe Përputhje me GDPR

Ligji Nr. 124/2024 erdhi si një përgjigje ndaj nevojës për të përditësuar kuadrin ligjor ekzistues, i cili deri më atëherë mbështetej mbi Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008, që ndonëse i frymëzuar nga Direktiva 95/46/EC e BE-së, kishte humbur aktualitetin pas hyrjes në fuqi të GDPR-së në vitin 2018.

Ligji i ri përcakton qartë parimet themelore të përpunimit të të dhënave personale, përfshirë legalitetin, transparencën, kufizimin në qëllim, proporcionalitetin, saktësinë, ruajtjen për kohëzgjatje të kufizuar dhe integritetin. Ai gjithashtu vendos një sërë të drejtash për subjektet e të dhënave, duke përfshirë të drejtën për informim, qasje, korrigjim, kufizim përpunimi, kundërshtim dhe, së fundi, fshirjen e të dhënave – një e drejtë që lidhet drejtpërdrejt me konceptin e të drejtës për t'u harruar.

Një nga risitë më të rëndësishme të ligjit të ri është njohja eksplicite e të drejtës për fshirje, e ngjashme me të drejtën për t'u harruar të sanksionuar në nenin 17 të GDPR-së. Subjekti i të dhënave ka të drejtën të kërkojë që të dhënat e tij të fshihen nëse:

ato nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë përpunuar;

individit tërheq pëlqimin për përpunim;

individit kundërshton përpunimin;

përpunimi është i paligjshëm;

kërkohet fshirja për të përmbushur një detyrim ligjor.

Përveç kësaj, ligji shqiptar përfshin gjithashtu detyrime të reja për operatorët e shërbimeve digjitale (përfshirë rrjetet sociale dhe motorët e kërkimit), të cilët duhet të marrin masa për fshirjen e të dhënave edhe nga shërbimet e indeksimit dhe shpërndarjes, në përputhje me

kërkesat e individëve dhe vendimet e autoritetit mbikëqyrës.

E Drejta për t'u Harruar” në Bashkimin Evropian: Precedenti dhe Zbatimi

E drejta për t'u harruar është një nga risitë më domethënëse që ka sjellë Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), dhe përfaqëson një evolucion të rëndësishëm në mënyrën se si kuptohet dhe garantohet privatësia në epokën digjitale. Kjo e drejtë u artikulua fillimisht në mënyrë të qartë në jurisprudencën evropiane, përmes një prej çështjeve më të njohura: Google Spain SL v. Agencia Española de Protección de Datos, vendim i marrë më 13 maj 2014 nga Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian.

Në këtë çështje, individit kërkoi që të hiqej nga rezultatet e motorit të kërkimit Google një lidhje me një artikull të vjetër në gazetën zyrtare spanjolle, i cili përmbante të dhëna personale që nuk ishin më të rëndësishme në kontekstin aktual dhe që dëmtonin reputacionin e tij. Gjykata vendosi se operatorët e motorëve të kërkimit janë përgjegjës për përpunimin e të dhënave personale që shfaqen në rezultatet e kërkimit dhe, për rrjedhojë, janë të detyruar të shqyrtojnë kërkesat për heqjen e lidhjeve që përmbajnë informacione të panevojshme, të papërshtatshme ose të pasakta në kohë.

Ky vendim theksoi rëndësinë e balancimit midis të drejtës për privatësi dhe lirisë së informacionit. Gjykata saktësoi se nuk bëhet fjalë për një të drejtë absolute për t'u harruar, por për një të drejtë që duhet të vlerësohet në kontekstin e rrethanave specifike dhe të drejtave të tjera themelore. Vendimi i GJDBE krijoi një precedent ligjor që më vonë u përfshi në mënyrë të qartë në nenin 17 të GDPR-së, i cili përshkruan kushtet

nën të cilat individët mund të kërkojnë fshirjen e të dhënave të tyre personale.

Sipas nenit 17 të GDPR-së¹⁹², individët kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre të fshihen kur:

- të dhënat nuk janë më të nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur;
- individ i tërheq pëlqimin e dhënë më parë;
- individ kundërshton përpunimin dhe nuk ka arsye të ligjshme prioritare;
- përpunimi është i paligjshëm;
- kërkohet fshirja për të përmbushur një detyrim ligjor të përcaktuar nga ligji i BE-së ose shtetit anëtar.

Përfshirjet nga kjo e drejtë përfshijnë situata ku të dhënat janë të nevojshme për lirinë e shprehjes dhe informimit, për përmbushjen e një detyrimi ligjor, për arsye të interesit publik, për kërkime shkencore ose historike, ose për mbrojtjen e kërkesave ligjore.

Zbatimi i kësaj të drejte në praktikë në BE është mbështetur nga autoritetet kombëtare për mbrojtjen e të dhënave dhe është forcuar nga vendimet e mëtejshme të gjykatave, të cilat kanë ndihmuar në konkretizimin e standardeve për heqjen e përmbajtjes dhe balancimin e të drejtave konkurruese.

Zbatimi në Shqipëri: Sfidat Praktike dhe Perspektivat

Përfshirja e të drejtës për fshirje në Ligjin Nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" është një hap i rëndësishëm në përputhjen e Shqipërisë me kuadrin ligjor të Bashkimit Evropian. Ky ligj njeh qartësisht të drejtën e individit për të kërkuar fshirjen e të dhënave personale, dhe parashikon detyrime të ngjashme me ato të përcaktuara në nenin 17 të

GDPR-së. Megjithatë, përtej kornizës ligjore, sfida më e madhe mbetet zbatimi praktik i kësaj të drejte.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP) është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen e respektimit të këtij ligji në Shqipëri. Ai ka kompetenca të gjera, përfshirë marrjen dhe shqyrtimin e ankesave, zhvillimin e hetimeve administrative, lëshimin e urdhrave për fshirjen e të dhënave dhe vendosjen e sanksioneve administrative.

Por, në praktikë, autoriteti përballlet me disa pengesa strukturore dhe institucionale:

I. Burimet e kufizuara – mungesa e kapaciteteve teknike dhe stafit të specializuar e bën të vështirë identifikimin dhe adresimin e të gjitha rasteve të shkeljeve, sidomos kur ato ndodhin në mjedisin online.

II. Ndërgjegjësimi i ulët i publikut – shumë qytetarë shqiptarë nuk janë të informuar për të drejtat që u garanton ligji i ri, përfshirë të drejtën për t'u harruar. Kjo çon në mungesë kërkesash zyrtare për fshirje ose përdorim të gabuar të kësaj të drejte.

III. Përvoja gjyqësore e kufizuar – në mungesë të një jurisprudence të zhvilluar vendase, gjykatat shqiptare ende nuk kanë krijuar praktikë të konsoliduar për trajtimin e rasteve që lidhen me të drejtën për t'u harruar. Kjo mungesë orientimi ndikon në efikasitetin dhe parashikueshmërinë e zgjidhjes së këtyre çështjeve.

IV. Roli i operatorëve privatë dhe platformave digjitale – shpeshherë, të dhënat që kërkohet të fshihen ndodhen në motorë kërkimi ose platforma sociale që operojnë jashtë juridiksionit të drejtpërdrejtë të

¹⁹² Neni 17 I GDPR-së <https://gdpr-info.eu/art-17-gdpr/>

autoriteteve shqiptare, çka krijon vështirësi në zbatimin praktik të vendimeve për fshirje.

Megjithatë, duhet theksuar se kuadri ligjor ekzistues në Shqipëri është potencialisht i aftë të ofrojë mbrojtje efektive, nëse mbështetet me politika ndërgjegjëse, trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe investime në infrastrukturë institucionale. Zbatimi efektiv i të drejtës për t'u harruar mund të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore dhe në vetë teknologjinë, duke vendosur një standard të ri për mbrojtjen e privatësisë në Shqipëri.

Në përfundim, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të përafrimit të legjislacionit të saj me atë të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale. Ligji Nr. 124/2024 është një ligj bashkëkohor, i ndërtuar mbi të njëjtat parime me GDPR-në, duke përfshirë në mënyrë të qartë edhe të drejtën për fshirje të të dhënave – një variant i të drejtës për t'u harruar.

Megjithatë, për të realizuar plotësisht qëllimin e këtij ligji, është e nevojshme që institucionet përgjegjëse të forcojnë kapacitetet e tyre, të rritet ndërgjegjësimi publik dhe të sigurohet një mekanizëm efektiv për trajtimin e kërkesave për fshirje dhe mbrojtje të të dhënave. Në të njëjtën kohë, nevojitet ndërtimi i një jurisprudence vendase që të shërbejë si udhëzues për rastet e ngjashme në të ardhmen, në mënyrë që të garantohet jo vetëm përputhja ligjore, por edhe zbatimi praktik i kësaj të drejte në realitetin shqiptar.

Përfundimet

Ky punim shkencor ka synuar të analizojë në mënyrë të gjithanshme dhe kritike konceptin e të drejtës për t'u harruar, duke e trajtuar atë si një ndër zhvillimet më delikate dhe të

debatueshme në fushën e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së privatësisë në epokën digjitale. Duke filluar nga një vështrim historik, u vu re se nocioni i harrimit ka qenë gjithmonë i pranishëm në shoqëri si një mekanizëm personal dhe social për të përballuar të kaluarën. Sot, në një realitet ku informacioni nuk fshihet por qarkullon pa fund, kjo nevojë njerëzore është transformuar në një të drejtë që kërkon mbrojtje ligjore. Punimi solli në vëmendje jo vetëm vlerën njerëzore dhe etike të harrimit, por edhe tensionin që ekziston mes së drejtës për t'u harruar dhe të drejtës për të informuar. Kjo e drejtë është shfaqur si një domosdoshmëri për mbrojtjen e dinjitetit në epokën e internetit, por në të njëjtën kohë ka krijuar sfida të mëdha juridike dhe morale, sidomos kur përplasen me të drejta të tjera si liria e shprehjes apo transparenca publike. Duke shqyrtuar kuadrin ligjor evropian, veçanërisht përmes Rregullores së Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR), u konstatua se e drejta për t'u harruar është e parashikuar në mënyrë të qartë në nivel normativ, por zbatimi i saj mbetet i ndërlikuar dhe i larmishëm në praktikën e vendeve të ndryshme anëtare të BE-së.

Një ndër gjetjet më domethënëse të këtij punimi është se, edhe pse e drejta për t'u harruar përfaqëson një përparim të rëndësishëm në mbrojtjen e privatësisë, ajo është ende një e drejtë në ndërtim, që përballen me shumë kufizime në praktikë. Neglizhenca e disa gjykatave ndaj mbrojtjes së konfidencialitetit, mungesa e një trajtimi të unifikuar mes kontrolluesve të të dhënave dhe vetëdija e ulët e qytetarëve për këtë të drejtë përbëjnë faktorë që e dobësojnë efektivitetin e saj. Gjithashtu, u analizua ndikimi i profesionit gazetaresk dhe u trajtua përjashtimi gazetaresk si një nga dilemat më të mëdha për aplikimin e kësaj të drejte, duke dëshmuar për nevojën e një ekuilibrimi delikat mes privatësisë dhe interesit publik. Theksi u vendos në nevojën për zgjidhje të personalizuar për çdo rast, në

mënyrë që asnjëra nga të drejtat të mos dominojë mbi tjetrën në mënyrë të padrejtë.

Përmes analizës së praktikave konkrete si formularët e Google për kërkesa për fshirje të të dhënave, dhe mënyrës se si GDPR e rregullon këtë proces, u evidentua se zbatimi i të drejtës për t'u harruar është lënë pjesërisht në dorën e platformave private. Kjo ngre çështje serioze përse i përket transparencës, llogaridhënies dhe mbrojtjes së të drejtave të individit përballë fuqisë së korporatave të mëdha digjitale. Një vështrim i rëndësishëm u bë edhe në ndikimin që teknologjitë e reja, veçanërisht inteligjenca artificiale, kanë në zbatimin dhe kufizimin e kësaj të drejte. U trajtua rasti i ChatGPT dhe u ngritën pikëpyetje mbi ruajtjen dhe përdorimin e të dhënave personale nga algoritmet, çka rrezikon të bëjë të pamundur fshirjen e plotë të informacionit edhe në rastet kur kjo kërkohet me të drejtë. Rëndësi të veçantë në këtë punim pati analiza e jurisprudencës ndërkombëtare, ku rastet më domethënëse si "Google Spain v. AEPD dhe Mario Costeja González" dhe "Biancardi v. Italy" treguan se e drejta për t'u harruar ka fituar status të qartë në praktikën gjyqësore evropiane, duke kontribuar në formësimin e saj si një e drejtë që ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen e lirisë digjitale. Nga ana tjetër, këto raste zbuluan edhe kufizimet dhe sfidat që vazhdojnë ta shoqërojnë atë në zbatim, sidomos përballë të drejtave konkurruese dhe mungesës së standardeve të njëtrajtshme në kuadër të shteteve anëtare. Përmes një vështrimi krahasues midis ligjit evropian dhe kuadrit shqiptar, u nxor përfundimi se Shqipëria ndodhet në një fazë të ndërmjetme, ku përafrimi me legjislacionin e BE-së është i nevojshëm, por ende jo i plotë. Mungesa e praktikës gjyqësore vendase dhe mungesa e ndërgjegjësimit të qytetarëve për këtë të drejtë e bën të domosdoshme marrjen e masave të mëtejshme ligjore, edukative dhe institucionale. Duke u

bazuar në përfundimet e nxjerra nga analiza teorike, juridike, praktike dhe krahasuese e të drejtës për t'u harruar, vlerësohet se janë të domosdoshme disa ndërhyrje dhe zhvillime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të garantuar një mbrojtje efektive të kësaj të drejte në praktikë.

Në radhë të parë, rekomandohet që kuadri ligjor shqiptar të përafrohet më tej me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR). Kjo do të duhej të realizohej jo vetëm në nivel formal përmes miratimit të legjislacionit, por edhe në nivel institucional, duke rritur kapacitetet e Autoritetit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe duke vendosur procedura të qarta dhe transparente për trajtimin e kërkesave për fshirje të të dhënave.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm lidhet me rritjen e ndërgjegjësimit qytetar mbi të drejtën për t'u harruar, përmes fushatave edukative dhe përfshirjes së këtij koncepti në programe të edukimit qytetar dhe digjital. Mungesa e njohurive për këtë të drejtë kufizon ndjeshëm mundësinë e ushtrimit të saj në praktikë dhe lë individët të pambrojtur ndaj ekspozimit të tepërt të të dhënave personale në internet.

Gjithashtu, është e nevojshme të krijohen mekanizma efektivë dhe të unifikuar në nivel kombëtar për shqyrtimin e kërkesave për fshirje të të dhënave, duke shmangur subjektivizmin dhe paqartësitë që ekzistojnë aktualisht. Këto mekanizma duhet të mbështeten në kritere të qarta dhe në një qasje të balancuar ndërmjet së drejtës për privatësi dhe së drejtës për informim.

Në kuadër të teknologjisë, rekomandohet që legjislacioni të marrë në konsideratë sfidat e inteligjencës artificiale, përfshirë edhe modelet si ChatGPT dhe motorët e avancuar të kërkimit, të cilët kanë aftësi për të ruajtur dhe riprodhuar të dhëna personale edhe pas fshirjes nga burimet origjinale. Rregullimi i mënyrës se si këto teknologji përpunojnë informacionin është një

domosdoshmëri për të garantuar zbatimin real të të drejtës për t'u harruar në të ardhmen.

Së fundmi, rekomandohet që të zhvillohen kërkime të mëtejshme akademike dhe ndërdisiplinore, jo vetëm në fushën e së drejtës, por edhe në etikë, teknologji dhe shkenca

sociale, për të kuptuar më mirë ndikimin e të drejtës për t'u harruar në jetën e përditshme, në sjelljen e individëve dhe në funksionimin demokratik të shoqërisë.

Në përfundim, ky punim argumenton se e drejta për t'u harruar është një e drejtë që mishëron tensionin e madh midis privatësisë dhe informacionit në epokën digjitale. Ajo ka potencialin të shërbejë si një mjet fuqizues për individin, por vetëm nëse zbatohet me përgjegjësi, transparencë dhe në kuadër të një sistemi të balancuar të të drejtave. Hulumtimet e ardhshme duhet të fokusohen jo vetëm në përmirësimin e kuadrit ligjor ekzistues, por edhe në rregullimin etik të teknologjive të reja që ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën për t'u harruar.

Kontratat virtuale: fuqia dhe zbatueshmëria e tyre

Migena Memaj

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Jonada Zyberaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali” Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Në një epokë ku transformimi digjital po ndryshon rrënjësisht mënyrën e komunikimit dhe të veprimtarisë ekonomike, kontratat digjitale përfaqësojnë një risi të rëndësishme në të drejtën kontraktore. Ky punim synon të analizojë kuadrin ligjor që rregullon kontratat virtuale në Shqipëri dhe të vlerësojë nëse ai garanton një mbrojtje efektive, në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe standardet e Bashkimit Evropian. Qasja metodologjike e ndjekur është juridike-normative, analitike dhe krahasuese, duke u mbështetur në analizën e ligjeve kombëtare, rregulloreve evropiane dhe instrumenteve ndërkombëtare, si dhe në literaturën shkencore përkatëse.

Gjetjet e studimit tregojnë se Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të përfshirë në legjislacionin e saj elementë të rëndësishëm të kontraktimit digjital, përmes akteve si Ligji për nënshkrimin elektronik, Ligji për tregtinë elektronike dhe Ligji për qeverisjen elektronike

etj. Megjithatë, boshllëqe të rëndësishme ekzistojnë, veçanërisht në rregullimin e kontratave të digjitale (smart contracts), në përdorimin e nënshkrimit të thjeshtë elektronik dhe në zbatimin praktik të kërkesave për transparencë në kontratat në distancë. Në këtë kontekst, harmonizimi i mëtijshëm me Rregulloren (BE) 910/2014 (eIDAS) dhe direktivat përkatëse është thelbësor.

Studimi sjell vlera si në aspektin teorik, përmes analizës së koncepteve bashkëkohore si blockchain dhe kontrata inteligjente, ashtu edhe në aspektin praktik, përmes vlerësimit të aplikimit të këtyre kontratave në Shqipëri. Në përfundim, paraqiten rekomandime konkrete për përmirësimin e kuadrit normativ, me synim rritjen e sigurisë juridike dhe nxitjen e përdorimit të kontratave digjitale në mënyrë të qëndrueshme.

Fjalët kyçe : *Kontrata virtuale, Fuqia ligjore, Zbatueshmëria, Elektronik, Blockchain.*

Abstract

In an era where digital transformation is fundamentally reshaping the way we communicate and conduct economic activities, digital contracts represent a significant innovation in contract law. This paper aims to analyze the legal framework governing virtual contracts in Albania and assess whether it ensures effective protection in line with technological developments and European Union standards. The methodological approach employed is legal-normative, analytical, and comparative, relying on the analysis of national laws, EU regulations, and international instruments, as well as relevant scholarly literature.

The findings of the study indicate that Albania has taken important steps to incorporate key elements of digital contracting into its legislation through acts such as the Law on Electronic Signature, the Law on Electronic Commerce, and the Law on Electronic Governance. However, significant gaps remain, particularly in the regulation of smart contracts, the use of simple electronic signatures, and the practical implementation of transparency requirements in distance contracts. In this context, further harmonization with Regulation (EU) 910/2014 (eIDAS) and relevant directives is essential.

The study offers value both from a theoretical perspective—through the analysis of contemporary concepts such as blockchain and smart contracts—and from a practical perspective—through the assessment of how

these contracts are applied in Albania. In conclusion, concrete recommendations are provided for improving the normative framework, aiming to enhance legal certainty and encourage the sustainable use of digital contracts.

Keywords: Virtual contract, Legal validity, Enforceability, Electronic, Blockchain.

Analizë ligjore mbi rastet përjashtimore të përdorimit të kontratave virtuale në Shqipëri

Kontratave virtuale, të cilat lidhen dhe ekzekutohen përmes mjeteve elektronike pa praninë fizike të palëve, kanë fituar një shtrirje të gjerë në praktikën juridike dhe tregtare shqiptare. Megjithatë, qasja e re e ligjvënësit shqiptar drejt dixhitalizimit të veprimtarive juridike ka sjellë lehtësira të shumta, legjislacioni parashikon gjithashtu edhe raste përjashtimore, ku forma elektronike nuk është e vlefshme, ose ku kontrata nuk mund të lidhet virtualisht.

Sipas nenit 659 të Kodit Civil shqiptar, kontratat mund të lidhen lirisht në formë gojore apo me shkrim, por kur ligji parashikon formën e shkruar si kusht vlefshmërie, mungesa e saj sjell pavlefshmërinë e kontratës¹⁹³. Kjo dispozitë aplikohet edhe për kontratat virtuale, kur forma e shkrimit duhet të jetë e firmosur fizikisht ose me nënshkrim elektronik të avancuar.

Një nga ligjet kryesore që rregullon kontratat elektronike është Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008

¹⁹³ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 659.

"Për Tregtinë Elektronike", i cili parashikon se në parim, kontratat e lidhura në mënyrë elektronike janë të vlefshme dhe të detyrueshme, me kushtin që të respektohen rregullat e zakonshme të vlefshmërisë së kontratës. Por në nenin 12 të po këtij ligji, përcaktohen edhe përjashtimet, konkretisht: *"Ky ligj nuk zbatohet për kontratat e mëposhtme:*

- a) për kontratat e lidhura për të krijuar, ndryshuar apo shuar të drejta mbi sendet e paluajtshme, përveç kontratës së qirasë për pasuri të paluajtshme me afat deri në 9 vjet;*
- b) për kontratat, që me ligj kërkojnë përfshirjen e gjykatave, të autoriteteve publike dhe profesioneve, që ushtrojnë apo japin një shërbim publik;*
- c) për kontratat e garancisë dhe kolaterali i letrave me vlerë, i dhënë nga persona, qëveprojnë për qëllime të ndryshme nga ato të biznesit, tregtisë apo profesionit të tyre;*
- ç) për kontratat e parashikuara nga Kodi i Familjes dhe veprimet juridike, tëparashikuara nga Kodi Civil pjesa III titulli III "Trashëgimia me testament";*
- d) për shërbimet financiare ose shërbimet e sigurimit, për të cilat zbatohet marketingu në distancë"*¹⁹⁴

Në aspektin procedural, edhe Kodi i Procedurave Civile në Shqipëri parashikon se disa akte të procedurës duhet të firmosen dorazi dhe vetëm në disa raste mund të pranohen si prova dokumente të lëshuara elektronikisht me firmë të siguruar elektronikisht.

Këto përjashtime lidhen ngushtë me sigurinë juridike dhe nevojën për autenticitetin dhe integritetin e dokumenteve, sidomos në fushat ku pasojat juridike janë të thella (p.sh.

transferimi i pronësisë, aktet trashëgimore, aktet noteriale).

Përfundimisht, ndonëse kontratat virtuale janë të lejuara dhe të mbrojtura me ligj në Shqipëri, ka raste specifike ku ligji kufizon ose ndalon përdorimin e formës elektronike, duke ruajtur forma tradicionale për shkak të natyrës së kontratës dhe interesave publike që ajo prek. Në këto raste, palët duhet të respektojnë format e kërkuara, përndryshe kontrata do të jetë juridikisht e pavlefshme.

Kontratat Inteligjente (Smart Contracts)

Kontrata inteligjente (Smart Contract) është një marrëveshje e koduar në një sistem blockchain, e cila ekzekutohet automatikisht kur plotësohen kushtet e paracaktuara. Ajo nuk është kontratë në kuptimin klasik të fjalës, por një program i vetë-ekzekutueshëm që përmban terma kontraktualë. Në Shqipëri nuk ka ende një ligj të posaçëm për kontratat inteligjente, por ato mund të integrohen dhe interpretohen në bazë të ligjeve ekzistuese. Në Shqipëri, nuk ka ende një standardizim të plotë për kontratat digjitale dhe mungon jurisprudenca e qëndrueshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me to. P.sh., Kodi Civil (nenet 659–666) e pranon vlefshmërinë e një kontrate nëse ka vullnet të lirë nga të dyja palët, por nuk jep udhëzime të qarta për format teknologjike të shprehjes së këtij vullneti në mënyrë digjitale. Kjo krijon pasiguri ligjore dhe e bën më të vështirë zbatimin në praktikë të kontratave që lidhen përmes internetit/ në distancë, veçanërisht kur palët ndodhen në juridiksione të ndryshme.

- a) **Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë :**
Konkretisht neni 663 përcakton konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës në një aspekt

¹⁹⁴ Ligji Nr. 9880/2008 "Për Tregtinë Elektronike.", neni 12.

të përgjithshëm; “Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma esaj e kërkuar nga ligji.”

Ky nen përfaqëson bazën ontologjike të së drejtës kontraktore në Shqipëri, duke përshkruar kushtet e vlefshmërisë që duhet të plotësojë çdo kontratë – tradicionale apo digjitale. Edhe pse është konceptuar në një kontekst analog, ai mbetet plotësisht i aplikueshëm ndaj zhvillimeve të reja teknologjike, përfshirë kontratat virtuale dhe veçanërisht kontratat inteligjente (smart contracts) të mbështetura në teknologjinë blockchain. Më poshtë paraqitet një interpretim sistematik i katër elementeve të tij, në raport me realitetin e kontraktimit digjital:

1. Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin

Në të drejtën shqiptare, vlefshmëria e kontratës është e kushtëzuar nga pëlqimi i lirë dhe i ndërgjegjshëm i palëve. Në kontratat dixhitale, pëlqimi jepet në forma elektronike, si p.sh. klikimi i një butoni “Prano” apo “Bli”, ose përmes përdorimit të nënshkrimit elektronik. Kjo është në përputhje me rregullimin e Ligjit nr. 9880/2008 për nënshkrimin elektronik, që i njeh këto forma si të vlefshme në të njëjtën mënyrë si nënshkrimet tradicionale¹⁹⁵.

Në rastin e smart contracts, pëlqimi shprehet në mënyrë të kodifikuar – zakonisht përmes ndërveprimit në një protokoll blockchain, siç është dërgimi i një kriptomonedhe në një adresë kontraktore. Ky veprim përfaqëson një formë të

vlefshme të manifestimit të vullnetit¹⁹⁶.

2. Shkaku i ligjshëm

Shkaku i kontratës është arsyeja juridike mbi të cilën mbështetet detyrimi. Në kontratat digjitale dhe inteligjente, ky element duhet të ruajë karakterin e tij të ligjshëm dhe të mos bjerë ndesh me rregullat imperative ose rendin publik. Automatizimi i detyrimeve përmes kodit nuk e përjashton nevojën për ekzistencën e një shkaku të vlefshëm në kuptimin juridik.

3. Objekti i kontratës

Objekti i kontratës duhet të jetë i përcaktuar, i mundshëm dhe i lejueshëm. Në kontratat dixhitale, objekt mund të jetë një shërbim online, një produkt dixhital (si softuer apo token), ndërsa në kontratat inteligjente, objekti mund të jetë vetë veprimi i automatizuar që zbaton marrëveshjen¹⁹⁷. Për sa kohë objekti plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 663 të Kodit Civil, forma digjitale nuk e pengon vlefshmërinë e kontratës.

b) Ligji Nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar

Ky ligj u jep fuqi të njëjtë ligjore dhe provuese dokumenteve elektronike të nënshkruara me nënshkrim elektronik të kualifikuar si dokumenteve të shkruara me dorë. Sipas nenit 4: “Veprimet juridike dhe aktet e hartuara nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, mund të bëhen edhe përmes një dokumenti elektronik, të cilit i bashkëlidhet një nënshkrim elektronik i kualifikuar. Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e

¹⁹⁵ Ligji Nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, neni 4

¹⁹⁶ K. Werbach, N. Cornell, “Contracts Ex Machina”, *Duke Law Journal*, 2017, <https://scholarship.law.duke.edu/dlj/vol67/iss2/2/>

¹⁹⁷ D. Tapscott, A. Tapscott, “Blockchain Revolution: How the technology behind bitcoin is changing money, business, and the world.”, 2016, fq.102-108.

tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore." Ky nen përligj vlefshmërinë e dokumenteve elektronike dhe i barazon ligjërisht me dokumentet fizike, me kushtin që ato të jenë të nënshkruara me nënshkrim elektronik të kualifikuar. Kjo është thelbësore për kontratat digjitale dhe smart contracts, pasi nënshkrimi i kualifikuar ofron garanci mbi identitetin e nënshkruesit, integritetin e dokumentit dhe pranimin e origjinës së tij.

Sipas nenit 3, pika 1 e këtij ligji, "nënshkrimi elektronik" është një të dhënë në formë elektronike, e cila lidhet ose bashkëngjitet një dokumenti tjetër elektronik dhe përdoret si mjet për të identifikuar nënshkruesin dhe për të dëshmuar pëlqimin e tij. Ky përkufizim përputhet me standardet e përcaktuara nga Direktiva 1999/93/EC e Bashkimit Evropian, duke garantuar që kontratat e nënshkruara në mënyrë elektronike të kenë të njëjtën fuqi juridike me ato të shkruara në letër, për sa kohë përmbushen kërkesat ligjore.

Ligji gjithashtu krijon bazën për funksionimin e një infrastrukture kombëtare për nënshkrimin elektronik, përfshirë entitete të certifikimit, ofruesit e shërbimit dhe autoritetet mbikëqyrëse. Kjo strukturë ndihmon në zbatimin praktik të kontratave virtuale, sidomos në marrëdhëniet me administratën publike, biznesin dhe sektorin bankar, duke rritur besueshmërinë dhe lehtësuar proceset.

Por si e bën të mundur ky ligj krijimin e një infrastrukture për nënshkrimin elektronik?

Ligji përcakton disa aktorë kyç që janë pjesë e infrastrukturës së nënshkrimit elektronik në Shqipëri:

Ofruesit e shërbimeve të besuara (të nënshkrimit elektronik) – këta janë subjekte publike ose private që lëshojnë certifikata elektronike dhe ofrojnë teknologjinë për aplikimin e nënshkrimeve elektronike.

Autoriteti mbikëqyrës – më parë Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik (AKCE), sot funksioni i është kaluar Autoritetit Kombëtar për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

Entitetet e certifikimit elektronik – përgjegjëse për vërtetimin e identitetit të nënshkruesve dhe për ruajtjen e sigurisë së certifikatave.

Marim një shembull për ta kuptuar më qartë: *Një kompani IT në Tiranë nënshkruan një kontratë pune me një programues që ndodhet në Vlorë. Palët bien dakord për kushtet dhe duan të nënshkruajnë kontratën online.*

Si funksionon:

Punonjësi përdor një nënshkrim elektronik të siguruar nga një entitet i certifikuar, si p.sh. **AKSHI**, që ka të drejtë të lëshojë certifikata elektronike.

- 1) Firma e nënshkruar elektronikisht përmban një **certifikatë dixhitale** që vërteton identitetin e tij dhe datën e nënshkrimit.
- 2) Kompania, nga ana e saj, nënshkruan me një nënshkrim të sigurt të lëshuar nga një tjetër entitet i certifikuar.
- 3) Kontrata është e vlefshme dhe e detyrueshme ligjërisht, pa nevojë për firmë me dorë.

Ligji u mundëson këtyre aktorëve të krijojnë një infrastrukturë teknike dhe rregullatore të standardizuar, e cila: garanton autenticitetin e identitetit të nënshkruesit; siguron integritetin e

dokumentit (që nuk është ndryshuar pas nënshkrimit); mban gjurmë dixhitale për qëllime sigurie dhe provueshmërie; mundëson që kontratat virtuale të zbatohen në praktikë, edhe në sektorë ku më parë kërkohej prania fizike, si bankat, noteri, shërbimet publike, etj.

c) Ligji Nr. 10128/2009 “Për tregëtime elektronike” i ndryshuar

Në kontekstin e zhvillimeve të fundit teknologjike dhe përhapjes së platformave të decentralizuara, kontratat inteligjente (“smart contracts”) janë shfaqur si një formë e re e marrëdhënieve juridike të lidhura në mënyrë automatike përmes teknologjive të tilla si blockchain. Në këtë sfond, Neni 1 i ligjit shqiptar për tregëtime elektronike ofron një kuadër të gjerë që, megjithëse nuk i referohet drejtpërdrejt kontratave inteligjente, mund të interpretohet si një bazë normative e aplikueshme për to.

Neni 1 përcakton se objekt i ligjit është “vendosja e rregullave për kryerjen e veprimeve tregtare në rrugë elektronike, nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga shoqëria e informacionit” si dhe “mbrojtjen e personave pjesëmarrës, [...] të dhënave konfidenciale të pjesëmarrësve” dhe “sigurimin e lëvizjes së lirë të shërbimeve të informacionit”¹⁹⁸.

Ky formulim është konceptualisht përfshirës dhe përkon me natyrën teknologjike të kontratave inteligjente, të cilat janë struktura automatike që ekzekutojnë dispozita kontraktore përmes kodeve kompjuterike. Duke qenë pjesë e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, ato mund të përfshihen nën juridiksionin e këtij ligji.

Një nga shtyllat thelbësore të nenit 1 është

garantimi i mbrojtjes ligjore të të dhënave konfidenciale dhe të pjesëmarrësve në veprime elektronike. Në rastin e smart contracts, të cilat përpunojnë dhe ruajnë automatikisht të dhëna në mënyrë të decentralizuar, kjo dispozitë merr rëndësi të veçantë. Ligji kërkon që edhe në transaksione të automatizuara, të respektohen standardet e privatësisë, konfidencialitetit dhe sigurisë së informacionit. Kjo mbrojtje është në përputhje me parimet e përcaktuara në të drejtën evropiane, veçanërisht me Direktivën 2000/31/EC, mbi të cilën ky ligj është i harmonizuar¹⁹⁹.

Klasifikimi i Kontratave Digjitale në Shqipëri

Lloji i Kontratës Digjitale	Përshkrim i Shkurtër	Baza Ligjore	Vlefshmëria Ligjore
1. Me nënshkrim elektronik të kualifikuar	Dokument i nënshkruar elektronikisht me certifikatë të lëshuar nga një ofrues i çertifikuar	Ligji Nr. 9880/2008; Ligji Nr. 90/2012	E barabartë me formën shkresore fizike
2. Me nënshkrim elektronik të thjeshtë/jo të kualifikuar	Nënshkrim me email, PIN, OTP etj. pa certifikatë zyrtare	Nuk ka bazë specifike, vlerësohet rast pas rasti	Mund të jetë e vlefshme, por me fuqi më të dobët provuese
3. Kontratë në distancë përmes internetit	Blerje, pajtime apo marrëveshje të lidhura online nga konsumatorët	Ligj Nr. 71/2018	Vlefshmëri e plotë për sa kohë respektohen kushtet e informimit
4. Kontratë pune digjitale	Marrëveshje punësimi e lidhur në mënyrë digjitale	Kodi i Punës + Ligji për nënshkrimin elektronik	Vlefshmëri vetëm nëse ka formë të shkruar ose nënshkrim të kualifikuar
5. Marrëveshje me platforma digjitale / Të dhënat / Shërbime online	"Terms & conditions" që përdoruesi pranon kur përdor një faqe apo app	Ligji për konsumatorin + Ligji për mbrojtjen e të dhënave	Vlen si kontratë, për sa kohë përdoruesi informohet dhe jep pëlqim

¹⁹⁸ Ligji nr. 10 128, datë 11.5.2009, “Për tregëtime elektronike”, i ndryshuar me ligjin nr. 135/2013, neni 1.

¹⁹⁹ European Parliament and Council. (2000). *Directive 2000/31/EC on electronic commerce*. Official Journal L178, 17.07.2000.

Kontratat me shkrim (në formë elektronike)

Kontratat me shkrim (në formë elektronike— Sipas Ligjit Nr. 9880, datë 25.2.2008 "Për nënshkrimin elektronik" (ndryshuar me aktin normativ nr.8, datë 30.9.2009, ligjin nr. 122/2016, 15.12.2016, aktin normativnr.18, datë 9.12.2022, nr.25, datë 21.3.2024): sipas këtij ligji, specifikisht në nenin 4 "Veprimet juridike dhe aktet e hartuara nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, mund të bëhen edhe përmes një dokumenti elektronik, të cilit i bashkëlidhet një nënshkrim elektronik i kualifikuar. Dokumenti elektronik, i cili mban emrin e nënshkruesit dhe nënshkrimin e tij të kualifikuar, ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore." Ky nen vendos një bazë ligjore të fortë për vlefshmërinë e dokumenteve dhe kontratave digjitale duke e barazuar fuqinë e tyre me dokumentet e shkruara në letër. Ai mbulon disa aspekte kyçe:

Çfarë përcakton ky nen?

Lejon që veprimet juridike dhe aktet të bëhen përmes një dokumenti elektronik – Kjo do të thotë se kontratat, marrëveshjet, deklaratat dhe çdo veprim tjetër juridik mund të realizohen plotësisht në mënyrë digjitale, pa nevojën e një dokumenti fizik.

Dokumenti duhet të ketë një nënshkrim elektronik të kualifikuar – Vetëm nënshkrimi elektronik i kualifikuar, i lëshuar nga një autoritet i çertifikuar (si AKCESK në Shqipëri), i jep një kontratë digjitale të njëjtën fuqi ligjore si një kontratë tradicionale në letër.

Dokumenti elektronik ka të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore – Do të thotë që një kontratë e nënshkruar elektronikisht mund të përdoret si provë në gjykatë,

njësoj si një kontratë e firmosur me dorë në letër.

Çfarë i bën ky nen kontratave digjitale?

I legalizon dhe i barazon me kontratat tradicionale – Nuk ka më nevojë që një dokument të printohet dhe të nënshkruhet fizikisht për të qenë i vlefshëm.

I bën të detyrueshme për palët – Një kontratë e nënshkruar elektronikisht nuk mund të mohohet nga asnjëra palë me arsyetimin se nuk është në letër.

U jep fuqi provuese në proceset gjyqësore dhe administrative – Nëse një palë refuzon të përmbushë detyrimet e kontratës, pala tjetër mund ta paraqesë si provë në gjykatë dhe ajo do të njihet njësoj si një kontratë e zakonshme e shkruar dhe firmosur në letër.

Ky nen është një garanci ligjore që mbështet përdorimin e kontratave dhe dokumenteve digjitale në Shqipëri, duke i dhënë atyre të njëjtën fuqi ligjore si kontratat tradicionale në letër. Kjo e bën më të lehtë dhe më të sigurt përdorimin e teknologjisë në transaksionet juridike, biznesore dhe administrative.

Kontratat me nënshkrim elektronik të thjeshtë, jo të kualifikuar

Kontratat me nënshkrim elektronik të thjeshtë / jo të kualifikuar - Lidhen elektronikisht, por pa përdorur një nënshkrim të kualifikuar nga një autoritet certifikues (AKSHI në Shqipëri ose një ent i njohur në BE). Raste konkrete mund të përmendim : Dërgim email-i me pranim të kushteve; Klikim "Pajtohem" në një faqe interneti; Kodi OTP (one-time password) në SMS/email; Fjalëkalime ose PIN të personalizuar. *Pse kanë fuqi më të dobët provuese?* Në të drejtën shqiptare dhe evropiane, vlefshmëria ligjore nuk

do të thotë automatikisht fuqi provuese e fortë. Kjo e fundit lidhet me sigurinë që një gjykatë ka se kush e ka kryer një veprim, domethënë, në mungesë të një nënshkrimi të kualifikuar (i cili ka vlefshmëri të garantuar me ligj si një nënshkrim i dorës), gjykata duhet të analizojë prova të tjera për të vendosur autenticitetin e kontratës. Një nënshkrim elektronik i thjeshtë mund të kontestohet më lehtë, sepse: -Nuk ka siguri se është bërë nga vetë individi ; -Nuk ka certifikatë që verifikon identitetin e nënshkruesit; -Mund të falsifikohet më lehtë (p.sh., dikush tjetër mund të ketë përdorur email-in ose telefonin tënd). Një shembull problematik: Një person klikon "Pajtohem" në një platformë për një pajtim mujor, por më pas mohon se ka rënë dakord. Pa nënshkrim të kualifikuar apo log të detajuar të sistemit (IP, orë, pajisje), kjo marrëveshje mund të konsiderohet e pavlefshme ose e kontestueshme në gjykatë.

Qëndrimi që mban legjislacioni shqiptar për raste të tilla, Ligji Nr. 9880/2008 "Për nënshkrimin elektronik", përcakton që: "Nënshkrimi elektronik i kualifikuar ka të njëjtën vlefshmëri ligjore me nënshkrimin me dorë"²⁰⁰. Ndërsa për nënshkrimet e tjera, ligji lë hapësirë që ato të pranohen vetëm nëse palët bien dakord ose nëse vërtetohen nga prova të tjera.

Pse kanë fuqi të dobët provuese?

Arsye	Shpjegim
Nuk është i certifikuar	Nuk ka një palë të tretë që garanton identitetin e nënshkruesit
Lehtësi manipulimi	Mund të dërgohet nga dikush tjetër, ose të përdoret pa dijeninë e përdoruesit
Vështirësi në gjykim	Gjykata duhet të analizojë teknologjinë, IP-të, kohën, pajisjen etj. për të konfirmuar
Rrezik për palën e pa mbrojtur	Nëse njëra palë nuk ka njohuri teknologjike, mund të abuzohet

Kontratat e lidhura me mjete elektronike (kontratat e distancës)

Kontratat e lidhura me mjete elektronike (kontratat e distancës) - Ligji Nr. 9902, datë 17.4.2008 "Për mbrojtjen e konsumatorit", i ndryshuar. Një kontratë distancë është një marrëveshje e lidhur mes një tregtari dhe një konsumatori duke përdorur vetëm mjete të komunikimit në distancë (pa prezencë fizike), deri në momentin e përfundimit të kontratës. Ky përkufizim përfshin kontratat online (përmes internetit, aplikacioneve, email-it), telefonike, përmes katalogëve me porosi etj. Ai vendos një bazë të qartë që kontratat elektronike për blerje, abonime ose shërbime të tjera janë të vlefshme, por gjithashtu duhet të jenë të mbrojtura në mënyrë të veçantë.

Sipas nenit 7: "Tregtari duhet t'i japë konsumatorit informacion të qartë, të saktë dhe të kuptueshëm për produktin/shërbimin, çmimin, afatet, të drejtën për të anuluar, mënyrën e pagesës, dhe të dhënat për identifikimin e tij." Ky nen garanton transparencë në kontratat digjitale, ku konsumatori shpesh nuk ka kontakt fizik me tregtarin. Kjo rrit sigurinë juridike dhe shmang abuzimet me kushte të fshehta ose mashtruese.

Kontrata në distancë është e vlefshme vetëm nëse tregtari ka përmbushur detyrimet e informimit dhe konsumatori ka pranuar me vullnet të lirë. Vlefshmëria e kontratës në distancë kushtëzohet nga transparenca dhe pëlqimi, gjë që e ndihmon konsumatorin të mos jetë viktimë e "kontratave të imponuara" ose "pranimeve të pavullnetshme".

Çfarë përcakton ky ligj?

□ Kontratat e distancës janë marrëveshje të lidhura **pa prezencë fizike**, përmes mjeteve të komunikimit elektronik (internet, email, aplikacione, telefon).

²⁰⁰ Ligji Nr. 9880/2008 "Për nënshkrimin elektronik", neni 4.

Ky ligj i barazon kontratat e distancës me kontratat e zakonshme për sa kohë që përmbushin kërkesat ligjore për informim, transparencë dhe mbrojtje të konsumatorit.

Kontratat digjitale kanë të njëjtën vlefshmëri ligjore si kontratat me shkrim, për sa kohë që përdoren mjetet e duhura të identifikimit (nënshkrimi elektronik i kualifikuar ose mënyra të tjera të njohura ligjërisht).

Si ndikon ky ligj në kontratat digjitale në distancë?

Ky ligj siguron një kuadër të qartë ligjor për kontratat e distancës dhe i bën ato të sigurta për përdorim duke:

- Detyruar tregtarët të japin informacion të qartë (Neni 7) Konsumatori duhet të dijë saktësisht çfarë po blen, me çfarë kushtesh dhe çfarë të drejtash ka.
- Siguruar të drejtën e tërheqjes nga kontrata (Neni 31) Konsumatori mund të tërhiqet brenda 14 ditëve pa penalitet.
- Detyruar respektimin e afateve të dorëzimit dhe përgjegjësinë për vonesat (Neni 30) Nëse produkti nuk dërgohet brenda afatit, konsumatori ka të drejtë për rimbursim.

Neni 4 i Ligjit Nr. 107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike” luan një rol kyç në rregullimin e kontratave digjitale në distancë në Shqipëri. Ky nen përcakton se një dokument elektronik i nënshkruar me një nënshkrim elektronik të kualifikuar ka të njëjtën fuqi ligjore dhe provuese si një dokument me nënshkrim dorëshkrim. Kjo do të thotë se kontratat që lidhen në distancë, përmes internetit apo mjeteve të tjera elektronike, nëse janë të pajisura me një nënshkrim të tillë, konsiderohen të vlefshme dhe

të mbrojtura ligjërisht. Rregullimi i këtij neni krijon një kuadër të sigurt për zhvillimin e marrëdhënieve kontraktore në formë digjitale, duke i mundësuar individëve dhe bizneseve të kryejnë transaksione juridike të vlefshme pa qenë të pranishëm fizikisht, si në rastin e kontratave të shërbimeve online, marrëveshjeve me administratën publike apo firmosjes së kontratave tregtare përmes platformave elektronike.

Një nga problemet më të shpeshta në kontratat në distancë është mosdhënia e informacionit të qartë dhe të plotë paraprak për konsumatorin nga ana e tregtarëve. Sipas nenit 7 të Ligjit Nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, tregtari është i detyruar të informojë konsumatorin, përpara lidhjes së kontratës, për çmimin total, karakteristikat e produktit ose shërbimit, mënyrën e pagesës, afatin e dorëzimit, si dhe për të drejtën e tërheqjes nga kontrata. Mospasja e një informacioni të tillë e bën kontratën jo vetëm të paqartë për konsumatorin, por rrit edhe mundësinë e abuzimit, veçanërisht në platformat online të pakontrolluara.

Shumë kontrata në distancë realizohen duke përdorur forma të nënshkrimit të thjeshtë elektronik, si klikimi në një buton, dërgimi i një emaili apo futja e një kodi OTP. Megjithatë këto forma janë të pranura në praktikë, nuk ofrojnë garanci për identitetin e palës dhe mund të kontestohen lehtësisht në gjykatë. Sipas nenit 4 të Ligjit Nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, vetëm dokumenti elektronik i nënshkruar me nënshkrim elektronik të kualifikuar, i cili është i certifikuar dhe përmban të dhëna të qarta mbi nënshkruesin, ka të njëjtën fuqi ligjore dhe provuese si një dokument me nënshkrim dorëshkrim. Në mungesë të këtij standardi, konsumatori apo tregtari mund të hasin vështirësi në provimin e vlefshmërisë së kontratës përpara organeve gjyqësore.

Marrëveshjet me Platforma Digjitale ("Terms & Conditions")

Terms & Conditions" (Kushtet e përdorimit) janë marrëveshje kontraktuale të paraformuara që vendosen nga një platformë online (app, faqe interneti, shërbim digjital etj.), të cilat përdoruesi i pranon në mënyrë elektronike (zakonisht me klikimin e një butoni "Prano" ose "I Agree").

Këto kontrata janë të vlefshme ligjërish, për sa kohë:

- Janë të qarta dhe të lexueshme,
- I janë vënë në dispozicion përdoruesit përpara krijimit të marrëdhënies,
- Dhe pranimi i tyre është i gjurmueshëm dhe i verifikueshëm.

Rregullimi i këtyre lloj kontratave në legjislacionin shqiptar mund të përmendim:

a) Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Neni 660 – Liria e kontraktimit : *"Palët janë të lira të lidhin kontratë dhe të përcaktojnë përmbajtjen e saj, brenda kufijve të caktuar nga ligji."* Interpretimi: Termat dhe kushtet e platformës janë formë kontrate e lejuar nga ligji, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me rendin publik apo dispozitat imperative.

Neni 682 – Forma e kontratës : *"Kontrata lidhet në çdo formë, përveç rasteve kur ligji kërkon shprehimisht një formë të caktuar."* Interpretimi: Platforma digjitale mund të krijojë marrëveshje edhe përmes mjeteve elektronike, përfshirë klikimin si shprehje vullneti (Clickwrap Contracts).

b) Ligji Nr. 9902/2008 "Për Mbrojtjen e Konsumatorëve" Neni 7 – Informimi i konsumatorit : *"Tregtari është i detyruar të informojë konsumatorin në mënyrë të plotë, të saktë dhe të kuptueshme për kushtet e*

kontratës."

-Platforma që ofron shërbime digjitale duhet të informojë përdoruesin përpara lidhjes së marrëveshjes për të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

c) Ligji Nr. 10128/2009 "Për Shërbimin e Pagesave Elektronike" dhe Ligji Nr. 107/2015 "Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara" -

Këto ligje përcaktojnë rregullat për ofruesit e shërbimeve digjitale dhe përdorimin e nënshkrimit elektronik.

Ligji 107/2015, Neni 4 "Për nënshkrimin elektronik" - *"Dokumenti elektronik me nënshkrim elektronik të kualifikuar ka të njëjtën vlefshmëri dhe fuqi provuese me dokumentin shkresor."* Nëse përdoruesi pranon kushtet përmes një metode të sigurt (p.sh. login me kredenciale personale), kjo konsiderohet si veprim juridik me fuqi kontraktuale.

Autoritetet që merren me sigurimin e kontratave elektronike

Në epokën e digjitalizimit dhe të teknologjisë së informacionit, kontratat elektronike përfaqësojnë një pjesë thelbësore të marrëdhënieve juridike në sferën ekonomike, administrative dhe shoqërore. Këto kontrata, ndryshe nga format tradicionale, krijohen, nënshkruhen dhe ekzekutohen përmes platformave elektronike, duke ngritur sfida të rëndësishme përsa i përket sigurisë, autenticitetit dhe vlefshmërisë së tyre. Në këtë kontekst, lind nevoja për institucione dhe autoritete të specializuara që sigurojnë infrastrukturën teknike, ligjore dhe rregullatore për funksionimin korrekt dhe të besueshëm të kontratave elektronike.

Autoritetet që merren me sigurimin e kontratave elektronike janë entitete publike ose të licencuara,

të cilat kanë për detyrë lëshimin, verifikimin, ruajtjen dhe revokimin e nënshkrimeve elektronike të kualifikuara, të cilat përbëjnë elementin themelor për vërtetësinë dhe integritetin e një kontrate digjitale. Në Bashkimin Evropian, kjo funksion kryhet në bazë të Rregullores (BE) nr. 910/2014 (eIDAS), që përcakton standarde të harmonizuara për identitetin elektronik dhe shërbimet e besueshme në transaksionet elektronike në tregun e përbashkët digjital²⁰¹.

Shembuj praktikë të nevojës për këto autoritete përfshijnë kontratat e shërbimeve publike të kryera nëpërmjet portalit e-Albania, ku nënshkrimi i dokumenteve (p.sh. deklarata noteriale, autorizime, kontrata pune) kryhet përmes nënshkrimit elektronik të kualifikuar (QES) të garantuar nga autoritetet përkatëse. Në mungesë të një entiteti të besueshëm që menaxhon infrastrukturën teknike dhe verifikimin ligjor të nënshkrimeve, rrezikohet jo vetëm vlefshmëria e kontratës, por edhe siguria juridike e palëve²⁰². Po kështu, në fushën e tregtisë ndërkombëtare ose të platformave e-commerce, autoritetet për sigurimin e nënshkrimeve digjitale ndihmojnë në parandalimin e mashtrimeve, sigurimin e transaksioneve, si dhe në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve përmes provave të pranueshme ligjrisht.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e

Informacionit (AKSHI) është institucioni qendror përgjegjës për zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit në administratën publike shqiptare²⁰³. Roli i saj është thelbësor në krijimin e kushteve teknologjike dhe standardeve për përdorimin e kontratave virtuale në Shqipëri, duke kontribuar në ndërtimin e një sistemi funksional për qeverisjen elektronike dhe transaksionet digjitale.

AKSHI u krijua me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 673, datë 22.11.2001, si një strukturë qeveritare pranë Kryeministrit për të koordinuar dhe zhvilluar infrastrukturën kombëtare të TIK²⁰⁴. Funksionimi i saj aktual rregullohet nga Ligji nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, i cili i njeh AKSHI-t një sërë kompetencash për zhvillimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit dhe ndërveprimin e institucioneve përmes platformave të centralizuara digjitale²⁰⁵.

Kompetencat kryesore të AKSHI-t:

Sipas neneve 25 – 29 të Ligjit nr. 43/2023, kompetencat e AKSHI-t shkurtimisht mund të përmbledhim:

a) *Ofrimi i shërbimeve digjitale* – AKSHI ofron shërbime online për qytetarët, subjektet private dhe institucionet publike, përmes platformës “e-Albania” dhe mjeteve të tjera TIK.

b) *Autentifikimi dhe nënshkrimi elektronik* – Garanton shërbime të identifikimit dhe nënshkrimit elektronik për individë dhe institucione, duke përfshirë vulën dhe certifikatën elektronike.

²⁰¹ Rregullorja (BE) nr. 910/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23.7.2014, mbi identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme për transaksionet elektronike në tregun e brendshëm (eIDAS).

²⁰² AKSHI, “Shërbimet elektronike të ofruara për institucionet publike dhe qytetarët”, www.akshi.gov.al

²⁰³ Ligji nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, Neni 22, pika 2.

²⁰⁴ Këshilli i Ministrave. (2001). *Vendimi nr. 673, datë 22.11.2001, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”*.

²⁰⁵ AKSHI. (2024). *Rreth nesh*. Marrë nga <https://akshi.gov.al>

c) *Menaxhimi i sistemeve TIK të administratës shtetërore* – AKSHI krijon, zhvillon dhe mirëmban sistemet dhe infrastrukturën e TIK për institucionet shtetërore nën Këshillin e Ministrave.

c) *Koordinimi i bazave të të dhënave* – Është autoriteti që rregullon regjistrimin, ndërveprimin dhe auditimin e bazave të të dhënave shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

d) *Zhvillimi i politikave dhe strategjive TIK* – Harton dhe zbaton politika për zhvillimin e teknologjisë së informacionit, shoqërisë së informacionit dhe agjendës digjitale.

e) *Siguria kibernetike dhe infrastruktura kritike* – Përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë kibernetike në sistemet dhe rrjetet shtetërore.

f) *Zbatimi i detyrimeve ndërkombëtare* – Është pika hyrëse për rrjetet transeuropiane të administratave dhe përmbush detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë në këtë fushë.

g) *Menaxhimi i prokurimeve të përqendruara TIK* – Organizimi i prokurimeve për pajisje, software dhe hardware për institucionet shtetërore.

h) *Zhvillimi i sistemeve të reja dhe implementimi i teknologjive inovative* – Përfshin integrimin e teknologjive si blockchain dhe sistemit "Smart-Albania".

j) *Mbikëqyrja dhe dhënia e mendimeve teknike* – Jep mendime të detyrueshme për institucionet publike për specifikime teknike, projekte dhe dhurata në fushën e TIK.

Roli i AKSHI-t në zhvillimin e kontratave virtuale

Ndërsa AKSHI nuk ushtron funksione juridike

mbi kontratat, ajo siguron kushtet teknologjike dhe infrastrukturore që mundësojnë:

a) *Nënshkrimin elektronik të kontratave*

AKSHI është përgjegjëse për integrimin e platformave me ofruesit e certifikimit të nënshkrimeve elektronike, në bashkëpunim me Autoritetin e Certifikimit Elektronik. Kjo i jep një vlerë juridike të barabartë nënshkrimit të zakonshëm edhe në marrëveshje të lidhura në formë virtuale, duke i bërë kontratat digjitale të zbatueshme ligjërisht sipas nenit 659 dhe 663 të Kodit Civil.

b) *Interoperabilitetin ndërinstitutional*

Platforma e-Albania, e zhvilluar dhe mirëmbajtur nga AKSHI, u mundëson institucioneve shtetërore të shkëmbejnë të dhëna dhe dokumente zyrtare në formë digjitale. Për shembull, kontratat për qira të pronës shtetërore, koncesionet, ose marrëveshjet për shërbime publike kryhen përmes formateve të standardizuara dhe të siguruar nga AKSHI²⁰⁶.

c) *Shembull ilustrues: Lidhja e kontratës për aplikim studimesh*

Një student që aplikon për një vend në një universitet publik, pas pranimit, nënshkruan një kontratë digjitale për regjistrim përmes sistemit të integruar në e-Albania. Nënshkrimi bëhet përmes kredencialeve të identitetit elektronik të cilat verifikohen në sistemin e AKSHI-t²⁰⁷.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)

Në prill 2024, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 25/2024 "Për Sigurinë Kibernetike", duke e formalizuar themelimin e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), si institucion shtetëror përgjegjës për menaxhimin e sigurisë në

²⁰⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve Publike. (2023). *Prokurimet elektronike dhe kontratat*.

²⁰⁷ e-Albania. (2025). *Platforma e shërbimeve elektronike*. Marrë nga <https://e-albania.al>

infrastrukturat digjitale të vendit. Ky ligj, duke zbatuar pjesërisht Direktivën NIS të BE-së, kërkon mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të ofruesve kryesorë të shërbimeve më jetike për shoqërinë. Shqipëria është një nga vendet e para në Europë që transpozon Ligjin Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” si angazhim për antarësimin në Bashkimin European.

Ligji i ri u prezantua dhe u miratua si angazhim i qeverisë që Shqipëria të jetë lider në sigurinë kibernetike, e përgatitur për t’ju përgjigjur sulmeve të vazhdueshme.

Ky ligj është gjithëpërfshirës në plotësimin e gjithë kuadrit ligjor në përgatitjen e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për të përballuar situatat dhe sulmet e vazhdueshme kibernetike. Përveç kësaj, ai parashikon procedurat për raportimin dhe trajtimin e incidenteve të sigurisë kibernetike në mënyrë të përshtatshme dhe të koordinuar.

AKCESK është i përkushtuar maksimalisht për të siguruar monitorim dhe mbrojtje kibernetike në nivel kombëtar për të parandaluar rreziqet e mundshme.²⁰⁸ Ky ligj, duke zbatuar pjesërisht Direktivën NIS të BE-së, kërkon mbrojtjen e infrastrukturave kritike të informacionit dhe të ofruesve kryesorë të shërbimeve më jetike për shoqërinë²⁰⁹. AKSK, me mandat të plotë nga Qeveria Shqiptare, po angazhohet në realizimin e bashkëpunimeve të ndryshme me partnerë të rëndësishëm ndërkombëtarë, për të nxitur komunikime më të sigurt dhe për të ndarë informacionin mbi kërcënimet kibernetike, në kohë reale.

Për AKSK, mbrojtja e të dhënave të qytetarëve dhe forcimi i sigurisë së infrastrukturave kritike të informacionit, është më e rëndësishme se kurrë, në një kohë kur kërcënimet kibernetike janë globale dhe ndikojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë ekonomike të vendeve.²¹⁰

Kuadri Ligjor:

- 1- Ligji Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike” – parashikon formalisht krijimin e AKSK dhe përcakton përgjegjësitë e tij në lidhje me sigurinë e infrastrukturës dhe shërbimeve elektronike.
- 2- Vendimi i Këshillit të Ministrave (18 Dhjetor 2024) – rregullon organizimin, funksionimin dhe varësinë e AKSK, si një person juridik buxhetor nën varësinë e Kryeministrit.

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) *ushtron një sërë kompetencash thelbësore për garantimin e sigurisë digjitale në Shqipëri*. Ai përcakton dhe mbikëqyr masat e sigurisë për infrastrukturat kritike të informacionit; monitoron 24/7 këto sisteme përmes strukturave teknike si SOC dhe CERT; ndërhyr dhe ndihmon në rastet e incidenteve kibernetike; administron regjistrin kombëtar të incidenteve; vlerëson nivelin e sigurisë dhe ofron auditime; harton skemën e certifikimit kombëtar për sigurinë; vendos penalitete për shkelësit e ligjit; koordinon me autoritete kombëtare dhe ndërkombëtare; zhvillon programe edukimi dhe ndërgjegjësimi; si dhe vepron si qendra zyrtare për menaxhimin teknik të incidenteve kibernetike në nivel kombëtar.²¹¹

²⁰⁸ AKSK. Publikohet Ligji Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, 2024, marrë nga https://aksk.gov.al/publikohet-ligji-nr-25-2024-per-sigurine-kibernetike/?utm_source

²⁰⁹ AKSK, “Drejt një ekosistemi kibernetik të sigurtë për Shqipërinë”, 2024

https://aksk.gov.al/drejt-nje-ekosistemi-kibernetik-te-sigurte-per-shqiperine/?utm_source

²¹⁰ *ibid.*

²¹¹ Ligji Nr. 25/2024 “Për Sigurinë Kibernetike”, neni 6.

Rëndësia për Kontratat Virtuale:

1. *Besueshmëria e nënshkrimit elektronik:* AKSK siguron që shërbimet e identifikimit dhe nënshkrimit elektronik kombëtar janë të mbrojtura teknikisht dhe ligjërisht, duke garantuar vlefshmërinë e kontratave virtuale.

2. *Mbrojtja e integritetit të dokumenteve:* Përmes vlerësimit të masave të sigurisë dhe verifikimit të certifikatave, AKSK garanton se dokumentet e nënshkruara nuk mund të ndryshohen pas nënshkrimit.

3. *Reagimi ndaj incidenteve që kërcënojnë kontratat:* Në rast sulmesh, AKSK mund të ndërhyjë menjëherë për të parandaluar shpërndarje të paligjshme ose manipulim të kontratave digjitale.

4. *Mbështetje për institucionet:* Përmes konsultimit, trajnimeve dhe standardizimit, AKSK ndihmon organizatat dhe bizneset të integrojnë kontratat virtuale në raport me legjislacionin dhe standardet.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Në Shqipëri, institucioni kyç që garanton respektimin e të drejtave të individit në raport me përpunimin e të dhënave personale, përfshirë edhe ato që burojnë nga kontratat digjitale, është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP). Ky autoritet mbikëqyr respektimin e legjislacionit në fuqi mbi të dhënat personale,

duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si funksionojnë kontratat virtuale në praktikë²¹².

Ky autoritet është themeluar mbi bazën e Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i cili është harmonizuar me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian²¹³. Ligji është rishikuar dhe përmirësuar në mënyrë progresive për të pasqyruar zhvillimet teknologjike dhe për t'u përputhur me Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të njohur si GDPR²¹⁴.

Kompetencat e Komisionerit

Sipas nenit 33 të Ligjit nr. 9887/2008, Komisioneri ka kompetenca për:

Mbikëqyrjen e përpunimit të të dhënave personale nga subjektet publike dhe private;

Dhënien e udhëzimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave;

Zhvillimin e politikave për edukimin e publikut mbi të drejtat e tyre në lidhje me privatësinë;

Dhënien e mendimeve për projekt-aktet, ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale, si dhe projektet që kërkojnë të zbatohen nga kontrolluesit vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë.

Inspektimin dhe vendosjen e masave ndëshkimore në rast shkeljesh.

Nxjerrjen e udhëzimeve për marrjen e masave të sigurisë në veprimtarinë e sektorëve të veçantë²¹⁵.

Këto kompetenca e vendosin Komisionerin si një autoritet të domosdoshëm në vlerësimin e

²¹² Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. (2023). *Raport Vjetor 2022*, fq. 4. Marrë nga: <https://www.idp.al/>

²¹³ Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.

²¹⁴ Regulation (EU) 2016/679 of the European Parliament and of the Council (General Data Protection Regulation), hyrë në fuqi më 25 maj 2018.

²¹⁵ Ligji nr. 9887/2008, neni 33.

ligjshmërisë së kontratave digjitale, të cilat zakonisht përfshijnë përpunimin e të dhënave personale në mënyrë të automatizuar.

Funksioni në kontratat virtuale

Në kontratat digjitale, ku palët nënshkruajnë përmes platformave elektronike, siguria dhe legjitimiteti i të dhënave personale (si emrat, ID-të, adresat elektronike dhe të dhënat bankare) janë thelbësore për vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e marrëveshjes.

Shembull ilustrues: Një kompani që përdor sistem të automatizuar për nënshkrimin e kontratave me klientët, duhet të garantojë që të dhënat personale të konsumatorit të përpunohen në përputhje me parimet e nenit 2 të GDPR: legalitet, transparencë, minimizim, saktësi dhe ruajtje e kufizuar. Në rast se këto kritere nuk plotësohen, individ mund t'i drejtohet Komisionerit për mbrojtje administrative ose edhe gjyqësore.

Rekomandime:

Bazuar në analizën e kuadrit ligjor shqiptar dhe krahasimin me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, ky punim sugjeron një sërë rekomandimesh që synojnë përmirësimin e mbrojtjes juridike të kontratave digjitale në Shqipëri.

Së pari, është e nevojshme të ndërmerren ndryshime dhe përditësime në Kodin Civil, duke përfshirë dispozita të posaçme për smart contracts dhe rregullimin e vlefshmërisë së veprimeve të automatizuara në marrëdhëniet kontraktore. Kjo do të krijonte siguri më të madhe juridike për palët dhe për gjykatat që mund të shqyrtojnë mosmarrëveshjet.

Së dyti, kërkohet standardizimi i nënshkrimeve elektronike të thjeshta dhe përcaktimi i qartë i

kushteve në të cilat ato janë të vlefshme. Kjo do të ndihmonte në shmangien e paqartësive dhe mosnjohjes së kontratave në praktikë.

Së treti, nevojitet forcimi i zbatimit praktik të ligjit për tregtinë elektronike, përmes monitorimit të vazhdueshëm të platformave dhe ndërgjegjësimit të konsumatorëve për të drejtat e tyre.

Së fundi, duhet të inkurajohet praktika gjyqësore në fushën e kontratave digjitale, përmes trajnimeve të vazhdueshme të gjyqtarëve dhe përfshirjes së mëtejshme të teknologjisë në administrimin e drejtësisë.

Ligji dhe e drejta për arsim

Taulant Brisku

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Loreta Tozaj Alushi
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Ky punim bachelor ka për synim të trajtojë temën Ligji dhe e drejta për arsim, duke analizuar bazat ligjore që garantojnë të drejtën e arsimit si një e drejtë themelore e njeriut. Punimi shqyrton kuadrin juridik kombëtar dhe ndërkombëtar që rregullon aksesin në arsim, si dhe sfidat e zbatimit të këtyre ligjeve në praktikë.

Për të kuptuar më mirë funksionimin e sistemit arsimor nga perspektiva juridike, studimi ndahet në disa pjesë kryesore:

- Parimet ligjore mbi arsimin dhe evolucioni i tyre në dokumente ndërkombëtare si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës.
- Zbatimi i së drejtës për arsim në nivel kombëtar dhe roli i institucioneve shtetërore në garantimin e kësaj të drejte.

-Sfida dhe problematika në realizimin e së drejtës për arsim, përfshirë hendekun midis politikave arsimore dhe realitetit shoqëror.

- Reformat dhe përmirësimet e mundshme në legjislacionin arsimor për të siguruar një qasje më efektive dhe gjithëpërfshirëse ndaj arsimit. Ky punim synon të kontribuojë në debatin akademik mbi rëndësinë e ligjit në garantimin e arsimit si një e drejtë universale, duke dhënë rekomandime për përmirësimin e politikave arsimore dhe rritjen e aksesit në arsim për të gjitha shtresat e shoqërisë

Fjalet kyce: *arsim, e drejte, sistem arsimor, reforma, politika arsimore*

Abstract

This bachelor's thesis aims to address the topic of Law and the Right to Education, analyzing the legal foundations that guarantee education as a fundamental human right. The study examines the national and international legal framework that regulates access to education, as well as the challenges in implementing these laws in practice.

To better understand the functioning of the education system from a legal perspective, the study is divided into several key sections:

- Legal principles of education and their evolution in international documents such as the Universal Declaration of Human Rights and the Convention on the Rights of the Child.
- Implementation of the right to education at the national level and the role of state institutions in guaranteeing this right.
- Challenges and issues in ensuring the right to education, including the gap between educational policies and social realities.
- Possible reforms and improvements in educational legislation to ensure a more effective and inclusive approach to education.

This paper aims to contribute to the academic debate on the importance of law in guaranteeing education as a universal right, providing recommendations for improving educational policies and increasing access to education for all segments of society.

Keywords: education, law, education system, reform, education policy

Kuadri ligjor dhe përputhja me standardet ndërkombëtare

Kuadri ligjor për arsimin në Shqipëri është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin për Arsimin Parauniversitar (Nr. 69/2012) dhe Ligjin për Arsimin e Lartë (Nr. 80/2015). Këto ligje kanë për synim të garantojnë arsimin si një e drejtë themelore për çdo individ, në përputhje me konventat ndërkombëtare si:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (Neni 26): Siguron të drejtën për arsimim falas në nivelet bazë dhe të mesme.
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (Neni 28-29): Nxit arsimin si mjet për zhvillimin e plotë të fëmijëve.
- Agjenda 2030 e UNESCO-s (SDG 4): Synon arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë.

Ligji shqiptar për arsimin përmban mekanizma për të siguruar qasjen në arsim për të gjitha kategoritë e shoqërisë, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe grupet vulnerabël. Megjithatë, sfida kryesore qëndron në zbatimin praktik të këtyre politikave dhe sigurimin e fondeve adekuate për realizimin e tyre.

Problemet në zbatimin e kuadrit ligjor

Edhe pse legjislacioni ka përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet, ekzistojnë disa probleme që e vështirësojnë zbatimin efektiv të tij:

- Financimi i pamjaftueshëm: Shqipëria ka një nivel relativisht të ulët të investimeve publike në arsim, duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve edukative.
- Mungesa e infrastrukturës arsimore: Në zonat rurale, shkollat kanë kushte të dobëta fizike dhe mungesa e mjeteve didaktike ndikon në procesin mësimor.
- Diskriminimi dhe përjashtimi social:

Fëmijët nga komunitetet e marginalizuara (si fëmijët romë apo fëmijët me aftësi të kufizuara) ende përballen me pengesa strukturore në qasjen në arsim.

- Zbatimi joefektiv i politikave: Disa dispozita ligjore mbeten në nivel teorik dhe nuk zbatohen plotësisht nga institucionet përkatëse.

Roli i reformave ligjore

Reformat e viteve të fundit kanë synuar përmirësimin e cilësisë së arsimit, përfshirjen e teknologjisë dhe rritjen e autonomisë së institucioneve arsimore. Disa nga përmirësimet kryesore përfshijnë:

- Zhvillimi i kurrikulës së re bazuar në kompetenca: Synon përgatitjen e nxënësve për tregun e punës dhe rritjen e aftësive praktike.

Zhvillimi dhe reformimi i Kurrikulës

Kurrikuli (lat.: curriculum, nga fjala currere - vrapoj, rend; d.m.th ecuria e vitit) fjalë e përdorur në arsim me kuptimin e planit arsimor me qëllime të caktuara.

Në morinë e konceptimeve të kurrikulës studiues të huaj kanë veçuar përcaktuar pesë pikëpamje apo përkufizime themelore të kurrikulës:

Përkufizimi 1. Kurrikula mund të përkufizohet si plan për veprim ose dokument i shkruar, që përfshin strategjitë për arritjen e objektivave ose qëllimeve të dëshiruara. Përfaqësues të këtij këndvështrimi janë Ralf Tiler dhe Hilda Taba. Përkufizimi lidhet me konceptimin linear të kurrikulës, ku planifikimi bëhet sipas një radhe të caktuar veprimesh. Ky përkufizimi për kurrikulën pranohet dhe nga përfaqësues të metodave bihevisoriste, menaxheriale dhe të sistemeve. Xhon Uaills dhe Xhozef Bondi, e shohin kurrillën si plan për të mësuarit, ku objektivat përcaktojnë se ç'lloj të mësuarit është i rëndësishëm.

Përkufizimi 2. Kurrikula përcaktohet si fusha që trajton përvojat e nxënësit. Përkufizimi bazohet në përcaktimin që Djui i bën arsimit, dhe të dijetarëve Kasuell dhe Kembell (1930), sipas të cilëve kurrikula përfaqëson të gjitha përvojat që fëmijët fitojnë në udhëzimin e mësuesve. Këtij parimi i përmbahen specialistët humanistë të kurrikulës. Kurrikula përbëhet nga përvoja të vazhdueshme të fëmijëve nën orientimin e shkollës. Shkolla përfaqëson një mjedis të veçantë, ku fëmijët vetë realizohen nëpërmjet pjesëmarrjes aktive brenda shkollës. Sipas Eisner, "Kurrikula është program, që shkolla u ofron nxënësve. Ajo përmban një tërësi të planifikuar pengesash arsimore për t'u kapërcyer dhe një game të gjerë përvojash që fiton fëmija Brenda shkollës".

Përkufizimi 3. Kurrikula mund të vlerësohet si sistemi për trajtimin e njerëzve dhe proceseve. Sistemi mund të jetë linear, që nënkupton një proces ose mekanizëm i cili synon arritjen e qëllimeve të dëshiruara. Por mund të jetë dhe jolineare, që do të thotë se specialistët e kurrikulës mund të prishin rregullin dhe sistemin të kapërcejnë elementët përbërës dhe të punojnë më shumë se një element njëkohësisht. Ky përkufizim mbështetet nga kurrikularistët menaxherialë dhe të sistemeve.

Përkufizimi 4. Kurrikula mund të shihet edhe si fushë studimi, me bazat e saj, lëmenjtë e veta të dijes, hulumtimit, teoritë, parimet dhe specialistët për interpretimin e dijeve. Diskutimi për kurrikulën është zakonisht teorik dhe jo praktik, trajton çështje të mëdha filozofike, historike dhe shoqërore.

Përkufizimi 5. Kurrikula mund të shqyrtohet në lidhje me lëndën (matematikë, gjuhë, histori, shkenca etj). Kur flasim për lëndën ose përmbajtjen, mund të marrim parasysh dhe nivelet e ndryshme sipas viteve të shkollimit. Kur flasim për këndvështrim, theksi vihet te faktet, konceptet dhe përgjithësimet e një lënde apo të një grupi

lëndësh. Këtij përkufizimi nuk i përmbahet asnjë metodë e caktuar kurrikule, ndërkohë që çdo metodë kurrikule duhet të mbështetet në këtë përkufizim.

Fusha e Kurrikulës

Kurrikula si fushë studimi është karakterizuar si e pakapshme dhe e ngatërruar, por ne duhet të ndërgjegjësohemi se kurrikula si fushë studimi është vendimtare në mbarëvajtjen e shkollave por të gjithë shoqërisë.

Nëse kurrikulën e vlerësojmë në kuptimin e ngushtë si një listë lëndësh që mësohen në shkollë, por dhe në kuptimin e gjerë të përvojave që kërkojnë individët për pjesëmarrje të plotë dhe reale në shoqëri, nuk mohohet se kurrikula ndikon tek të gjithë, jo vetëm arsimtarët dhe kurrikularistët por tek shoqëria në përgjithësi.

Janë shkruar shumë libra për kurrikulën por ka ende paqartësi, sidoqoftë me këtë kurs leksionesh nuk synojmë të sqarojmë paqartësitë por të thellojmë të kuptuarit e paradigmes së këtij aspekti.

Ne duhet të kuptojmë se kurrikula është produkt dhe rezultat i shoqërisë njerëzore.

Shoqëria sot është dinamike dhe shpesh anëtarët e saj shfaqin pasiguri dhe paqartësi, prandaj edhe kurrikula pasqyron paqartësi të tilla.

Se çfarë kuptojmë me kurrikul, çfarë gërsheton ajo, kush përfshihet në ndërtimin e kurrikulës dhe kujt i shërben ajo, të gjitha këto kuptohen më së miri duke analizuar konceptin e kurrikulës në një kontekst të gjerë.

Prandaj kurrikulën e studiojmë në kuptimin e metodës dhe të përkufizimit.

Këtë panoramë të gjerë të kurrikulës e paraqesim duke qenë të vetëdijshëm se ne si autorë dhe ju si lexues jemi krejtësisht të përfshirë në sistemin dinamik të saj

Metodat e kurrikulës

Metoda e kurrikulës përfshin një qëndrim gjithëpërfshirës ose gjithë-orientues.

Ajo pleks bazat e kurrikulës, lëmet e kurrikulës si dhe parimet teorike dhe praktike të kurrikulës.

Metoda shpreh një pikëpamje për zhvillimin dhe hartimin e kurrikulës, për rolin e nxënësit, të mësuesit dhe të specialistit të kurrikulës, përcaktimin e objektivave të kurrikulës si dhe çështjet e rëndësishme që duhen të shqyrtohen.

Metoda pasqyron pikëpamjet tona për shkollën dhe shoqërinë. Duke kuptuar qëndrimin e një njeriu ndaj kurrikulës dhe metodën mbi sunduese të shkollës ose të komunitetit të shkollës ku

punon atëherë mund të arrijmë në përfundimin nëse pikëpamja e tij bie ose jo ndesh me pikëpamjet zyrtare të institucionit.

Shpesh arsimtarët nuk kanë një metodë të vetme por ata ndikohen nga shumë metoda. Metodatat e kurrikulës janë pesë, tre të parat mund të klasifikohen si teknike ose shkencore dhe dy të fundit si jo teknike ose jo shkencore.

Metodat teknike, shkencore pasqyrojnë metoda shkollimi të zbatuara dhe zyrtare. Këto metoda shqyrtohen brenda kampit pozitiviste ose modern. Metodatat jo teknike ose jo shkencore kanë prirjen të kundërvihen praktikave të zyrtarizuara të arsimit, këto pasqyrojnë pikëpamjet e post pozitivistëve.

Bazat e Kurrikulës

Debatet vazhdojnë në lidhje me atë se çfarë është kurrikula dhe si të përcaktohen themelet bazë dhe lëmet(njohuritë) e kasaj fushe.

Bazat kryesore: filozofia, historia, psikologjia dhe sociologjia.

Këto baza përcaktojnë kufijtë e njohurive për kurrikulën, nga të cilat vijjnë teoritë, parimet dhe idetë përkatëse të fushës së kurrikulës.

Sigurisht vetëm shqyrtimi i bazave nuk është i

mjaftueshëm, specialistët duhet të bëjnë lidhjen mes bazave dhe kurrikulës, ata duhet të analizojnë dhe sintetizojnë njohuritë e secilës bazë dhe ndikimet e sotme që kanë të bëjnë me kurrikulën.

Kjo do të thotë që specialisti i kurrikulës përdor koncepte, metoda dhe mjete kërkimore të filozofit, psikologut, sociologut, ekonomistit dhe shkencave politike.

Pavarësisht nga pikëpamjet e tyre filozofike, historike, psikologjike dhe sociale, njerëzit që merren me kurrikulat natyrisht mbështeten në bazat që përbëjnë bazat e kurrikulës dhe i përdorin si mjete për studimin dhe lëvrimin e kurrikulës.

- Ndryshimet në sistemin e maturës shtetërore: Kanë për qëllim të rrisin transparencën dhe cilësinë e vlerësimit të nxënësve.- Fuqizimi i institucioneve për sigurimin e cilësisë: AKKSH (Agjencia Kombëtare e Cilësisë në Arsimin e Lartë) ka rol në monitorimin e cilësisë së universiteteve.

Ndryshimet në sistemin e maturës shtetërore Matura shtetërore ka pësuar disa reformime në vitet e fundit për të garantuar më shumë transparencë dhe objektivitet në vlerësimin e nxënësve. Disa nga ndryshimet kryesore përfshijnë:

- Standardizimi i testeve: Përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së testeve, duke u bazuar në kompetenca të matshme dhe duke reduktuar subjektivitetin.

- Përdorimi i teknologjisë në korrigjimin e testeve: Kjo ndihmon në rritjen e saktësisë dhe shmangien e gabimeve të mundshme në vlerësim.

- Rritja e transparencës në procesin e pranimeve në universitete: Lidhja më e ngushtë mes rezultateve të maturës dhe kritereve të pranimit në fakultete, duke e bërë sistemin më të drejtë. Megjithatë, sfidat mbeten, veçanërisht në garantimin e një procesi vlerësimi të barabartë

për të gjithë nxënësit, si dhe në trajtimin e ankesave mbi rezultatet.

Fuqizimi i institucioneve për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë

AKKSH (Agjencia Kombëtare e Cilësisë në Arsimin e Lartë) ka një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve universitare. Disa nga funksionet kryesore të saj janë:

- Akreditimi i institucioneve arsimore: Vlerësimi dhe verifikimi i cilësisë së universiteteve bazuar në standarde kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Monitorimi i kurrikulave dhe metodologjive didaktike: Sigurimi i një harmonizimi mes universiteteve shqiptare dhe atyre europiane, duke rritur konkurrueshmërinë e diplomave shqiptare.

- Përmirësimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë: Kjo përfshin vlerësimet periodike dhe integrimin e praktikave më të mira nga vendet e zhvilluara.

Pavarësisht progresit, ende ekzistojnë sfida si financimi i pamjaftueshëm për institucionet e arsimit të lartë, nevoja për më shumë transparencë në akreditimin e universiteteve dhe përmirësimi i metodave të mësimdhënies.

- Ligji Nr. 80/2015 – "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" – Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e arsimit të lartë, duke përfshirë akreditimin e universiteteve dhe kërkimin shkencor.

- Ligji Nr. 69/2012 – "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" – Rregullon arsimin parauniversitar, duke garantuar të drejtën për arsimim falas dhe gjithëpërfshirës.

- Ligji Nr. 9741/2007 – "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" – Ligj i mëparshëm për arsimin e lartë, i ndryshuar disa herë për të përmirësuar cilësinë dhe autonominë e

institucioneve arsimore²¹⁶

Analiza e Sistemit Arsimor ne Shqiperi

Struktura e sistemit arsimor

Sistemi arsimor shqiptar ndahet në tri nivele kryesore:

- Arsimi parauniversitar: përfshin arsimin fillor (9 vite, i detyrueshëm), arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe arsimin profesional.
- Arsimi i lartë: universitete dhe institute të larta, ku ofrohen programe bachelor, master dhe doktoratë.
- Arsimi pasuniversitar: përfshin trajnimet dhe specializimet profesionale pas përfundimit të arsimit të lartë.

Sfidat e sistemit arsimor parauniversitar

- Braktisja shkollore: Ndër nivelet kryesore të braktisjes janë zonat rurale dhe familjet me status socio-ekonomik të ulët.
- Infrastruktura dhe mjetet mësimore: Shumë shkolla kanë mungesa në infrastrukturë, teknologji dhe literatura të përditësuara.
- Cilësia e mësimdhënies: Problematikat në kualifikimin dhe motivimin e mësuesve ndikojnë në rezultatet e nxënësve.
- Përfshirja dhe barazia: Ka nevojë për politika më të forta për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe grupeve minoritare.

Sfida në arsimin e lartë

- Autonomia universitare: Në praktikë ka kufizime të pavarësisë së institucioneve në menaxhim dhe financim.


- Cilësia dhe akreditimi: Sistemi i akreditimit është në zhvillim, dhe ka shqetësime mbi cilësinë e programeve dhe kualifikimeve.
 - Migrimi i trurit: Shumë studentë dhe akademikë preferojnë të studiojnë apo punojnë jashtë vendit.
- Përputhja me tregun e punës: Programet akademike shpesh nuk janë në përputhje me nevojat reale të tregut të punës.

Politikat dhe masat për përmirësim

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë masa si:

- Investime në shkolla dhe teknologji.
- Trajnime për mësues dhe reformat në kurrikulë.
- Nisma për barazi dhe përfshirje sociale në arsimin parauniversitar.
- Reforma në arsimin e lartë me fokus në autonomi dhe cilësi.

Megjithatë, zbatimi dhe monitorimi mbeten sfida të vazhdueshme




Arsimi Parauniversitar (deri i mesëm i lartë)

Për publikim 03.05.2024

²¹⁶ <https://www.asc.al/sq/rreth-nesh/legjislacioni>

Vijon Në vitin shkollor 2023-24, 88,7 % e nxënësve të arsimit 9 vjeçar u regjistruan në institucionet e arsimit publik dhe 11,3 % në institucionet e arsimit privat. Ndër nxënësit e regjistruar në arsimin 9 vjeçar, vajzat përbëjnë 47,9 % të totalit.


Fig. 2 Të regjistruar në arsimin 9 vjeçar sipas gjinisë



Në vitin shkollor 2023-24, u regjistruan në arsimin e mesëm të lartë 91.755 nxënës, duke shënuar një ulje prej 4,3 %, krahasuar me vitin e kaluar shkollor. Në vitin 2023-24, pjesën më të madhe të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë e përbëjnë nxënësit e gjimnazit dhe të arsimit të mesëm social-kulturor prej 82,1 %. Ky proporcion ka mbetur pothuaj në të njëjtin nivel përgjatë tre viteve të fundit.


Pjesa më e madhe e nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë ndjek arsimin në institucionet arsimore publike (85,0 %).

Fig. 3 Të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë



Në vitin shkollor 2023-24, numri i mësuesve në arsimin 9 vjeçar është 24.109, ndër të cilët 78,0 % janë gra. Raporti nxënës për një mësues në arsimin fillor publik është 15,1 dhe në atë privat është 15,2. Ndërsa në ciklin e lartë të arsimit 9 vjeçar, raporti nxënës për një mësues në arsimin publik është 7,9 dhe në atë privat 8,0. Numri i mësuesve në arsimin e mesëm të lartë është 8.307 prej të cilëve 69,6 % janë gra. Raporti nxënës për një mësues në arsimin e mesëm të lartë është 11,5 në arsimin publik dhe 9,1 në atë privat.

Fig. 4 Raporti nxënës për mësues në arsimin zyrtar 9-vjeçar dhe të mesëm të lartë, 2023-24



Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Në arsimin pas të mesmes, jo të lartë, në vitin shkollor 2023-24 u regjistruan 179 nxënës. Femrat përbëjnë 39,7 % ndërsa meshkujt 60,3 %. 71,5 % e tyre ndjekin kualifikimin “Ndërmjetësim i Pasurive të Paluajtshme”, 17,9 % “Teknologji Automatizimi” dhe 10,6 % “Dizajn dhe Modë”.

Arsimi i lartë


Në vitin akademik 2023-24, vazhdojnë studimet në të gjithë programet e arsimit të lartë 116.994 studentë, duke shënuar një ulje prej 3,6 % krahasuar me 2022-23. Studentët që marrin pjesë në arsimin e lartë publik, përbëjnë 72,3 % të numrit total të studentëve. Në të gjithë programet e arsimit të lartë, në vitin akademik 2023-24,

marrin pjesë 68.305 studente femra, ose 58,4 % e numrit të përgjithshëm të studentëve në arsimin e lartë.

Në programet bachelor, për të njëjtën periudhë, morën pjesë në arsimin e lartë 67.283 studentë duke shënuar një ulje prej 5,5 % krahasuar me 2022-23.

Në vitin akademik 2023-24, ashtu si edhe vitin e kaluar akademik, studentët preferojnë fushën e studimit “Biznes, administrim dhe ligj”, ku është përqendruar një e katërta e numrit gjithsej të studentëve. Fusha të tjera më të preferuara janë: “Shëndet dhe mirëqenie” dhe “Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim” me përkatësisht 20.9% dhe 19.7% të numrit gjithsej të studentëve të regjistruar. Fusha “Shëndet dhe mirëqenie” është njëkohësisht edhe fusha me rritjen më të madhe të studentëve të regjistruar krahasimisht me vitin e kaluar (8,8 %).

Fig. 5 Shpërndarja në përqindje e numrit të studentëve të regjistruar në arsimin universitar sipas fushave të studimit, 2023-24



Aneks

Tab. 1 Të regjistruar në arsimin deri të mesëm të lartë

ISCED2011	Viti shkollor / akademik	2021-22	2022-23	2023-24
2	Në Kopshte	72.384	69.75	66.711
1+2	Në arsimin 9 vjeçar	278.138	267.275	258.072
1	Në fillore	154.14	146.962	141.089
2	Në ciklin e lartë të arsimit bazë	123.998	120.313	116.983
3	Në arsimin e mesëm	103.467	95.845	91.755
	Gjimnaz dhe Social-Kulturor	85.188	79.032	75.348
	Profesional	18.279	16.813	16.407
Të regjistruar në arsimin parauniversitar (deri i mesëm i lartë)		453.989	432.87	416.538

Shënim: Të dhënat e arsimit profesional për vitin 2023-24 përfshijnë dhe transferimet e nxënësve nga arsimi i mesëm i përgjithshëm në arsimin profesional, gjatë tremujorit të parë të vitit shkollor.

Tab. 2 Nxënës/studentë të regjistruar në arsimin publik dhe privat, 2023-24

ISCED2011	Niveli i arsimit	Në arsim publik		Në arsim privat		Gjithsej	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
		Gjithsej		Gjithsej		Gjithsej	
02	Në kopshte	27.495	29.505	4.562	5.151	32.057	34.654
		56.998					
1	Në fillore	59.435	64.056	8.339	9.259	67.774	73.315
		123.491		17.598			
2	9 vjeçar	50.370	54.972	5.601	6.040	55.971	61.012
	cikli i lartë	105.342		11.641			
3	Në arsimin e mesëm	36.277	41.759	7.051	6.668	43.328	48.427
		78.036		13.719			
4	Në arsimin pas të mesëm, jo të lartë	71	108	0	0	71	108
		179		0			

Tab. 3 Numri i mësuesve në arsimin deri të mesëm të lartë, 2023-24

ISCED2011	Niveli arsimor	Në Femra	arsim publik		Në Femra	arsim privat		Gjithsej		
			Meshkuj	Gjithsej		Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
1	Fillore	7.224	958	8.182	1.066	88	1.154	8.290	1.046	9.336
2	9 vjeçare cikli i lartë	9.344	3.976	13.320	1.182	271	1.453	10.526	4.247	14.773
3	Në arsimin e mesëm	4.675	2.130	6.805	1.107	395	1.502	5.782	2.525	8.307
	Gjithsej	21.243	7.064	28.307	3.355	754	4.109	24.598	7.818	32.416

Tab. 4 Studentë të regjistruar në arsimin universitar

ISCED2011	Niveli arsimor	2021-22			2022-23			2023-24		
		Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
5	Programet 9 vjeçare	22.551	4.223	6.784	2.615	4.343	6.958	2.558	4.150	6.748
6	Bachelor	41.402	31.260	72.852	39.735	31.457	71.192	37.119	39.173	67.283
7	Master	23.159	14.525	43.684	28.775	14.206	42.981	28.122	14.156	42.458
8	Doktoraturë	281	779	560	123	96	219	315	190	505
	Gjithsej	73.493	50.387	123.880	71.248	50.104	121.352	68.305	48.659	116.964

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2023-24)

Tab. 5 Studentë të regjistruar në arsimin universitar, sipas fushave të studimit

Fushat e studimit	2021-22	2022-23	2023-24
Shkenca arsimi	8.085	7.317	6.840
Artet dhe shkenca humane	9.536	7.976	7.302
Shkenca sociale, gazetari dhe informacion	9.204	9.222	8.260
Biznes, administrim dhe ligj	32.227	30.713	28.510
Shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë	4.553	4.056	2.297
Teknologji dhe komunikim	8.458	9.797	8.964
Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim	22.555	22.834	23.053
Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar	2.770	3.108	3.001
Shëndet dhe mirëqenie	22.130	22.433	24.410
Sherbime	4.362	4.446	4.357
Gjithsej	123.880	121.352	116.964

Shënim: Të dhënat e arsimit të lartë nuk janë përfundimtare, për regjistrimet në programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2023-24.

Metodologjia e përdorur nga INSTAT:

Arsimi në Shqipëri është i ISCED- organizuar sipas këtyre programeve dhe klasifikuar sipas Klasifikimit 2011 që përdoret ndërkombëtarisht në statistikat e arsimit:

Niveli 0 - Arsimi parashkollor – çerdhe/kopshte

Niveli 1 - Arsimi fillor ose cikli i ulët i arsimit bazë

Niveli 2 - Arsimi i mesëm i ulët ose cikli i lartë i arsimit bazë

Niveli 3 - Arsimi i mesëm i lartë – Gjinnaz / Profesional / Social kulturor

Niveli 4 - Arsimi pas të mesmes, jo i lartë

Niveli 5 - Arsimi i lartë, cikël i shkurtër

Niveli 6 - Bachelor ose ekuivalent

Niveli 7 - Master ose ekuivalent

Niveli 8 - Doktoraturë ose ekuivalent

Përkufizime

Arsimi zyrtar është përcaktuar si arsimi i institucionalizuar, i qëllimshëm dhe i planifikuar, përmes institucioneve publike dhe private, të njohura (licensuara) nga autoriteti kombëtar arsimor, të cilët në tërësinë e tyre përbëjnë sistemin arsimor zyrtar të një vendi. Programet e arsimit zyrtar janë të njohura si të tilla nga autoritetet përkatëse të arsimit kombëtar, ato ekuivalente ose vartëse të tij. Arsimi zyrtar konsiston më tepër në arsimin që fillon nga klasa e parë dhe vazhdon rregullisht vit pas viti, kryesisht në sistemin pa shkëputje nga puna ose me kohë të plotë (përpara se të bëhen pjesë e tregut të punës), në atë profesional, arsimin për nevojat të veçanta dhe disa pjesë të arsimit për të

rritur, shpesh të njohura si pjesë e sistemit arsimor zyrtar.

Arsimi 9 vjeçar ose arsimi bazë, përbëhet nga dy cikle: cikli i ulët ose arsimi fillor, i cili kryhet në klasat 1 - 5 dhe cikli i lartë ose arsimi i mesëm i ulët, i cili kryhet në klasat 6 - 9. Arsimi 9 vjeçar është i detyruar, fillon në moshën 6 vjeç dhe zgjat 9 vjet. Nxënësi ka detyrimin të ndjekë arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç.

Arsimi i mesëm i lartë përfshin gjimnazin, atë social-kulturor dhe arsimin profesional. Raporti nxënës për mësues është raporti i nxënësve të regjistruar në një nivel arsimit me numrin e mësuesve në të njëjtin nivel.²¹⁷

Të dhënat e statistikave të arsimit 9 vjeçar, të mesëm të përgjithshëm dhe arsimi i lartë sigurohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndërsa të dhënat për arsimin profesional sigurohen nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me periudicitet vjetor.

Të dhënat mbi *statistikat e regjistrimeve në arsimin e lartë, programet e studimit Doktoraturë dhe Specializime Afatgjata, për vitin 2023-24 janë* paraprake dhe subjekt rishikimi.

Bazuar në Udhëzim Nr. 28, datë 16.10.2023, "Për Kushtet dhe Procedurat për Transferimin nga Arsimi i Përgjithshëm (gjimnaz) në Arsimin Profesional dhe Anasjelltas", të dhënat e arsimit profesional për vitin shkollor 2023-2024 përfshijnë dhe transferimet e nxënësve nga arsimi i mesëm i përgjithshëm në arsimin profesional gjatë tremujorit të parë të vitit shkollor.

Në vitin shkollor 2023-24, u regjistruan në arsimin parauniversitar (*deri të mesëm të lartë*) 416.538 nxënës dhe fëmijë, duke shënuar një

ulje prej 3,8 %, krahasuar me vitin shkollor 2022-23.

Në arsimin parashkollor, gjatë këtij viti shkollor marrin pjesë gjithsej 66.711 fëmijë, 4,4 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar shkollor. Në arsimin 9-vjeçar, u regjistruan 258.072 nxënës, 54,7 % në arsimin fillor dhe 45,3 % në ciklin e lartë të arsimit bazë. Krahasuar me vitin shkollor 2022-23, marrin pjesë në arsimin 9-vjeçar 3,4 % më pak nxënës.

Konkluzione

1. E drejta për arsim në Shqipëri është e garantuar ligjërisht, por zbatimi i saj në praktikë përballet me sfida të shumta, sidomos në zonat rurale dhe për grupet vulnerabël.
2. Kuadri ligjor shqiptar është në përputhje të përgjithshme me normat ndërkombëtare dhe evropiane, por kërkon përsosje dhe forcim të mekanizmave të zbatimit.
3. Problemet kryesore të sistemit arsimor lidhen me cilësinë e mësimit, mungesën e burimeve dhe infrastrukturës, si dhe pabarazitë në akses dhe përfshirje.
4. Në arsimin e lartë, sfidat përfshijnë mungesën e autonomisë së plotë universitare, cilësinë e programeve dhe largimin e trurit drejt vendeve të tjera.
5. Masat dhe reformat e ndërmarra nga qeveria janë të rëndësishme, por ndikimi i tyre kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm.

Rekomandime

1. Përforcimi i zbatimit ligjor: Duhet krijuar një mekanizëm më i fuqishëm monitorimi dhe përgjegjshmërie për zbatimin e të drejtës për arsim në të gjitha nivelet.

²¹⁷ <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/>

2. Investime në infrastrukturë dhe teknologji: Veçanërisht në zonat rurale, për të siguruar mjedise mësimore moderne dhe të përshtatshme.

3. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies: Trajnime të vazhdueshme për mësuesit dhe stimulime për performancë më të mirë.

4. Politika për përfshirjen sociale: Programet dhe shërbimet për nxënësit me nevoja të veçanta, minoritetet dhe grupet në rrezik të braktisjes duhet të fuqizohen.

5. Autonomia dhe cilësia në arsimin e lartë: Duhet të forcohet autonomia universitare dhe sistemi i akreditimit të programeve të studimit për të përmirësuar cilësinë dhe konkurrencën.

6. Përballja me migrimin e trurit: Krijimi i kushteve të favorshme për studentët dhe akademikët për të qëndruar dhe kontribuar në Shqipëri që do t'vendosi një theks te vecante pasi, është një fenomen i rëndësishëm që ndikon në zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Sipas INSTAT, migrimi ndërkombëtar është një komponent kyç që ndikon në numrin e popullsisë dhe ka qenë objekt studimi për vlerësimin e emigrantëve dhe imigrantëve në Shqipëri.

Një studim nga ekspertët e INSTAT ka treguar se Shqipëria ka pasur një përqindje të lartë të emigrimit të njerëzve të arsimuar, duke ndikuar në varfërimin e ekonomisë dhe rritjen e qëndrueshme të vendit. Sipas raportit "Diaspora e Shqipërisë në Shifra", deri në vitin 2020, numri i popullatës së larguar nga Shqipëria ishte 1.684.135 individë, ndërsa mbi 47% e personave me arsim të lartë kanë emigruar gjatë viteve 2011-2019.

Ky fenomen ka pasoja të rëndësishme, pasi largimi i profesionistëve dhe akademikëve mund të ndikojë në zhvillimin teknologjik dhe intelektual të vendit. Megjithatë, ekspertët sugjerojnë se për të zbutur efektet negative të migrimit të trurit, duhen ndërmarrë politika që

përfshijnë zhvillimin ekonomik, përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe krijimin e mundësive konkurruese për profesionistët.

7. Angazhimi i komunitetit: Rritja e bashkëpunimit mes shkollave, prindërve dhe komunitetit për të mbështetur mësimin dhe zhvillimin e nxënësve.

8. Si mund të zvogelojmë fenomenin e migrimit të trurit nga Shqipëria:

- Përmirësimi i cilësisë së arsimit – Investimi në infrastrukturë, kurrikula moderne dhe programe kërkimore mund të bëjë arsimin vendas më konkurrues.

- Mundësi punësimi dhe zhvillimi profesional – Krijimi i kushteve të favorshme për punësim dhe rritje profesionale mund të motivojë të diplomuarit të qëndrojnë në vend.

- Incentiva financiare dhe akademike – Bursat, grantet dhe mbështetja për kërkimin shkencor mund të ndihmojnë në mbajtjen e talenteve.

- Bashkëpunime ndërkombëtare – Programet e shkëmbimit dhe partneritetet me universitete të huaja mund të ofrojnë mundësi pa nevojën e emigrimit të përhershëm.

- Politika për rikthimin e trurit – Krijimi i programeve që inkurajojnë profesionistët e larguar të kthehen dhe të kontribuojnë në zhvillimin e vendit.

Rekomandime për përmirësimin e kapaciteteve në mësimdhënie

- Rritja e investimeve në trajnimet e mësuesve – Organizimi i kurseve të vazhdueshme për përmirësimin e metodave të mësimdhënies.

- Modernizimi i kurrikulës – Integrimi i teknologjisë dhe metodave interaktive në procesin mësimor.

- Zhvillimi i një sistemi vlerësimi për mësuesit – Krijimi i mekanizmave për vlerësimin

e performancës së mësuesve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

- Reduktimi i numrit të nxënësve në klasa
- Ndërtimi i shkollave të reja dhe riorganizimi i klasave për të siguruar një mësim më efektiv.

Rekomandime për përmirësimin e infrastrukturës

- Rritja e investimeve publike – Qeveria duhet të rrisë fondet për rikonstruksionin dhe pajisjen e shkollave me mjete moderne.
- Përmirësimi i kushteve të ngrohjes dhe ajrosjes – Instalimi i sistemeve të ngrohjes dhe ajrosjes në të gjitha shkollat për të siguruar një ambient të përshtatshëm për nxënësit.
- Zhvillimi i laboratorëve shkencorë – Investime në pajisje laboratorike për të rritur cilësinë e mësimdhënies në lëndët shkencore.
- Digjitalizimi i shkollave – Integrimi i teknologjisë në procesin mësimor për të përgatitur nxënësit për sfidat e shekullit XXI.

Përfundime dhe reflektime mbi të drejtën për arsim

Për më tepër, situata në zonat rurale paraqet një sfidë shumëdimensionale që ndikon drejtpërdrejt jo vetëm te e drejta për arsim, por në vetë strukturën sociale dhe kulturore të vendit. Mbyllja graduale e shkollave në komunitetet rurale, për shkak të reduktimit të numrit të nxënësve dhe mungesës së investimeve, ka çuar në një cikël të pashmangshëm: migrim i familjeve drejt zonave urbane apo jashtë vendit, shpenzime të papërbalueshme për transport, akomodim dhe materiale shkollore, dhe si rrjedhojë, braktisje e këtyre zonave.

Kjo braktisje sjell me vete humbjen e traditave lokale, shuarjen e trashëgimisë kulturore, si dhe rënie të ndjeshme të prodhimit bujqësor, që në

thelb cenon edhe zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të vendit. Kështu, mungesa e investimeve në arsim nuk është thjesht një problem edukativ, por një problem strategjik për të ardhmen e Shqipërisë.

Rekomandime për zonat rurale dhe ruajtjen e identitetit lokal nëpërmjet arsimit.

- Rihapja dhe mbështetja e shkollave lokale – Shteti duhet të shqyrtojë politika për të mbajtur të hapura shkollat në zonat me popullsi të shpërndarë, duke krijuar modele fleksibël shkollimi dhe staf të përbashkët për disa zona afër njëra-tjetrës.
- Subvencionimi i shpenzimeve për familjet në zonat rurale – Ofrimi i mbështetjes për transportin e nxënësve, materiale shkollore dhe bursa për të nxitur pjesëmarrjen në arsim.
- Programet e ndërthurura edukim–zhvillim rural. Integrimi i arsimit me zhvillimin rural përmes kurseve profesionale që lidhen me bujqësinë, zanatet tradicionale dhe teknologjinë, për të rritur mundësinë e qëndrimit dhe punësimit në vendlindje.
- Rivitalizimi kulturor nëpërmjet shkollës – Shkollat duhet të shndërrohen në qendra komunitare që ruajnë dhe promovojnë kulturën lokale, gjuhën, folklorin dhe traditat përmes orëve të edukimit qytetar dhe projekteve kulturore.
- Frenimi i zhvendosjes dhe përhapja e zhvillimit të qëndrueshëm – Duke e vendosur arsimin si pikën qendrore të zhvillimit lokal, mund të ndalohet tendenca e braktisjes së zonave rurale dhe të krijohen kushte që brezi i ri të qëndrojë, të kontribuojë dhe të ndërtojë një të ardhme aty ku ka rrënjët e veta.

Zbatimi i garancive ligjore në rastet e birësimit surrogativ

Shefqet Hoxha

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: Dr. Jonada Zyberaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Birësimi surrogativ është një fenomen i cili po merr përmasa globale kjo prej zhvillimit të teknologjive të riprodhimit të asistuar, rritjes së shkaqeve të infertilitetit dhe zgjerimit të lidhjeve homoseksuale. Pavarësisht përmasave globale që ky institut ka, ende nuk ekziston një kuadër i mirëfilltë ligjor për rregullimin e marrëdhënieve të surrogacisë. Punimi fokusohet në rregullimin e birësimit surrogativ në rangun e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Shtetet anëtare në bazë të legjislacionit që ato kanë në kuadër të surrogacisë ndahen në: shtete që nuk e ndalojnë surrogacinë por nuk kanë një ligj të posaçëm për rregullimin e saj (rasti i Belgjikës); shtete që e ndalojnë surrogacinë duke e cilësuar atë si vepër penale (rasti i Italisë) si dhe shtete që e njohin surrogacinë si dhe kontratën e surrogacisë, cilësi legjislative që e gëzon Greqia. Në rang ndërkombëtar nuk ekzistojnë garanci ligjore

specifike për birësimin surrogativ, vakum i cili është plotësuar nga akte ligjore të karakterit ndërshtetëror si : Koventa Evropiane për Të Drejtat e Njeriut; Konventa për Birësimin Ndërkombëtar; Koventa për të Drejtat e Fëmijëve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara etj. Pavarësisht ekzistencës së këtyre garancive studiuesit e të drejtës propozojnë krijimin e një Kovente Për Surrogacinë, në bazë të së cilës shtet nënshkruese njohin prindërit e synuar si prindërit biologjik të fëmijës së lindur nga nëna surrogate duke shmangur kështu problemet që hasen me regjistrimin e fëmijës dhe kthimin e tij në shtetin e shtetësisë së prindërve në rastin e turizmit surrogativ.

Fjalët kyç: *birësimi surrogativ, turizmi surrogativ, njohja ndërshtetërore e surrogacisë, certifikata e lindjes për surrogacinë*

Abstract

Surrogacy Adoption is a phenomenon that is gaining global dimensions due to the development of assisted reproductive technologies, the increasing causes of infertility, and the expansion of homosexual relationships. Despite the global scope this institution has, there is still no comprehensive legal framework for the regulation of surrogacy relations. This paper focuses on the regulation of surrogacy adoption within the Member States of the European Union. Based on their legal frameworks regarding surrogacy, Member States are categorized as follows: countries that do not prohibit surrogacy but do not have a specific legal framework to regulate it (e.g., Belgium); countries that prohibit surrogacy and classify it as a criminal offense (e.g., Italy); and countries that recognize surrogacy and the surrogacy contract, a legislative quality enjoyed by Greece. At the international level, there are no specific legal guarantees for surrogacy adoption, a vacuum that has been partially filled by intergovernmental legal instruments such as: the European Convention on Human Rights; the Convention on Intercountry Adoption; the Convention on the Rights of the Child by the United Nations, etc. Despite the existence of these guarantees, legal scholars propose the creation of a Convention on Surrogacy, under which the signatory states would recognize the intended parents as the legal parents of the child born through surrogacy, thus avoiding issues related to the registration of the child and their return to the parents' home country in cases of surrogacy tourism.

Keywords: surrogacy adoption, surrogacy tourism, cross-border recognition of surrogacy, surrogacy birth certificate

Hipoteza

Procedura e birësimit është më efikase sesa procedura e njohjes së certifikatave të lindjes për të garantuar të drejtat e palëve të përfshira në një marrëveshje surrogacie ndërshtetërore.

Koncepti dhe llojet e surrogacisë

Fjala “surrogaci rrjedh nga fjala latinishte “subrogare” që nënkupton “në vend të dikujt tjetër” e përbërë nga “sub” (në vend të) dhe “rogare” (të propozosh).”²¹⁸ Koncepti i surrogacisë është sa shkencor po aq sa edhe juridik. Përsa i përket konceptit juridik “surrogacia në vetëvete është një marrëdhënie juridike, me ose pa kontratë, me ose pa kompesim, në të cilin një grua, që njihet si nëna surrogate, mbart dhe lind një fëmijë për një person apo çift që njihen si prindi/prindërit e destinuar/të synuar, të cilët me lindjen e fëmijës do të fitojnë të drejtat prindërore.”²¹⁹ Shkencërisht surrogacia është pjesë e praktikave të riprodhimit të asistuar, në të cilën një grua e njohur si surrogate mbart embrionin e krijuar duke përdorur metodën e inseminimit artificial ose nëpërmjet fertilizimit in vitro. Llojet kryesore të surrogacisë janë surrogacia tradicionale dhe surrogacia gestacionale. “Surrogacia tradicionale është

²¹⁸ Etymonline - Online Etymology Dictionary.

<https://www.etymonline.com/word/surrogate/related>

²¹⁹ Ms. Kamalpreet Kaur, Dr. Rajwant Kaur Randhawa, 10 Oct 2022, Surrogacy and its legal issues,

<https://scispace.com/pdf/surrogacy-and-its-legal-issues-39cq28cg.pdf>

rezultat i inseminimit artificial të nënës surrogate me materialin gjenetik të babait të synuar. Kjo do të thotë që përdoren vezoret e nënës surrogate, duke e bërë atë një prind gjenetik së bashku me babain e synuar. Surrogacia gestacionale realizohet nëpërmjet fertilizimit in vitro, procedurë në të cilën materialet gjenetike të të dy prindërve të synuar, fertilizohen në kushte laboratorike dhe embrioni i krijuar impletohet tek nëna surrogate. Në surrogacinë gestacionale, gruaja që mban fëmijën (mbartësja gestacionale) nuk ka asnjë lidhje gjenetike me fëmijën.”²²⁰ Surrogacia tradicionale ashtu si dhe surrogacia gestacionale mund të jenë altruiste ose me kompesim. “Surrogacia altruiste i referohet rasteve kur nëna surrogate motivohet nga kujdesi apo shqetësimi për të qënë surrogatja e fëmijës së prindërve të synuar, me të cilët mund të ketë marrëdhënie shoqërore apo afenitive, pa përfutur shuma monetare përtej shpenzimeve të nevojshme. Nga ana tjetër surrogacia me kompesim organizohet nëpërmjet një agjencie ku nëna surrogate ka lidhur një marrëveshje surrogacie për të ofruar këtë shërbim dhe që kjo e fundit nxjerr përfitime monetare personale prej saj.”²²¹

Njohja ndërkombëtare e birësimit surrogativ

Problemet ndërkombëtare të birësimit surrogativ

Një problem lidhur me birësimin surrogativ është diskriminimi që u bëhet çifteve homoseksuale në mundësinë që këta të fundit

kanë që në bazë të ligjit të fitojnë të drejtat prindërore mbi fëmijën e lindur nga një marrëveshje surrogacie ndërshtetërore. Procesi i gjatë i birësimit për të fituar të drejtat prindërore është diskriminues, veçanërisht ndaj çifteve lezbike ku asnjëri nga prindërit nuk është biologjikisht babai i fëmijës.²²² Vështirësitë për të përcaktuar një “nënë” apo “baba” janë shtuar për shkak të rritjes së rasteve të çifteve të të njëjtës gjini apo personave transgjjinorë të përfshirë në këto marrëveshje.

Shumë shtete i japin automatikisht statusin e nënës ligjore gruas që ka lindur fëmijën. Kjo do të thotë se në rastet e surrogacisë, nëna e synuar nuk konsiderohet automatikisht si nëna ligjore, edhe pse do të jetë kujdestarja ligjore e fëmijës. Po ashtu, disa vende përdorin testet gjenetike për të përcaktuar prindërit ligjor të fëmijës, pra ata që ndajnë lidhje gjenetike me të. Një mënyrë shtesë për të përcaktuar prindërimin është përmes qëllimit, ku prindërit e synuar njihen ligjërisht në dokumentacionin e fëmijës.

Një tjetër problematik është ajo e përfshirjes së shumë palëve në një marrëveshje surrogacie. Palët në një marrëveshje surrogacie shumëpalëshe për nënën mund të jenë: dhuruesja e vezoreve, nëna surrogate dhe nëna e synuar; për babain: dhuruesi i spermës dhe babai i synuar; nga ana tjetër dhuruesi i spermës dhe dhuruesja e vezoreve mund të jenë gjithashtu edhe prindërit e synuar. Rrethanat në të cilat mund të zhvillohet një marrëveshje e tillë përcaktohen nga ligji kombëtar. Për shembull, sipas ligjit aktual në Mbretërinë e Bashkuar, kërkohet që të paktën një nga prindërit e synuar të ketë lidhje gjenetike me fëmijën. Bazat mbi të cilën ky prindërim

²²⁰ Söderström-Anttila, V., Wennerholm, U. B., Loft, A., Pinborg, A., Aittomäki, K., Romundstad, L. B., & Bergh, C. (2016). Surrogacy: outcomes for surrogate mothers, children and the resulting families—a systematic review. *Human reproduction update*, 22(2), 260-276.

²²¹ Liezl van Zyl. A Case for Paid Surrogate Motherhood. <https://scispace.com/pdf/a-case-for-paid-surrogatemotherhood-19t0yop538.pdf>

²²² A.Lane (2023) The Right to Recognition: International Surrogacy and the Implications on Birthright Citizenship Fq 38

konfirmohet duhet të jetë e qartë për të shmangur keqkuptime dhe vështirësi të panevojshme, veçanërisht në rastet e surrogacisë.

Për vendet që nuk kanë rregullim ligjor të posaçëm për surrogacinë, janë ngritur shqetësime për rreziqet që një industri e tillë të lihet të vetërregullohet. Legalizimi dhe rregullimi eksplícit i surrogacisë do t'u mundësonte grave surrogate të forcojnë të drejtat e tyre kontraktuale për t'u kompensuar, duke u dhënë grave të pafavorizuara dhe të paarsimuara një mundësi për të fituar të ardhura të mira, ndërkohë që njëkohësisht forcohet autonomia e tyre për të marrë vendime mbi trupin e tyre. Disa argumentojnë që surrogacia duke qënë se në shumë shtete përbën një praktikë të vetëkontrolluar, rregullimi i saj mund të bëhet në prizmin e të drejtës së punës. Organizata Ndërkombëtare e Punës është organizata ndërkombëtare përgjegjëse për hartimin dhe mbikëqyrjen e standardeve ndërkombëtare të punës. Në përgjithësi kjo organizatë promovon vlera të tilla si barazia, puna e denjë dhe kushte pune të mira e të sigurta për të gjithë punëtorët. Shumica e praktikave të ligjshme të punës në botë, nuk përmbajnë dilema morale dhe etike si ato të pranishme në praktikën e surrogacisë, dhe kjo sjell dilemën që nëse Organizata Ndërkombëtare e Punës ka ekspertizën institucionale për të dhënë përgjigje thelbësore për pyetjet e vështira që përballet industria e surrogacisë. Nuk ekziston asnjë mekanizëm detyrues për zbatimin e ligjeve të organizatës por një instrument që bazohej në të do të ishte padyshim më i favorshëm krahasuar me një instrument të bazuar në tregtinë e lirë, ku pabarazia do të përfitonte prindërit kontraktues. Megjithatë, fushëveprimi relativisht i kufizuar i

mandatit të organizatës mund të rrezikojë përjashtimin e fëmijëve të lindur nga surrogacia nga mbrojtja, si dhe të injorojë disa nga pengesat vërtet ndërkombëtare për trajtim të barabartë, siç janë ligjet për emigracionin dhe shtetësinë.²²³

Propozimet për unifikimin ligjor të birësimit surrogativ

Përshtatja e instrumenteve ekzistuese për birësimin ndërkombëtar është një nga mundësitë për të adresuar çështjet që lindin nga marrëveshjet ndërkombëtare të surrogacisë, do të ishte përdorimi i procedurave të birësimit ndërkombëtar dhe përshtatja e Konventës së Hagës të vitit 1993 për

Birësimin Ndërkombëtar. Sipas Thomale, "përshtatja e procedurës së birësimit me marrëveshjet e surrogacisë duhet të jetë fokusi kryesor i reformës ligjore". Ky autor beson se duhet të krijohen procedura të përshpejtuara, qoftë kur prejardhja gjenetike e fëmijëve të lindur nga surrogacia me prindërit komisionues mund të vërtetohet, qoftë kur prindërimi ligjor i njërit prej prindërve të synuar është tashmë i njohur në mënyrë të pavarur. Prindërit komisionues mund të vendosen në krye të listës së aplikantëve ose të trajtohen me përparësi në procesin e birësimit. Procedurat e reformuara të birësimit do të garantonin kështu ruajtjen e interesit më të mirë të fëmijës, pasi do të bëhej një shqyrtim i plotë nëse është vërtet në interesin më të mirë të fëmijës që prindërit komisionues të jenë prindërit e tij ligjor. Në këtë qasje, ndërhyrja e Bashkimit Evropian do të ishte e kufizuar në një rol mbështetës, për shembull duke punuar për një ligj model për birësim ose udhëzime për shtetet anëtare, dhe duke qëndruar larg rregullimit të çështjes.

Zhvillimi i një instrumenti të ri ndërkombëtar për

²²³ Brugger, K. (2011). International law in the gestational surrogacy debate. Fordham Int'l LJ, 35,665.

surrogacinë është një tjetër opsion për rregullim e surrogacisë në rang ndërkombëtar. Në kontrast, një shumicë e gjerë e opinionit ligjor kërkon miratimin e një instrumenti të së drejtës ndërkombëtare private. Në vitin 2013, Katarina Trimmings dhe Paul Beaumont publikuan librin “International Surrogacy Arrangements: Legal Regulation at the International Level”, një vepër që konsiderohet si referencë kyçe për debatin doktrinar mbi marrëveshjet ndërkombëtare të surrogacisë. Në argumentet e tyre, autorët prezantuan atë që, sipas tyre, do të ishte konventa ideale për marrëveshjet ndërkombëtare të surrogacisë, që synon harmonizimin e së drejtës ndërkombëtare private në këtë fushë.²²⁴ Koferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private është një organizatë ndërqeveritare me 80 anëtarë, përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European dhe së fundmi vendosi të krijojë një grup ekspertësh për të shqyrtuar “mundësinë e avancimit të punës” mbi “çështjet e së drejtës ndërkombëtare private që lidhen me statusin e fëmijëve, përfshirë ato që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare të surrogacisë. Konventat e Hagës për të drejtën ndërkombëtare private mund të ofrojnë zgjidhje në katër fusha: juridiksioni (cilat autoritete shtetërore janë kompetente për të vendosur për çështjet e karakterit ndërkufitar), ligji i zbatueshëm, njohja dhe zbatimi, si dhe bashkëpunimi ligjor përmes një autoriteti qendror. Organizata thekson se Konventat e Hagës ndërtojnë ura mes sistemeve të ndryshme ligjore dhe ofrojnë “shenja orientimi” të nevojshme në situata ndërkufitare, ndërkohë që

respektojnë sistemet dhe traditat etike të ndryshme ligjore.⁶⁸

Një projekt tjetër interesant është zhvillimi aktual i parimeve jo detyruese nga Shërbimi Social Ndërkombëtar, një fondacion global me seli në Zvicër i krijuar në vitin 1924 për të ndihmuar familjet që përballen me sfida ndërkufitare. Duke besuar se ekziston një “nevojë urgjente” për veprim në këtë fushë dhe duke marrë parasysh vështirësitë për të arritur një konsensus për një instrument global ligjor detyrues.

Shërbimi Social krijon grupe ekspertësh për të hartuar disa parime kyçe. Është interesante se shumë prej ekspertëve të përfshirë në këto iniciativa marrin pjesë në zhvillimet brenda Konferencës së Hagës. Parimet ndërkombëtare të përcaktuara deri më tani i referohen instrumenteve kryesore ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe të drejtat themelore, duke rikujtuar se fëmijët janë mbajtës të të drejtave individuale dhe kanë nevojë për mbrojtje të veçantë. Parimet pasqyrojnë koncepte si dinjiteti njerëzor, përparësia e interesit më të mirë të fëmijës, mosdiskriminimi, parandalimi i shitjes dhe trafikimit të fëmijës, e drejta për regjistrimin e lindjes dhe shtetësinë, aksesin në origjinën e vet, dhe standarde të qarta se çfarë ndodh në rast shkeljeje të marrëveshjes ndërkombëtare të surrogacisë, braktisje të fëmijës, etj.²²⁵

²²⁴ Richard Blauwhoff and Lisette Frohn (2016), ‘International Commercial Surrogacy Arrangements: The Interests of the Child as a Concern of Both Human Rights and Private International Law’, in *Fundamental Rights in International and European Law – Public and Private Law Perspectives*, Asser Institute, 211-241 Claire Fenton-Glynn (2014) fq 10 ⁶⁸Rigon, A., & Chateau, C. (2016). *Regulating International Surrogacy*

Arrangements--state of Play. Policy Department C: Citizens' Rights and Constitutional Affairs, European Parliament.

²²⁵ V. Raita (2024) “Birth certificates in cross-border surrogacy: Legal implications to the identity of the child” [Bachelor’s thesis, TALLINN UNIVERSITY OF TECHNOLOGY School of Business and Governance Department of Law]

Birësimi surrogativ nën juridiksionin e GJEDNJ-ës -Çështja “D. and Others v. Belgium”*Faktet e çështjes*

Çështja zhvillohet ndërmjet një çifti heteroseksual (Aplikuesit, z.D dhe znj. R shtetas belgë) me palë kundërshtare Qeverinë belge (u përfaqësua nga z. M.Tysebaert, Këshilltar i Lartë në Departamentin Federal të Drejtësisë). Aplikuesit udhëtuan drejt Ukrainës për të realizuar një shtatëzani me nënë surrogate prej së cilës më 26 shkurt 2013 lind Fëmija A. Aplikuesit deklaruan lindjen e A-së para autoriteteve ukrainase dhe morën një certifikatë lindjeje ukrainase në të cilën aplikuesi i parë ishte regjistruar si babai i A-së dhe aplikuesja e dytë si nëna e tij, pra certifikata e lindjes nuk përmendte përdorimin e një nëne surrogate. Më 15 mars 2013, aplikuesit kërkuar nga ambasada belge në Kiev të lëshonte një pasaportë belge për A-në. Më 18 mars 2013, ambasada i informoi aplikuesit për refuzimin për të lëshuar një pasaportë, me arsyetimin se nuk ishin në gjendje të paraqisnin dokumente të caktuara që do të mundësonin konfirmimin e marrëdhënies familjare me fëmijën A, veçanërisht një certifikatë shtatzënie për aplikuesen e dytë e përpiluar nga mjeku i saj në Belgjikë dhe një certifikatë spitalizimi për aplikuesen e dytë në Ukrainë.

Më 19 mars 2013, aplikuesit, nëpërmjet avokatit të tyre, iu drejtuan Presidentit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Brukselit, që vepronte si gjyqtari për kërkesa urgjente, duke kërkuar që autoritetet belge të urdhëroheshin të lëshonin një dokument udhëtimi në mënyrë që fëmija A të hynte në territorin belg. Më 22 mars 2013, aplikuesit, sërisht nëpërmjet avokatit të tyre ngritën padi, në bazë të nenit 27 të Kodit të së Drejtës Private Ndërkombëtare për të siguruar

njohjen e vlefshmërisë së certifikatës së lindjes për fëmijën në Ukrainë. Në 5 prill 2013, Presidenti i Gjykatës së Shkallës së Parë në Bruksel e shpalli kërkesën urgjente, të pranueshme, por të pabazuar. Gjykatësi e pranoi natyrën urgjente dhe të përkohshme të kërkesës, por konstatoi se dosja e aplikuesve linte shumë pyetje pa përgjigje në lidhje me nënën surrogate dhe metodën e surrogacisë të përdorur. Aplikuesit nuk kishin paraqitur prova të mjaftueshme për të lejuar që gjykata të pranonte *prima facie* ekzistencën e një marrëdhënieje familjare midis tyre dhe fëmijës A. Sa i përket nënës, ligji belg e përcakton mëmësinë në bazë të lindjes, dhe aplikuesja e dytë për rrjedhojë nuk ishte në gjendje të provonte një marrëdhënie familjare me fëmijën. Sa i përket babait, nuk ishte dhënë informacion për metodën e surrogacisë së përdorur apo marrëveshjen për surrogaci, dhe rezultatet e testit të ADN-së të kryer nëpërmjet një faqeje interneti nuk kishin vlerë provuese

“sepse origjina e mostrave të analizuara nuk ishte e certifikuar”. Aplikuesit apeluan ndaj këtij vendimi. Më 8 prill 2013, aplikuesi i parë deklaroi para një noteri në Bruksel se e njihte A-në si djalin e tij. Më 25 prill 2013, kërkuar u detyruan të ktheheshin në Belgjikë pa A për shkak të skadimit të afërt të lejes së qëndrimit të tyre në Ukrainë. Ata punësuan një dado për t’u kujdesur për fëmijën në Ukrainë gjatë mungesës së tyre. Kërkuar udhëtuan drejt Ukrainës sa më shpesh të ishte e mundur, në veçanti midis 30 majit dhe 6 qershorit 2013, si dhe midis 11 dhe 18 korrikut 2013.

Më 31 korrik 2013, Gjykata e Apelit në Bruksel, duke vendosur mbi një kërkesë urgjente, konstatoi se kërkuar kishin mbledhur një sasi të konsiderueshme dokumentesh shtesë krahasuar me dosjen e paraqitur në shkallën e parë. Gjykata vuri në dukje se disa fakte dukeshin se konfirmonin statusin e kërkuar të parë si ati biologjik, dhe se në rastin konkret, njohja e lidhjes

atësore në dukje nuk përbënte ndonjë kërcënim serioz për rendin dhe sigurinë publike në Belgjikë. Gjykata e Apelit vlerësoi se ekzistonte një pamje e ligjshmërisë faktike dhe se balancimi i interesave në lojë kërkonte marrjen në konsideratë të së drejtës së kërkuesit të parë për një jetë familjare me fëmijën dhe të drejtës së këtij të fundit për t'u lidhur emocionalisht me kërkuesin e parë pa pritur përfundimin e procedurave në themel. Si rrjedhojë, Gjykata e Apelit e shpalli të mirëbazuar ankesën e paraqitur nga kërkuesit dhe urdhëroi shtetin belg të lëshonte për kërkuesin e parë një dokument udhëtimi (*laissez-passer*) ose çdo dokument tjetër administrativ të përshtatshëm që mbante emrin e fëmijës me qëllim që ky i fundit të mund të udhëtonte drejt Belgjikës së bashku me kërkuesin e parë. Kërkuesit udhëtuan drejt Ukrainës më 5 gusht 2013 për të marrë dokumentin e udhëtimit. Më 6 gusht 2013, A mbërriti në Belgjikë së bashku me kërkuesit. Që nga ajo datë, të tre kanë jetuar së bashku në Belgjikë.

Pretendimet e kërkuesve

Kërkuesit vlerësuan se ishte krijuar pa dyshim një jetë familjare që përfshinte lidhje të ngushta midis tyre dhe fëmijës. Ata konsideruan se refuzimi i autoriteteve belge për të lëshuar një dokument udhëtimi për fëmijën nuk kishte pasur asnjë bazë ligjore, nuk kishte ndjekur ndonjë qëllim legjitim dhe kishte përbërë një pengesë të pambështetur dhe të tepruar ndaj të drejtës së tyre për respektimin e jetës familjare. Kërkuesit theksuan se e drejta për të mbajtur marrëdhënien familjare midis prindërve dhe fëmijëve duhet të kishte përparësi ndaj interesave të Shtetit dhe se, në çdo rast, interesi më i mirë i fëmijës duhet të ishte konsiderata parësore. Në këtë kontekst, kërkuesit pretenduan se fusha e vlerësimit të shtetit duhej të ishte e kufizuar në këtë rast, pasi

ishte në diskutim një aspekt veçanërisht i rëndësishëm i ekzistencës ose identitetit të një individi.

Paraqitjet e Qeverisë

Në kundërshtim me pohimet e aplikuesve, certifikata e lindjes së A-së nuk kishte qenë e vlefshme *ipso jure* në Belgjikë, pasi nuk kishte një marrëveshje midis Belgjikës dhe Ukrainës për njohjen e ndërsjellë të akteve të huaja. Refuzimi i autoriteteve belge për të lëshuar një *laissez-passer* për fëmijën ishte legjitim, pasi ishte pasojë normale e zbatimit të neneve 27 dhe 62 të Kodit të së Drejtës Private Ndërkombëtare, dhe gjithashtu sepse aplikuesit kishin mundur të apelonin në gjykatë ndaj atij refuzimi.

Për më tepër, Qeveria vlerësoi se refuzimi nga gjyqtari i çështjeve urgjente për të urdhëruar lëshimin e një dokumenti udhëtimi kishte qenë tërësisht ose kryesisht i atribuueshëm vetë aplikuesve, pasi ata kishin dështuar të paraqisnin dokumente që provonin lidhjen biologjike familjare me fëmijën. Sapo aplikuesit kishin shtuar një certifikatë të lidhjes gjenetike në dosjen e tyre, gjykata e apelit kishte pranuar kërkesën e tyre.

Qeveria vuri gjithashtu në dukje se, para se të nisin projektin e tyre, aplikuesit kishin kontaktuar me autoritetet belge dhe ukrainase për të marrë informacion mbi legjislacionin e zbatueshëm në fushën e surrogacisë. Prandaj, ata kishin ose duhet të kishin njohuri për rregullat e zbatueshme dhe për dokumentacionin që duhej të paraqisnin para autoriteteve belge për të siguruar njohjen e marrëdhënieve familjare me fëmijën.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata vëren se kërkuesit dhe Qeveria bien dakord mbi faktin se situata në fjalë bën pjesë në fushën e zbatimit të nenit 8 të Konventës.

Kërkuesit ishin padyshim të ndarë nga fëmija i tyre, gjatë periudhës në fjalë. Megjithatë, Gjykata rikujton se një jetë familjare e synuar nuk bie plotësisht jashtë fushës së nenit 8. Në këtë drejtim, ajo ka mbajtur qëndrimin se neni 8 mund të shtrihet edhe në marrëdhënien e mundshme që mund të zhvillohet, për shembull, midis një babai natyror dhe një fëmije të lindur jashtë martese ose në marrëdhënien që rrjedh nga një martesë e ligjshme dhe e vërtetë, edhe nëse një jetë familjare ende nuk është themeluar plotësisht. Nuk kontestohet në këtë rast që kërkuesit kishin vullnet të sinqertë për t'u kujdesur për A-në si prindërit e tij që nga lindja dhe se ndërmorën veprime për të garantuar një jetë efektive familjare. Që nga mbërritja e A-së në Belgjikë, të tre kanë jetuar së bashku në një mënyrë të pandashme nga kuptimi i zakonshëm i "jetës familjare". Në vlerësimin e Gjykatës, këto konsiderata janë të mjaftueshme për të vendosur se neni 8 është i zbatueshëm në çështjen në fjalë.

Qeveria nuk e kontestoi faktin se refuzimi nga autoritetet belge për të lëshuar një dokument udhëtimi për A, që çoi në ndarjen efektive të aplikuesve prej tij, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e aplikuesve për respektimin e jetës së tyre familjare. Prandaj, i takon Gjykatës të përcaktojë nëse kjo ndërhyrje ishte "në përputhje me ligjin", nëse synonte një ose më shumë nga qëllimet legjitime të përcaktuara në nenin 8 të Konventës dhe nëse ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për t'i arritur ato. Gjykata vëren se refuzimi i ambasadës belge në Ukrainë për të lëshuar një pasaportë u bazua në nenin 7 të Ligjit të datës 14 gusht 1974 për lëshimin e pasaportave, i cili parashikonte se lëshimi i një pasaporte ose dokumenti tjetër në vend të saj mund të pezullohej për aq kohë sa ekzistonte ndonjë dyshim, në veçanti në lidhje me kombësinë e personit në fjalë. Ky dyshim rridhte nga fakti se marrëdhënia familjare midis

aplikuesve dhe A. nuk mund të vërtetohej mbi bazën e certifikatës së lindjes ukrainase, e cila nuk njihej ipso jure në përputhje me nenin 27 të Kodit të së Drejtës Private Ndërkombëtare. Prandaj, ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin në kuptimin e nenit 8 të Konventës.

Gjykata vëren se autoritetet belge fillimisht kishin refuzuar të autorizonin hyrjen e A.-së në territorin kombëtar për shkak të nevojës për të verifikuar nëse ishte respektuar legjislacioni belge dhe ai ukrainas. Ndërhyrja ishte e justifikuar nga qëllimet e parandalimit të veprave penale dhe në veçanti nga lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Gjykata më parë ka pranuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e luftës kundër këtij fenomeni. Për më tepër, Gjykata vlerëson se ndërhyrja ishte gjithashtu e motivuar nga qëllimi i mbrojtjes së të drejtave të personave të tjerë, në këtë rast të nënës surrogate dhe gjithashtu, në një farë mase, të fëmijës A. Gjykata vëren se aplikuesit kanë qenë të ndarë nga A nga data 25 prill 2013, kur ata u kthyen në Belgjikë, deri më 5 gusht 2013, kur ata shkuan për ta marrë A.-në në Ukrainë, pra për tre muaj e dymbëdhjetë ditë. Kjo periudhë ndarjeje ishte ndërprerë nga të paktën dy vizita njëjavore të aplikuesve në Ukrainë.

Lidhur me kërkesën urgjente, aplikuesit paraqitën kërkesën më 19 mars 2013, Presidenti i Gjykatës së Shkallës së Parë nxori vendimin më 5 prill 2013 dhe Gjykata e Apelit dha vendimin më 31 gusht 2013, katër muaj e dymbëdhjetë ditë pas fillimit të procedurës për masë urgjente. Duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se as procedura e kërkesës urgjente dhe as periudha e ndarjes efektive midis aplikuesve dhe A. nuk mund të konsiderohen si të pajustificueshëm apo të tejzgjatura në mënyrë të arsyeshme. Gjykata konsideron se Konventa nuk mund të kërkojë nga Shtetet Palë që të autorizojnë hyrjen në territorin e tyre të fëmijëve të lindur nga një nënë surrogate pa verifikime të mëparshme ligjore nga ana e autoriteteve kombëtare. Për më

tepër, Gjykata pajtohet me Qeverinë se kërkuesit mund të kishin parashikuar në mënyrë të arsyeshme nëse ishte e nevojshme, duke kërkuar këshillim juridik lidhur me procedurën që do ndiqnin për të siguruar njohjen e marrëdhënies familjare dhe për të garantuar që fëmija të mund të vinte në Belgjikë. Gjykata vëren në këtë kontekst se kërkuesit ishin këshilluar nga një avokat belg dhe një avokat ukrainas, të cilët i kishin konsultuar para se të fillonin projektin e tyre. Për më tepër, gjykatat belge tashmë kishin dhënë vendime për raste të ngjashme. Kërkuesit duhet gjithashtu ta kenë ditur se procedura për të kërkuar dokumentet e nevojshme për të marrë një dokument udhëtimi për A.-në dhe përpunimi i kërkesës përkatëse do të shkaktonte domosdoshmërisht një farë vonese. Gjykata gjithashtu vëren se Shteti belg nuk mund të mbahet përgjegjës për vështirësitë e kërkuesve në qëndrimin për një kohë më të gjatë në Ukrainë, apo gjatë gjithë periudhës gjatë së cilës procedura ishte në shqyrtim pranë gjykatave belge. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkuesit udhëtonin rregullisht për të kaluar kohë me fëmijën e tyre dhe se asnjë autoritet nuk ishte përpjekur t'ua pengonte këtë gjë.

Sa i përket argumentit të Qeverisë se zgjatja e procedurave i atribuohet vetë kërkuesve, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të përcaktojë nëse kërkuesit do ta kishin fituar realisht çështjen në shkallë të parë nëse do të kishin paraqitur një dosje më të plotë. Megjithatë, Gjykata vëren se Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë e kishte pranuar natyrën urgjente dhe të përkohshme të kërkesës, por kishte deklaruar se kishte mungesë provash për të vërtetuar në mënyrë të dukshme (prima facie) ekzistencën e një marrëdhënieje biologjike familjare midis kërkuesve dhe fëmijës A.

Prandaj, Gjykata pajtohet me pretendimin e Qeverisë se vonesa në marrjen e “laissez-passer-it” ishte të paktën pjesërisht për shkak të vetë kërkuesve.

Në përfundim, Gjykata vlerëson se Shteti belg ka vepruar brenda kufijve të fushës së vlerësimit që i takon në refuzimin – deri më 31 korrik 2013 – për të lejuar hyrjen e fëmijës, A në territorin belg. Si rrjedhojë, ankesa në bazë të nenit 8 është në mënyrë të qartë e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 paragrafët 3(a) dhe 4 të Konventës. Për këto arsye, Gjykata, unanimisht: *Deklaron pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme.*²²⁶

Çështja “Fjölnisdóttir and Others v. Iceland”

Faktet e çështjes

Një çift i martuar nga Islanda, znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir, kishin hyrë në një marrëveshje surrogacie me një grua në Kaliforni. Gametet e përdorura nuk ishin dhuruar nga asnjëra prej nënave të synuara, që do të thotë se çifti nuk kishte asnjë lidhje biologjike me fëmijën që lindi në Kaliforni në shkurt të vitit 2013 dhe që më pas u regjistrua si fëmijë i znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir sipas ligjit të Kalifornisë. Për shkak të lindjes së tij në Shtetet e Bashkuara, fëmija fitoi shtetësinë amerikane, dhe për pasojë pati mundësinë të hynte në Islandë së bashku me nënat e tij të synuara në bazë të pasaportës amerikane. Pas kthimit në Islandë, nënat e synuara aplikuan për transkriptimin e certifikatës së lindjes të fëmijës nga Kalifornia në regjistrat civil të Islandës, por kjo kërkesë u refuzua me arsyetimin se nëna surrogate konsiderohej si nëna ligjore e fëmijës sipas ligjit islandez.

Meqenëse fëmija u konsiderua si një i mitur i

²²⁶ European Court of Human Rights. (2022). D. and Others v. Belgium, no. 9245/21.

pashoqëruar sipas ligjit islandez, autoritetet islandeze emëruan një kujdestar ligjor të pavarur për fëmijën. Më pas, fëmijës iu dha shtetësia islandeze në vitin 2015, por autoritetet islandeze vazhduan të refuzonin njohjen e prindërimit ligjor të znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir, pavarësisht se ky prindërim ishte vendosur ligjërisht sipas ligjit të Kalifornisë. Çifti ngritën padi kundër refuzimit të autoriteteve islandeze për të njohur prindërinë e tyre ligjore. Padia e tyre u hodh poshtë përfundimisht nga Gjykata e Lartë e Islandës në vitin 2017, e cila vendosi se njohja e prindërimit ligjor të znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir ishte në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës islandeze (ordre public), veçanërisht ndalimin e brendshëm të surrogacisë dhe parimin *mater semper certa est*, që do të thotë se vetëm gruaja që lind fëmijën mund të njihet si nëna e tij ose saj ligjore në momentin e lindjes.

Në parim, znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir do të kishin pasur mundësi të vendosnin prindërinë e tyre ligjore ndaj fëmijës sipas ligjit islandez përmes birësimit. Megjithatë, për shkak të divorcit të tyre në vitin 2015, atyre nuk iu lejua birësimi i përbashkët, që do të thotë se vetëm njëra prej tyre mund të birësonte fëmijën sipas ligjit islandez (diçka që nuk u pranua nga asnjëra prej prindërve të synuar). Si pasojë, as znj. Fjölnisdóttir dhe as znj. Agnarsdóttir nuk u njohën si prindër ligjor të fëmijës sipas ligjit islandez në kohën e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut por fëmija ishte vendosur nën kujdesin e përhershëm të znj. Fjölnisdóttir (dhe bashkëshortes së saj të re) dhe gëzonte akses të barabartë tek znj. Agnarsdóttir.

Meqenëse znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir ende kërkonin njohjen e përbashkët si prindër ligjor të fëmijës sipas ligjit islandez, ato paraqitën një ankesë në GJEDNJ në emër të tyre dhe të fëmijës, duke argumentuar se

refuzimi i autoriteteve islandeze për të njohur prindërinë e tyre ligjore përbënte një shkelje të së drejtës së tyre dhe të fëmijës për respektimin e jetës familjare sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Në një hap të parë, GJEDNJ vlerësoi se refuzimi nga autoritetet islandeze për të njohur prindërinë ligjore të znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir përbënte një ndërhyrje në të drejtën e tyre dhe të fëmijës për respektimin e jetës familjare. Në veçanti Gjykata theksoi se jeta familjare në kuptimin e nenit 8 të KEDNJ-së parashikon “ekzistencën e lidhjeve të ngushta personale”, të cilat u konstatua se ekzistonin në këtë rast, pasi fëmija ishte kujdesur në mënyrë të pandërprerë nga znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir që nga lindja e tij në vitin 2013. Në një hap të dytë, GJEDNJ argumentoi se kjo ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës familjare të fëmijës dhe të znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir ishte e justifikuar. Ajo u pajtua me qeverinë islandeze se refuzimi i njohjes kishte një qëllim legjitim, pasi “ndalimi i surrogacisë shërbente për të mbrojtur interesat e grave që mund të ndiheshin të detyruara të hynin në marrëveshje surrogacie, si dhe të drejtat e fëmijëve për të njohur prindërit e tyre natyrorë”.

Gjykata argumentoi se ndërhyrja në të drejtën për respektimin e jetës familjare ishte proporcionale me këtë qëllim, pasi autoritetet islandeze kishin ndërmarrë hapa për të mbrojtur jetën familjare të fëmijës dhe të znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir, veçanërisht duke i dhënë fëmijës shtetësinë islandeze dhe duke vendosur një marrëveshje për kujdestari të përhershme që i mundësonte fëmijës të jetonte me znj. Fjölnisdóttir dhe të kishte akses të barabartë te znj. Agnarsdóttir.

GJEDNJ vlerësoi se këto masa mbrojtëse ishin të mjaftueshme për të “kompensuar” faktin që znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir nuk mund të fitonin prindëri të përbashkët ligjore të fëmijës sipas ligjit islandez, për shkak të mosnjohjes së certifikatës së lindjes nga Kalifornia nga autoritetet islandeze, dhe duke qenë se birësimi i përbashkët nuk ishte i mundur pas divorcit të tyre.

Në një obiter dictum (koment anësor), gjyqtari Paul Lemmens shprehu shqetësimin se refuzimi i njohjes së prindërisë ligjore të nënave të synuara mund të ishte në kundërshtim me të drejtën e fëmijës për respektimin e jetës së tij private, pasi fëmija mund të merrte njohje ligjore të marrëdhënies prind-fëmijë vetëm me njërën nga nënat e synuara, por jo me të dyja. Ai rikujtoi se GJEDNJ kishte pranuar më parë se e drejta për respektimin e jetës private përfshinte të drejtën e fëmijës për të pasur marrëdhënien e tij me prindërit e synuar të njohur ligjërisht, nëse të paktën njëri nga prindërit e synuar ishte prind biologjik i fëmijës. Ai argumentoi se kjo praktikë gjyqësore duhet të zbatohet edhe në rastet ku fëmija nuk ka lidhje biologjike me prindërit e synuar, pasi “birësimi nuk është gjithmonë një zgjidhje” (siç e tregon rasti Fjölnisdóttir), dhe për fëmijët ndikimi është i njëjtë, pavarësisht nëse njëri apo të dy prindërit e synuar kanë apo jo lidhje biologjike me ta. Në të dy rastet, ai shtronte pyetjen nëse “situata e paqartë ligjore në të cilën ndodhet fëmija mund të justifikohet mbi bazën e sjelljes së prindërve të synuar apo me referencë ndaj bindjeve morale që mbizotërojnë në shoqëri.”

Megjithatë, gjyqtari Lemmens u bashkua me vendimin unanim, pasi ankesa e paraqitur në emër të fëmijës nuk trajtonte shkeljen e të drejtës së tij për respektimin e jetës private, por vetëm

të drejtës për respektimin e jetës familjare. Në këtë drejtim, ai rikujtoi se e drejta për jetën familjare dhe ajo për jetën private kanë qëllime dhe fusha të ndryshme. Gjyqtari Lemmens ishte dakord me gjyqtarët e tjerë se gëzimi i jetës familjare nga fëmija me dy nënat e tij të synuara, e përcaktuar nga e drejta për jetën familjare, ishte mbrojtur në mënyrë të përshtatshme nga shteti islandez. Megjithatë, ai shprehu dyshime nëse e njëjta gjë mund të thuhet për të drejtën e fëmijës për të pasur marrëdhënien e tij prind-fëmijë të njohur ligjërisht, e cila mbrohet nga e drejta për respektimin e jetës private.²²⁷

Përparësia e interesave më të mira të fëmijëve të lindur nga surrogacia në jurisprudencën e GJEDNJ-së

GJEDNJ-ja ka dhënë një përgjigje të qartë për këtë çështje në vendimet Mennesson kundër Francës dhe Labassee kundër Francës (të cilat janë dy çështjet kryesore të saj mbi surrogacinë transnacionale): “[S]a herë që situata e një fëmije është në diskutim, interesat më të mira të atij fëmije janë prioritare”. Këto çështje kishin të bënin me dy çifte franceze që ishin shpallur prindërit ligjor të fëmijëve të lindur nga surrogacia përmes vendimeve gjyqësore në Kaliforni dhe Minnesota. Sperma ishte siguruar nga babai i synuar në secilin rast, që do të thotë se njëri nga prindërit e synuar kishte një lidhje biologjike me fëmijët (në kontrast me çështjen Fjölnisdóttir, ku asnjë nga nënat e synuara nuk kishte një lidhje biologjike me fëmijën). Pas një procesi të gjatë gjyqësor, Gjykata e Kasacionit franceze vendosi në vitet 2008 dhe 2011 që prindërimi ligjor i të dy prindërve të synuar (përfshirë babain gjenetik) nuk mund të transkriptohej në regjistrat civil francez (dhe për

²²⁷ European Court of Human Rights. (2021). Valdís Fjölnisdóttir and Others v. Iceland, no. 71552/17. .

rrjedhojë të njëjhej sipas së drejtës familjare franceze), pasi kjo do të ishte në kundërshtim me ndalimin e surrogacisë në Francë, që përbën pjesë të rendit publik francez (ordre public).

GJEDNJ-ja gjeti se një shtet ndjek një qëllim legjitim (në kuptimin e nenit 8 të KEDNJ-së) kur refuzon njohjen e prindërimit ligjor të prindërve të synuar në të drejtën vendase për të mbrojtur të drejtat e nënave surrogate (potenciale) dhe të fëmijëve të lindur nga surrogacia. Kufizimi i të drejtave të prindërve të synuar për respektimin e jetës së tyre private dhe familjare (neni 8 KEDNJ) përmes një politike të mosnjohjes së prindërimit të tyre ligjor është, në përgjithësi, proporcional me këtë qëllim. Megjithatë, për sa i përket të drejtave të fëmijëve sipas nenit 8 të KEDNJ-së, GJEDNJ e konsideron një politikë të mosnjohjes së prindërimit ligjor të prindërve të synuar si të papërpjesëtueshme me këtë qëllim nëse:

- fëmijëve u mohohet marrja e shtetësisë nga babai i tyre gjenetik;
- fëmijët nuk kanë asnjë mundësi për të pasur një marrëdhënie prind-fëmijë me prindërit e synuar, veçanërisht me babain gjenetik, të njohur ligjërisht në të drejtën vendase;
- fëmijët nuk kanë mundësi të konsiderohen si fëmijë të prindërve të synuar për qëllime të së drejtës së trashëgimisë.

Meqë jurisprudenca franceze e komplikonte marrjen e shtetësisë dhe nuk lejonte njohjen e prindërimit ligjor të prindërve të synuar, GJEDNJ e dënoi Francën për shkelje të të drejtave të fëmijëve sipas nenit 8 të KEDNJ-së në çështjet Mennesson dhe Labassee.

Rëndësia e lidhjes biologjike në jurisprudencën e GJEDNJ-së

Fakti që një nga prindërit e synuar ishte një prind

gjenetik i fëmijëve luajti një rol të madh në vendimet e GJEDNJ-së në çështjet Mennesson dhe Labassee. Në Opinionin Këshillimor të saj të datës 10 prill 2019, i cili sqaroi vendimet Mennesson dhe Labassee, GJEDNJ theksoi rëndësinë e

“lidhjes biologjike” të të paktën njërit nga prindërit e synuar me fëmijën në jurisprudencën e saj mbi prindërimin ligjor në rastet e surrogacisë. Ajo përsëriti se njohja ligjore e marrëdhënies prindfëmijë me një baba gjenetik të synuar sipas së drejtës vendase është me rëndësi të veçantë për të drejtat e fëmijës sipas nenit 8 të Koventës dhe duhet të jetë e mundur pa vonesa të panevojshme për të shmangur një gjendje të mungesës së prindërimit për fëmijën. Për më tepër, nëse fëmija ka një lidhje biologjike me të paktën një nga prindërit e synuar, njohja ligjore e marrëdhënies me prindin e dytë jo-gjenetik të synuar në të drejtën vendase duhet të jetë e mundur sapo lidhja me këtë prind jo-gjenetik të jetë bërë një “realitet praktik”. Sipas gjykatës, një mënyrë e zbatueshme për përmbushjen e këtyre kërkesave për të drejtat e fëmijës sipas nenit 8 është njohja automatike e prindërimit ligjor të babait gjenetik të synuar, siç është vendosur në të drejtën e huaj, dhe referimi i prindit jo-gjenetik për procedura birësimi.

Në përputhje me vendimet Mennesson dhe Labassee dhe Opinionin Këshillimor të vitit 2019, çështja Fjöltnisdóttir thekson se kërkesa për një lidhje biologjike midis prindërve të synuar dhe fëmijës është në qendër të jurisprudencës së GJEDNJ-së mbi surrogacinë. Për prindërit e synuar në çështjen Fjöltnisdóttir, të cilët nuk kishin asnjë lidhje biologjike me fëmijën, kjo do të thoshte se ato nuk mund të përfitonin nga jurisprudenca Mennesson dhe Labassee, e cila favorizonte familjet e ndërtuara përmes surrogacisë me lidhje gjenetike. Ato janë, megjithatë, në një pozitë më të pafavorshme jo vetëm në krahasim me një baba gjenetik të synuar që gëzon përparësinë e njohjes automatike të

prindërimit të tij ligjor në të drejtën vendase, por edhe në krahasim me një prind jogjenetik të synuar, bashkëshorti apo partneri i të cilit është babai gjenetik i fëmijës. Në këtë rast, fëmija ka të drejtë që marrëdhënia e tij me këtë prind jogjenetik të njihet ligjërisht, sapo ajo të jetë bërë një "realitet praktik" (p.sh., përmes procedurave të birësimit në moshë të hershme).

Në kontrast, GJEDNJ nuk e njohu një të drejtë të ngjashme të fëmijës në çështjen Fjöltnisdóttir, duke e lënë fëmijën pa asnjë mundësi për të pasur marrëdhënien e tij me të dy prindërit e synuar të njohur ligjërisht në të drejtën vendase, pavarësisht se kjo marrëdhënie ishte vendosur në mënyrë të ligjshme sipas ligjit të Kalifornisë.

Dallimet midis çështjes Fjöltnisdóttir dhe çështjes Paradiso dhe Campanelli

Në vendimin Fjöltnisdóttir, GJEDNJ-ja ka përmendur dhe dalluar vazhdimisht çështjen Paradiso dhe Campanelli, e cila ishte e vetmja çështje tjetër mbi surrogacinë transnacionale e trajtuar nga GJEDNJ deri më tani që kishte të bënte me një fëmijë pa lidhje biologjike me prindërit e synuar.

Çështja Paradiso dhe Campanelli kishte të bënte me një çift italian që kishte hyrë në një marrëveshje surrogacie me një kompani ruse. Fëmija ishte konceptuar përmes gametesh të dhuruara anonimisht (që nuk ndalohet dhe as nuk autorizohet shprehimisht nga ligji rus), dhe z. Paradiso dhe znj. Campanelli, të cilët ishin prindërit e synuar, u regjistruan si prindër në certifikatën e lindjes së fëmijës. Çifti e përdori këtë certifikatë për të marrë dokumente udhëtimi për fëmijën nga Konsullata Italiane në Moskë dhe u kthyen në Itali me fëmijën.

Autoritetet italiane, megjithatë, refuzuan transkriptimin e certifikatës së lindjes në regjistrat civil italian dhe më pas urdhëruan vendosjen e fëmijës në një institucion për fëmijë,

pasi çifti nuk kishte lidhje biologjike me fëmijën dhe pretendohet se kishin shkelur ligjet italiane mbi birësimin ndërkombëtar. Çifti paraqiti ankesë në GJEDNJ si në emër të tyre, ashtu edhe në emër të fëmijës, por kjo e fundit u shpall e papranueshme për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv të çiftit në emër të fëmijës (i cili, në kohën e paraqitjes së ankesës, nuk kishte jetuar me çiftin për 6 muajt e fundit). Megjithatë, Seksioni i Dytë i GJEDNJ-së e dënoi Italinë për shkelje të së drejtës së çiftit për respektimin e jetës private dhe familjare. Dhoma gjykuese vlerësoi se vendimi për të refuzuar njohjen e prindërimit ligjor të çiftit për shkak të mungesës së lidhjes biologjike ishte proporcional me qëllimin e autoriteteve italiane për të trajtuar sjelljen (sipas tyre) të paligjshme të çiftit. Megjithatë, ajo vendosi se vendimi për vendosjen e fëmijës në kujdes shtetëror shkelte të drejtën e çiftit për respektimin e jetës familjare, pasi nuk ishte marrë parasysh në mënyrë adekuate interesi më i mirë i fëmijës, për të cilin çifti kishte treguar kujdes të mirë.

Ky vendim u përmbys më pas nga Dhoma e Madhe. Dhoma e Madhe arriti në përfundimin se kufizimi i të drejtës së çiftit për respektimin e jetës private dhe familjare përmes vendosjes së fëmijës në institucion ishte proporcional me qëllimin e autoriteteve italiane për të adresuar sjelljen (sipas tyre) të paligjshme të çiftit, dhe se interesat më të mira të fëmijës ishin vlerësuar në mënyrë adekuate nga autoritetet italiane.

Në vendimin Fjöltnisdóttir, GJEDNJ-ja tregoi se rasti Paradiso dhe Campanelli ishte një përjashtim. Në kontrast me çiftin Paradiso/Campanelli, çifti Fjöltnisdóttir/Agnarsdóttir ishin njohur pa asnjë dyshim si prindërit ligjor të fëmijës sipas ligjit të Kalifornisë, dhe fëmija kishte hyrë ligjërisht në Islandë me pasaportën e tij amerikane. Më e rëndësishmja, fëmija ishte palë në çështjen Fjöltnisdóttir (në kontrast me çështjen Paradiso

dhe Campanelli).

Këto dallime faktike patën ndikim të madh në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Fjölnisdóttir. Në fakt gjykata argumentoi se refuzimi i njohjes së prindërimit ligjor të prindërve të synuar jogjenetik nga autoritetet islandeze është i pajtueshëm me të drejtat e fëmijës sipas nenit 8 të Koventës së vetëm për shkak se autoritetet islandeze kishin marrë masa për të mbrojtur jetën familjare që fëmija kishte me znj. Fjölnisdóttir dhe znj. Agnarsdóttir.

Në veçanti, GJEDNJ-ja iu referua marrëveshjes për kujdestari të përhershme me znj. Fjölnisdóttir (e cila i siguronte fëmijës qasje të barabartë të znj. Agnarsdóttir), si dhe dhënies së shtetësisë islandeze fëmijës. Për më tepër gjykata vuri në dukje se fëmija ka mundësinë që lidhja e tij me të paktën një nga prindërit e synuar të njihet ligjërisht përmes procedurës së birësimit.²²⁸

Përfundime

Punimi në përfundim të tij, mbron hipotezën "Procedura e birësimit është më efikase sesa procedura e njohjes së certifikatave të lindjes për të garantuar të drejtat e palëve të përfshira në një marrëveshje surrogacie ndërshtetërore", kjo bazuar në këto argumenta:

- Duke qënë se nuk ekziston një standart lidhur me njohjen e të drejtave prindërore, brenda Bashkimit Europian, ngelet në vlerësimin e shteteve për të pranuar ose jo njohjen e certifikatave të lindjes së fëmijëve të lindur nga surrogacia.
- Në dallim nga njohja e certifikatave të lindjes për fëmijët e lindur nga surrogacia, birësimi i tyre bazohet në akte të tilla

ndërkombëtare si Koventa për Birësimin, çka privon fenomenin e pashtetësisë.

- Shtetet Anëtare e cilësojnë si të justifikuar refuzimin për të njohur një certifikatë lindjeje të hartuar në zbatim të një vendimi të një gjykate të huaj nëse ky vendim bie ndesh me parimet themelore të rendit juridik të atij shteti.
- Shteti nuk është i detyruar të njohi një vendim të gjykatës së huaj nëse nuk ekziston një marrëveshje ndërkombëtare. Që një vendim i tillë të njihet varet nga tre kushte: juridiksioni i tërthortë i gjykatës së huaj në bazë të lidhjes ndërmjet gjykatës dhe çështjes; pajtueshmëria e përmbajtjes dhe procedurës me rendin publik ndërkombëtar; dhe mungesa e shmangies së ligjit.
- Shtetet argumentojnë se pamundësia për të regjistruar certifikatat e lindjes në regjistrat civil të tyre nuk cënon jetën familjare pasi nuk privon prindërit e synuar që të qëndrojnë në atë shtet bashkë me fëmijën/ët e tyre.

Pavarësisht faktit që procedurat e birësimit përbëjnë garancinë më efikase për të mbrojtur të drejtat e palëve të përfshira në një marrëveshje ndërshtetërore surrogacie kjo procedurë nuk i përgjigjet kuptimit të surrogacisë. Në dallim nga birësimi fëmija në bazë të rastit mund të gëzojë lidhje gjenetike me të dy prindërit e synuar. Prindërit e synuar dëshirojnë lindjen e një fëmije i cili do të njihet automatikisht si fëmija i tyre dhe si i birësuar, dëshirë realizimi i së cilës është shoqëruar me kosto të larta financiare.

²²⁸ März, J. W. (2021). What makes a parent in surrogacy cases? Reflections on the Fjölnisdóttir et al. v. Iceland

decision of the European Court of Human Rights. Medical Law International, 21(3), 272-285.

Ekstradimi dhe llojet e tij

Lidia Agalliu

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”
Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: PhD. Ilir Kanaj
Fakulteti i Shkencave Humane
Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Ekstradimi është një proces ligjor ndërkombëtar që lejon një shtet të kërkojë dorëzimin e një personi të akuzuar ose të dënuar për një krim nga një shtet tjetër, në përputhje me marrëveshjet bilaterale ose shumëpalëshe. Ky proces është thelbësor për mbrojtjen e rendit të shtetit dhe zbatimin e drejtësisë penale ndërkombëtare. Ekstradimi ka disa lloje, të cilat përfshijnë ekstradimin bilateral, shumëpalësh, për shkelje të ligjit të brendshëm dhe për krime politike. Çdo lloj ekstradimi ka procedura dhe kushte të veçanta që kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar, mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe respektim të parimeve të ligjit. Ky proces mund të hasë në çështje të sigurisë kombëtare, diskriminim politik, dhe mbrojtjen e të drejtave

të individëve të ekstraduar. Artikujt ndërkombëtarë, si traktatet dhe marrëveshjet e ekstradimit, luajnë një rol të rëndësishëm në realizimin e këtyre proceseve. Ekstradimi mund të kërkojë një balancë të kujdesshme midis forcës ligjore dhe mbrojtjes së të drejtave individuale, si dhe mund të përfshijë vlerësime të kujdesshme për rastet që mund të lidhen me mundësinë e torturës, dënimeve të pandershme ose gjykimeve të padrejta. Gjithashtu, zbatimi i ekstradimit është një proces i ndërlikuar që përfshin standarde të ndryshme ligjore dhe politike, dhe kërkon bashkëpunim të ngushtë mes shteteve për të siguruar një zbatim të drejtë dhe të barabartë të ligjit në nivel ndërkombëtar.

Ekstradimi është një mekanizëm jetik për

sigurinë dhe rendin ndërkombëtar, i cili mundëson ndjekjen e drejtësisë për ata që janë akuzuar ose dënuar për krime të rënda. Ai shtrihet përtej kufijve shtetërorë dhe përfshin një gamë të gjerë procedurash ligjore, të cilat ndryshojnë në varësi të marrëveshjeve mes shtetesh dhe kushteve të ligjit ndërkombëtar. Në disa raste, ekstradimi mund të refuzohet për arsye të sigurisë kombëtare, të drejtave të njeriut, ose të natyrës politike të krimit, duke e bërë atë një proces që kërkon një vlerësim të kujdesshëm dhe të balancuar të të drejtave të individëve dhe nevojës për drejtësi. Këto aspekte kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm midis shteteve, të mbështetur nga traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare, për të siguruar që procesi i ekstradimit të zbatohet në mënyrë të drejtë dhe të ndershme.

Fjalët kyçe: Ekstradimi, llojet e ekstradimit, ekstradimi bilateral, ekstradimi shumëpalësh, krime politike, kërkesa për ekstradim, marrëveshje ndërkombëtare, drejtësia penale ndërkombëtare, mbrojtja e të drejtave të njeriut, procedura e ekstradimit.

Abstract

Extradition is an international legal process that allows one state to request the surrender of a person accused or convicted of a crime by another state, in accordance with bilateral or multilateral agreements. This process is essential for the protection of state order and the enforcement of international criminal justice. Extradition has several types, including bilateral, multilateral, violations of domestic law, and political crimes. Each type of extradition has its own procedures and requirements, necessitating international

cooperation, protection of human rights, and adherence to the principles of law. This process may encounter issues related to national security, political discrimination, and the protection of the rights of extradited individuals. International articles, such as treaties and extradition agreements, play an important role in carrying out these processes. Extradition requires a careful balance between legal enforcement and the protection of individual rights, and it may involve careful assessments of cases that may involve the possibility of torture, unfair penalties, or unjust trials. Moreover, the implementation of extradition is a complex process that involves varying legal and political standards and requires close cooperation between states to ensure fair and equal application of the law at an international level.

Extradition is a vital mechanism for international security and order, enabling the pursuit of justice for those accused or convicted of serious crimes. It transcends state borders and involves a wide range of legal procedures, which vary depending on agreements between states and international legal conditions. In some cases, extradition may be refused on grounds of national security, human rights, or the political nature of the crime, making it a process that requires a careful and balanced assessment of individual rights and the need for justice. These aspects require ongoing close cooperation between states, supported by treaties and international agreements, to ensure that the extradition process is implemented fairly and justly.

Keywords: Extradition, types of extradition, bilateral extradition, multilateral extradition, political crimes, extradition request, international agreements, international criminal justice, human rights protection, extradition procedure

Çështje dhe ndërlidhje të ekstradimit

Çështjet dhe ndërlidhjet e ekstradimit janë të shumta dhe përfshijnë aspekte juridike, politike dhe të drejta të njeriut, të cilat kërkojnë një balancë të kujdesshme mes nevojës për drejtësi dhe mbrojtjes së të drejtave individuale. Ekstradimi është një proces kompleks që shpesh shkakton çështje dhe konflikte mes shtetesh, për shkak të natyrës ndërkombëtare të tij dhe variacioneve në legjislacionet e shteteve të ndryshme. Këtu janë disa çështje dhe ndërlidhje kryesore që lidhen me ekstradimin, të cilat ndikojnë në realizimin e tij në praktikë:

1. *Çështja e politizimit të krimeve*: Një nga çështjet më të rëndësishme që lidhen me ekstradimin është mundësia që një krim të klasifikohet si një "krim politik", që shpesh mund të çojë në refuzimin e ekstradimit. Shtetet mund të refuzojnë ekstradimin e individëve për krime politike, për shkak të rrezikut që ata të ndodhen përballë ndëshkimeve të padrejta ose ndjekjeve të motivuara nga arsye politike. Ky parim është mbrojtur në shumë traktate ndërkombëtare dhe është një çështje thelbësore për mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të drejtave civile. Siç theksohet nga Bassiouni (2007), "Ekstradimi i individëve të akuzuar për krime politike shpesh shkakton tensione dhe është një prej arsyeve të mundshme për refuzimin e ekstradimit, si dhe një çështje e diskutueshme në marrëveshjet ndërkombëtare."²²⁹

2. *Çështjet e të drejtave të njeriut*: Ekstradimi mund të përfshijë çështje të drejta të njeriut, sidomos në rastet kur individit mund të përballë me tortura, trajtim të keq ose ndëshkime të padrejta në shtetin kërkues. Sipas konventave ndërkombëtare, si Konventa

Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (1966) dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit të Keq ose Dënimeve të Padrrejtë (1984), ekstradimi mund të ndalohe nëse ekziston rreziku që individit të përballë me tortura ose trajtime të tjera çnjerëzore ose poshtërues. Ky aspekt ka ndikuar në praktikën e ekstradimit, duke u kërkuar shteteve të sigurojnë që të drejtat e individëve të mbrohen dhe të respektohen, siç është theksuar nga raportet e Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara (1994).

3. *Çështja e dyshes së mundësisë së veprës penale (principi i dyfishtë)*: Ky parim është një nga rregullat thelbësore të ekstradimit, sipas të cilit një person mund të ekstradohet vetëm nëse veprimi i tij është gjithashtu një vepër penale në të dy shtetet: shtetin kërkues dhe shtetin që ka personin e kërkuar. Ky parim ka për qëllim të sigurojë që individët nuk do të ekstradohen për akuzat që nuk janë të njohura si krime në shtetin ku ata ndodhen, dhe është një nga kriteret kryesore që autoritetet gjyqësore marrin parasysh gjatë procesit të ekstradimit. Sipas Bassiouni (2007), "principi i dyfishtë është një nga kërkesat themelore në procesin e ekstradimit, i cili siguron se individit nuk do të ekstradohet për krime që nuk janë të ndaluara në shtetin ku ai ndodhet."²³⁰

4. *Çështja e mundësisë së refuzimit të ekstradimit për shkak të sigurisë kombëtare*: Ekstradimi mund të refuzohet nëse është i rrezikshëm për sigurinë kombëtare të shtetit që ka individin. Ky është një çështje e zakonshme në raste ku personi i kërkuar është një figurë kyçe në një çështje politike ose një individ me ndikim të lartë që mund të përbëjë një kërcënim për rendin dhe stabilitetin e shtetit. Ky parim është shpesh në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare që lejojnë refuzimin e ekstradimit për arsye të

²²⁹ M. Cherif Bassiouni, "International Extradition: United States Law and Practice," 2007.

²³⁰ M. Cherif Bassiouni, "International Extradition: United States Law and Practice," 2007.

sigurisë kombëtare. Sipas një raporti të Komitetit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara (1994), "çështja e sigurisë kombëtare është një nga arsye të mundshme që shtetet mund të përdorin për të refuzuar kërkesat për ekstradim.²³¹"

5. *Çështjet e procedurës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar:* Ekstradimi kërkon një bashkëpunim të ngushtë dhe të strukturuar ndërmjet shteteve, dhe gjithashtu përfshin përpunjen me traktate ndërkombëtare që mund të ndihmojnë në harmonizimin e procedurave të ekstradimit. Shtetet mund të kenë ndryshime të rëndësishme në ligjet dhe procedurat e ekstradimit, që mund të bëjnë procesin më të ngadalshëm dhe të ndërlikuar. Për më tepër, ndihma juridike e ofruar nga organizatat ndërkombëtare, si Interpol, është një faktor i rëndësishëm për të siguruar zbatimin e suksesshëm të ekstradimeve ndërkombëtare.

Çështje të ndjeshmërisë politike

Çështjet e ndjeshmërisë politike janë ndër aspektet më të ndërlikuara të ekstradimit, pasi ato lidhin ndërhyrjen e shtetit në procesin juridik të ekstradimit me konsideratat për sigurinë politike dhe interesat kombëtare. Kjo çështje lidhet me mundësinë që një shtet të refuzojë ekstradimin e individëve për arsye që kanë të bëjnë me natyrën politike të krimin të kryer, duke përfshirë krimet që mund të jenë të lidhura me veprimtari të ligjshme politike, siç janë protestat, shprehjet e kundërshtimit apo veprimet që mund të jenë cilësuar si kundër shtetit nga autoritetet.

Një nga parimet kryesore që ndërlidhen me këtë çështje është parimi i "krimeve politike", i cili shpesh shërben si një arsye për të

refuzuar ekstradimin. Siç është theksuar nga Kelsen (1949), "nuk duhet të kërkohej ekstradimi për individët që akuzohen për krime politike, sepse ndjekja penale për shkaqe politike shkel parimet e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut." Ky parim ka një rëndësi të veçantë në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe është thelbësor për mbrojtjen e lirisë politike dhe të drejtave civile, pasi siguron që individët të mos ndodhen përballë ndjekjeve të motivuara politikisht, të cilat mund të kërcënojnë jetën e tyre dhe të drejtat e tyre themelore.

Ndërsa traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare shpesh përfshijnë klauzola për ndalimin e ekstradimit të individëve të akuzuar për krime politike, kjo mund të nënkuptojë se shtetet mund të refuzojnë ekstradimin nëse ata besojnë se kërkesa e ekstradimit ka motivime politike, pavarësisht natyrës kriminale të akuzave. Për shembull, në rastin e *United States v. Espinoza* (1997), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi që, në rastet kur krimi është i lidhur me një veprimtari politike, shteti kërkuar mund të kundërshtojë ekstradimin për të shmangur rrezikun që individit të përballet me ndjekje për arsye politike.

Për më tepër, mundësia e ndjeshmërisë politike shpesh shkakton tensione mes shteteve, sidomos në rastet kur një individ është i akuzuar për veprime që mund të jenë cilësuar si të paligjshme nga një shtet dhe si të ligjshme nga një tjetër, veçanërisht kur krimi është i lidhur me aktivitete si kundërshtimi i qeverisë, fushatat politike ose veprimet për lirinë e shprehjes. Sipas dokumenteve të Komitetit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut (2012), "refuzimi i ekstradimit për krime politike është një mjet për të mbrojtur individët nga ndjekjet e padrejta dhe abuzimet nga regjime autoritare."²³²

²³¹ United Nations Human Rights Committee, *Report on State Security and Extradition Refusals*, 1994.

²³² United Nations Human Rights Committee, *General Comment No. 34 on Freedoms of Opinion and Expression*, 2012.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të vlerësohet nëse kërkesa e ekstradimit është motivuar nga arsye politike dhe të sigurohet që individët të mos kalojnë përmes një procesi të padrejtë dhe të motivuar politikisht, i cili mund të shkelë të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile të individëve të ekstraduar. Siç konfirmohet në praktikën ndërkombëtare, ndjeshmëria politike është një çështje që ndikon në mënyrën se si shtetet mund të bashkëpunojnë dhe të sigurojnë një proces të drejtë ekstradimi.

Çështje të sigurisë kombëtare

Çështjet e sigurisë kombëtare janë një tjetër element i rëndësishëm në procesin e ekstradimit dhe shpesh shërbejnë si një arsye për refuzimin e kërkesave për ekstradim. Shtetet mund të përdorin sigurinë kombëtare si një justifikim për të refuzuar ekstradimin e individëve, duke argumentuar se dorëzimi i personit të kërkuar mund të dëmtojë interesat e sigurisë së shtetit, përfshirë rrezikun e zbërthimit të informacionit të ndjeshëm, kërcënimet ndaj infrastrukturës shtetërore, ose ndikimet në stabilitetin politik dhe social.

Sipas parimit të sigurisë kombëtare, një shtet mund të vendosë të refuzojë ekstradimin nëse ka arsye të arsyeshme për të besuar se individi i kërkuar mund të përballë me dënime ose trajtime që mund të ndikojnë në sigurinë kombëtare të shtetit. Ky parim ka një rëndësi të veçantë për shtetet që janë në luftë, në periudha të pasigurisë politike ose kur ekzistojnë tensione të brendshme të lidhura me sigurinë kombëtare²³³.

Një shembull i rëndësishëm është rasti i *United States v. Noriega* (1990), ku Shtetet e Bashkuara kërkuan ekstradimin e Manuel

Noriega nga Panamaja për akuza të drogës dhe pastrim parash. Gjatë procedurës, Panamaja përdori çështjet e sigurisë kombëtare si një arsye për të refuzuar ekstradimin, duke argumentuar se dorëzimi i Noriegas do të kishte pasoja negative për stabilitetin e qeverisë panamaneze. Megjithatë, Gjykata e Shtetit të Bashkuar miratoi ekstradimin pas një procesi gjyqësor të gjatë, duke argumentuar se nuk kishte rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare të Panamasë.

Për më tepër, koncepti i sigurisë kombëtare si arsye për refuzimin e ekstradimit është shpesh i lidhur me shqetësime për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar ose të ndjeshëm. Në raste të tilla, shtetet mund të argumentojnë se ekstradimi do të rrezikonte zbulimin e informacionit të klasifikuar ose do të ekspozonte shtetin ndaj rreziqeve të jashtme. Për shembull, Shtetet e Bashkuara janë përpjekur të mbrojnë informacionin e klasifikuar nga mundësia e përdorimit të tij për qëllime të huaja, duke përfshirë rastet që lidhen me spiunazhin²³⁴.

Nga ana tjetër, proceset e ekstradimit mund të përballen gjithashtu me çështje që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe sigurinë kombëtare. Shumë shtete kanë krijuar një ndarje të qartë mes krimeve të zakonshme dhe atyre të lidhura me terrorizmin, duke argumentuar se këto të fundit mund të kenë pasoja më të rënda për sigurinë kombëtare dhe stabilitetin global. Sipas Komitetit të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara për Luftën kundër Terrorizmit (2008), "ekstradimi i individëve të lidhur me aktivitete terroriste është një sfidë për shtetet, pasi mund të krijohet një kërcënim për sigurinë e tyre dhe të

²³³ United Nations Office on Drugs and Crime, *Manual on International Cooperation in Criminal Matters*, 2009.

²³⁴ *United States v. Noriega*, 746 F. Supp. 1506 (S.D. Fla. 1990); United Nations Office on Drugs and Crime, *Manual on International Cooperation in Criminal Matters*, 2009.

rajonit.²³⁵ Kjo ka bërë që shumë shtete të ndryshojnë politikat e tyre të ekstradimit në rastet e terrorizmit, duke u munduar të ruajnë ekuilibrin ndërmjet nevojës për drejtësi dhe nevojës për siguri kombëtare.

Për më tepër, praktikat ndërkombëtare janë të ndryshme përsa i përket kërkesës për ekstradimin e individëve të akuzuar për krime që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare. Traktatet ndërkombëtare shpesh përfshijnë klauzola të veçanta që mund të lejojnë shtetet të refuzojnë ekstradimin për arsye të sigurisë kombëtare, duke përfshirë ato që lidhen me spiunazhin, terrorizmin, dhe aktivitetet që mund të dëmtojnë interesat shtetërore.

Në këtë kontekst, përfundimi është se çështjet e sigurisë kombëtare luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrjen për ekstradimin, duke kërkuar një balancë të kujdesshme mes nevojës për të mbajtur stabilitetin politik dhe sigurinë kombëtare dhe nevojës për drejtësi dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Mbështetja ndërkombëtare dhe traktatet e ekstradimit

Mbështetja ndërkombëtare dhe traktatet e ekstradimit janë elementë kyç për funksionimin e procedurave të ekstradimit dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm ndërkombëtar të drejtësisë penale. Traktatet ndërkombëtare luajnë një rol thelbësor në rregullimin e ekstradimit, duke përcaktuar parimet dhe kushtet që duhen ndjekur nga shtetet kur kërkohet dorëzimi i individëve të akuzuar për krime të ndryshme. Këto marrëveshje lejojnë që shtetet të bashkëpunojnë për të siguruar që

kriminelët të përballen me drejtësinë, pavarësisht kufijve shtetërorë.

Traktatet e ekstradimit mund të jenë bilaterale, midis dy shteteve, ose shumëpalëshe, përfshirë disa shtete që bien dakord për rregulla të përbashkëta. Ato ndihmojnë për të standardizuar procedurat e ekstradimit dhe për të siguruar një proces të drejtpërdrejtë dhe të drejtoruar sipas ligjit ndërkombëtar²³⁶.

Një shembull i njohur i traktatit shumëpalësh është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, e cila është miratuar në vitin 2000. Kjo konventë ofron një kornizë të rëndësishme për bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër krimeve të rënda si trafikimi i drogës, krimi i organizuar, dhe korrupsioni. Ajo gjithashtu përfshin dispozita që mundësojnë ekstradimin e individëve që janë akuzuar ose dënuar për krime që lidhen me këto aktivitete.

Një tjetër marrëveshje ndërkombëtare e rëndësishme është Konventa Europiane për Ekstradimin e vitit 1957, e cila përcakton procedurat dhe kushtet për ekstradimin e individëve brenda shteteve anëtare të Këshillit të Europës. Ky traktat ofron një kornizë të qartë ligjore dhe mbështetje për vendet europiane për të trajtuar kërkesat për ekstradim, duke lejuar bashkëpunimin mes shteteve që kanë angazhime të përbashkëta për të luftuar krimin ndërkombëtar.

Po ashtu, ekzistojnë traktate dypalëshe të ekstradimit, si marrëveshjet mes Shteteve të Bashkuara dhe shteteve të tjera për krime të caktuara, përfshirë ato që lidhen me krimin e organizuar, pastrimin e parave, dhe krimet e korrupsionit. Shtetet e Bashkuara, për shembull, kanë nënshkruar marrëveshje ekstradimi me mbi 100 shtete të ndryshme, dhe këto marrëveshje

²³⁵ United Nations Security Council Resolution 1269 (1999) kërkon bashkëpunim ndërkombëtar për ndjekjen penale ose ekstradimin e personave që mbështesin akte terroriste; Security Council Resolution 1373 (2001)

²³⁶ Bassiouni, M.C., "International Extradition: United States Law and Practice," 2007 – mbi rëndësinë e traktateve për harmonizimin e ekstradimit ndërmjet shteteve.

specifikojnë llojin e krimeve për të cilat kërkohet ekstradimi, si dhe procedurat për t'u ndjekur.

Sipas Ginsburg (2015), "traktatet e ekstradimit janë themeli i bashkëpunimit ndërkombëtar për zbatimin e ligjit, duke ofruar një kornizë ligjore që siguron një proces të parashikueshëm dhe të drejtë për kërkesat e ekstradimit."

Përveç kësaj, traktatet ndërkombëtare kanë rëndësi edhe për shkak të integritetit të normave të të drejtave të njeriut në proceset e ekstradimit. Pjesëmarrësit në këto marrëveshje janë të angazhuar të respektojnë të drejtat themelore të individëve, duke përfshirë mos lejen e ekstradimit në rastet kur ka rrezik të mundshëm për torturë, trajtim të keq ose gjykim të padrejtë. Ky është një parim i njohur ndërkombëtarisht, i njohur si parimi i *non-refoulement*, i cili është i përfshirë në traktate të tilla si Konventa e Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve (1951) dhe konventa të tjera të të drejtave të njeriut²³⁷.

Mbështetja ndërkombëtare dhe traktatet e ekstradimit janë thelbësore për sigurimin e një sistemi të drejtësisë penale ndërkombëtare që është i efektshëm dhe i respektueshëm ndaj të drejtave të njeriut. Ato krijojnë mundësi për ndjekjen e drejtësisë për individët që janë të akuzuar për krime të rënda dhe për ndihmën në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve ndërkombëtare.

Përfshirja nga ekstradimi

Përfshirja nga ekstradimi janë një pjesë thelbësore e procesit të ekstradimit, pasi ato ndihmojnë në balancimin e nevojës për ndjekjen

e drejtësisë me mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe sigurinë kombëtare. Shtetet mund të vendosin përfshirje të caktuara nga ekstradimi në raste të veçanta, të cilat janë të përfshira në traktatet ndërkombëtare dhe legjislacionet kombëtare. Këto përfshirje janë të rëndësishme për të siguruar që procesi i ekstradimit të zbatohet në përputhje me parimet e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Një nga përfshirjet më të njohura është parimi i *non-refoulement* (moskthimi), i cili ndalon ekstradimin e individëve në shtete ku ata mund të përballen me torturë, trajtim të keq, ose ndëshkim të padrejtë. Ky parim është i njohur ndërkombëtarisht dhe është përfshirë në traktate të rëndësishme, si Konventa e Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve (1951) dhe Konventa kundër Torturës (1984). Sipas këtyre traktateve, një individ nuk mund të ekstradohet në një shtet ku ai ka arsye të arsyeshme për të besuar se mund të përballlet me trajtim të keq ose torturë²³⁸.

Një përfshirje tjetër është *krimi politik*, i cili zakonisht përjashtohet nga ekstradimi. Shtetet kanë tendencë të mos e pranojnë ekstradimin e individëve që janë të akuzuar për krime politike, të cilat mund të përfshijnë aktivitetet kundër qeverisë së një shteti, protestat dhe përpjekjet për ndryshime të regjimeve. Traktatet ndërkombëtare shpesh përfshijnë klauzola që e bëjnë të mundur refuzimin e ekstradimit për ata që janë akuzuar për krime politike, duke i lënë shtetit kërkues mundësinë për të ndjekur individin brenda kufijve të tij të ligjshëm.

Përfshirjet mund të përfshijnë gjithashtu *moskryerjen e veprës penale* në një shtet tjetër. Parimi i dyshes së mundësisë së veprës penale (principi i dyfishtë), që kërkon që veprimi për të cilin kërkohet ekstradimi të jetë një krim si në

²³⁷ Ginsburg, F., "International Cooperation in Extradition: Ensuring Due Process and Human Rights," 2015.

²³⁸ United Nations, *Convention Relating to the Status of Refugees* (1951), Article 33; United Nations, *Convention against Torture* (1984), Article 3.

shtetin kërkues ashtu edhe në shtetin kërkuar, është një nga përjashtimet më të rëndësishme në procesin e ekstradimit. Ky parim ka për qëllim të sigurojë që individët të mos ndëshkohen për veprime që nuk janë të ndaluara në të dyja shtetet.

Një përjashtim tjetër mund të jetë *vjetërsimi i krimit*, ku ekstradimi nuk mund të kërkohet për individë që janë akuzuar për krime që janë të vjetruara, sipas ligjit të shtetit kërkues. Kjo është një masë për të parandaluar ndjekjen e individëve për krime që kanë ndodhur shumë kohë më parë dhe që nuk janë të ndaluara më nga ligji.

Përveç këtyre, *kushte të tjera të sigurisë kombëtare dhe interesat e sigurisë shtetërore* mund të shërbejnë si përjashtime për ekstradimin, siç janë rastet ku një individ mund të përballet me një kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare të shtetit kërkues ose mund të vënë në rrezik stabilitetin e tij politik. Këto përjashtime janë shpesh të përcaktuara në traktatet bilaterale dhe shumëpalëshe dhe kërkojnë vlerësim të kujdesshëm për të mbrojtur interesat kombëtare dhe sigurinë.

Sipas Bassiouni (2007), "përjashtimet nga ekstradimi janë të nevojshme për të siguruar që procesi i ekstradimit të mos shkelë të drejtat e njeriut dhe për të ruajtur sovranitetin dhe sigurinë kombëtare të shtetit kërkues."

Në përmbledhje, përjashtimet nga ekstradimi janë një pjesë e rëndësishme e balancimit të nevojës për drejtësi me mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe sigurinë kombëtare. Ato sigurojnë që proceset e ekstradimit të jenë të drejta dhe të përputhshme me normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sigurisë kombëtare.

Konkluzione

Ekstradimi përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm juridik në nivel ndërkombëtar, i cili mundëson dorëzimin e individëve të dyshuar ose të dënuar për vepra penale të rënda nga një shtet tek një tjetër. Ky proces realizohet në bazë të legjislacionit të brendshëm, marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe dhe parimeve themelore të së drejtës ndërkombëtare si reciprociteti, ndalimi i kthimit në vende ku individit rrezikon torturë apo trajtim çnjerëzor (non-refoulement), si dhe garantimi i barazisë dhe drejtësisë procedurale. Ekstradimi luan një rol thelbësor në luftën kundër krimit ndërkombëtar, parandalimin e pandëshkueshmërisë dhe forcimin e bashkëpunimit juridik midis shteteve, duke siguruar që askush të mos mbetet i papërgjegjshëm përpara ligjit, pavarësisht vendndodhjes së tij.

Zbatimi i parimeve të sigurta në procesin e ekstradimit – përfshirë parimin e dyfishtë të dënueshmërisë (ku vepra duhet të jetë e dënueshme në të dy shtetet), ndalimin e ekstradimit për arsye politike apo drejt persekutoreve politike, dhe garantimin e barazisë procedurale – siguron që ky mekanizëm të funksionojë mbi baza të drejtësisë dhe jo të shndërrohet në një mjet të abuzimit politik. Këto garanci juridike janë themelore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë procedurës së ekstradimit dhe për të ruajtur balancën ndërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar në ndjekjen e krimeve dhe respektimit të sovranitetit dhe të drejtave themelore të individit.

Kosova, Shqipëria dhe shumë vende të tjera të rajonit të Ballkanit kanë ndërtuar dhe vazhdojnë të zhvillojnë sistemet e tyre juridike në përputhje me kërkesat e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke pasur si synim kryesor harmonizimin e vazhdueshëm me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën gjyqësore të Bashkimit Evropian

dhe Këshillit të Evropës. Kjo përpjekje lidhet drejtpërdrejt me aspiratat integruuese të këtyre vendeve, por edhe me nevojën për forcimin e shtetit të së drejtës, garantimin e të drejtave themelore dhe rritjen e efikasitetit në luftën kundër krimit ndërkombëtar. Harmonizimi përfshin jo vetëm përshtatjen e legjislacionit të brendshëm me konventat ndërkombëtare për ekstradimin, por edhe ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të këtyre standardeve.

Procesi i ekstradimit është kompleks dhe ndërveprues, duke përfshirë disa nivele institucionale dhe juridike. Ai nis me hartimin dhe paraqitjen e kërkesës për ekstradim nga autoritetet gjyqësore ose diplomatike të shtetit kërkues, duke përmbushur kriteret ligjore dhe dokumentacionin përkatës. Më tej, kërkesa i nënshtrohet shqyrtimit administrativ dhe juridik nga autoritetet e shtetit të kërkuar, të cilat vlerësojnë përmbushjen e kushteve për ekstradim, përfshirë ekzistencën e marrëveshjeve, natyrën e veprës penale dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të individit. Procesi kulmon me një vendim gjyqësor që mund të ankimohet në instanca më të larta, duke garantuar kështu mbikëqyrje të plotë ligjore dhe respektimin e të drejtës për mbrojtje dhe një proces të rregullt ligjor. Ky shumëniveleshëm është thelbësor për të balancuar kërkesat për drejtësi me mbrojtjen e të drejtave individuale.

Marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale përbëjnë bazën ligjore për funksionimin efektiv të mekanizmit të ekstradimit ndërmjet shteteve. Këto marrëveshje përcaktojnë qartë kushtet juridike të ekstradimit, përfshirë kategoritë e veprave penale që mund të çojnë në ekstradim, procedurat e ndjekura nga palët, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet kohore për përpunimin e kërkesave. Ato gjithashtu përfshijnë dispozita për ndalimin e ekstradimit në raste të caktuara, si për arsye politike,

rrezikim të të drejtave të njeriut, ose nëse ekziston mundësia e dënimeve çnjerëzore në vendin kërkues. Prandaj, këto marrëveshje shërbejnë si mekanizma siguries që rrisin besimin ndërmjet shteteve dhe garantojnë një proces ekstradimi të drejtë, të standardizuar dhe në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Procesi i ekstradimit, ndonëse një instrument kyç i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, nuk është i lirë nga sfida dhe rreziqe. Rreziqet më të mëdha lidhen me mundësinë e keqpërdorimit të ekstradimit për qëllime politike, ku shtetet kërkuese mund të maskojnë ndjekjen penale me motive të persekutimit politik. Po ashtu, ekziston rreziku që individët e ekstraduar të përballen me shkelje të të drejtave të tyre themelore në vendin përfitues, si mungesa e një procesi të drejtë, rreziku për torturë apo trajtim çnjerëzor, dhe mungesa e mbrojtjes së duhur ligjore. Një tjetër sfidë është mungesa e standardizimit dhe interpretimit uniform të marrëveshjeve ndërkombëtare për ekstradimin, gjë që krijon pasiguri juridike dhe mund të çojë në trajtim të pabarabartë të rasteve të ngjashme. Këto rreziqe kërkojnë një kontroll të rreptë ligjor dhe monitorim të vazhdueshëm ndërkombëtar për të siguruar respektimin e parimeve të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut.

Rekomandime

Përforcimi i kuadrit ligjor dhe procedural është thelbësor për një sistem ekstradimi të drejtë dhe efikas. Kjo nënkupton harmonizimin e vazhdueshëm të legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe konventat evropiane si Konventa Evropiane për Ekstradimin dhe instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe BE-së. Një qasje e tillë siguron që proceset e ekstradimit të zhvillohen në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës, duke ofruar mbrojtje maksimale të të drejtave të individëve, garantimin

e një procesi të rregullt ligjor dhe shmangien e shkeljeve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, kjo lehtëson bashkëpunimin ndërkombëtar mes autoriteteve gjyqësore dhe administrative të shteteve, rrit besimin reciprok dhe përmirëson efikasitetin në ndjekjen e krimeve ndërkufitare.

Krijimi i një strukture të posaçme për monitorimin e rasteve të ekstradimit është një masë thelbësore për të garantuar zbatimin korrekt të procedurave dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të individëve të përfshirë. Një mekanizëm transparent dhe i koordinuar – që përfshin bashkëpunimin ndërmjet gjykatave, prokurorisë dhe njësive ndërlidhëse me autoritetet ndërkombëtare – do të mundësonte një ndjekje të vazhdueshme të çdo faze të procesit të ekstradimit. Kjo strukturë do të siguronte që vendimet të bazohen në kritere të qarta ligjore, të dokumentuara dhe të verifikueshme, duke minimizuar rreziqet për abuzim politik apo procedura të padrejta. Monitorimi i rregullt do të përmirësonte transparencën institucionale, do të rriste llogaridhënien dhe do të kontribuonte në standardizimin e praktikave në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

Përmirësimi i trajnimit të personelit juridik përbën një shtyllë kyçe në sigurimin e një procesi të drejtë dhe të qëndrueshëm ekstradimi. Është thelbësore që avokatët, prokurorët dhe gjykatësit të jenë të pajisur me njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare dhe evropiane që rregullojnë ekstradimin, duke përfshirë konceptet thelbësore si ndalimi i refoulement (moskthimit në vende ku individ i rrezikon torturë apo trajtim çnjerëzor), mbrojtja kundër diskriminimit politik, mjekësor dhe ekonomik, dhe zbatimi i procedurave të barabarta për të gjithë. Trajnimet duhet të jenë të vazhdueshme, të ndërdisiplinare dhe të mbështetura në praktikën më të mira ndërkombëtare, në mënyrë që vendimmarrja

gjyqësore të jetë jo vetëm ligjërish e saktë, por edhe e ndjeshme ndaj sfidave të të drejtave të njeriut dhe realiteteve gjeopolitike.

Zbatimi i sistemeve të forta verifikimi dhe parandalimi në procedurat e ekstradimit është thelbësor për të garantuar një mbrojtje efektive ndaj keqpërdorimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut. Kjo kërkon vendosjen e kontroleve të shumëfishta që përfshijnë një proces gjyqësor të pavarur, i cili shqyrton me kujdes çdo kërkesë për ekstradim në funksion të vlerësimit të rreziqeve të mundshme, veçanërisht nëse ekziston dyshimi për motive politike. Një sistem i tillë duhet të mbështetet në procedura transparente, verifikime ndër-institucionale dhe konsultime me organizata ndërkombëtare për të siguruar që individët të mos kthehen në vende ku rrezikojnë ndëshkim të padrejtë, torturë apo shkelje të tjera të rënda. Këto mekanizma rrisin sigurinë ligjore dhe forcojnë integritetin e sistemit të ekstradimit.

Rritja e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar është një komponent jetik për funksionimin efikas të sistemit të ekstradimit në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur. Kjo përfshin jo vetëm nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, por edhe përfshirjen aktive në mekanizma institucionale si Eurojust, Europol, OSBE dhe Kombet e Bashkuara. Vendosja e strukturave të përhershme bashkëpunimi – si grupet e përbashkëta për ekstradim apo qendrat e ndërlidhjes për shkëmbim informacioni – ndihmon në rritjen e efikasitetit, shpejtësisë dhe besueshmërisë së procedurave. Këto mekanizma përmirësojnë koordinimin ndërmjet shteteve, sigurojnë qasje më të shpejtë në të dhëna kritike, ofrojnë mbështetje teknike dhe ligjore, dhe ndihmojnë në ndërtimin e një fronti të përbashkët kundër krimit ndërkufitar dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Hartimi dhe zbatimi i politikave të qarta për rastet me përmasa humanitare është thelbësor për të siguruar që ekstradimi të mos kthehet në mjet

shkeljeje të të drejtave themelore të njeriut. Në raste kur ekziston rreziku i torturës, trajtimit çnjerëzor ose degradues në vendin pritës, duhet të ekzistojë mundësia ligjore për të refuzuar ekstradimin, duke u mbështetur në parimin e mos refoulement. Si alternativë, shteti kërkues mund të ofrojë gjykim të drejtë dhe të pavarur në vendin e tij, por vetëm nëse mund të garantohet respektimi i standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Këto masa mbrojtëse janë të domosdoshme për të ruajtur integritetin e sistemit të drejtësisë ndërkombëtare dhe për të shmangur instrumentalizimin e ekstradimit në dëm të individëve në situata të cënueshme.

Përmirësimi i transparencës së marrëveshjeve për ekstradim është një hap i domosdoshëm drejt rritjes së llogaridhënies institucionale dhe garantimit të një procesi të drejtë për të gjithë palët e përfshira. Marrëveshjet ekzistuese duhet të bëhen të qasshme publikisht në mënyrë proaktive, së bashku me interpretimin e tyre në kuadrin e ligjit vendor dhe shembuj praktikë të aplikimit në vendime gjyqësore. Ky qartësim ndihmon jo vetëm qytetarët dhe personat e prekur nga procedurat e ekstradimit, por gjithashtu avokatët, studiuesit dhe profesionistët e drejtësisë, duke lehtësuar aksesin në informacion dhe duke forcuar kontrollin demokratik mbi procedurat. Transparenca gjithashtu minimizon keqkuptimet dhe keqpërdorimet, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe besimin publik në sistemin e drejtësisë.

Përfshirja aktive e organizatave të shoqërisë civile dhe medias në procesin e ekstradimit është thelbësore për të forcuar transparencën, mbikëqyrjen dhe reformën e sistemit. Organizatat e shoqërisë civile kanë kapacitetin për të monitoruar procedurat, për të identifikuar raste të dyshimta apo shkelje të të drejtave të njeriut, dhe për të ushtruar presion publik dhe

institucional për përmirësime. Ndërkohë, media luan një rol kritik në informimin e publikut dhe në ndriçimin e rasteve problematike që përndryshe mund të kalonin të heshtura. Kjo pjesëmarrje kontribuon në krijimin e një kulture transparence, ku çdo kërkesë ekstradimi nuk trajtohet thjesht si çështje teknike apo diplomatike, por si proces me ndikim të drejtpërdrejtë mbi të drejtat dhe liritë themelore të individit.

Ekzekutimi i vendimeve penale: problematikat

Erisa Jaupi

Program i Integruar i Ciklit të dytë “ Master i Shkencave në Drejtësi ”

Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: PhD. Ilir Kanaj

Fakulteti i Shkencave Humane

Univeristeti “Ismail Qemali”Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Ekzekutimi i vendimeve penale është një nga fazat më të rëndësishme të sistemit të drejtësisë penale, i cili synon të sigurojë zbatimin e vendimeve të gjykatave dhe mbrojtjen e rendit shoqëror. Ky punim analizon problematikat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale në Shqipëri, duke u fokusuar në tri aspekte kyçe: aspektin ligjor dhe procedural, aspektin institucional dhe administrativ, dhe aspektin e të drejtave të njeriut dhe kushteve të ekzekutimit. Në aspektin ligjor dhe procedural, punimi shqyrton kuadrin ligjor që rregullon ekzekutimin e dënimeve, duke analizuar dispozitat ligjore dhe procedurat që ndihmojnë në implementimin e vendimeve, si dhe problemet që lindin nga zbrazëtirat në ligj dhe praktikën. Nga ana tjetër, në aspektin institucional dhe administrativ, punimi thekson

rolin e institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve, si shërbimi i provës dhe institucionet penitenciare, duke analizuar sfidat që ato hasin për shkak të mungesës së burimeve dhe mbingarkesës.

Në aspektin e të drejtave të njeriut dhe kushteve të ekzekutimit, punimi përqendrohet në respektimin e të drejtave të personave të dënuar gjatë ekzekutimit të vendimeve, duke shqyrtuar kushte të papërshtatshme në institucione dhe ndikimin e këtyre kushteve në realizimin e drejtësisë. Punimi gjithashtu ofron rekomandime për përmirësimin e efikasitetit të procesit të ekzekutimit të vendimeve penale dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjatë këtij procesi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në ekzekutimin e vendimeve penale është ndikimi i

politikave penale dhe ndryshimet ligjore mbi këtë proces. Në Shqipëri, reformat e vazhdueshme në legjislacionin penal dhe procedural kanë synuar të përmirësojnë ekzekutimin e dënimeve, duke përfshirë masa alternative ndaj burgimit dhe forcimin e mbikëqyrjes së personave të dënuar. Megjithatë, sfidat mbeten në zbatimin efektiv të këtyre reformave, veçanërisht për shkak të mungesës së koordinimit midis institucioneve dhe burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore.

Për më tepër, një problematikë që nuk mund të anashkalohet është ndikimi i sistemit të ekzekutimit të vendimeve penale në riintegrimin e të dënuarve në shoqëri.

Mungesa e programeve efektive të rehabilitimit dhe mbështetjes pas lirit shpesh e vështirëson rikthimin e individëve në jetën normale, duke rritur mundësinë e recidivizmit. Për të adresuar këtë çështje, është e nevojshme të forcohen mekanizmat e mbështetjes për të dënuarit pas përfundimit të dënimit, përfshirë mundësitë për punësim dhe përfshirje sociale, në mënyrë që ekzekutimi i vendimeve të mos shihet vetëm si një mjet ndëshkimi, por edhe si një hap drejt rehabilitimit dhe riintegrit të suksesshëm.

Fjalët kyçe: *Ekzekutimi i vendimeve penale, aspekti ligjor, institucionet përgjegjëse, të drejtat e njeriut, standartet ndërkombëtare*

Abstract

The execution of criminal decisions is one of the most important phases of the criminal justice system, aiming to ensure the enforcement of court rulings and the protection of social order. This paper analyzes the issues related to the execution of criminal decisions in Albania, focusing on three key aspects: the legal and

procedural aspect, the institutional and administrative aspect, and the aspect of human rights and execution conditions.

In the legal and procedural aspect, the paper examines the legal framework governing the execution of sentences by analyzing legal provisions and procedures that facilitate the implementation of decisions, as well as the problems arising from legal gaps and practical challenges. On the other hand, in the institutional and administrative aspect, the paper highlights the role of the institutions responsible for the execution of decisions, such as the probation service and penitentiary institutions, analyzing the challenges they face due to a lack of resources and excessive workload. Regarding human rights and execution conditions, the paper focuses on respecting the rights of convicted persons during the execution of decisions, examining inadequate conditions in institutions and the impact of these conditions on the realization of justice. The paper also provides recommendations for improving the efficiency of the criminal decision execution process and for protecting human rights throughout this process.

Another important aspect of the execution of criminal decisions is the impact of criminal policies and legal changes on this process. In Albania, ongoing reforms in criminal and procedural legislation have aimed to improve the execution of sentences, including alternative measures to imprisonment and the strengthening of supervision over convicted persons. However, challenges remain in the effective implementation of these reforms, particularly due to the lack of coordination between institutions and limited financial and human resources.

Furthermore, an issue that cannot be overlooked is the impact of the criminal decision execution system on the reintegration of convicts into society. The lack of effective rehabilitation programs and post-release support often makes it

difficult for individuals to return to normal life, increasing the likelihood of recidivism. To address this issue, it is necessary to strengthen support mechanisms for convicts after the completion of their sentences, including employment opportunities and social inclusion, so that the execution of decisions is not only seen as a means of punishment but also as a step towards rehabilitation and successful reintegration.

Keywords: *Execution of criminal sentences, legal aspects, responsible institutions, human rights, international standards*

Hipotezat

1. *Kuadri ligjor shqiptar për ekzekutimin e vendimeve penale paraqet mangësi të konsiderueshme që ndikojnë në efektivitetin dhe zbatimin uniform të vendimeve.*

Kjo hipotezë ngrihet mbi supozimin se, ndonëse ekzistojnë rregullime të detajuara ligjore, ato janë të fragmentarizuara, shpeshherë në konflikt me njëra-tjetrën dhe jo të harmonizuara me standardet bashkëkohore të të drejtës penale ekzekutive.

2. *Zbatimi i vendimeve penale në praktikë has pengesa të shumta që lidhen me mungesën e kapaciteteve administrative, bashkëpunimit ndërinstitutional dhe mbikëqyrjes efektive.*

Kjo hipotezë nënkupton se pengesat nuk janë vetëm juridike, por kryesisht institucionale dhe organizative, dhe ndodhin si rezultat i mungesës së koordinimit të duhur mes aktorëve përgjegjës.

3. *Të drejtat e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale nuk garantohen në mënyrë të plotë dhe sistematike.*

Hipoteza sugjeron se, pavarësisht dispozitave ligjore për mbrojtjen e të drejtave të

individit gjatë zbatimit të dënimit, në praktikë ka shpesh shkelje që lidhen me trajtimin e pabarabartë, mungesën e aksesit në ankesa efektive dhe kushtet jo të përshtatshme të vuajtjes së dënimit.

4. *Mungesa e një strategjie të qartë për ekzekutimin e vendimeve penale dëmton besimin e qytetarëve tek drejtësia dhe e bën sistemin penal më pak funksional.*

Kjo hipotezë lidhet me perceptimin publik mbi pandëshkueshmërinë dhe me rëndësinë e fazës së ekzekutimit për garantimin e autoritetit të vendimit gjyqësor.

Kuptimi i dënimit

Dënimi është një nga format më të vjetra të reagimit shoqëror ndaj shkeljeve dhe veprave penale, i cili ka evoluar në përputhje me zhvillimin e shoqërisë dhe ndryshimin e qëllimeve të saj. Edhe pse koncepti dhe funksioni i dënimit kanë pësuar transformime të rëndësishme, ai vazhdon të mbetet një mjet thelbësor për ruajtjen e rendit juridik.

Në doktrinën juridike, dënimi është përkufizuar në mënyra të ndryshme, por gjithmonë si një kufizim i të drejtave të individit për shkak të shkeljes së një norme ligjore. Në kuptimin penal, ai përfaqëson një sanksion ndëshkues të parashikuar nga ligji dhe të vendosur nga gjykata për individët që kryejnë vepra penale. Sanksionet penale janë masa shtrënguese që shteti aplikon ndaj kryerësve të këtyre veprave, duke synuar parandalimin e sjelljeve të dëmshme dhe mbrojtjen e rendit shoqëror.

Pavarësisht nga mënyra se si përkufizohet, thelbi i dënimit mbetet i pandryshuar:

ai shërben si një mjet i sistemit të drejtësisë për të garantuar zbatimin e normave dhe për të vendosur një balancë ndërmjet interesit publik dhe të

drejtave individuale.

Dënimet kryesore

Në legjislacionin penal shqiptar, dënimet kryesore janë ato që shqiptohen për veprat penale dhe që kanë për qëllim ndëshkimin e personit që ka kryer një krim. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë parashikon disa lloje dënimesh kryesore, të cilat mund të jepen në varësi të natyrës dhe rrezikshmërisë së veprës penale. Dënimet kryesore që parashikohen në Kodin Penal shqiptar janë:

1. **Burgimi** (Dënimi me burg):

Burgimi është një nga dënimet më të rëndësishme dhe përfshin privimin e lirisë së individit për një periudhë të caktuar kohe. Kodi Penal parashikon disa lloje burgimi, si:

Burgimi i rëndë – për krimet më të rënda, ku periudha e burgimit mund të jetë nga disa vite deri në burgim të përjetshëm.

Burgimi i thjeshtë – për krime të natyrës më pak të rënda, ku periudha e burgimit është më e shkurtër.

2. **Burgimi i përjetshëm:**

Ky dënim është një dënim ekstreme dhe shqiptohet për krimet më të rënda, si vrasjet e qëllimshme. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk ka një kohëzgjatje të caktuar dhe mund të zgjatet deri në fund të jetës së personit të dënuar, megjithatë ekzistojnë mundësi për lirim me kusht pas një periudhe të caktuar kohe.

3. **Dënimi me gjobë:**

Dënimi me gjobë është një masë shtrënguese që imponon një detyrim financiar ndaj personit të dënuar. Gjohat mund të variojnë në vlerë, në varësi të rëndësisë së veprës penale dhe kushteve të veçanta të rrethanave të veprës.

4. **Dënimi me detyrime shërbimi në interes të komunitetit:**

Ky dënim, i njohur si "shërbimi në komunitet", është një dënim alternativ që mund të jepet në vend të burgimit për disa krime të lehta. Personi i dënuar duhet të kryejë punë të caktuara që i shërbejnë interesit të shoqërisë, siç janë punët për përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitet ose shërbimet e tjera publike.

5. **Dënimi me arrest shtëpie:**

Ky dënim është një formë e dënimit që ndalon personin të dalë nga shtëpia e tij dhe të ndërveprojë lirisht me të tjerët, me përjashtim të rasteve kur ka nevojë të kryejë aktivitete të caktuara si vizitat në spitale apo punë. Ky dënim është më i butë se burgimi dhe shpesh përdoret për personat që kanë kryer krime të lehta ose kur ka mundësi që individit të risocializohet pa qenë i privuar nga liria.

6. **Dënimi me vërejtje ose paralajmërim:**

Dënimi me vërejtje ose paralajmërim është një masë e butë, që mund të shqiptohet për shkelje të lehta të ligjit. Kjo mund të ndihmojë në risocializimin e individit pa e privuar nga liria apo imponuar ndëshkime financiare. Çdo lloj dënimi është i lidhur me një natyrë dhe qëllim të caktuar, dhe secili prej tyre ka rregulla dhe procedura specifike për t'u implementuar, siç është parashikuar nga Kodi Penal shqiptar dhe ligjet përkatëse.

Dënimet plotësuese, kuptimi dhe zbatimi i tyre në praktikë nga gjykatat shqiptare

Kuptimi i dënimeve plotësuese

Ashtu siç është cituar dhe në hyrjen e kësaj teme, një nga fokuset kryesore të këtij trajtimi modest do të jenë dhe dënimet plotësuese, llojet e tyre,

mënyra se si ato zbatohen nga gjykatat dhe roli që ato luajnë në riedukimin apo risocializimin e të dënuarit. Arsyeja kryesore pse do të përqëndrohem më gjatë në trajtimin e këtyre dënimeve ka të bëjë me rolin e posaçëm që ato luajnë si për individualizimin e dënimit nga ana e gjykatës, ashtu dhe për parandalimin apo risocializimin e personit të dënuar. Po ashtu, një arsye tjetër lidhet me faktin se, deri sot, këto dënime nuk janë trajtuar në mënyrë të hollësishme nga pikëpamja teorike dhe as nga pikëpamja praktike, ashtu siç janë trajtuar dënimet kryesore apo instituti i dënimit në përgjithësi. Prandaj, në këtë trajtim synohet pikërisht që të bëhet një studim më i zgjeruar i kuptimit të këtyre lloj dënimeve duke e shoqëruar gjithnjë me rastet e zbatimit të tyre në praktikë nga gjykatat.

Dënimet plotësuese kanë filluar të zbatohen më vonë në kohë se dënimet kryesore, pasi siç dihet tashmë, për një periudhë mjaft të gjatë kohore janë aplikuar disa lloje të rënda dënimesh dhe nuk konceptohej një ndarje mes llojeve të dënimeve në dënime plotësuese dhe në dënime kryesore. Një ndarje e tillë filloi të mendohej dhe të merret jetë më vonë, sepse u vërejt se vetëm me anë të dënimeve kryesore nuk po arriheshin rezultate dhe aq konkrete në parandalimin, riedukimin dhe risocializimin e të dënuarve, e si rrjedhim duhej ndryshuar diçka në politikën e ndëshkimit.

Dënimet kryesore, siç u citua dhe më lart, kanë qenë i vetmi lloj i sanksioneve penale për një periudhë shumë të gjatë, deri në fund të shekullit XIX. Pas kësaj periudhe, nga fundi i shekullit XIX, nën ndikimin e shkollës pozitive dhe socioantropologjike, filluan të parashikoheshin

dhe lloje të tjera sanksionesh penale. Këto sanksione nuk u emërtuan që në fillim si dënime plotësuese, një gjë e tillë filloi të bëhej veçanërisht pas luftës së dytë botërore, periudhë në të cilën shumica e shteteve të Evropës filluan të parashikonin si dënime plotësuese sanksionet të cilat deri në këtë periudhë konsideroheshin si masa siguruese²³⁹.

Ky ndryshim erdhi si rezultat i konstatimit se dënimet kryesore nuk mund të ishin i vetmi mjet efikas ndaj kryerësve të veprave penale. Prandaj ishte e domosdoshme që krahas dënimeve kryesore duhej të të parashikoheshin edhe sanksione të tjera të karakterit plotësues, me të cilat do të bëhej i mundur parandalimi më efektiv i kriminalitetit dhe risocializimi i personave të dënuar²⁴⁰.

Aktualisht, dënimet plotësuese parashikohen në shumicën dominuese të legjislacioneve, ato kanë një natyrë të ndryshme nga dënimet kryesore dhe kanë të bëjnë me humbjen e disa të drejtave²⁴¹. Ky kufizim i disa të drejtave të posaçme me anë të dënimeve plotësuese bëhet kryesisht për dy arsye :

Së pari, sepse ushtrimi i disa detyrave dhe funksioneve shtetërore apo publike, kërkon që personi i cili i ushtron ato të ketë një të kaluar të pastër, pa precedentë kriminalë.

Së dyti, në këtë mënyrë, duke aplikuar krahas dënimt kryesor dhe një dënim plotësues synohet të parandalohet recidivizmi²⁴².

Pra, siç edhe vërehet, dënimet plotësuese janë një nga llojet e sanksioneve me anë të të cilave synohet të ushtrohet lufta kundër kriminalitetit, veçanërisht recidivizmi, prandaj në vetvete këto sanksione kanë karakter kryesisht preventiv. Në ndryshim nga dënimet kryesore, dënimet

²³⁹ Ismet Salihu, e drejta penale pjesa e përgjithshme, fq 486.

²⁴⁰ Po aty, fq 487 – 488.

²⁴¹ Vllado Kambovski – e drejta penale – pjesa e përgjithshme, fq 893 – 894.

²⁴² Ismet Salihu, e drejta penale pjesa e përgjithshme, fq 487.

plotësuese kanë një karakter më pak ndëshkues, ato kanë si përparësi kryesore faktin se i ndihmojnë gjykatat në individualizimin sa më të përshtatshëm të dënimit dhe krijojnë më shumë mundësi për risocializimin e të dënuarit²⁴³

Legjislacioni ynë penal i ka parashikuar për herë të parë, në mënyrë të shprehur, dënimet plotësuese në kodin penal të vitit 1952²⁴⁴, duke bërë dhe ndarjen e tyre nga dënimet kryesore. Në kodin e mëparshëm penal të miratuar në vitin 1927, nuk ishin të parashikuara shprehimisht dënimet plotësuese, por kishte dënime të tilla, si ndalimi nga ofiqet publike, i cili për nga mënyra se si ishte i formuluar kishte natyrën e një dënimi plotësues²⁴⁴. Ndërsa në kodin penal të vitit 1977 kemi një ndarje më të qartë, aty parashikohen pesë lloje dënimesh plotësuese, por edhe në këtë kod, ashtu si dhe në kodin penal aktual, nuk bëhet një ndarje mes dënimeve plotësuese që jepen për krime dhe atyre që jepen për kundravajtjet penale²⁴⁵.

Për të vijuar me kodin penal aktual, dënimet plotësuese që janë parashikuar nga ky kod janë më të shumta në krahasim me kodet e mëparshme. Kjo ishte dhe një nga risitë që solli ky kod, duke i krijuar mundësi gjykatës që në çdo rast të japë një dënim, i cili veç të tjerash, të jetë sa më i individualizuar dhe të arrijë të realizojë veçanërisht²⁴ Kodi penal I R. P. së Shqipërisë, viti 1952, neni 16, kundër personave që kanë kryer krime jepen këto dënime : *vdekja, burgimi, internimi, dëbimi, puna korrektonjëse, humbja e të drejtave,*

konfiskimi i pasurisë, ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie të caktuar ose mjeshtërie, heqja e gradës, humbja e nëpunësisë, gjoba, qortimi shoqëror.

neni 17, dënimet kryesore dhe plotësuese : *Vdekja, burgimi, internimi, puna korrektonjëse, qortimi shoqëror janë dënime kryesore, të tjerat përveç, humbjes së të drejtave, konfiskimit të pasurisë, ndalimit të ushtrimit të një veprimtarie të caktuar ose mjeshtërie, mund të jepen qoftë si dënime kryesore qoftë si dënime plotësuese. për parandalimin e këtyre personave që të kryejnë sërish të njëjtën vepër penale. Në kodin tonë penal, neni 30, parashikohen 9 lloje dënimesh të posaçme²⁴⁶, si më poshtë: *Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepen edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:**

- 1) *Ndalimi i të drejtës për të ushtruar funksione publike,*
- 2) *Konfiskimi i mjeteve të kryerjes së veprës penale dhe produkteve të veprës penale.*
- 3) *Ndalimi për të drejtuar automjete.*
- 4) *Heqja e dekoratave, titujve të nderit.*
- 5) *Heqja e së drejtës të ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie. Heqja e së drejtës për të ushtruar detyra drejtuese pranë personave juridik.*
- 6) *Ndalimi për të qëndruar në një ose disa njësi administrative.*
- 7) *Nxjerrja jashtë territorit.*

²⁴³ Po aty, fq 488.

²⁴⁴ Fletore zyrtare, viti 1928, kodi penal, dt. 3. VI.1927, neni 21 : ndalimi nga ofiqet pulike asht I përjetshëm ose i përkohshëm. Ndalimi I përjetshëm shkakton humbjen e së drejtës për të zgjedhur në çdo qark elektoral, si dhe çdo të drejtë tjetër politike, të cilësisë si deputet ose senator..., të gradave, dinjiteteve akademike, dekoratave dhe të shenjave të tjera nderi publike, etj. Ndalimi i përkohshëm shkakton pamundësinë e të dënuemit me fitue ose me ushtrue jo më pak se 3 muaj dhe jo më shumë se 5 vjet të drejtat e mësipërme.

²⁴⁵ Gazeta zyrtare e R. P. S. Sh, 18.qershor.1977. nr. 3, kodi penal i R. P. S. Shqipërisë, neni 17/3

Kundër personave që kanë kryer vepra penale nga gjykata mund të jepen edhe këto dënime plotësuese: Heqje e dekoratave. Ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie ose mjeshtërie të caktuar.Heqje e së drejtës së zgjedhjes.Dëbim.Internim.

²⁴⁶ Kodi penal I Republikës së Shqipërisë, i azhurnuar deri në tetor 2004.

8) Detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

Siç vërehet, disa nga këto dënime plotësuese parashikohen për herë të parë në Kodin Penal të R. Sh, ndërsa disa dënime të tjera të cilat kishin karakter politik nuk janë më pjesë e këtij kodi. Po ashtu, nisur nga mënyra se si është formuluar dispozita në fjalë rezulton se gjykata ka të drejtë që, në çdo rast që ajo jep një dënim të caktuar kryesor, të vlerësojë rrethanat dhe kur ajo e çmon të nevojshme të caktojë një apo disa dënime plotësuese të parashikuara në këtë kod²⁴⁷. Pra, nëse në një rast të caktuar, krahas dënimit kryesor duhet dhënë apo jo dhe një dënim plotësues, në bazë të këtij kodi është në vlerësimin e gjykatës. Por pavarësisht kësaj, një mundësi e tillë kufizohet nga nenet në vijim të tij, të cilat parashikojnë në mënyrë të hollësishme rastet dhe mënyrat e caktimit të këtyre dënimeve plotësuese, duke parashikuar se në disa raste një dënim i caktuar plotësues duhet të jepet detyrimisht nga gjykata.

Mënyrat e caktimit të dënimit

Ekzekutimi i vendimeve penale përfaqëson një nga fazat më kritike në sistemin e drejtësisë penale, pasi në këtë moment bëhet realitet ndëshkimi i personit që është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Mënyra e caktimit dhe më pas zbatimi i dënimit nuk është thjesht një akt formal; ai përmbledh dhe ndërthur një sërë parimesh themelore të së drejtës penale dhe të drejtës procedurale penale. Këto parime, të tilla si ligjshmëria, individualizimi i dënimit dhe

domosdoshmëria e tij, kërkojnë jo vetëm një kuadër ligjor të qartë, por edhe profesionalizëm të lartë nga të gjitha subjektet e përfshira në ekzekutimin e vendimeve penale.

Në këtë kuadër, dënimi nuk mund të trajtohet në mënyrë të shkëputur nga zbatimi i tij praktik. Ekzistojnë gjithashtu disa parime të tjera thelbësore si pavarësia e gjykatës, mbështetja e vendimit mbi prova dhe ligj, si dhe drejtësia apo proporcionaliteti i dënimit – të cilat, ndonëse mbartin karakter procedural, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe legjitimitetin e vendimit penal dhe në fazën e ekzekutimit të tij. Pikërisht këtu lindin një sërë problematikash, të cilat lidhen me përputhjen ndërmjet vendimit gjyqësor dhe realitetit të ekzekutimit, përfshirë vështirësitë institucionale, administrative dhe sociale që pengojnë një zbatim efektiv dhe të drejtë të dënimeve²⁴⁸.

Zbatimi i saktë dhe i përpiktë i parimeve themelore gjatë procesit të caktimit të dënimit ka një rëndësi thelbësore jo vetëm për garantimin e një ndëshkimi të drejtë dhe të individualizuar, por edhe për ruajtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut. Kjo qasje siguron që sistemi penal të funksionojë jo si një instrument represiv i pushtetit, por si një mekanizëm ligjor që vepron në përputhje me parimet e shtetit të së drejtës. Në këtë kuptim, shteti nuk lufton kriminalitetin në mënyrë arbitrare apo të selektuar, por përmes një qasjeje të bazuar në ligj, ku çdo vendim penal duhet të respektojë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të drejtësisë penale.

Për më tepër, respektimi i këtyre parimeve ndihmon në forcimin e besimit të publikut te drejtësia dhe garanton që ekzekutimi i vendimeve

²⁴⁷ Neni 30, paragrafi i 1 i K.P. Për personat që kanë kryer krime ose kundërvajtje penale, bashkë me dënimin kryesor, mund të jepet edhe një ose disa nga këto dënime plotësuese:

²⁴⁸ Shefqet Muci, e drejta penale: pjesa e përgjithshme, fq.291.

penale të mos shndërrohet në një mjet hakmarrjeje apo abuzimi, por të mbetet një formë e ligjshme dhe proporcionale e reagimit shtetëror ndaj veprës penale. Parimet e ligjshmërisë, drejtësisë dhe humanizmit në këtë kontekst nuk janë vetëm udhëzues etikë apo teorikë, por mekanizma konkretë që duhet të reflektohen në çdo hallkë të sistemit penal, përfshirë edhe fazën e ekzekutimit të vendimit. Individualizimi i dënimit përbën një ndër komponentët më të rëndësishëm të procesit penal dhe kërkon një vlerësim të hollësishëm dhe të kujdesshëm të të gjitha rrethanave përkatëse të çështjes. Ky proces bëhet veçanërisht sfidues në kuadrin e legjislacioneve si ai shqiptar, ku Kodi Penal, për një sërë veprash penale, parashikon një diapazon të gjerë midis minimumit dhe maksimumit të dënimit të mundshëm. Një strukturë e tillë e normës ndëshkuese u jep gjykatave një hapësirë të konsiderueshme diskrecionale, por njëkohësisht u imponon atyre një përgjegjësi të lartë në arsyetimin dhe motivimin e vendimeve të tyre. Në këto kushte, gjykata duhet të realizojë një analizë të thelluar dhe të balancuar, duke marrë në konsideratë jo vetëm rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe pasojat e saj, por edhe karakteristikat personale të të pandehurit, qëndrimin e tij ndaj veprës, rrethanat lehtësuese apo rënduese, si dhe nevojën për barazi në trajtimin penal të rasteve të ngjashme. Qëllimi përfundimtar është dhënia e një dënimi që i përgjigjet jo vetëm kërkesave të ligjit, por edhe parimit të drejtësisë materiale.

Megjithatë, duhet theksuar se vlerësimi i pabarazisë ndërmjet dënimeve të ndryshme për të njëjtën vepër penale nuk mund të bazohet thjesht në krahasimin e sasisë së dënimit të dhënë. Çdo vendim është unik dhe përbëhet nga

një kombinim kompleks faktorësh që, në përputhje me parimin e individualizimit, mund të çojnë në rezultate të ndryshme, edhe në dukje kontradiktore. Prandaj, ndryshimet në masën e dënimit nuk janë domosdoshmërisht tregues të trajtimeve të padrejta apo të pabarabarta, për sa kohë që ato janë të arsyetuara ligjërisht dhe të mbështetura në prova konkrete²⁴⁹.

Individualizimi i dënimit dhe zbatimi i tij në praktikën shqiptare

Individualizimi i dënimit përbën një nga parimet qendrore të institutit të dënimit penal dhe është thelbësor për garantimin e një drejtësie materiale në procesin penal. Ky parim nuk kufizohet vetëm në përcaktimin e fajësisë, por shtrihet në mënyrë të veçantë në fazën e caktimit dhe më pas në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Me individualizim të dënimit kuptohet si zgjedhja e llojit të dënimit (p.sh. burgim, gjobë, punë në dobi të komunitetit), ashtu edhe përcaktimi i masës konkrete që duhet të zbatohet ndaj personit konkret.

Kodi Penal shqiptar kërkon në mënyrë eksplicite që gjykata, gjatë vendosjes së dënimit, të respektojë të dyja këto aspekte në mënyrë kumulative. Për këtë qëllim, ligji parashikon edhe disa kriterë të detyrueshëm që gjykata duhet të marrë parasysh, si rrezikshmëria shoqërore e veprës, pasojat konkrete të saj, personaliteti i autorit, qëndrimi i tij gjatë hetimit e gjykimin, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si dhe nevoja për rehabilitim.

Gjithsesi, individualizimi i dënimit nuk është një proces që përfundon me shpalljen e vendimit penal. Në praktikën juridike dhe në shkencën e së drejtës penale, njihet një ndarje trefazore e individualizimit të dënimit:

²⁴⁹ COUNCIL OF EUROPE. Collected studies in criminological research, volume XXVI - disparities in sentencing:: causes and solution, fq. 11. Strasbourg 1987.

Individualizimi ligjor, i cili kryhet përmes përcaktimit të kufijve të dënimit në dispozitat e Kodit Penal;

Individualizimi gjyqësor, që kryhet nga gjykata gjatë shqyrtimit të çështjes konkrete dhe në vendimin përfundimtar;

Individualizimi administrativ, që lidhet ngushtësisht me fazën e ekzekutimit të vendimit penal, i cili realizohet nga institucionet e ekzekutimit të dënimit, si shërbimi i provës apo administrata penitenciare.

Pikërisht në këtë fazë të tretë lindin një sërë problematikash që lidhen me mënyrën e zbatimit të vendimit të gjykatës, sidomos në rastet kur mungon koordinimi ndërmjet vendimit të dhënë dhe realitetit të ekzekutimit, apo kur institucionet ekzekutuese nuk arrijnë të respektojnë në praktikë individualizimin që ka realizuar gjykata. Kjo sjell rrezik për deformimin e qëllimit ndëshkues dhe rehabilitues të dënimit, duke cenuar parimet themelore të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Individualizimi ligjor

Individualizimi ligjor i dënimit është niveli i parë i procesit të individualizimit dhe përfaqëson kufizimin e kompetencës së gjykatës për të vepruar vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligji penal. Me fjalë të tjera, është vetë ligji – përmes dispozitave të Kodit Penal – që përcakton llojet e dënimeve që mund të aplikohen për një vepër të caktuar penale si dhe minimumin dhe maksimumin e tyre. Këto kufizime nuk janë të rastësishme, por reflektojnë një balancim të paracaktuar ndërmjet rrezikshmërisë shoqërore të veprës dhe qëllimit të përgjithshëm të ndëshkimit. Individualizimi ligjor, pra, shërben si një garanci për siguri juridike dhe parandalon arbitraritetin gjyqësor.

Përmes individualizimit ligjor, ligjvënësi realizon një parapërzgjedhje normative, duke caktuar se për cilat vepra penale parashikohet dënimi me gjobë, burgim, heqje e të drejtave, etj., si dhe duke sanksionuar kufijtë ekstremë të ndëshkimit. Këto kufij përbëjnë bazën mbi të cilën gjykata do të zhvillojë procesin e individualizimit gjyqësor. Në sistemin penal shqiptar, shumë dispozita ndëshkuese janë të formuluar në mënyrë të tillë që ofrojnë një hapësirë të gjerë diskrecioni, çka në një anë u jep gjykatave fleksibilitet, por nga ana tjetër ngre pikëpyetje lidhur me barazinë në zbatim dhe koherencën e praktikës gjyqësore.

Në praktikën gjyqësore shqiptare, individualizimi ligjor shpesh shoqërohet me problematika që lidhen me mungesën e kriterëve të qarta për zgjedhjen ndërmjet llojeve të ndryshme të dënimit, si dhe me faktin se dispozitat ndëshkuese janë shumë të gjera, duke krijuar hapësirë për interpretime të ndryshme nga gjykatë në gjykatë. Kjo situatë mund të ndikojë në mosrespektimin e barazisë para ligjit dhe në perceptimin e padrejtësisë nga ana e të dënuarve. Nëse në fazën e ekzekutimit nuk ruhet logjika e individualizimit të vendimit, atëherë mund të cenohet funksioni edukues dhe rehabilitues i dënimit, duke e kthyer ndëshkimin në një akt mekanik dhe jo të përshtatur me realitetin personal dhe social të të dënuarit.

Individualizimi gjyqësor

Individualizimi gjyqësor i dënimit është faza më vendimtare në procesin e ndëshkimit penal, sepse është pikërisht gjykata ajo që, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji (individualizimi ligjor), vendos llojin dhe masën konkrete të dënimit që duhet të zbatohet për një rast të caktuar. Në këtë fazë, gjyqtari nuk vepron mekanikisht, por vlerëson të gjitha rrethanat konkrete që lidhen me veprën penale dhe me autorin e saj.

Qëllimi është që dënimi i dhënë të jetë **i drejtë**,

proporcional dhe i përshtatshëm me nevojën për ndëshkim dhe rehabilitim, duke përmbushur njëkohësisht edhe funksionin preventiv të tij.

Kodi Penal shqiptar parashikon një sërë kriteresh që gjykata duhet të marrë parasysh gjatë individualizimit të dënimit, si: shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale; qëndrimi i autorit pas kryerjes së veprës; rrethanat lehtësuese ose rënduese; ndikimi i dënimit në riintegrimin e autorit në shoqëri; si dhe gjendja personale, familjare, ekonomike dhe shëndetësore e tij. Zbatimi i këtyre kriterëve nuk është një zgjedhje diskrecionale, por një detyrim ligjor, i cili siguron që vendimi i gjykatës të mos jetë i përgjithësuar apo standard, por i përshtatur me kontekstin e secilit rast konkret. Gjykata duhet të japë arsyetim të detajuar për çdo element që ndikon në masën e dënimit, në mënyrë që vendimi të jetë transparent dhe i kontrollueshëm.

Në praktikën shqiptare, individualizimi gjyqësor shpesh ndeshet me vështirësi që lidhen me mungesën e uniformitetit në zbatimin e kriterëve të mësipërme, si dhe me vendime që mungojnë në arsyetim ose justifikim të thelluar. Kjo krijon perceptimin e mungesës së konsistencës dhe ushqen ndjenjën e pabarazisë për subjekte që gjykohen për vepra të ngjashme, por përfundojnë me dënime të ndryshme. Një tjetër problem është se në disa raste, gjykatat fokusohen në elementët formalë të veprës penale dhe nuk marrin në konsideratë mjaftueshëm aspektet sociale apo psikologjike të autorit, duke çuar në dënime që janë të rrepta por jo domosdoshmërisht efikase. Këto problematika ndikojnë drejtpërdrejt edhe në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale, ku mund të vihet re një mospërputhje ndërmjet vendimit të dhënë dhe zbatimit praktik të tij.

Individualizimi administrativ

Individualizimi administrativ i dënimit është faza e tretë dhe përfundimtare në procesin e ndëshkimit penal, e cila ndodh pas shpalljes së vendimit të formës së prerë nga gjykata. Kjo fazë realizohet nga institucionet që kanë kompetencën për ekzekutimin praktik të dënimit, si shërbimi i provës, administrata e burgjeve apo strukturat e drejtësisë penale për të mitur. Qëllimi i kësaj faze është përshtatja e dënimit të dhënë me rrethanat reale të të dënuarit në fazën e zbatimit, për të siguruar që ndëshkimi të jetë efektiv, proporcional dhe i orientuar drejt rehabilitimit. Ky lloj individualizimi ka një karakter më praktik dhe operacional, duke u fokusuar në mënyrën se si dënimi aplikohet në realitet.

Individualizimi administrativ realizohet nëpërmjet një sërë mekanizmesh të përcaktuar me ligj, si: përcaktimi i regjimit të vuajtjes së dënimit (i zakonshëm, i rreptë, i sigurisë së lartë); programet e riintegritit social dhe profesional; përdorimi i alternativeve ndaj burgimit (si provë, shërbimi në komunitet, ose pezullimi me kusht); si dhe aplikimi i lehtësimeve si lirimi me kusht apo transferimi në institucione të tjera. Për të qenë efektiv, ky individualizim kërkon bashkëpunim të ngushtë ndër-institucional dhe një vlerësim të vazhdueshëm të sjelljes, progresit dhe nevojave të të dënuarit. Në thelb, administrata penale nuk duhet të zbatojë verbërisht dënimin, por ta modulojë atë në mënyrë dinamike, duke ruajtur qëllimin ndëshkues, por pa cenuar dinjitetin dhe të drejtat e të dënuarit.

Në realitetin shqiptar, individualizimi administrativ përballet me një sërë sfidash serioze. Mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare në shërbimin e provës dhe në institucionet penitenciare, si dhe mbingarkesa e sistemit të burgjeve, shpesh e pengojnë zbatimin e personalizuar të vendimit penal. Një tjetër problem është mungesa e profileve të personalizuar për të dënuarit dhe zbatimi mekanik i masave të njëjta për raste të ndryshme.

Kjo situatë krijon një shkëputje të rrezikshme ndërmjet logjikës së vendimit gjyqësor dhe mënyrës së ekzekutimit të tij në praktikë. Në shumë raste, mungon ndjekja sistematike e progresit të të dënuarit dhe vlerësimi i rrezikshmërisë së tij, çka cenon objektivin kryesor të sistemit penal modern: rehabilitimin dhe riintegrimin në shoqëri.

Qëllimi i dënimit në kuadër të ekzekutimit penal

Qëllimi i dënimit ka qenë dhe mbetet një element qendror në të gjithë strukturën e sistemit penal, që nga fazat e hershme të reagimit shoqëror ndaj krimit e deri në zbatimin praktik të vendimeve penale. Dënimi, përtej funksionit të tij ndëshkues, ka gjithmonë pasur një objektiv më të gjerë: parandalimin e kriminalitetit dhe ruajtjen e rendit juridik në shoqëri. Edhe pse teoritë mbi qëllimin e dënimit janë trajtuar në mënyrë të detajuar më herët, është e rëndësishme të ritheksohet se këto qëllime janë reflektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe në fazën e ekzekutimit të dënimit, ku ato testohen dhe vihen në funksion praktik.

Historikisht, politikat penale që kanë theksuar dënimin e ashpër si mjet ndëshkues nuk kanë arritur të reduktojnë kriminalitetin në mënyrë të qëndrueshme. Përkundrazi, përvojat penale botërore kanë treguar se dënimi i pashoqëruar me elementë rehabilitues dhe resocializues rezulton joefektiv, madje kontraproduktiv. Kjo ka çuar drejt riorientimit të politikave penale drejt një qasjeje më të balancuar, ku parandalimi i përgjithshëm dhe parandalimi i posaçëm trajtohen së bashku me qëllime si rehabilitimi dhe riintegrimi i të dënuarit. Kjo filozofi

moderne kërkon që dënimi të mos përfundojë me vendimin gjyqësor, por të gjejë zbatim të drejtë dhe të personalizuar gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit.

Në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve penale në Shqipëri, sfida kryesore është se sa realisht arrihen këto qëllime në praktikë. Shpesh ekzekutimi mbetet thjesht formal dhe i distancuar nga objektivat që ligji dhe politika penale synojnë të realizojnë. Problematika të tilla si mungesa e kushteve për rehabilitim, mbingarkesa në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe moszbatimi efektiv i masave alternative, kufizojnë rëndësisht funksionin parandalues dhe rehabilitues të dënimit, duke e reduktuar atë në një ndëshkim statik, larg qëllimeve që synon të përmbushë ligji penal bashkëkohor.

Kuptimi i parandalimit të përgjithshëm në dënimin penal

Parandalimi i përgjithshëm përfaqëson një nga funksionet themelore të dënimit penal dhe lidhet me ndikimin që një vendim ndëshkues ushtron mbi shoqërinë në tërësi, duke synuar të frenojë individët e tjerë nga kryerja e veprave penale. Ky koncept ka evoluar bashkë me zhvillimin e mendimit juridik dhe të filozofisë penale. Në periudhat e hershme të reagimit penal, dënimi kishte një karakter të theksuar represiv, me qëllim jo vetëm ndëshkimin e autorit të veprës, por edhe frikësimin e pjesës tjetër të shoqërisë, në mënyrë që ata të shmangnin sjellje të ngjashme në të ardhmen. Kjo filozofi justifikonte aplikimin e dënimeve të rënda dhe shpesh çnjerëzore, si dënimet trupore apo dënimet me vdekje, të cilat përdoroheshin si instrument parandalues kolektiv²⁵⁰.

Me kalimin e kohës dhe zhvillimin e standardeve

²⁵⁰ Garland, D. (2001). *The Culture of Control: Crime and Social Order in Contemporary Society*. Oxford University Press

demokratike dhe të drejtave të njeriut, koncepti i parandalimit të përgjithshëm ka marrë një formë më të moderuar dhe më humane, duke u orientuar jo më nga frikësimi ekstrem, por nga forcimi i autoritetit të ligjit dhe besimit të qytetarëve te drejtësia. Në këtë kuptim, shoqëria edukon veten përmes vendimeve gjyqësore të drejta, të argumentuara dhe të zbatueshme, të cilat tregojnë se sjelljet devijante nuk tolerohen dhe ndëshkohen në mënyrë proporcionale. Teoritë mbi këtë formë parandalimi kanë qenë të shumta, përfshirë teorinë e frikës përmes parashikimit të dënimit, teorinë e frikës përmes ekzekutimit të dënimit, si dhe teorinë e reagimit shoqëror negativ ndaj sjelljes penale²⁵¹.

Në realitetin bashkëkohor, parandalimi i përgjithshëm nuk konceptohet më thjesht si pasojë e frikës ndaj ndëshkimit, por si një rezultat i besimit qytetar në drejtësinë dhe efektivitetin e sistemit penal. Mendimtarë si Cesare Beccaria, në shekullin XVIII, i dhanë hov këtij transformimi filozofik, duke e orientuar dënimin drejt proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe humanizmit, parime që më vonë u përfshinë edhe në konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut²⁵². Sot, organizma ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, Komiteti i Parandalimit të Krimit i OKB-së dhe institute kombëtare të politikave penale kontribuojnë në hartimin dhe promovimin e strategjive gjithëpërfshirëse për parandalimin e kriminalitetit, jo vetëm në nivel teorik, por edhe përmes masave konkrete në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

Kuptimi i parandalimit të posaçëm dhe sfidat në ekzekutimin penal

Krahas funksionit të parandalimit të përgjithshëm, një komponent thelbësor i qëllimit të dënimit është parandalimi i posaçëm, i cili synon të pengojë rikryerjen e veprave penale nga vetë personi i dënuar. Ky dimension i politikës penale është i fokusuar jo më te shoqëria në tërësi, por te subjekti konkret që ka shkelur ligjin, dhe përbën një aspekt qendror në fazën e ekzekutimit të vendimit penal. Që në etapat e hershme të zhvillimit të së drejtës penale, dënimi ka shërbyer si një formë ndëshkimi edukues për individin, në mënyrë që ai të mos përsërisë sjelljet devijante. Megjithatë, metodat e përdorura në të kaluarën – si dënimet trupore, torturat apo ndëshkimet degradues – ndonëse efektive në frenimin e menjëhershëm, nuk arritën të sigurojnë rehabilitimin e qëndrueshëm të individit dhe shpesh rezultuan në marginalizim të mëtejshëm²⁵³.

Në realitetin bashkëkohor, parandalimi i posaçëm kërkon më shumë sesa ndëshkim: kërkon ndërhyrje sistematike, të planifikuara dhe të orientuara drejt rehabilitimit, me qëllim reduktimin e recidivizmit. Kjo përbën një sfidë të madhe në praktikën penale shqiptare, ku shumë të dënuar përbëjnë një kategori të rrezikuar për shoqërinë, me prirje të forta për të përsëritur veprimtarinë kriminale. Numri i lartë i recidivistëve, i theksuar në raportet e sistemit penitenciar shqiptar, tregon qartë sfidën e madhe që paraqet realizimi i këtij qëllimi. Prandaj, për një trajtim të suksesshëm, kërkohet bashkëpunim ndërinstitutional, përfshirë strukturat e shërbimit të provës, psikologët korrektues, qendrat komunitare, si dhe mbështetjen e institucioneve të specializuara në fushën e shëndetit mendor dhe arsimit profesional.

²⁵¹ Von Hirsch, A., & Ashworth, A. (2005). *Proportionate Sentencing: Exploring the Principles*. Oxford University Press.

²⁵² Beccaria, C. (1764). *Dei delitti e delle pene*. (Për: Mbi krimet dhe ndëshkimet). Përkthyer në shqip, Botimet "Fan Noli", Tiranë, 2002.

²⁵³ Tonry, M. (2006). *Purposes and Functions of Sentencing*. *Crime and Justice*, Vol. 34, pp. 1–52.

Në këtë drejtim, disa praktika pozitive janë shënuar në institucionet shqiptare si IEVP Peqin dhe IEVP Lezhë, ku janë aplikuar programe të veçanta për arsimimin dhe aftësimin profesional të të dënuarve, si dhe programe psiko-sociale për vlerësimin dhe monitorimin e rrezikut të përsëritjes së veprës penale. Për shembull, në IEVP Lezhë është ngritur një strukturë e dedikuar për përgatitjen e të dënuarve për lirimin me kusht, që synon të bëjë vlerësime individuale mbi nivelin e risocializimit dhe përfshirjen në shoqëri. Ndërkohë, në IEVP Peqin janë zhvilluar projekte në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile për trajnimin në zeje të ndryshme si marangozëri dhe hidraulikë, të cilat synojnë të rrisin mundësinë e integritetit të të dënuarve pas lirim.

Po ashtu, Avokati i Popullit, në raportet vjetore për të drejtat e personave të privuar nga liria, ka evidentuar se mungesa e stafit të kualifikuar psiko-social dhe e strukturave të mjaftueshme mbështetëse për risocializim përbën një pengesë serioze për realizimin e parandalimit të posaçëm në mënyrë efektive. Avokati i Popullit ka rekomanduar përmirësimin e kushteve të trajtimit individual të të dënuarve, përmes rritjes së burimeve njerëzore në shërbimin social në burgje dhe krijimit të mekanizmave të rregullt të monitorimit për progresin e risocializimit²⁵⁴.

Parandalimi i posaçëm, sot më shumë se kurrë, kërkon trajtim profesional, të personalizuar dhe të integruar, i cili nuk duhet të përfundojë me vuajtjen e dënimit, por duhet të shtrihet edhe në periudhën e pas-lirim. Vetëm në këtë mënyrë, dënimi mund të arrijë një nga qëllimet e tij më thelbësore: transformimin e individit nga një subjekt i rrezikshëm penal në një anëtar aktiv dhe i përgjegjshëm i shoqërisë.

²⁵⁴ Avokati i Popullit (2023). *Raporti Vjetor për të Drejtat e Personave të Privuar nga Liria*. Seksioni për institucionet e vuajtjes së dënimit, Tiranë.

Qëllimi i dënimit sipas legjislacionit shqiptar

Në legjislacionin penal shqiptar, ndryshe nga shumë sisteme të tjera, nuk ka një dispozitë të posaçme që të përcaktojë në mënyrë të shprehur qëllimin e dënimit, as në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, as në Kodin Penal dhe as në ligje të tjera të fushës. Megjithatë, fryma që përshkon të gjithë sistemin ligjor penal dhe parimet mbi të cilat mbështetet e drejta penale shqiptare, tregojnë qartë se qëllimi i dënimit përputhet me qëllimet që përkrah politika penale bashkëkohore: mbrojtja e shoqërisë, parandalimi i kriminalitetit, rehabilitimi dhe risocializimi i të dënuarit.

Kodi Penal shqiptar, si produkt i një reforme të vonshme në krahasim me kodet e vendeve perëndimore, ka përfituar nga përvoja e mëparshme e vetë sistemit penal shqiptar, por edhe nga përvojat ndërkombëtare. Ndryshe nga kuadri aktual, legjislacioni penal i periudhës së viteve 1950 parashikonte në mënyrë eksplicite qëllimin e dënimit. Për shembull, neni 3 i ligjit për organizimin gjyqësor përcaktonte se:

“Gjykata, duke dhënë dënimet penale, nuk dënon vetëm fajtorët, por njëkohësisht ka për qëllim të përmirësojë dhe të riedukojë fajtorët.”²⁵⁵

Ky formulim, edhe pse i krijuar në kontekstin e një regjimi autoritar, paraqet një koncept funksional të dënimit që është mbështetur edhe në sistemet moderne të së drejtës penale – ndëshkimi i bazuar në riedukim.

Në mungesë të një dispozite të posaçme që të përcaktojë qëllimin e dënimit, ky qëllim nxirret në mënyrë interpretuese, duke u mbështetur në nenin 1, shkronja “b” të Kodit Penal, i cili përcakton se:

²⁵⁵ Gazeta zyrtare, nr 20, 30 korrik 1951

“Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën... nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre.”²⁵⁶

Ky formulim jep një bazë të qartë për të kuptuar se objektivat e legjislacionit penal përfshijnë si mbrojtjen e vlerave themelore të rendit shoqëror, ashtu edhe funksionin parandalues të ndëshkimit penal.

Gjithashtu, parimet themelore të Kodit Penal, të cilat zbatohen në mënyrë të pandarë edhe gjatë caktimit dhe ekzekutimit të dënimit, si parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit, drejtësisë dhe humanizmit, ofrojnë një kuadër të qartë mbi qëllimin real të ndëshkimit. Këto parime, të kombinuara me standardet ndërkombëtare të drejtësisë penale dhe të drejtave të njeriut, orientojnë gjykatat shqiptare që në vendimmarrjen e tyre të kenë parasysh jo vetëm ndëshkimin, por edhe funksionin rehabilitues dhe integruar të dënimit, sidomos në fazën e zbatimit të vendimeve penale.

Në përputhje me këto zhvillime, edhe pse ligjvënësi shqiptar nuk e ka përfshirë shprehimisht qëllimin e dënimit në një nen të posaçëm, ai e ka orientuar gjykimin dhe zbatimin penal drejt një balancimi mes mbrojtjes së rendit publik dhe mbrojtjes së dinjitetit të individit. Kjo qasje është plotësisht në harmoni me të drejtën ndërkombëtare dhe me instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut, në të cilat Shqipëria është palë.

Konkluzione dhe Rekomandime

Sistemi penal shqiptar, në dritën e përpjekjeve për integrimin evropian dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare, ka ndërmarrë hapa

të rëndësishëm për përafrimin e kuadrit ligjor me praktikën bashkëkohore të së drejtës penale. Pavarësisht këtyre përparimeve, ekzekutimi i vendimeve penale mbetet një ndër hallkat më sfiduese të sistemit të drejtësisë, ku problematikat e natyrës ligjore, institucionale dhe sociale ndikojnë ndjeshëm në përmbushjen e funksioneve thelbësore të dënimit.

Së pari, është evidente se legjislacioni shqiptar ka përfituar nga modelet e vendeve demokratike, duke përfshirë parimet themelore të së drejtës penale dhe duke ratifikuar një sërë aktesh ndërkombëtare të rëndësishme. Megjithatë, vërehet se karakteri ndëshkues dhe represiv vijon të dominojë në shumë dispozita të Kodit Penal, ku individualizimi i dënimit dhe trajtimi risocializues i të dënuarve nuk janë gjithmonë të garantuara në praktikë.

Së dyti, pavarësisht organizimit të trajnimeve dhe përpjekjeve institucionale për forcimin e mekanizmave të ekzekutimit të dënimeve, mungojnë politika gjithëpërfshirëse me fokus social dhe rehabilitues. Shpesh, masa ndëshkuese zbatohen pa një analizë të thelluar të rrethanave individuale të të dënuarit, çka ndikon negativisht në efikasitetin e dënimit si mjet risocializimi.

Së treti, gjykatat shpesh përballen me vështirësi në individualizimin e dënimit për shkak të diferencave të mëdha mes dënimeve minimale dhe maksimale që parashikohen në dispozitat penale. Kjo hapësirë e gjerë diskrecioni, pa udhëzime të qarta interpretimi, çon në zbatime jo të njëtrajtshme dhe rrezikon cenimin e parimit të barazisë para ligjit.

Së fundi, dënimet plotësuese dhe dënimi me gjobë nuk zbatohen në mënyrë të qëndrueshme apo të njësuar, për shkak të paqartësive ligjore dhe mungesës së një strukture ekzekutive efektive, duke i kthyer këto forma ndëshkimi në

²⁵⁶ Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë, Tetor 2004, neni 1/b, fq 10

masa shpesh të papërdorura ose të zbatuara në mënyrë formale.

Rekomandime

1. Harmonizimi i qëllimeve të dënimit me funksionin e tij rehabilitues në fazën e ekzekutimit, përmes përfshirjes së qartë të konceptit të risocializimit në tekstin e Kodit Penal dhe në praktikat e vendimmarrjes gjyqësore.

2. Përgatitja dhe zbatimi i planeve individuale të ekzekutimit të dënimit, të bazuara në vlerësimin e rrezikshmërisë penale, profilin psikologjik dhe nevojave të rehabilitimit të personit të dënuar.

3. Rishikimi i disa dispozitave të Kodit Penal, në mënyrë që të reduktohen diferencat e tepërta ndërmjet kufijve minimal dhe maksimal të dënimit, veçanërisht në ato raste ku diferenca kalon dhjetë vite, duke garantuar më shumë drejtësi dhe parashikueshmëri.

4. Klasifikimi më i qartë i veprave penale sipas shkallës së rrezikshmërisë shoqërore, duke ndarë qartë midis veprave me rrezikshmëri të lartë dhe atyre që duhet të trajtohen si kundërvajtje ose shkelje administrative.

5. Riorganizimi i kuadrit ligjor për dënimin me gjobë, në mënyrë që ky lloj dënimi të jetë i përcaktuar në mënyrë të njëtrajtshme në të gjitha nenet përkatëse, dhe të mund të aplikohet në mënyrë efektive si alternativë ndaj burgimit për vepra të lehta.

6. Rritja e rolit të dënimeve plotësuese përmes rishikimit të dispozitave që i rregullojnë, si dhe përmes detyrimit të gjykatave për të arsyetuar aplikimin ose jo të tyre në çdo rast.

7. Zbatimi i një strategjie kombëtare për edukimin ligjor të shoqërisë, me fokus të veçantë te fëmijët, të rinjtë dhe grupet në risk, si pjesë e një politike parandaluese të qëndrueshme ndaj kriminalitetit.

8. Zbatimi i rekomandimeve të Këshillit të Europës dhe Avokatit të Popullit, veçanërisht atyre që lidhen me trajtimin e të burgosurve dhe krijimin e kushteve për risocializimin efektiv.

9. Forcimi i mekanizmave mbikëqyrës për fazën e pas-lirimit, përmes zgjerimit të kapaciteteve të shërbimit të provës dhe ndërlidhjes së tij me institucionet e punësimit, shëndetit mendor dhe integritetit social.

Ky grup rekomandimesh synon të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi penal më efikas, të drejtë dhe njerëzor, ku dënimi të mos shihet si qëllim në vetvete, por si mjet për mbrojtjen e shoqërisë dhe transformimin pozitiv të individit.

Instituti i martesës në rastin e vdekjes së prezumuar të bashkëshortit

Enerjeta Jançaj

Program i Integruar i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Drejtësi"

Fakulteti i Shkencave Humane

Udhëheqës shkencor: PhD. Ilir Kanaj

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Martesa si një e drejtë kushtetuese njeh garanci të larta ligjore për gëzimin dhe mbrojtjen e saj. E drejta për një jetë private dhe personale, parashikuar edhe në Konventën Europiane të Drejtave të Njeriut është interpretuar edhe si e drejta e çdo individi për të lidhur martesë. Nga ana tjetër ashtu si divorci apo zgjidhja e martesës për shkak të moskonsumimit të martesës në çiftë edhe zgjidhja e martesës për shkak të shpalljes së vdekjes së prezumuar të bashkëshortit sjellë pasoja si në martesën dhe trashgimin, por edhe të rimartesën nëse bashkëshorti i shpallur i vdekur rezulton gjallë. Instituti i kthimit të martesës në rastet e shfaqes së bashkëshortit të shpallur të vdekur, si dhe studimi i parashikimit ligjor aktual për këtë institut ka shtyrë të bëjmë një studim lidhur me këtë parashikim ligjor. Martesa dhe

procedura e lidhjes së saj duhet për shkak vlefshmërie dhe ligjshmërie të kryhet në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi. Gjithashtu, kthimi i martesës duhet të plotësojë kushtet ligjore për vlefshmërinë e saj.

Vdekja e prezumuar nuk është vetëm një status juridik, por një vendim i cili do të prodhojë më pas pasoja si në trashgimin dhe pasurinë e personit të shpallur të vdekur, si në martesën e tij/saj. Kryesisht në legjislacionin civil të shteteve janë parashikuar kushtet dhe kriteret për shpalljen e vdekjes së prezumuar, prishja e martesës pas disponimit të vendimit për vdekjen e prezumuar, si dhe e drejta për rimartesë. Gjithashtu, për të mbrojtur të drejtat e trashgimisë edhe ato pasurore, legjislatori ka njohur dhe hartuar garanci ligjore për kthimin e të drejtave të humbura nëse personi që është

shpallur i vdekur rezulton gjallë.

Rimartesa si një e drejtë e bashkëshortit tjetër, pas shpalljes së vdekur të partnerit të tij, është një e drejtë e prejardhur, e cila duhet të plotësojë kushtet ligjore, edhe pse të ndryshme në legjislatura apo kultura të ndryshme juridike.

Fjalët kyçe: *Martesa, vdekje e prezumuar, përfundim i martesës, bashkëshort, rimartesa.*

Abstract

Marriage as a constitutional right recognizes high legal guarantees for its enjoyment and protection. The right to a private and personal life, also provided for in the European Convention on Human Rights, has also been interpreted as the right of every individual to enter into marriage. On the other hand, just as divorce or dissolution of marriage due to non-consummation of the spouse in the couple, dissolution of marriage due to the declaration of the presumed death of the spouse has consequences both in marriage and inheritance, but also in remarriage if the spouse declared dead turns out to be alive.

The institution of the restoration of marriage in cases of the appearance of the spouse declared dead, as well as the study of the current legal provision for this institution has prompted us to conduct a study regarding this legal provision. Marriage and the procedure for its conclusion must, for reasons of validity and legality, be carried out in accordance with the legal and sub-legal acts in force. Also, the restoration of marriage must meet the legal conditions for its validity.

Presumed death is not only a legal status, but a decision that will subsequently produce consequences both in the inheritance and property of the person declared dead, as well as

in his/her marriage. Mainly in the civil legislation of the states, the conditions and criteria for the declaration of presumed death, the dissolution of marriage after the disposition of the decision on presumed death, as well as the right to remarry are provided. Also, in order to protect inheritance rights and property rights, the legislator has recognized and drafted legal guarantees for the return of lost rights if the person who has been declared dead turns out to be alive.

Remarriage as a right of the other spouse, after the declaration of his/her partner's death, is a derived right, which must meet the legal conditions, although different in different legislatures or legal cultures.

Keywords: *Marriage, presumed death, termination of marriage, spouse, remarriage.*

Martesa sipas percaktimit ligjor

Martesa sipas parashikimit ligjor është një bashkëjetëse ligjore e cila mbështetet në barazinë morale dhe ligjore të partnerëve në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit. Zgjidhja e saj kërkon iniciativën ligjore të paktën nga njëri prej partnerët dhe vullnetin e të paktën një bashkëshorti për ta zgjidhur atë dhe proceduralisht kërkohet prezenca e dy bashkëshortëve në proces, ndërkohë përfundimi i martesës për shkak të shpalljes së vdekur të njërit prej bashkëshortëve është një procedurë ligjore, ku provohet vdekja për shkak të ligjit, pa pasur një vdekje fizike të bashkëshortit dhe pa pasur vullnetin e këtij të fundit në përfundimin e martesës. Legjislatori është kujdesur që në rast të kthimit të bashkëshortit të shpallur të vdekur, martesa të rifitojë statusin e saj, por me kushtin që partneri të mos jetë martuar përsëri.

Ky parashikim nuk është i tillë në gjitha shtetet, apo në të gjitha regjimet juridike, por zhvillimi i së drejtës e ka elaboruar këtë institut dhe zhvillimi i të drejtës gjyqësore ka interpretuar normën e kthimit të martesës në rast të rrëzimit të vendimit të shpalljes së vdekur të një bashkëshorti.

Hipotezat

- *Koha e kaluar nga zhdukja e bashkëshortit/tes shërben si kusht ligjor për kërkimin e vdekjes së prezumuar në gjykatë.*
- *Ligji përcakton kushtet, kriteret dhe subjektet që legjitimohen për të kërkuar vdekjen e prezumuar të një personi dhe kontrolli i këtyre kushteve duhet të jenë të rrepta dhe të qarta për shpalljen e vdekjes së prezumuar, sepse kjo do të minimizonte mundësitë për abuzim dhe siguron drejtësi për palët e përfshira.*
- *Vendimi për shpalljen e vdekjes së prezumuar të bashkëshortit/tes sjell në shumë shtete si pasojë zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, por jo çdo legjislaturë ka një përcaktim të tillë.*

Garancia ligjore e martesës si një e drejtë private dhe familjare

E drejta për jetë private dhe familjare, garantohet nga një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare dhe njeh garanci të larta ligjore, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, etj.

Po, jo çdo periudhë kohore ka njohur këtë standard për të drejtat e individit. Sot jeta private është një e drejtë që garantohet nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (në

vijim KEDNJ) në nenin 8 e cila parashikon se “Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.” dhe më tej në nenin 12 të KEDNJ-së në mënyrë të qartë u parashikohet se “Burri dhe gruaja që kanë mbushur moshën për martesë kanë të drejtë të martohen dhe të krijojnë familje sipas ligjeve kombëtare që rregullojnë ushtrimin e kësaj të drejte” dhe në protokollin e 7, në nenin 5 u parashikua barazia midis bashkëshortëve dhe shprehimisht u sanksionua se “Bashkëshortët do të gëzojnë barazi të drejtash dhe përgjegjësisë të karakterit të së drejtës private midis tyre dhe në marrëdhëniet me fëmijët e tyre, në lidhje me martesën, gjatë martesës dhe në rastin e zgjidhjes së saj. Ky nen nuk do t'i ndalojë shtetet që të marrin masa të nevojshme në interesin e fëmijëve.”

Republika e Shqipërisë është bërë pjesë e Konvetës Europiane të të Drejtave të Njeriut në vitin 1996²⁵⁷, duke pranuar detyrimet që lindin nga kjo konventë për të harmonizuar legjislacionin vendas në përputhje me këto detyrime.

E drejta për martesë mbrohet edhe nga Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e cila në nenin 16 të saj ka parashikuar se:

1. *Burrat dhe gratë e moshës madhore kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të krijojnë familje, pa kurrfarë kufizimesh në pikëpamje të racës, të shtetësisë ose të fesë. Ata kanë të drejta të*

²⁵⁷ Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, së bashku me protokollet nr. 1, nr. 2, nr. 4, nr. 7 dhe nr. 11 është ratifikuar me ligjin nr.8137, datë

31.7.1996, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 20, datë 12 gusht 1996.

barabarta ndaj martesës, gjatë martesës dhe në kohën kur ajo priset.

2. Martesa duhet të lidhet vetëm me pëlqimin e lirë dhe të plotë të bashkëshortëve të ardhshëm.

3. Familja është njësi e natyrshme dhe thelbësore e shoqërisë dhe ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti.

Legjislatori në këtë rast është kujdesur që barazia e palëve të jetë e garantuar në çdo fazë të martesës dhe atëherë kur ajo ka humbur qëllimin për të cilin është krijuar duke u përpjekur të garantoj barazinë e palëve dhe të “armëve” edhe në këtë rast.

Neni 12 i Deklaratës Universale e të Drejtave të Njeriut garanton të drejtën për të formuar familje, por kjo e drejtë nënkupton detyrimin e shtetit për të mos ndërhyrë në gëzimin e kësaj të drejte dhe nuk përmban detyrime pozitive për shtetin për të siguruar këtë të drejtë.

Barazia ndërmjet bashkëshortëve, përveç dispozitave që garantojnë barazinë para ligjit të gjithë individëve, garantohet edhe nga neni 5 i Protokollit nr. 7 i KEDNj-së, e cila ka parashikuar barazinë e palëve në një martesë.

Dispozitat që lidhen me respektimin e jetës private dhe familjare (të parashikuara në nenin 7), dhe e drejta për të lidhur martesë (e parashikuar në nenin 9), marrin një dimension të ri. Karta aplikohet në mënyrë universale që çon më tej argumentin se përdorimi i shprehjes “çdo individ” dhe jo “çdo shtetas që ka shtetësinë e një prej shteteve anëtare të BE-së”, tregon se sfera e saj subjektive e zbatimit nuk kufizohet vetëm në lidhje me shtetasit që mbartin shtetësinë e një prej shteteve anëtare të BE-së (Canaj, 2014: 42).

Gjyakata Europiane e të Drejtave të Njeriut parashikon se e drejta për martesë garantohet

nga ligji por mund të kufizohet po pa u cënuar nga e ligjet kombëtare si p.sh, mosha lidhur me martesën, incestin, poligaminë, etj.

Neni 12 parashikon shprehimisht rregullimin e martesës nga ligji kombëtar dhe duke pasur parasysh ndjeshmërinë morale për çështjen dhe rëndësinë që duhet ti kushtosh fëmijëve dhe nxitjes së mjedisve të sigurta familjare, ko gjykatë nuk duhet të nxitoj të zëvendësoj me gjykimin e saj autoritetet që janë në dispozicion për të vlerësuar dhe përgjigjur nevojave të shoqërisë.

Sipas GJEDNJ martesa, e drejta për martesë dhe mbrotja e saj janë të lidhura ngushtësisht me kulturën, emancipimin dhe historin e një shteti, ashtu siç edhe legjislacioni kombëtar që rregullon këto çështje buron nga historia dhe kultura e shtetit përkatës.

Standartet europiane mbi konstatimin e personit të zhdukur dhe shpalljen e tij të vdekur.

Për shkak të lëvizshmërisë së madhe të njerëzve të shkakuar nga zhvillimi i udhëtimeve dhe qëndrimeve të gjata jashtë vendit, si dhe rritjes së rreziqeve nga sulmet terroriste dhe fatkeqësitë natyrore apo të shkaktuara nga njeriu, është e nevojshme të plotësohet dhe të harmonizohet më tej legjislacioni mbi prezumimin e vdekjes së personave të zhdukur në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Gjithashtu, ka raste të tjera në të cilat njerëzit zhduken, përfshirë konfliktet e armatosura.²⁵⁸

Në këtë kontekst, u krijua një grup pune për personat e zhdukur, nën autoritetin e Komitetit Evropian për Bashkëpunim Ligjor (CDCJ), me detyrën për të përpiluar një rekomandim që

²⁵⁸ Council of Europe, “Principles concerning missing persons and the presumption of death”, faqe 2

ndihmon shtetet anëtare në trajtimin e rasteve të personave të zhdukur dhe në lëshimin e deklaratave për vdekjen e prezumuar.

I Duke konsideruar synimin e Këshillit të Evropës për të arritur një unitet më të madh midis shteteve anëtare, veçanërisht përmes promovimit të rregullave të përbashkëta në çështjet ligjore;

- Duke njohur rritjen e rreziqeve të zhdukjes së njerëzve për shkak të fatkeqësive natyrore, konflikteve të armatosura dhe situatave të dhunës së përgjithësuar;

- Duke marrë në konsideratë Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjitha Personave nga Zhdukjet e Detyruara (2006) dhe rëndësinë e respektimit të obligimeve ndërkombëtare mbi këtë çështje;

- Duke pranuar se në shumë shtete anëtare mungon një legjislacion i përshtatshëm mbi këtë çështje rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare të marrin ose të forcojnë masat e nevojshme për zbatimin e parimeve të përfshira në aneksin e këtij rekomandimi.

Kështu është përkufizuar nocioni "person i zhdukur" i cili sipas Këshillit të Europës është një person fizik, ekzistenca e të cilit është bërë e pasigurt për shkak se ai ose ajo është zhdukur pa asnjë gjurmë dhe nuk ka asnjë shenjë se është ende gjallë.

Parimet drejtuese²⁵⁹ sipas Deklaratës së Këshillit European për prezumimin e vdekjes.

Parimi 1 – Rastet në të cilat mund të lëshohet një deklaratë për vdekjen e prezumuar

Deklarata për vdekjen e prezumuar të një personi të zhdukur mund të lëshohet, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e zhdukjes:

Së pari: Vdekja mund të konsiderohet e sigurt; Së dyti. Është e arsyeshme të përfundohet se

vdekja e personit të zhdukur është e mundshme; Së treti: Megjithëse vdekja është e pasigurt, zhdukja nuk mund të atribuohet ndonjë shkak tjetër përveç vdekjes.

Parimi 2 – Autoriteti kompetent

Një autoritet kompetent mund të caktohet për të lëshuar një deklaratë për vdekjen e prezumuar, bazuar në kriteret e mëposhtme:

1. Kur personi i zhdukur ishte shtetas, kishte vendbanim ose vendqëndrim të zakonshëm në atë shtet;
2. Kur personi ishte shpallur i zhdukur në territorin e atij shteti;
3. Kur personi u shpall i zhdukur gjatë një udhëtimi me një anije ose avion të regjistruar në atë shtet.

Parimi 3 – Personi, organi ose autoriteti që mund të bëjë kërkesën.

Një kërkesë për deklaratë për vdekjen e prezumuar mund të bëhet nga çdo person ose organ që demonstroi një interes legjitim ose nga një autoritet i caktuar nga shteti për këtë qëllim.

Parimi 4 – Periudha e pritjes për paraqitjen e kërkesës

1. Kur vdekja e personit të zhdukur është e sigurt, kërkesa duhet të lejohet pa një periudhë pritjeje.

2. Kur rrethanat e zhdukjes e bëjnë mundshme vdekjen, periudha e pritjes duhet të jetë jo më shumë se një vit.

3. Kur vdekja është e pasigurt, por nuk ka ndonjë shkak tjetër të mundshëm për zhdukjen, periudha e pritjes duhet të jetë jo më shumë se shtatë vjet.

Parimi 5 – Data dhe ora e vdekjes së prezumuar

Data dhe nëse është e mundur, ora e vdekjes së

²⁵⁹ Council of Europe, "Principles concerning missing persons and the presumption of death", faqe 9

prezumuar duhet të përcaktohen duke iu referuar të gjitha provave dhe rrethanave të rastit.

Parimi 6 – Efektet e deklaratës për vdekjen e prezumuar

1. Me ligj, deklarata për vdekjen e prezumuar duhet të ketë të gjitha efektet ligjore të vdekjes.

2. Shtetet mund të bëjnë përjashtime të kufizuara lidhur me martesën, partneritetet e regjistruara, të drejtat pronësore dhe trashëgiminë.

Parimi 7 – Kthimi i personit të zhdukur

1. Nëse personi i deklaruar i vdekur rikthehet, ose nëse dalin informacione që dëshmojnë se ai është ende gjallë, shtetet duhet të marrin masa për të anuluar vendimin e vdekjes së prezumuar.

2. Kërkesa për anulimin e deklaratës mund të bëhet nga personi i prekur ose nga një autoritet kompetent.

Ky dokument synon të sigurojë qartësi ligjore për personat e zhdukur dhe familjet e tyre, duke lehtësuar procedurat për shpalljen e vdekjes së prezumuar dhe duke ofruar masa mbrojtëse në rast të kthimit të personit të zhdukur.

GJEDNJ pranon vdekjen e prezumuar ku zhdukja ndodh në situata si konflikte të armatosura, arrestime të forcave shtetore, katastrofa, pra gjatë fenomeneve me rrezik të lartë për jetën. Kjo gjë është pranuar nga GJEDNJ edhe në çështjen Baysayeva v. Russia, ku shtetasi Shakhid Baysayeva u zhduk në vitin 2000 në eçeni në bazë të kontaktit me forcat ruse. Gjykata gjeti shkelje të nenit 2 të Konventës (e drejta për jetë) për shkak të mungesës së investigimit efektiv dhe nuk kishte trup, por vdekja u prezumua për shkak të rrethanave. Në rastin konkret, Gjykata nuk mori

asnjë vendim në lidhje me shterimin e mjeteve juridike vendase në fazën e pranueshmërisë. Gjykata kujton se rregulli i shterimit të mjeteve juridike vendase i përmendur në nenin 35 § 1 të Konventës i detyron aplikantët së pari të përdorin mjetet juridike që janë normalisht të disponueshme dhe të mjaftueshme në sistemin ligjor vendas për t'u mundësuar atyre të marrin dëmshpërblim për shkeljet e pretenduara.

Ekzistenca e mjeteve juridike duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt, në praktikë si dhe në teori, në rast se kjo nuk arrihet, atyre do t'u mungojë aksesueshmëria dhe efektiviteti i kërkuar. Neni 35.1 kërkon gjithashtu që ankesat që synohen të sillen më pas para Gjykatës duhet t'i jenë bërë organit përkatës vendas, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale të përcaktuara në ligjin vendas, por jo që të përdoren mjete juridike që janë të pamjaftueshme ose joefektive.

Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve juridike vendase duhet të zbatohet me një farë shkalle fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar. Ajo ka njohur më tej se rregulli i shterimit nuk është as absolut dhe as i aftë të zbatohet automatikisht; për qëllimet e shqyrtimit nëse është respektuar, është thelbësore të merren në konsideratë rrethanat e rastit individual.

Kjo do të thotë, në veçanti, se Gjykata duhet të marrë në konsideratë në mënyrë realiste jo vetëm ekzistencën e mjeteve juridike formale në sistemin ligjor të shtetit kontraktues në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm në të cilin ato veprojnë, si dhe rrethanat personale të aplikantit. Pastaj duhet të shqyrtojë nëse, në të gjitha rrethanat e rastit, aplikanti bëri gjithçka që mundej ose pritet në mënyrë të arsyeshme prej tij ose saj që të shterojë mjetet juridike vendase.

Gjykata vëren se sistemi ligjor rus parashikon, në parim, dy rrugë ankimi për viktimat e akteve të paligjshme dhe kriminale që i atribuohen shtetit ose agjentëve të tij, përkatësisht procedurën civile dhe mjetet juridike penale.

Gjykata kujton më tej se edhe duke supozuar se aplikanti kishte ndjekur procedura të tilla dhe kishte pasur sukses në rikuperimin e dëmeve civile nga një organ shtetëror, kjo prapë nuk do ta zgjidhte çështjen e mjeteve efektive në kontekstin e kërkesave të ngritura sipas nenit 2 të Konventës.

Një gjykatë civile nuk është në gjendje të ndjekë ndonjë hetim të pavarur dhe është e paaftë, pa përfitimin e përfundimeve të një hetimi penal, të nxjerrë ndonjë përfundim kuptimplotë në lidhje me autorët e sulmeve fatale, e aq më pak të përcaktojë përgjegjësinë e tyre.

Për më tepër, detyrimi i një shteti kontraktues sipas neneve 2 dhe 13 të Konventës është për të kryer një hetim të aftë të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës në rastet e sulmeve fatale mund të bëhet iluzor.

Në dritën e sa më sipër, Gjykata konstaton se aplikantja nuk ishte e detyruar të ndiqte mjetet juridike civile të sugjeruara nga qeveria me qëllim që të shteronte mjetet juridike të brendshme, dhe kundërshtimi paraprak në këtë drejtim është i pabazuar.

Lidhur me mjetet juridike penale, Gjykata vëren se kërkesja u ankua te agjencitë e zbatimit të ligjit sapo burri i saj u zhduk dhe se një hetim ka qenë në pritje që nga maji 2000. Kërkesja dhe qeveria nuk pajtohen në lidhje me efektivitetin e këtij hetimi.

Gjykata konsideron se kjo pjesë e kundërshtimit paraprak të qeverisë ngre çështje në lidhje me efektivitetin e hetimit penal, të cilat janë të lidhura ngushtë me meritat e padisë së aplikantit.

Kërkesja pretendoi se burri i saj ishte vrarë në mënyrë të paligjshme nga agjentë të shtetit. Ajo gjithashtu deklaroi se autoritetet nuk kishin kryer një hetim efektiv dhe të përshtatshëm mbi rrethanat e zhdukjes së tij. Ajo u mbështet në nenin 2 të Konventës, i cili parashikon:

“1. E drejta e kujtdo për jetën mbrohet me ligj. Askush nuk mund të privohet nga jeta e tij qëllimisht, përveçse në ekzekutimin e një vendimi të një gjykate pas dënimit të tij për një krim për të cilin ky dënim parashikohet me ligj.

2. Privimi nga jeta nuk do të konsiderohet si i shkaktuar në kundërshtim me këtë nen kur rezulton nga përdorimi i forcës që është jo më shumë se absolutisht i nevojshëm:

- (a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;
- (b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të ndaluar ligjërisht;
- (c) në veprim të ndërmarrë ligjërisht me qëllim shtypjen e një trazire ose kryengritjeje.

Pra, GJEDNJ vlerëson rolin aktiv të shtetit për mbrotjen e jetës së personit dhe kryerjen e veprimeve aktive, procedurale efektive në mbrojtje të jetës. Pra, GJEDNJ, e vë theksin të procedurat e ndjekur nga shtetet për mbrotjen e jetës dhe më pas për gjetjen e personit dhe mbetet fleksibël në vendosjen e afateve për vdekjen e prezumuar, duke lënë gjithmonë hapsirën për rivlerësim në rast të kthimit të personit dhe rezultimit të tij gjallë pas marrjes së vendimit për vdekjen e prezumuar.

Çdo deklaratë duhet të deklarojë se kur personi i zhdukur duhet të konsiderohet i vdekur kjo është e rëndësishme sepse, interesat pronësore, për shembull, mund të preken ndryshe sipas kohës kur një person përcaktohet se ka vdekur. Nëse gjykata është e bindur se personi i zhdukur ka vdekur, por nuk është e sigurt se kur, ajo duhet ta konsiderojë personin të vdekur në fund të periudhës në të cilën gjykata mendon se ai ose ajo mund të ketë vdekur. Nga ana tjetër, nëse gjykata është e bindur se personi i zhdukur nuk dihet të jetë gjallë për një periudhë prej të paktën shtatë vjetësh, por nuk është e bindur se personi

ka vdekur, koha dhe data e vdekjes së konsideruar do të jetë fundi i periudhës prej shtatë vjetësh duke filluar nga dita pas ditës në të cilën ai ose ajo dihet të jetë gjallë për herë të fundit.²⁶⁰

Një deklaratë duhet të jetë provë përfundimtare e vdekjes së supozuar të personit të zhdukur dhe kohës dhe datës së asaj vdekjeje të supozuar. Deklarata është e vlefshme për të gjitha qëllimet dhe kundër të gjithë personave, dhe se efekti i deklaratës shtrihet në çështjet e pronësisë së pronës dhe përfundimin e martesës ose partneritetit civil të personit të zhdukur. Megjithatë, një deklaratë është përfundimtare dhe efektive vetëm në kuptimin që nuk i nënshtrohet më apelimit.¹⁷ Ose periudha për të bërë një apel kundër vendimit të gjykatës për të bërë deklaratën duhet të ketë skaduar pa u bërë apelim ose, nëse është bërë një apelim, apelimi (dhe çdo apelim i mëtejshëm) duhet të jetë hedhur poshtë ose tërhequr dhe çdo periudhë për një apelim të mëtejshëm duhet të ketë përfunduar.

Sipas legjislacionit anglez, gjykata që bën një deklaratë të vdekjes së supozuar përcakton vendbanimin e personit të zhdukur në kohën e vdekjes së supozuar dhe duhet të shprehet për çdo çështje që lidhet me interesat dhe pronësinë që lind si rezultat i deklaratës së vdekjes së supozuar dhe gjithashtu mund të nxjerrë çdo urdhër që e konsideron të arsyeshëm në lidhje me çdo interes në pronën e fituar si rezultat i deklaratës. Gjatë nxjerrjes së një urdhri gjykata mund të specifikojë (nënkushte ose në përgjithësi që vlera e një pasurie të fituar si rezultat i deklaratës nuk mund të rikuperohet në kohën e duhur sipas një urdhri të nxjerrë nga gjykata kur ndryshon ose revokohet një

deklaratë.²⁶¹

Termi "interes në pronë" përkufizohet si një interes në pronë të çdo përshkrimi, duke përfshirë një pronë të lirë ose me qira në tokë dhe një të drejtë mbi pronën. Termi "një interes" nuk është përcaktuar posaçërisht, por i referohet një të drejte pronësie të një lloji mbi të gjithë ose një pjesë të pronës në fjalë.

Gjykata e Lartë (GJL) mund të urdhërojë ndryshimin ose revokimin e një deklarate për vdekje të supozuar, një shembull i qartë i rrethanave në të cilat kjo do të ishte e përshtatshme është kur personi i zhdukur kthehet, është ende gjallë, ose kur ka prova të qarta se personi i zhdukur ka qenë gjallë në një kohë më vonë se ajo e deklaruar si koha e vdekjes në deklaratën origjinale.

Një urdhër i tillë mund të jepet me kërkesën e çdo personi, por gjykata duhet të refuzojë të shqyrtojë një kërkesë nëse konsideron se aplikanti nuk ka interes të mjaftueshëm në rezultat.²⁶² I takon gjykatës të përcaktojë se çfarë përbën një interes të mjaftueshëm për këto qëllime.

Gjykata nuk ka vetëm rol deklarativ, pra vetëm të deklarojë vdekjen e supozuar të një personi por edhe të bëjë verifikimet e duhura edhe të ketë rol aktiv në mbledhjen e fakteve dhe provave që të provojë vdekjen e personit apo sipas rastit gjetjen e gjurmëve për ekzistencën e tij.

Kështu, shumë shtete gjykata i ka kërkuar shtetit kryerjen e të gjitha verifikimeve lidhur me vendodhjen e personave dhe nëse ata kanë humbur jetën gjetjen e trupave të tyre. Këtu kemi parasysh rastet e luftrave apo genocideve apo fatkeqësive natyrore.

Shembull për këtë është - Çështja e Komunikuar - ZUBAN kundër BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS dhe 17 kërkesa të tjera.

²⁶⁰ Presumption of Death Act 2013 - Explanatory Notes ¹⁷ Po aty.

²⁶¹ Presumption of Death Act 2013 - Explanatory

Notes

²⁶² Po aty

Vdekja e prezumuar e bashkëshortit/tes

Instituti i martesës në rastin e vdekjes së prezumuar të bashkëshortit është një koncept juridik që lidhet me situatën ku një person shpallet i vdekur bazuar në mungesën e gjatë të tij dhe pamundësinë për të provuar ekzistencën e tij në jetë.

Ky institucion mbështetet në nevojën për të siguruar stabilitetin juridik dhe pasuror të palës tjetër në martesë dhe të familjes në tërësi.

Vdekja e prezumuar lidhet me dikë që ka munguar për një kohë të gjatë dhe për të cilin ka dyshime nëse mund të jetë ende gjallë. Sigurisht termi mungesë mund të ketë një kuptim të përgjithshëm dhe mund të zbatohet për persona që nuk janë në një vend të caktuar. Ndërsa nga pikëpamja ligjore për të konsideruar një person të zhdukur dhe më pas për të vendosur vdekjen e tij të prezumuar duhet të plotësohen disa kushte:

Së pari, mungesa e tij për një periudhë të caktuar kohore dhe sipas Kodit Civil, për të paktën 2 vite²⁶³ dhe së dyti, mungesa e çdo lajmi për jetën e tij. Por, që të kemi pasoja për martesën, nuk mjafton që personi i cili mungon dhe nuk ka informacion për të paktën 2 vjet të shpallet i zhdukur, por ligjërisht ai duhet të shpallet i vdekur që të flasim për zgjidhje të martesës dhe për rrjedhojë edhe rregullimin e pasojave të mbarimit të martesës.

Kështu legjislatori ka parashikuar se një person

i zhdukur të shpallet ligjërisht i vdekur duhet të plotësohen së paku dy kushte përkatësisht, personi të jetë shpallur i zhdukur dhe nga ky moment deri në kërkesën për të shpallur vdekjen e tij ligjore të kenë kaluar të paktën katër vite.²¹

Legjislatori ka parashikuar gjithashtu se, më rast fatkeqësie natyrore personi mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme dy vjet nga dita që ka ngjarë fatkeqësia, pa qenë e nevojshme të shpallet më parë i zhdukur.²⁶⁴

Kur nuk caktohet dita në të cilën ka ndodhur fatkeqësia, afati dyvjeçar fillon nga dita e parë e muajit që vjen pas atij në të cilin ka ndodhur fatkeqësia dhe, kur nuk mund të caktohet as muaji, afati fillon nga dita e parë e muajit janar të vitit të mëpasshëm²⁶⁵ dhe me kërkesë të çdo të interesuari gjykata mund ta ndryshojë datën e vdekjes kur provohet se personi ka vdekur në një datë tjetër.²⁶⁶

Në aspektin e vëzhgimit ligjor duket sikur vdekja natyrore dhe ajo ligjore nuk kanë ndonjë dallim të rëndësishëm, dhe të gjitha efektet e vdekjes natyrore do të zbatohen edhe për vdekjen e prezumuar²⁶⁷, por legjislatori është treguar i kujdesshëm në rastin e vdekjes së prezumuar duke lënë një garanci ligjore për personin që mund të jetë shpallur i vdekur por, dalin prova dhe më vonë provohet se ai është gjallë duke i njohur atij të drejtën që të kërkojë kthimin e të drejtave të tij, edhe të pasurisë së tij dhe pasurinë e fituar me anë të pasurisë së tij, qoftë edhe nga të tretët.²⁶⁸

²⁶³ Neni 15 "Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës" ²¹ Neni 17 "Personi që është shpallur i zhdukur, me kërkesën e çdo të interesuari, mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës, kur kanë kaluar pa patur lajme katër vjet nga dita që është shpallur i zhdukur"

²⁶⁴ Neni 19 i Kodit Civil

²⁶⁵ Neni 20 i Kodit Civil

²⁶⁶ Neni 21 i Kodit Civil

²⁶⁷ Neni 22 i Kodit Civil "Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë."

²⁶⁸ Neni 23 i Kodit Civil "Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi priset nga gjykata që e ka dhënë. Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së

Martesa është një kontratë dhe personaliteti i palëve është elementi kryesor i kontratës. Jetesa e palëve është po aq e rëndësishme dhe e nevojshme si për përfundimin e kontratës ashtu edhe për ekzistencën e saj, dhe nuk ka dyshim se vdekja e njëres palë çon në shpërbërjen e saj.²⁶⁹

Megjithatë në kultura të ndryshme ka qëndrime të ndryshme për vdekjen e prezumuar dhe për zgjidhjen e martesës. Për shembull në vendet islamike, studiuesit kanë argumentuar se ligji nuk është i qartë nëse vdekja e prezumuar ka efekt për martesën²⁸.

Studiuesit kanë treguar se shkak për prishjen e një martese janë tradhëtia, pabesia dhe janë shkaqe të qëllishme. Vdekja e prezumuar nuk është një shkak i qëllimshëm dhe fakti që ka një vendim gjykate për shpallur të vdekur një person nuk supozon që martesa është shpërbërë dhe ndarja e pasurisë dhe trashëgimia e një personi të zhdukur nuk është një arsye e mjaftueshme për të pohuar se marrëdhënia martesore ka marrë fund.²⁷⁰ Aspektet kryesore të këtij instituti:

1. Deklarimi i vdekjes së prezumuar –

Nëse një person zhduket dhe nuk ka asnjë provë për ekzistencën e tij për një periudhë të gjatë kohore, ligji mund të lejojë shpalljen e vdekjes së tij të prezumuar përmes një vendimi gjyqësor.

2. **Pasojat në martesë** – Sipas ligjit, një martesë mund të shpallet e përfunduar kur një bashkëshort deklarohet i vdekur me vendim gjyqësor, duke i lejuar palës tjetër të martohet përsëri.

3. **Pasojat pasurore dhe trashëgimore** – Vdekja e prezumuar hap trashëgiminë e pasurisë së personit të shpallur të vdekur, duke

u mundësuar trashëgimtarëve të ligjshëm të kërkojnë pjesën e tyre.

4. Rikthimi i personit të shpallur të

vdekur – Nëse personi i shpallur i vdekur kthehet, ligji mund të ketë dispozita për rishikimin e pasojave të shpalljes së vdekjes së tij, si rikthimi i pasurisë ose shqyrtimi i vlefshmërisë së martesës së dytë të ish-bashkëshortit.

Ky institut synon të balancojë nevojën për siguri ligjore me mbrojtjen e të drejtave të individëve të përfshirë, duke siguruar një procedurë të rregulluar për zgjidhjen e pasigurive që vijnë nga mungesa e zgjatur e një personi.

Në Kodin Civil Italian për shkak të rrethanave të ndryshme që mund të sjellin zhdukjen e një personi, legjislatori ka parashkuar disa raste për disponimin me vendim të vdekjes së supozuar. Në nenin 60 të Kodit Civil është parashikuar e vdekja e supozuar mund të deklarohet në rastet e më poshtë:

1) Kur dikush është zhdukur në operacione lufte në të cilat ka marrë pjesë, qoftë të forcat e armatosuara ose në shpurën e tyre, ose në çdo rast ishte i pranishëm në to cilat, pa pasur asnjë lajmë për të dhe kanë kaluar dy vjet nga hyrja në fuqi e traktatit të paqes, ose në mungesë të këtij, tre vjet nga fundi i vitit që kanë pushuar armiqësitë; 2) kur dikush është zhdukur për shkak të një aksidenti dhe nuk ka lajme të mëtejshme për të, ose nëse muaji nuk dihet nga fundi i vitit që ka ndodhur aksidenti.

Deklarimi i vdekjes së supozuar mund të kërkohej në raste kur nuk ka qënë e mundur të vazhdohej hetimet e kërkuara me ligj përpara përpilimit të certifikatës së vdekjes. Ky deklarim shpallet me vendim gjykate me kërkesë të prokurorit publik ose një pale të interesuar dhe

tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes.”

²⁶⁹ Ramghani.H, Roshan.M& Khah.M “The effect of death dissolution of marriage, contract With emphasis, presumed death”, fq 222 ²⁸ Po aty

²⁷⁰ Po aty, faqe 223

gjykata kur nuk e shikon të përshtatshme të pranoj kërkesën për deklarimin e vdekjes së supozuar, mund të deklaroj vetëm mungesën e personit të zhdukur.²⁷¹

Nocioni i martesës ka pasur zhvillime që janë ndikuar nga e drejta zakonore ose fetare, ose nga nevoja për të rregulluar ligjërisht marrëdhënin e një burri dhe një gruaje që pranojnë me vullnet të lirë lidhin martesë.

Deri në arritjen e përkufizimit që kemi sot për martesën, instituti i martesës ka pasur përkufizime të ndryshme në regjime të ndryshme politike, sociale dhe kulturore, por zhvillimet e fundit dhe globalizmi, martesa me elementë të huaj ka shtuar nevojën për përditësime të legjislacioneve lidhur me deklarimin e vdekjes së supozuar dhe me zgjidhjen e martesës.

Shpërbërja e martesës për shkak të vdekjes apo shpalljes së vdekjes së supozuar të njërit prej bashkëshortëve.

Zgjidhja e martesës është një nga format e mbarimit të martesës me vullnetin e shprehur nga bashkëshortët për mbarimin e saj. Në Kodin e Familjes janë parashikuar ose janë rregulluar 3 format e ndryshme të zgjidhjes së martesës.

Forma e parë është me pëlqimin reciprok të dy bashkëshortëve, e cila rregullohet me nenet 125-128 të Kodit të Familjes;

Forma e dytë është ajo për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët, e rregulluar nga nenet 129 deri 131 të Kodit të Familjes;

Forma e tretë është ajo me kërkesën e njërit bashkëshort, e cila rregullohet në nenet 132-133 të Kodit të Familjes.

Efektet ligjore të shpërndarjes së bashkimit civil.

Në shtetet të cilat kanë përqafuar konceptin e “bashkimit civil”, vdekja e njërit prej partnerëve sjell shpërndarjen e këtij bashkimi. Shpërndarja e bashkimit civil sjell pasoja të shumta ligjore, marrë në referim këtu legjislacionin e shtetit të Kosovës, por edhe të shtetit Italia, si për shembull:

E drejta për trashëgimi: Partneri i mbijetuar ka statusin e trashëgimtarit të ligjshëm dhe si pasojë gëzon të drejta pasurore.

Përfundimi i detyrimeve reciproke: Obligimet e ndihmës materiale dhe përkujdesjes së ndërgjellte përfundojnë.

Zgjidhja e regjimit pasuror: Nëse ishte zgjedhur regjimi i bashkimit të pasurisë, ai zgjidhet automatikisht.

Pas shpërndarjes së bashkimit civil, partneri i mbijetuar konsiderohet ligjërisht i lirë. Ai mund të krijojë një bashkim civil të ri ose të martohet me një person të seksit të kundër nëse zgjedh këtë rrugë. Ligji nuk vendos asnjë pengesë për këtë. Përmbledhtas, shpërndarja e bashkimit civil për shkak të vdekjes ose shpalljes së vdekjes ka pasoja të ngjashme me shpërndarjen e martesës, duke garantuar të drejtat e partnerit të mbijetuar dhe duke ruajtur qartësinë ligjore të statusit të tij. Format e mbarimit të martesës parashikohen në mënyrë shteruese në Kodin e Familjes dhe nuk ka hapsira për interpretim apo boshllëqe ligjore. Konkretisht, në nenin 123 të Kodit të Familjes, shprehen tri rastet kur mbaron martesa²⁷² dhe ka qënë doktrina ajo që ka elaboruar më tej këto raste dhe si parashikohen.

Së pari me *vdekjen e njërit bashkëshort*, së dyti me *shpalljen të vdekur të njërit bashkëshort* si dhe

²⁷¹ Neni 63 i Kodit Civil Italian

²⁷² Neni 123 i ligjit 9062, datë 8.5.2003 “Martesa mbaron me vdekjen e njërit

nga bashkëshortët, me shpalljen e vdekjes së njërit bashkëshort ose me zgjidhjen e martesës së tyre.

me zgjidhjen e saj.

Vetë koncepti i vdekjes apo shpalljes së vdekjes ka disa dallime. Vdekja natyrore nga pikëpamja biologjike dhe mjekësore, përcaktohet si ndalimi i funksioneve jetësore të trupit. Nga ana filozofike, ajo shpjegohet si ndarja e shpirtit nga trupi, duke shkaktuar prishjen e rendit natyror trupor. Vdekja natyrore rezulton në humbjen e personalitetit juridik të individit.

Vdekja e supozuar ndodh kur një individ është i zhdukur për një periudhë të gjatë kohore dhe gjykata e shpall ligjërisht të vdekur. Kjo ka pasoja ligjore mbi trashëgiminë dhe statusin martesor të bashkëshortit të tij.

Në qasje të parë duket sikur rasti i parë, pra vdekja e bashkëshortit dhe i dytë i mbarimit të martesës ngjajnë dhe kanë të njëjtat pasoja juridike, por nga doktrina, interpretimet e atyre instituteve më vete për të identifikuar ndryshimin ndërmjet shpalljes i vdekur dhe vdekjes natyrore, kanë treguar se kemi të bëjë me dy institute që proceduralisht ndryshojnë dhe pasojat nuk janë të njëjta, qoftë për partnerin që ngel i/e ve, nga shpallja e vdekur e partnerit tjetër, por që mund të lidhi martesë.

Pasojat janë në të dyja raste pasoja juridike konkretisht me trashëgiminë dhe pasurinë.

Ndryshimi ndërmjet këtyre dy rasteve është pikërisht tek pasojat kur subjekti i së drejtës ndahet nga jeta për shkak të natyrës njerëzore dhe kur ai shpallet i vdekur. Shpallja i vdekur i një subjekti gëzon mbrojtjen e veçantë nga ligji, pikërisht për të rregulluar raportet ekonomike pasurore, si edhe të drejta të tjera jopasurore dhe për këtë arsye për të shpallur të vdekur një subjekt duhet të zhvillohet një proces gjyqësor i cili për nga natyra konsiderohet proces i posaçëm dhe merr mjaftueshëm garanci nga ligji për të qenë korrekt në këtë përcaktim, pasi vdekja në këtë rast nuk është natyrore, por është si rezultat i fakteve njerëzore, duke qenë se nuk

ka informacion prej vitesh dhe nuk dihet se ku mund të jetë një subjekt, atëherë do të konsiderohet i vdekur, por jo domosdoshmërisht është i vdekur.

Jo vetëm afati, por edhe procesi gjyqësor është i dyti në radhë për nga provat, pasi së pari personi që të shpallet i vdekur duhet të jetë shpallur i zhdukur me vendim të gjykatës. Pra, duhet të plotësohen si elementët material dhe procedural për efekt vlefshërie dhe ligjshmërie. Pra që kjo martesë ligjërisht të mbaroj fillimisht duhet të disponohet një vendim gjykate për shpalljen e zhdukur dhe më pas të vdekur të partnerit.

Por njerëzorja, elementët natyrorë, humanë duhet të prevalojnë në konkurim me pasojat juridike, prandaj edhe ligji i garanton personit për të cilin nuk ka informacion për një kohë të gjatë të pezullimit të të drejtave dhe formën e zhvillimit të këtij procesi me të gjithë karakteristikat e një procesi extra ordinem.

Për nga pasojat vdekjes natyrore barazohen me atë të shpalljes së vdekur edhe kjo njihet ligjërisht edhe nga Kodi Civil i cili në mënyrë eksplicite në nenin 22 parashikon se *“Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë. Vendimi i gjykatës me të cilin një person është shpallur i vdekur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile përkatëse”*.

Nga ana tjetër ligji parashikon edhe kthimin, shfaqjen apo informacionin për personin që me vendim Gjykate është shpallur i vdekur, duke i mundësuar atij rikthimin e të gjitha të drejtave të tij në kohën kur ai i kishte lënë, nëse për nga natyra e të drejtave nuk janë shuar.

Konkretisht në nenin 23 të Kodit Civil, thuhet se nëse personi që është shpallur i vdekur kthehet ose ka informacione se është gjallë ai, ose të afërmit, ose çdo person tjetër mund t'i kërkojnë Gjykatës prishjen e vendimit që e ka shpallur të

vdekur.²⁷³

Me këtë veprim ligji i ka garantuar pa kufi çdo të drejte pasurore personit të shpallur të vdekur të rikthyer, jo vetëm me pasurinë që ka patur në kohën kur ka qënë gjallë, por edhe me përfitimet që ka pësuar kjo pasuri, duke zhveshur tërësisht pronarin që kishte marrë titullin nga trashëgimia.

Normalisht rikthimi i këtyre të drejtave do t'i nënshtrohet dhe kryhet nëpërmjet një procesi gjyqësor dhe do të rregulloj marrëdhëniet juridike të cilat ishin krijuar si rezultat i rrethanave të tjera.

Pikërisht, për këtë gjendje jostatike që ka 'shpallja i vdekur' në ndryshim nga vdekja e subjektit të së drejtës, ligji e parashikon si mënyrë ndryshme të mbarimit të martesës për të rregulluar pasojat. Pra, ligji i rezervon bashkëshortit të shpallur të vdekur disa të drejta nëse ai realisht nuk ka vdekur, dhe tashmë si një subjekt juridik të gëzoj të drejtat e tij që ka pasur apo kanë rrjedhur nga martesa.

Për sa i përket formës së tretë të mbarimit të martesës me zgjidhjen e saj, Kodi i Familjes ndalet në mënyrë të posaçme duke shpjeguar format e zgjidhjes së martesës, duke bërë dallim vetëm për sa i përket mënyrës dhe jo pasojave të zgjidhjes së martesës. Me zgjidhjen e martesës ish bashkëshortët kërkojnë edhe pjesëtimin e pasurisë, pasi regjimi pasuror martesor ka patur fuqi vepruese për aq kohë sa bashkëshortët kanë qënë në statusin e të martuarit.

Në mënyrë standarde, ish bashkëshortët kërkojnë pjestimin e pasurisë në gjykatë për shkak të zgjidhjes së martesës, ndërkohë nga ana tjetër nuk haset praktika e kërkesave për të

pjesëtuar pasurinë bashkëshortore me vdekjen e njërit bashkëshort. Kështu kur kërkohet lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë tek noteri, asnjëherë bashkëshorti pasjetues nuk paraqet vendim gjykate për veçimin e pjesës takuese nga kjo pasuri për të likujduar bashkësinë fillimisht dhe më tej për të realizuar kalimin e pronësisë vetëm të trashëgimlënësit tek trashëgimtarët.

Automatikisht ndodh që pasuria që ka patur trashëgimlënësi në emër të tij gjatë martesës, ku në rast se janë në regjimin e bashkësisë ligjore prezumohet kontributi i përbashkët dhe në këto kushte bashkëshortit të cilit nuk i rezulton emri, përfiton nga kjo pasuri vetëm si trashëgimtar në pjesë të barabarta nëse është në radhë me fëmijët dhe në ½ në rast se konkuron me trashëgimtarë të tjerë.

Bashkëshorti pasjetues mund edhe t'i shmanget detyrimeve që kanë lindur gjatë martesës si rezultat i veprimeve që kanë bërë me bashkëshortin në regjimin e bashkësisë ligjore duke u fshehur edhe pas një detyrimi (huaje) për të cilën detyroheshin vetëm ata të dy, jo të gjithë trashëgimtarët në pjesët përkatëse. Pjesëtimi i pasurisë ndërmjet bashkëshortëve i jep bashkëshortit pasjetues pasurinë e tij dhe mbi këtë do të shtohet pjesa takuese si trashëgimtar i të ndjerit duke trashëguar sipas formulës dhe statusit të tij.

Megjithatë në shume vende të besimit myslinam pavarësisht se gjykatat civile kanë juridiksionin përfundimtar për të vendosur për çështjet civile, dhe veçanësisht për të drejtat e pasurisë dhe të trashëgimisë, gjykatat Syriah ndonjëherë pretendoj të drejta për të vendosur mbi vdekjen e një personi, veçanësisht kur ky person është mysliman. Kjo ka ndodhur në rastet kur një

²⁷³ "Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi priset nga gjykata që e ka dhënë. Personi që del se është gjallë ka të drejtë të kërkojë pasurinë e tij dhe pasurinë e fituar me anë të saj, qoftë edhe nga personat e

tretë që e kanë fituar nga ata, të cilëve u ka kaluar kjo pasuri për shkak të deklarimit të vdekjes së tij, në kufijtë dhe kushtet e parashikuara nga ky Kod e nga Kodi i Familjes"

individ mysliman është zhdukur për një kohë të gjatë dhe është paraqitur kërkesë për të shpallur personin si të vdekur me qëllim që pasuria e tij të ndahet midis trashgimtarëve sipas ligjit Syriah.

Deklarata e vdekjes së një personi kërkohet për shkak të provave për vdekjen e tij dhe gjykata civile bazohet në provat dhe dëshmitë për të shpallur të vdekur një person, por edhe vet gjykatat Syriah kanë nxjerrë aktin e vdekjes së një personi të zhdukur që më pas janë përdorur për të ndarë pasurinë sipas ligjit islam.

Në Malajzi sipas Aktit të Administrimit të Trashgimisë në rast të shpalljes së zhdukur ose të vdekur të një personi, është Gjykata e Lartë ajo që vendos nëse personi do të konsiderohet i zhdukur apo i vdekur edhe nëse do të konsiderohet i vdekur se kujt do ti kaloj pasuria për administrim. Ligji Malajzian njeh parimin se pas kalimit të një afati shtatë vite mungesë të një personi pa dëshmi që ai është gjallë, ai mund të konsiderohet i vdekur.

Por si në të drejtën islame ashtu edhe në ligjin malajzian, shpallja e vdekjes nuk është e lehtë dhe kërkon prova bindëse përpara se të shpallet vdekja e prezumuar një personi. Kjo fillimisht kërkon një veprim aktiv të të gjithë instancave për të kërkuar për personin, për ta gjetur atë gjallë ose për të gjetur trupin e tij në mënyrë që të provohet vdekja natyrore.

Në të drejtën islame një person që ka humbur konsiderohet ende gjallë për sa kohë nuk ka prova të qarta për vdekjen e tij dhe ky qëndrim mbështetet në parimin "istishab" që nënkupton vazhdimësinë e një gjëndje të mëparshme, pra të ekzistencës së jetës.

Megjithatë mungesa për disa vite pa pasur asnjë informacion ka bërë që disa shkolla të vendosin një kufijë kohorë për të shpallur të vdekur personin.

Shkolla Henefite lejon shpalljen e vdekjes pas 90 vite nga lindja e personit duke pasur parasysh jetëgjatësinë e një personi.

Shkolla Malikite përcakton një periudhë 4 vite nga momenti i shpallur i zhdukur, kur nuk ka asnjë lajm për të dhe që ka arsye për të besuar vdekjen e tij/saj, psh., ka qënë pjesë e një formacioni ushtarak.

Shkolla Hanbelite nuk ka një periudhë kohore të përcaktuar po e le atë në diskrecion të gjyqtarit.²⁷⁴

Rimartesa në sistemin civil (law dhe common law)

Në sistemin Civil Law, rimartesa (martesat e dyta ose të mëvonshme) trajtohet sipas rregullave të Kodit Civil dhe Kodit të Familjes të secilit shtet. Disa nga pikat kryesore për rimartesën në këtë sistem juridik janë:

I) Për të drejtat pasurore, ku rimartesa ashtu si martesa mund të ndikojë në marrëveshjet pasurore nga martesa e mëparshme, përfshirë pensionet, trashëgiminë, ose ndihmën financiare pas divorcit. Shumë shtete parashikojnë që partneri i mbetur i ve, pas ndarjes për shkak të vdekjes së prezumuar të bashkëshortit të mos përfitoj nga ato të drejta që përfitonte si partneri i ve, psh., pensioni i partnerit të vdekur, apo të drejta të tjera që rrjedhin nga zgjidhja e martesës së mëparshme.

II) Për kujdestarinë e fëmijëve, ku rimartesa nuk ndikon automatikisht në të drejtat prindërore, por mund të ndikojë në dinamikën e kujdestarisë ose vendimet gjyqësore mbi fëmijët nga martesa e mëparshme, pasi angazhimi në një martesë të re, mund të kërkojë vendosjen me një vendim gjykate të të drejtave apo detyrimeve ndaj fëmijëve dhe kjo kryesisht kërkohet nga familjarët e partnerit të shpallur të vdekur.

²⁷⁴ Law Journal, Volume 18 Number 2, 2010, faqe 335

III) Ndryshimet në mbiemër. Pas zgjidhjes së martesës për shkak të shpalljes së vdekur të bashkëshortit, i/e veja mund të mbajë mbiemrin e vajzërisë por mund të mbajë edhe mbiemrin e bashkëshortit të shpallur të vdekur. Nëse bashkëshorti rimartohet atëherë ai/ajo nuk mund të mbajë mbiemrin e ish-bashkëshortit. Ky përfundim del po të lexosh në mënyrë të integruar dhe me interpretim dispozitën e parashikuar në nenin 51 të Kodit të Familjës i cili parashikon se *“Bashkëshortët, kur lidhin martesën, kanë të drejtë të zgjedhin për të mbajtur si mbiemër të përbashkët njërin nga mbiemrat e tyre ose të mbajnë secili mbiemrin e vet. Mbiemri regjistrohet në regjistrin e martesave.”* Nëse një person kishte marrë mbiemrin e bashkëshortit/es në martesën e parë, rimartesa mund të sjelli një ndryshim të ri të mbiemrit, sipas rregullave ligjore.

IV) Poligamia ku në shumicën e vendeve me sistem Civil Law poligamia është e ndaluar, që do të thotë se një person nuk mund të jetë i martuar me më shumë se një partner në të njëjtën kohë dhe në çdo rast kemi parasysh martesën ligjore.

V) Ndryshimi i statusit civil ku pas rimartesës, regjistrat civilë përditësohen për të reflektuar statusin e ri dhe partneri nga statusi “i/e ve” merr statusin “i martuar” dhe ky status reflektohet në regjistrin e gjendjes civile.

Nëse ndalemi në analizë të sistemit që ka Italia, rimartesa rregullohet nga Kodi Civil Italian dhe disa ligje specifike që përcaktojnë kushtet dhe kufizimet për një martesë të re pas divorcit ose vejanisë.

Shteti Italian që të legjetimohet rimartesa kërkon plotësimin e disa kushteve:

1. Përfundimi i martesës së parë ku një person mund të rimartohet vetëm nëse martesa e mëparshme ka përfunduar ligjërisht përmes:

- **Divorcit** – Me një vendim gjyqësor përfundimtar të divorcit;

- **Vdekjes së bashkëshortit** – Në rastin e vejanisë apo shpalljes së vdekjes së prezumuar të bashkëshortit;

- **Anulimit të martesës** – Nëse martesa e mëparshme është shpallur e pavlefshme.

2. Periudha e pritjes për gratë (Interdizione Temporale), ku: Në bazë të nenit 89 të Kodit Civil Italian, një grua që divorcohet ose mbetet e ve duhet të presë 300 ditë para se të martohet përsëri.

Ky rregull nuk zbatohet nëse provohet që gruaja nuk është shtatzënë ose nëse martesa e re bëhet me të njëjtin person.

3. Shtetasit e huaj që duan të martohen në Itali duhet të dorëzojnë një “Nulla Osta”, një dokument që konfirmon se nuk ka pengesa ligjore për martesën e tyre, lëshuar nga vendi i tyre i origjinës.

Ndërkohë që efektet e rimartesës në shtetin Italian lidhen me ndikimin në pensione dhe në ndihmat financiare, pasi nëse një ish-bashkëshort merr pensionin nga partneri i mëparshëm (p.sh., pension ushqimor), ky përfitim mund të ndërpritet me martesën e re. Në rastin e vejanisë, nëse një person rimartohet, ai mund të humbasë të drejtën për të marrë pensionin e vejanisë nga ish-bashkëshorti i ndjerë. Në Itali, gratë nuk marrin automatikisht mbiemrin e bashkëshortit pas martesës, kështu që rimartesa nuk ndikon në mbiemërin e tyre, ndërkohë që në Zvicër kemi edhe një vendim të GJEDNJ që trajton mbiemrin. Ligji që rregullon mbiemrat në Zvicër bazohet në faktin që çiftet që martohen mbajnë një mbiemër të vetëm familjar i cili automatikisht është ai i burrit, përveç rastit kur me kërkesë të përbashkët vendosin përdorimin e mbiemrit të gruas. Personat e martuar me origjinë të huaj mund të kërkojnë që mbiemri të rregullohet nga ligji i tyre kombëtar.

Në çështjen *Losonci Rose and Rose v. Switzerland* - [664/06](#), aplikantët janë shtetas hungarezë dhe gruaja e tij shtetase zvicerane.

Përpara martesë ata njoftuan rregjistrin e lindjeve, vdekjeve dhe martesave se do të mbanin mbiemrat e tyre në vend që të zgjidhnin të mbanin një mbiemër të përbashkët. Kjo kërkesë u refuzua nga autoritetet dhe për të çuar përpara martesën ata vendosën që të mbanin mbiemrin e gruas.

Pas martesë aplikanti (burri) kërkoi nga autoritetet që mbiemri që ai mbante (i bashkëshortes) të zëvendësohej nga mbiemri i tij, pa u ndryshuar mbiemri i bashkëshortes) dhe përsëri autoritetet e refuzuan. Aplikantët apeluan duke argumentuar se kjo gjë nuk do të kishte ndodhur nëse gjinitë e tyre do të kishin ndryshe, pasi mbiemri i burrit bëhet automatikisht mbiemri i familjes dhe gruaja do të kishte qenë e lirë të kishte zgjedhjen e saj të mbiemrit të rregulluar nga ligji i saj kombëtar.

Edhe pse në rastin e një burri zviceran dhe një gruaje me origjinë të huaj, gruaja mund të zgjidhte që mbiemri i saj të rregullohej nga ligji i saj kombëtar, një zgjedhje e tillë nuk ishte e mundur në rastin e një gruaje zvicerane që martohej me një burrë me origjinë të huaj, ku çifti zgjodhi mbiemrin e gruas si mbiemrin e tyre familjar, siç kishin bërë aplikantët.

Prandaj, ata mund të pretendonin se ishin viktimat të një ndryshimi në trajtim midis njerëzve në situata të ngjashme.

Sipas autoriteteve kombëtare, ndërhyrja në fjalë kishte ndjekur qëllimin legjitim të pasqyrimin të unitetit familjar me anë të një mbiemri të vetëm familjar. Megjithatë, sa i përket masave që mund të merreshin në këtë sferë, vetëm arsye bindëse mund të justifikonin një ndryshim në trajtim në bazë të seksit. Një konsensus po shfaqej brenda shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në lidhje me barazinë midis bashkëshortëve në zgjedhjen e mbiemrit familjar, dhe aktivitetet e Kombeve të Bashkuara po shkonin drejt njohjes së të drejtës së secilit partner të martuar për të mbajtur

mbiemrin e tij ose të saj ose për të pasur një zë të barabartë në zgjedhjen e një mbiemri të ri familjar.

Megjithatë, aplikanti i parë ishte penguar të mbante mbiemrin e tij pas martesës, megjithëse ai mund ta kishte bërë këtë nëse gjinitë e aplikantëve do të ishin të kundërta. Për më tepër, nuk mund të thuhet se aplikanti i parë nuk kishte pësuar ndonjë disavantazh serioz, pasi emri i një personi, si mjeti kryesor i identifikimit personal brenda shoqërisë, ishte një nga aspektet kryesore që duhej të merrej në konsideratë në lidhje me të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.

Prandaj, justifikimi i paraqitur nga Qeveria nuk dukej i arsyeshëm dhe ndryshimi në trajtim kishte qenë diskriminues. Nga kjo rrjedh se rregullat në fuqi në shtetin e paditur shkaktonin diskriminim midis çifteve dykombëshe sipas faktit nëse burri apo gruaja ishte shtetas i atij shteti.

Rimartesa nuk ndryshon automatikisht të drejtat dhe detyrimet prindërore mbi fëmijët nga martesë e mëparshme, por mund të ndikojë në vendimet gjyqësore për kujdestarinë ose pensionin ushqimor për fëmijët.

Edhe procedura për rimartesë kërkon disa dokumente dhe parashikon një procedurë ligjore, ku shtetasi italian kërkon me qëllim vijim e procedurës për lidhjen e martesës këto dokumente;

- Certifikata e lindjes;
- Dokumenti i divorcit (ose certifikata e vdekjes së bashkëshortit për të vejat);
- "Nulla Osta" për shtetasit e huaj;
- Dokument identiteti.

Shpallja duhet të bëhet në komunë për 8 ditë, për të lejuar kundërshtime ligjore, nëse ka dhe martesë mund të bëhet civilisht (në komunë) ose fetarisht me efekt civil (në kishë).

Në sistemin Common Law, rimartesa rregullohet nga ligjet e martesës dhe divorcit të secilit shtet, por ka disa parime të përgjithshme që vlejné në

shumicën e vendeve që ndjekin këtë sistem juridik, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Kanada, Australia etj.

Edhe në sistemin Common Law parashikohen disa kushte për rimartesë siç janë:

I) Përfundimi i martesës së parë

Një person mund të rimartohet vetëm nëse martesa e mëparshme ka përfunduar ligjërisht përmes:

- Divorcit – Duhet të ketë një vendim përfundimtar të divorcit nga gjykata.
- Vdekjes së bashkëshortit – Në rastin e vejanisë apo shpalljes së vdekur të bashkëshortit
- Anulimit të martesës – Nëse martesa është shpallur e pavlefshme.

II) Nuk ka periudhë pritjeje për rimartesë (zakonisht) në shumicën e vendeve Common Law, nuk ka një periudhë të detyrueshme pritjeje pas divorcit për t'u rimartuar përjashtim bëjnë disa shtete ose juridiksione specifike që mund të kërkojnë një periudhë të shkurtër administrative.

III) Në disa vende si SHBA dhe Kanada, disa shtete njohin martesën e zakonshme (common law marriage), ku një çift konsiderohet i martuar ligjërisht pa një ceremoni zyrtare, nëse kanë jetuar së bashku për një kohë të gjatë dhe janë paraqitur publikisht si bashkëshortë. Për rimartesë, një person në një martesë të zakonshme duhet të sigurohet që nuk është ligjërisht i martuar me partnerin e mëparshëm. Pas rimartesës, statusi civil përditësohet në dokumentet ligjore dhe administrative.

Nëse një ish-bashkëshort merr pension ushqimor (alimony), ky përfitim mund të ndalojë nëse rimartohet dhe në rastin e vejanisë, një person mund të humbasë të drejtën për pensionin e vejanisë pas martesës së re.

◆ Efekti mbi kujdestarinë dhe të drejtat prindërore;

- Rimartesa nuk ndryshon automatikisht të drejtat prindërore për fëmijët nga martesa e mëparshme.
- Megjithatë, gjykata mund të rishikojë vendimet për kujdestarinë ose përkrahjen financiare të fëmijëve nëse rimartesa ndikon në jetesën e tyre.
- Një bashkëshort i ri mund të adoptojë ligjërisht fëmijët e partnerit me lejen e prindit tjetër ose vendimin e gjykatës.
- Gratë mund të zgjedhin të mbajnë mbiemrin e ish-bashkëshortit ose të marrin mbiemrin e partnerit të ri, sipas rregullave të vendit ku jetojnë.

Në sistemin Common Law për efekt vlefshërie duhet të zbatohet edhe procedura, e cila fillon me dorëzimin e dokumentacionit si:

- Certifikata e lindjes;
- Vendimi i divorcit ose certifikata e vdekjes së bashkëshortit (për të vejat);
- Dokument identifikimi.

Marrja e licencës së martesës

- Në shumicën e vendeve Common Law, çiftet duhet të aplikojnë për një licencë martese pranë autoriteteve lokale.
- Ka një periudhë të shkurtër pritjeje (zakonisht disa ditë) para se martesa të mund të realizohet.

Celebrimi i martesës

- Martesa mund të bëhet nga një zyrtar i autorizuar (gjyqtar, kryebashkiak, prift, etj.).
- Pas martesës, certifikata e martesës regjistrohet në zyrën e gjendjes civile.

Por rimartesa edhe në sistemin Common Law ka disa kufizime që fillon siç janë:

Poligamia. Në shumicën e vendeve me sistem Common Law, poligamia është e jashtëligjshme, që do të thotë se një person nuk mund të jetë i martuar ligjërisht me më shumë se një person në të njëjtën kohë.

Martesa e përfaqësuar (Proxy Marriage)

- Disa vende lejojnë martesën në distancë përmes një përfaqësuesi (proxy marriage), por rimartesa zakonisht kërkon praninë fizike të të dy partnerëve.

Lidhur me pasurinë disa shtete aplikojnë ndarjen e pasurisë së vendosur pas martese në mënyrë të barabartë, nëse nuk ka pasur një marrëveshje paraprake midis çiftit për një formë tjetër të regjimit pasuror, ose ndarjen e pasurisë sipas kontributit të tyre gjatë martesës. Pasuritë e rregjistruara individualisht para martese apo të fituara nëpërmjet dhurimit në emer të një bashkëshorti nuk i nënshtrohen ndarjes pasurore.

Pasuritë e fituara gjatë martesës ndahen sipas rregullave të vendit (p.sh., "community property" në disa shtete të SHBA ose "equitable distribution" në të tjerat).

Pensioni ushqimor për bashkëshortin (Alimony) parashikon se njëri nga bashkëshortët mund të detyrohet të paguajë përkrahje financiare për tjetrin nëse ai/ajo ka më pak të ardhura ose ka sakrifikuar karrierën për familjen dhe 'alimony' mund të jetë i përkohshëm ose i përhershëm, në varësi të gjatësisë së martesës dhe nivelit të jetesës që kishin bashkëshortët.

Në rastin e shpalljes së vdekjes së një prej bashkëshortëve gjykata përcakton kujdestarinë ligjore dhe fizike bazuar në interesin më të mirë të fëmijës. Mund të ketë kujdestari të përbashkët ose kujdestari të vetme përgjithësisht kur prindi ngel i ve, por është në kushtet për të mbajtur kujdestarinë e fëmijës.

Në shtetin Rus edhe martesa dhe rimartesa duhet të plotësojnë disa kushte, por në çdo rast familja, amësia, atësia dhe fëmijëria në Federatën Ruse janë në mbrojtje nga shteti. Legjislacioni familjar buron nga nevoja për të

konsoliduar familjen dhe për të ndërtuar marrëdhëniet familjare mbi ndjenjat e dashurisë dhe të respektit të ndërsjelltë, mbi ndihmën e ndërsjelltë dhe mbi përgjegjësinë e të gjithë anëtarëve të familjes, nga papranueshmëria e ndërhyrjes arbitrare të kujdo në punët e familjes, nga nevoja për tu siguruar të gjithë anëtarëve të familjes mundësinë për të ushtruar lirisht të drejtat e tyre dhe mundësinë për ti mbrojtur këto të drejta në gjykaatë.

Njohja i nënshtrohet vetëm një martese të lidhur pranë organeve për rregjistrimin e akteve të gjendjes civil dhe marrëdhëniet familjare rregullohen në përputhje me parimet e një bashkimi vullnetar martesor midis një burri dhe një gruaje, të barazisë së të drejtave të bashkëshortëve në familje, të zgjidhjes së problemeve të brendshme, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre, si dhe të sigurimit të mbrojtjes pasurore të të drejtave dhe interesave të anëtarëve të mitur dhe me aftësi të kufizuara të familjes.

do formë e kufizimit të të drejtave të qytetarëve në lidhje e tyre të martesës ose në marrëdhëniet e tyre të familjes për shkak të përkatësisë sociale, racore, etnike, gjuhësore ose fetare është e ndaluar.

Të drejtat e qytetarëve në familje mund të kufizohen vetëm në bazë të ligjit federal dhe vetëm për aq sa është e nevojshme për të mbrojtur moralin, shëndetin, të drejtat dhe interesat ligjore të famijles dhe të qytetarëve të tjerë.²⁷⁵

Në martesë përfundon sipas legjislacionit Rus si pasojë e vdekjes së njërit prej bashkëshortëve, ose si pasojë e shpalljes së njërit prej bashkëshortëve të vdekur. Gjithashtu, mund të përfundoj me zgjidhjen e saj me kërkesën e njërit prej bashkëshortëve, ose të dy prej tyre, por edhe me kërkesën e kujdestarit të bashkëshortit të

²⁷⁵ The Family Code of the Russian Federation, Article 1.

njohur nga gjykata si të paaftë ligjërisht.

Nëse fëmija ka lindur nga persona të martuar, si dhe brenda 300 ditëve nga momenti i zgjidhjes së martesës ose i njohjes së saj të pavlefshme ose nga momenti i vdekjes së bashkëshortit/tes së nënës së fëmijës, bashkëshorti/ja i/e nënës njihet si babai i fëmijës, përveç se kur provohet ndryshe (neni 52 i Kodit të familjes Ruse).

Zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve, pavarësisht nëse kanë apo jo fëmijë të mitur të përbashkët, kryhet në zyrat e rregjistrimit, nëse bashkëshorti tjetër:

1 Shpallet nga gjykata i zhdukur; 1 Shpallet nga gjykata i paaftë për të vepruar; 1 Dënohet nga gjykata për kryerjen e një krimi për një afat mbi tre vjet.

Zgjidhja e martesës dhe lëshimi i certifikatës së zgjidhjes së martesës kryhet nga zyra e rregjistrimit pas kalimit të një muaji nga data e paraqitjes së kërkesës për zgjidhjen e martesës dhe rregjistrimi i zgjidhjes së martesës kryhet nga zyrat e rregjistrimit në përputhje me procedurën e përcaktuar për rregjistrimin shtetëror të akteve të gjendjes civile.

Martesa konsiderohet e zgjidhur në zyrat e gjendjes civile që nga data e rregjistrimit shtetëror të zgjidhjes së martesës në Rregjistrin e Akteve të Gjendjes Civile dhe nëse martesa zgjidhet në gjykatë nga data e hyrjes në fuqi të vendimi të gjykatës.

Zgjidhja e martesës në gjykatë i nënshtrohet rregjistrimit në zyrat e gjendjes civile në përputhje me procedurën e përcaktuar administrative për efekt vlefshmërie.

Gjykata është e detyruar që brenda tre ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës për zgjidhjen e martesës, të dërgoj në zyrën e gjendjes civile pjesë nga dispozitivi i vendimit për kryerjen e veprimeve për zgjidhjen e martesës në aktet e gjendjes civile.

Bashkëshortët nuk kanë të drejtë të hyjnë në një martesë të re derisa të marrin certifikatën e

zgjidhjes së martesës së mëparshme në vendbanimin e çdonjërit prej tyre.

Edhe në rastin e martesave me elementë të huaj, martesa do të konsiderohet e zgjidhur vetëm pasi janë respektuar të gjitha procedurat për zgjidhjen e saj sipas legjislacionit që bashkëshortët kanë lidhur martesë.

Martesa mund të rivendoset vetëm nëse bashkëshorti i shpallur i vdekur paraqitet dhe me kërkesë të përbashkët të të dy bashkëshortëve, ose me kërkesë në gjykatë për të anuluar vendimet përkatëse për zgjidhjen e martesës.

Martesa nuk kthehet në gjendjen e mëparshme nëse bashkëshorti ka vendosur një martesë të re. Në këtë rast bashkëshorti i shfaqur mund të kërkojë vetëm të drejtat e tij pasurore, por jo kthimin e martesës së mëparshme.

Kodi Civil Portuguez përcakton afate dhe kushtet disi të ndryshme nga legjislacionet që kemi studiuar deri tani lidhur me vdekjen e prezumuar. Legjislacioni portugez përcakton se dhjetë vjet pas datës së lajmit të fundit, ose pesë vjet pas datës së lajmit të fundit, nëse ndërkohë personi që mungon ka mbushur moshën tetëdhjetë vjeç, palët e interesuara mund të kërkojnë një deklaratë të vdekjes së supozuar. Deklarata e vdekjes së supozuar nuk do të lëshohet para se të kenë kaluar pesë vjet nga data në të cilën personi që mungon, nëse do të ishte gjallë, do të kishte mbushur moshën madhore. Deklarata e vdekjes së supozuar të personit që mungon është e pavarur nga vendosja paraprake e kujdestarisë së përkohshme ose përfundimtare dhe do t'i referohet fundit të ditës së lajmit të fundit për të. Ndërsa disa shtete kanë parashikuar në legjislacionin e tyre se vdekja e prezumuar e zgjidh automatikisht martesën, por sipas Kodit Civil Portuguez, deklarimi i vdekjes së prezumuar prodhon të njëjtat efekte si vdekja, por nuk e

zgjidh martesën.²⁷⁶

Lidhur me pasurinë dhe trashgimin e personit të prezumuar të vdekur Kodi Civil Portugez ka përcaktuar se, kur vërtetohet se personi që mungon ka vdekur në një datë tjetër nga ajo e përcaktuar në vendimin që deklaroi vdekjen e supozuar, e drejta e trashëgimisë u përket atyre që duhet ta kishin trashëguar atë në atë datë, pa cenuar rregullat e uzukupimit. Pasardhësit e sapocaktuar gëzojnë, në lidhje me të parët, vetëm të drejtat që i atribuohen personit që mungon.

Por edhe ligji portugez ka parashikuar një rezervë në rast kthimi apo rezultimi gjallë të personit të prezumuar i vdekur. Ligji parashikon se nëse personi që mungon kthehet ose ka lajme për të, pasuritë do t'i kthehen atij në gjendjen në të cilën janë gjetur, me çmimin e pasurive të shitura ose me pasuritë e zëvendësuar drejtpërdrejt, si dhe me pasuritë e fituara nëpërmjet çmimit të pasurive të shitura, kur origjina e parave është deklaruar shprehimisht në titullin e blerjes. Nëse ka keqbesim nga ana e pasardhësve, personi që mungon ka të drejtë të kompensohet për humbjen e pësuar. Keqbesimi, në këtë rast, konsiston në dijeninë se personi që mungon ka mbijetuar datën e vdekjes së supozuar.²⁷⁷

Bashkëshorti/ja i/e personit që mungon dhe është i/e martuar në mënyrë civile mund të lidhë një martesë të re; në këtë rast, nëse personi që mungon kthehet, ose ka lajme se ai/ajo ka qenë gjallë kur është celebruar martesa e re, martesa e parë konsiderohet e zgjidhur me divorc në datën e deklarimit të vdekjes së supozuar, sipas Kodit Civil Portugez.

Fati i martesës në rast kthimi të bashkëshortit të shpallur të vdekur

Fitimi i të drejtave nga personi që rezulton gjallë pas shpalljes së tij të vdekur është një çështje juridike e rregulluar në legjislacionin shqiptar nga Kodi Civil.

Për të kuptuar se çfarë të drejtash përfiton ky person që rezulton gjallë pas shpalljes së tij të vdekur, duhet të kuptoj që në vendimin gjyqësor të shpalljes së tij të vdekur rregullohen edhe pasojat nga shpallja e vdekur e bashkëshortit siç janë: i) mbarimi e martesës, ii) ndahen pasuritë, iii) rregjistrimi i vdekjes në gjendjen civile dhe iv) të drejtat dhe detyrimet që kalojnë te trashëgimtarët.

Sipas nenit 22 të Kodit Civil vdekja e shpallur me vendim gjykate barazohet nga pasojat juridike me vdekjen natyrale²⁷⁸.

Proceduralisht nëse një person i shpallur i vdekur rezulton gjallë, ai personalisht ose çdo i interesuar mund të paraqitet në gjykatë edhe të kërkojë anulimin e vendimit të shpalljes së vdekjes²⁷⁹ dhe personi në rastin e studimit tonë bashkëshorti rifiton statusin civil që kishte më parë, emër/mbiemër, dokumentat e identitetit dhe nëse bashkëshortja/ti është ende gjallë merr edhe statusin martesor.

Rifitimi i të drejtave përfshinë edhe të drejtat pasurore mund ti marrë ato në gjendjen natyrore ose në rast tjetërsimi të kërkojë dëmshpërblim.

Legjislatori ka parashikuar që ka disa pasuri që pavarësisht se janë vënë si të tilla gjatë martesës nuk i nënshtrohen ndarjes midis bashkëshortëve dhe në regjimin e bashkësisë ligjore të tilla janë: pasuritë e fituara me trashgimi, me dhurim, pasurit e fitimit ngushtësisht vetjak, mjetet e

²⁷⁶ Neni 115 i Kodit Civil Portugez

²⁷⁷ Neni 118 i Kodit Civil Portugez

²⁷⁸ Neni 22 i Kodit Civil "Vdekja e shpallur me vendim të gjykatës barazohet në të gjitha pasojat juridike me vdekjen e vërtetë."

²⁷⁹ Neni 23 "Kur personi që është shpallur i vdekur del se është i gjallë, me kërkesën e tij ose të çdo të interesuari, vendimi priset nga gjykata që e ka dhënë"

nevojshme të punës për ushtrimin e profesionit, pasuritë e fituara nga shpërblimi apo dëmshpërblimi i dëmit vetjak, pasuritë e fituara nga tjetërsimi i pasurive vetjake, shkëmbimi i tyre kur ajo është e deklaruar shprehimihit në aktin e blerjes.²⁸⁰

Lidhur me fitimin e të drejtës për të qënduar i/e martuar me ish-bashkëshortin, legjislatori sigurisht në respektimin e të drejtës për tu martuar ka parashikuar që nëse bashkëshorti/tja është martuar pas shpalljes së vdekjes së partnerit, personi i shpallur i vdekur që rezulton gjallë nuk mund ta rifitoj martesën.

Nëse legjislatori në Shqipëri nuk e ka elaboruar në mënyrë të zgjeruar institutin e rimartesës, në Kodin e Familjes së shtetit të Kosovës është parashikuar në mënyre eksplicite edhe rimartesa në kushtet e një martese të mëparshme ende të vlefshme ligjrisht.

Nëse një shtetas lidh një martesë të re, në kohën kur ende është e vlefshme ligjrisht martesa e mëparshme, atëherë martesa e re është absolutisht e pavfshme, ose nul²⁸¹, përjashtimisht në rastin kur martesa e mëparshme është zgjidhur ndërkohë që konstatohet ekzistenca e saj, citojmë *“Martesa e re e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët nuk do të anulohet, nëse martesa e mëparshme është zgjidhur ndërkohë”*²⁸².

Në rastin e vdekjes së bashkëshortit, apo vdekjes së tij ligjore me vendim gjykate, kur ky bashkëshort ka lidhur martesë ndërkohë që nuk ka zgjidhur një martesë të mëparshme ligjrisht legjislatori ka parashikuar se *“Kur të dy martesat zgjidhen njëkohësisht për shkak të vdekjes së bashkëshortit i cili ka hyrë në*

*martesë të re duke qenë i martuar me person tjetër, martesa e re do të anulohet, përveç në rastet kur martesa e re ka zgjatur për disa vite, dhe kur bashkëshorti nga martesa e mëparshme nuk ka ndërmarrë veprime për të rithemeluar bashkësi martesore dhe bashkëjetesë.”*⁵⁰

Në interpretim të zgjedhur të normës juridike do të themi se, ky status do të ishte për martesat edhe në rastin e zgjidhjes së tyre për shkak të vdekjes natyrore të bashkëshortit dhe në rastin e vdekjes së supozuar, për sa kohë që legjislatori ka parashikuar se vdekja e supozuar barazohet në pasojë me vdekjen natyrore.

Ndërkohë që Kodi Civil Italian ka parashikuar se vetëm pasi vendimi gjyqësor që shpall vdekjen e supozuar është bërë i ekzekutueshëm, bashkëshorti/tja mund të martohet përsëri.

Personi, vdekja e të cilit është deklaruar e supozuar, kthehet ose ekzistenca e tij provohet, vërtetohet, merr pasurinë në gjendjen në të cilën ato gjendjen dhe ka të drejtë të marrë edhe vlerën e pasurive të tjetërsuara, ose pasuritë e investuara. Ai/ajo mund të kërkoj përmbushjen e detyrimeve që janë shuar me shpalljen e vdekjes së tij.

Nëse data e vdekjes së tij vërtetohet dhe është ndryshme nga ajo e shpalljes me vendim gjykate e drejta e tashgimisë u takon atyre që në atë datë do të kishin qenë trashgimtarët ose legatarët e tij. Deklarimi i ekzistencës së personit, vdekja e të cilit është deklaruar e supozuar dhe verifikimi i vdekjes mund të bëhet në çdo kohë nga prokurori publik ose nga çdo i interesuar, në prani të të gjithë atyre që ishin kur u shpall vendimi për vdekjen e supozuar.

Por në ndryshim nga Kodi Civil shqiptar në Kodin Civil Italian martesa e lidhur pas shpalljes

²⁸⁰ Të drejtat pasurore dhe grua, Anastasi.A; Mandro.A, Saliaj.E, fq.19

²⁸¹ Pika 1, neni 62 i Kodit të Familjes së Kosovës “Martesa e lidhur në kohën e ekzistimit të martesës së mëparshme të njërit nga bashkëshortët është nule”

²⁸² Po aty, pika 2, neni 62 e Kodit të Familjes së Kosovës ⁵⁰ Po aty, pika 3

së vdekjes së supozuar është e pavlefshme nëse personi vdekja e të cilit është deklaruar e supozuar kthet ose ekzistenca e tij vërtëtohet²⁸³, por pasojat civile të kësaj martese ruhen⁵². Martesa e re nuk shpallet e pavlefshme në rastin kur vërtetohet vdekja edhe nëse ajo ka ndodhur në një datë pas asaj të martesës së re.

Konkluzione dhe rekomandime

- Martesa është bashkëjetesa ligjore, e cila mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe mirëkuptimit reciprok, si baza e unitetit në familje.
- Kodi Civil i vitit 1929 përbënë ndoshta dokumentin e parë ligjor i cili rregulloi marrëdhëniet civile dhe kryesisht ato familjare, por ndryshimet e rregjimit politik do të çonin në humbjen e statusit juridik të këtij dokumenti dhe sot ky dokument mund të studiohet vetëm për efekt krahasimi me kodin aktual, edhe pse nën zë shumë studiues pohojnë së ka qënë një ndër dokumentet/aktet ligjore më të plotë edhe shumë avangard për kohën.
- Martesa si institut në Republikën e Shqipërisë rregullohet nga Kodi i Familjes miratuar me Ligjin nr. 9062, datë 8.5.2003 "Kodi i Familjes" dhe në të parashikohen disa kushte dhe kriteret për të pasur një martesë të ligjshme dhe të vlefshme, siç janë zotësia për të vepruar, mosha, vullneti për të lidhur martesë, monogamia, etj.
- Detyrimet që lindin nga martesa duhet të zbatohen vullnetarisht dhe me mirëkuptim

midis palëve në respektimit të të drejtës për familje dhe unitetit familjar.

- E drejta për martesë është një e drejtë kushtetuese e garantuar nga akti më i lartë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e një burri dhe një gruaje për tu martuar, në respektim të unitetit familjar dhe ndihmës së ndërsjellë midis partnerëve dhe garantohej gjithashtu nga aktet ndërkombëtare ku Shqipëria ka aderuar siç është Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Format e zgjidhjes së martesës të njohur nga legjislacioni në fuqi janë:

1. Zgjidhja e martesës.

- Me vdekjen e njërit prej bashkëshortëve, ose me shpalljen e vdekjes së supozuar të njërit prej tyre.
- Me anullim të aktit të martesës.

Mbarimi i martesës nëpërmjet shpalljes së vdekjes së partnerit me vendim gjykatë përveç se kërkon një procedurë të mirëpërcaktuar përpara disponimit me vendim të vdekjes së supozuar, kërkon edhe një afat kohor nga momenti i shpalljes së zhdukur deri në marrjen e vendimit për vdekjen e prezumuar dhe legjilacioni shqiptar parashikon 2 vjet nga mosgjeteja e tij për shpalljen të zhdukur dhe 4 vjet pas shpalljes së zhdukur për ta shpallur atë të vdekur.

Vdekja e supozuar barazohet me pasojat dhe me gjithë të drejtat dhe detyrimet e partnerit të mbetur me vdekjen natyrore.

Vendimi për vdekjen e supozuar është edhe vendimi për zgjidhjen e martesës pothuaj në të gjitha shtetet demokratike, përjashtimisht për disa shtete myslimane që nuk e barazojnë

²⁸³ Neni 68 Kodit Civil Italian

<https://www.madonnas.it/PISA/C>

[ORSI/TP/codice_civile.pdf](https://www.orsi.it/TP/codice_civile.pdf) ⁵² Po

aty

vjekjen e prezumuar me shkakun për zgjidhjen e martesës dhe shpesh grave myslimane nuk u lejohet që të rimartohen.

- Shteti duhet të luaj një rol aktiv me veprimet e tij për të obserbuar dhe vlerësuar të gjitha format për gjetjen e personave të shpallur të zhdukur dhe pasi janë rezauruar të gjitha mundësitë për të gjetur gjallë individin ose për të gjetur trupin e tij, atëherë gjykata mund të disponoj me vendim vdekjen e personit.

- Lëvizja e shpesht e njerëzve, luftrat, aksidentet detare, uzurpimet, etj., kanë qënë disa nga dukuritë të cilat kanë motivuar shtetet për të rregulluar me akte të posaçme dhe të njohura nga shtetet për vlerësimin ligjor të statusit “të zhdukur” dhe më pas “të vdekur” të individit dhe të shpalljes së datës, ditës dhe orës së vdekjes së supozuar. Vdekja e supozuar me vendim gjykatë sjellë pasojat ligjore pas hyrjes në fuqi të vendimit që e shpall atë të vdekur dhe martesa konsiderohet e zgjidhur me hyrjen në fuqi të vendimit.

- Personi i cili deklarohej i/e ve pas disponimit me vendim të vdekjes së supozuar të partnerit ka të drejtë të rimartohet nëse i) vendimi për zgjidhjen e martesës ka hyrë në fuqi, ii) ka zotësi për të vepruar, iii) nuk ka një kohë pritje kryesisht për gratë shtatëzanë për të vërtetuar atësinë e fëmijës, përpara lidhjes së një martese të re.

- Regjime të ndryshme kanë rregulluar në aktet e tyre ligjore procedurën për zgjidhjen e martesës dhe hyrjen në një martesë të re, procedurë e cila kërkohet për vlefshmëri dhe ligjshmëri të martesës apo të rimartesës. Martesa gëzon mbrojtje të veçantë nga shteti në çdo shtet demokratik.

- Zgjidhja e martesës nënkupton edhe fundin e një bashkimi civil, prandaj pasojat e vdekjes së supozuar zgjidhen sipas legjilacionit për ndarjen e një bashkimi civil

dhe vdekja e supozuar ka të njëjtat pasojat ligjore me vdekjen natyrore.

- Në rast se bashkëshorti i shpallur i vdekur shfaqet ose vërtetohet së është gjallë ai, ose çdo person i intersuar mund të kërkojë anulimin e vendimit të shpalljes së vdekur dhe rregullimin e pasojave nga ky vendim. Partneri i shpallur i vdekur përveç se merr statusin e tij civil, dokumentet e identifikimit, merr edhe të gjitha pasuritë e tij që do të kishte nëse do të ishte gjallë në momentin e shpalljes së vendimit dhe nëse pasuritë janë tjetërsuar të marrë dëmshpërblimin ose investimin e kryer me to. Në rast se vërtetohet vdekja faktike e tij atëherë vendimi do të rregulloj pasojat për trashgimtarët nga momenti i konstatimit të vdekjes.

- Bashkëshorti i shfaqur pas shpalljes së vdekjes me vendim gjykatë mund të kërkojë të drejtat e tij pasurore dhe të drejtat e tij mbi fëmijet por nuk mund të rifitoi bashkëshortin/ten nëse ky i fundit është rimartuar, ka hyrë në një marrëdhënie të re. Përgjithësisht në shtetin Italian i cili konsideron martesën e re të pavlefshme, por pasojat e kësaj martese të vlefshme.

- Vendimi për shpalljen e vdekjes dhe zgjidhjen e martesës depozitohet gjithmonë në zyrat e gjendjes civile e cila reflekton në aktet civile/administrative statusin e individëve.

- Martesa me elementë të huaj ka bërë që shtete të ndryshme si Italia të kërkojnë nga partneri që nuk është shtetas italian dokumentin që provon se në shtetin e tij të origjinës nuk është një një lidhje martesë në momentin e lidhjes së martesës në këtë shtet.

- Pasojat e zgjidhjes së martesës, vejania, trashgimi dhe regjimi pasuror rregullohet me ligjet e posaçme të çdo shteti, si dhe vlefshmëria e një rimartese rregullohet nga norma specifike të çdo shteti.

- Gjykata Europiane e Të Drejtave të Njeriut është treguar e kujdesshme në rastin e trajtimit të së drejtës për martesë në radhët e çifte me të njëjtën gjini, në interpretim të ndërthurur të së drejtës për një jetë private dhe personale dhe të drejtës për martesë, ku ka nënvizuar se është

- e drejtë e shteteve anëtare të rregullojnë dhe harmonizojnë legjislacionin kombëtar duke u siguruar shtetasve të drejtën për jetë private, por pa cënuar dhe diskriminuar të drejtën për martesë edhe brenda çifteve me të njëjtën gjini. Sipas GJEDNJ-së është detyrë e shtetit të sigurojë mbrojtje ligjore për familjen dhe garanci për partnerët.

- Martesa me elementë të huaj ka sjellë nevojën për përditësime të akteve ligjore dhe nënligjore dhe kërkon gjithashtu leximin dhe interpretimin më të zgjeruar të normave juridike mbi të drejtën për jetë private, të drejtën për martesë, të drejtën për tu rimatuar nëse gjykata ka disponuar me vendim vdekjen e bashkëshortit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e personit që me vendim gjykate është shpallur i vdekur ose për të ka lajme që jeton ose ka vdekur në një datë tjetër nga ajo e vendosur në vendimin e gjykatës.

- Përditësimin e kuadrit ligjor aktual për familjen, duke mbajtur në konsideratë që ligji për familjen në Shqipëri është miratuar në vitin 2003 dhe pas gati dy dekadave zbatimi në praktikë i tij ka diktuar nevojën adekuate për ndryshime në përshtatje të tij edhe me detyrimet që lindin nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, por edhe përshtatje me legjilacionet e vendeve fqinje.

- Antarësimi në Bashkimin European do të sjellë si nevojë edhe harmonizimin e legjislacionit të brendshëm për familjen me legjislacionin european, por kryesisht çështetjet familjare janë tema që nuk mund të

shkëputen lehtësisht nga tradita, zakoni apo prejardhja.

- Sistemet Cammon Law dhe Civil Law mund të themi që kanë elementë të ngjashëm lidhur me kriteret për lidhjen e një martese të re pas konstatimit të vdekjes së supozuar të partnerit, por ndryshimet mund të themi që kemi të sistemet fetare pasi ka ende besime fetare që nuk e lidhin zhdukjen e një personi me shkakun për zgjidhjen e martesës ashtu siç kemi kushte dhe kriteret të ndryshme, apo edhe afate kohore të ndryshme për ta shpallur një person të vdekur apo të zhdukur. P.sh, shkollat islame, duke pasur në fokus individin, për ta gjetja e personit ose e trupit të tij ka më shumë rëndësi sesa shpallja e tij e vdekur me një vendim gjykate.

- Për të pasur një zhvillim të qendrueshëm të martesës dhe të jetës legjislacioni duhet të rregulloj edhe momentin e shpalljes së vdekjes së një personi edhe kushtet dhe kriteret për një martesë të re, pa cënuar të drejtën e asnjë individi pa përjashtim.



BULETINI SHKENCOR